Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti _______________, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, ka caktuar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale të të akuzuarve _____________________________ dhe ___________________________, për datën __________________, mirëpo në ketë seancë është konstatuar së i akuzuari _________________, nuk e kishte pranuar thirrjen, ndërsa sipas fletë kthesës rezulton së ky i pandehur nga muaji Janar i vitit __________, e ka lëshuar Kosovën dhe tani është duke jetuar në ________________.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të Prokurorit të shtetit ____________, të akuzuarit ______________ dhe mbrojtësit të tij __________________, të cilët nuk e kanë kundërshtuar veçimin e procedurës penale, gjeti se në ketë çështje penale duhet të veçohet procedura penale për të akuzuarin __________________, për të cilin do të zhvillohet procedurë penale e veçantë pasi që të bëhet sigurimi i prezencës së tij në gjykatë.

Ky aktvendim vjen për shkak se sipas fletë kthesës, i akuzuari __________________, nuk jeton në Kosovë por në _________________ dhe i njëjti nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e tij të re në __________________, andaj, për momentin, është e pa mundur që të sigurohet fletë kthesa e konfirmuar për prezencën e tij në gjykatë, për të mbajtur gjykim të përbashkët me të akuzuarin __________________, i cili është

përgjigjur në mënyrë të rregullt ndaj ftesës dhe është i pajtimit që procedura të veçohet dhe të vazhdohet më shqyrtimin gjyqësor.

**Kryetari i trupit gjykues**
**N.N.**

______________________________

**________.nr._______**

**GJYKATA E APELIT NË __________________ -** Departamenti për krime të rënda; Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: ____________, kryetar dhe ________________, dhe ______________ anëtarë, me sekretaren juridike ____________, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________, nga neni ____________, i KPRK-së, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në _________________ dhe Gjykatës Themelore në _______________, në bazë të nenit __________ të KPPK, më datën _______________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Si Gjykatë kompetente për të zhvilluar procedurën penale në çështjen penale ______, nr.______, kundër të pandehurit _____________________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni ______, i KPRK-së, CAKTOHET Gjykata Themelore në _________________, Departamenti ___________________________.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda është paraqitur Aktvendimi për fillimin e hetimeve i Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, kundër të pandehurit ________________, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, i KPRK-së.

Pas pranimit të Aktvendimit për fillimin e hetimeve, Gjykata Themelore në ____________________ ka mbajtur edhe seancën për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit _________________ dhe pastaj shkresat e lëndës ia ka dërguar Gjykatës Themelore në ________________, në kompetencë të mëtejme, duke konsideruar se për këtë çështje penale është kompetente Gjykata Themelore në _________________, me arsyetim se i pandehuri _______________, veprimet e tij inkriminuese i ka kryer edhe në territorin e komunës së ___________________, për të cilin territor është kompetente Gjykata Themelore në ___________________.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, Gjykata Themelore në _____________, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Apelit për të hapur konfliktin e kompetencës dhe për të vendosur se cila gjykatë është kompetente për këtë çështje penale, ndërsa si arsyetim ka përmendur faktin se kjo gjykatë nuk është kompetente, duke marrë parasysh se Prokuroria Themelore në _____________, ka paraqitur Aktvendimin për fillimin e hetimeve, së pari në Gjykatën Themelore në ___________, e jo në ketë gjykatë.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës së Gjykatës Themelore në _________________ dhe marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit i cili është kompetent për të vepruar para gjykatës Themelore në _____________, (mund të jetë edhe të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave dhe të pandehurit apo mbrojtësit të tij) gjeti se:

Për të zhvilluar procedurën në këtë çështje penale, kompetente është Departamenti _________________ i Gjykatës Themelore në ________________.

Kjo vije për shkak se në bazë të nenit __________, të KPPK-së, kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet, apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, kompetente është ajo gjykatë e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje ndaj kërkesës së Prokurorit të autorizuar, andaj duke marrë parasysh se Gjykata Themelore në _________________, e ka filluar procedurën e para në bazë të aktvendimit dhe kërkesës për caktimin e paraburgimit të Prokurorit të shtetit, në rastin konkret e njëjta gjykatë është kompetente për të vazhduar procedurën penale.

Në bazë të nenit 37, par. 6, të KPPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**GJYKATA E APELIT NË ____________________**
**DEPARTAMENTI____________________**
**__________, NR. _______, më datë ____________**

**Kryetari i Kolegjit**
**N.N.**
**________________________**

**______, nr.___________**

**GJYKATA THEMELORE NË** ___________________________, Kryetari i gjykatës ____________, me sekretaren juridike ____________, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale __________________, nga neni ____________, i KPRK-së, duke vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës në mes të Departamentit të krimeve të rënda dhe Departamentit të përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në _____________, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Si departament kompetent për të zhvilluar procedurën penale në çështjen penale ______, nr.____ kundër të pandehurit ______________, për shkak të veprës penale _____________________, nga neni ______, të KPRK,-së, CAKTOHET Departamenti ________________________.

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda, është paraqitur aktvendimi për fillimin e hetimeve i prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, PP___, nr._____/_____, të datës ___________, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, të KPRK-së.

Pas pranimit të Aktvendimit për fillimin e hetimeve, gjyqtari i çështjes në Departamentin e krimeve të rënda _________________, ia ka dërguar Departamentit të përgjithshëm aktvendimin e sipërpërmendur, së bashku me shkresat tjera të bashkangjitura në kompetencë të mëtejme duke konsideruar se për këtë çështje penale nuk është kompetent Departamenti i krimeve të rënda por Departamenti i përgjithshëm.

Gjyqtari në Departamentin e përgjithshëm të kësaj gjykate, _____________, ka paraqitur kërkesë për të hapur konfliktin e kompetencës dhe për të vendosur se cili departament është kompetent për këtë çështje penale.

Kryetari i Gjykatës Themelore në _______________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së gjyqtarit në Departamentin e përgjithshëm, _____________, gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar** dhe së kompetent për të zhvilluar procedurën në këtë çështje penale është Departamenti _________________, i kësaj gjykate.

Kërkesa është e bazuar për shkak se në bazë të nenit __________, të KPPK-së, si dhe nenit __________, të Ligjit për Gjykatat, për çështjet penale ku është paraparë dënimi me burgim prej ______________, kompetente për të vendosur është Departamenti _____________. Meqenëse të pandehurit i vihet në barrë vepra penale ___________, nga neni ________, të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi me burgim prej ________, deri _________, kompetente për të zhvilluar procedurën penale është Departamenti ___________, e jo Departamenti _____________ i kësaj gjykate.

**Kryetari i Gjykatës**
**N.N.**
______________________

**_____, nr.___/_____**

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**, Departamenti _____________, trupi gjykues i përbërë nga __________________ si kryetar dhe _____________ dhe ___________, si anëtarë _____________, me sekretaren juridike ____________ si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit _____________, për shkak të veprës penale ______________, nga neni ____________, të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kundërshtimin për shkak të mungesës së kompetencës territoriale të të akuzuarit ______________ dhe mbrojtësit të tij ________________, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR MUNGESË TË KOMPETENCËS**

Refuzohet si i pabazuar kundërshtimi i përbashkët i të akuzuarit _________________ dhe mbrojtësit të tij ________________, për shkak të mungesës së kompetencës territoriale të Gjykatës Themelore në _________________ dhe dërgimin e shkresave të lëndës në Gjykatën Themelore në _______________________.

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në _________________, Departamenti _______________, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, ka caktuar mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale të të akuzuarit _________________, për datën _________________, mirëpo në fillim të shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari _________________ dhe mbrojtësi i tij __________________, kanë paraqitur kundërshtim të përbashkët lidhur me mungesën e kompetencës territoriale të kësaj gjykate dhe kanë kërkuar që shkresat e lëndës t'i dërgohen Gjykatës Themelore në _________________ si gjykatë kompetente.

Trupi gjykues, pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, gjeti se kundërshtimi i përbashkët i të akuzuarit ________________ dhe mbrojtësit të tij _________________, për shkak të mungesës së kompetencës territoriale të Gjykatës Themelore në _______________ dhe dërgimin e shkresave të lëndës në Gjykatën Themelore në _________, është i pabazuar.

Kërkesa është e pabazuar për shkak se sipas nenit ________, të KPPK-së, pasi aktakuza të marrë formë të prerë, gjykata nuk mund të shpallë veten jokompetente në pikëpamje territoriale dhe palët nuk mund të paraqesin kundërshtim për shkak të mungesës së kompetencës territoriale.

**Kryetari i trupit gjykues**
**N.N.**

__________________________

**_____, nr.________**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________**, Kryetari i gjykatës _____________, me sekretaren juridike ____________ si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ____________, nga neni __________, i KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit të procedurës paraprake _____________, në bazë të nenit __________ të KPPK-së, më datën _______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET kërkesa për përjashtim të gjyqtarit të procedurës paraprake _____________, nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në çështjen penale ____, nr._____.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda, më datë _____________, është paraqitur aktvendimi për fillimin e hetimeve nga prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________________, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, i KPRK-së.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, pas pranimit të aktvendimit, për fillimin e hetimeve, ka paraqitur kërkesë për përjashtim, me arsyetim se ______________________________ _______________________________________.

Kryetari i Gjykatës Themelore në _______________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për përjashtim të gjyqtarit të Procedurës Paraprake gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar** dhe është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i gjyqtarit të procedurës paraprake ________________, nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në çështjen penale të PPRKR-së, nr._______.

Kërkesa është e bazuar për shkak se __________________________________.

Në bazë të nenit __________, të KPPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI ____________________________**
**_______, nr._________, më datë ______________**

**Kryetari i gjykatës**
**N.N.**
**______________________**

**_____, nr.______**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________**, Kryetari i gjykatës _____________, me sekretaren juridike ____________, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit ________________________, për shkak të veprës penale ______________, nga neni ____________, të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _________________, për përjashtimin e gjyqtarit ____________, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit ________________ avokatit ____________________, ashtu që gjyqtari i procedurës paraprake ________________, përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në çështjen penale ______, nr._______.

Lënda i dorëzohet në punë të mëtejme gjyqtarit te procedurës paraprake të kësaj gjykate _______________.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda, më datë ______________, është paraqitur aktvendimi për fillimin e hetimeve nga prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, i KPRK-së.

Më datë ______________________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit______________________.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, pas pranimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, ka caktuar seancën dëgjimore për caktimin paraburgimit më datë ____________, në ora _______.

Para fillimit të seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit, mbrojtësi i të pandehurit, avokati _____________, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, me arsyetim se ________________________________________ _______________________________________________.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, pas pranimit të kërkesës për përjashtim, ka paraqitur deklaratë lidhur me këtë kërkesë dhe ka deklaruar se _________________________ _____________________________________________________________.

Kryetari i Gjykatës Themelore në _______________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, si dhe deklaratës së gjyqtarit të procedurës paraprake, gjeti se:

Kërkesa për përjashtim është e bazuar dhe së është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i gjyqtarit të procedurës paraprake _____________________, nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në çështjen penale ______, nr.________.

Ky përjashtim vjen nga shkaku se ___________________________________________ __________________________.

Nga sa u tha më sipër, në bazë të nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të nenit _________, të KPPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI _____________________________**
**________, nr._________, më datë ______________**

**Kryetari i gjykatës**
**N.N.**
______________________

**_____, nr._____**

**GJYKATA E APELIT NË _______________**, Kryetari i gjykatës ____________, me sekretaren juridike ______________ si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit ________________, për shkak të veprës penale _____________, nga neni ____________, i KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _________________, për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në ______________________, në bazë të nenit _______________, të KPPK-së, më datën _______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET kërkesa e avokatit __________________________, që mbron të pandehurin _________________ për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në ___________, për ushtrimin e funksionit gjyqësor, në çështjen penale _____________, nr.__________.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti _________________, më datë _____________, është paraqitur aktvendimi për fillimin e hetimeve nga prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, të KPRK-së.

Më datë ___________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit _____________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas pranimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, ka caktuar seancën dëgjimore për caktimin paraburgimit më datë ____________, në ora _______.

Para fillimit të seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit, mbrojtësi i të pandehurit avokati _____________, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kryetarit të Gjykatës Themelore në ____________, me arsyetim se ______________________________________________________________________________________________________________________________.

Kryetari i Gjykatës Themelore në _________________, pas pranimit të kërkesës për përjashtim, ka paraqitur deklaratë lidhur më këtë kërkesë dhe ka deklaruar se ________ _______________________________________.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, si dhe deklaratës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në _____________ gjeti se:

Kërkesa është e pabazuar dhe nuk është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në ____________________, nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në çështjen penale _________, nr._________.

Kërkesa është e pabazuar për shkak se ________________________________________ _______________, andaj në këtë rast, nuk mund të krijohet ndonjë perceptim lidhur me pavarësinë dhe paanëshmërinë e kryetarit të Gjykatës Themelore.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**
**__________, nr.____________, më datë__________.**

| | |
|---|---|
| **Procembajtës** | **Kryetari i gjykatës së Apelit** |
| **N.N.** | **N.N.** |
| _________________ | _________________________ |

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë te Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, nëpërmjet Gjykatës Themelore në _________________, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së kopjes së këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në ____________________, në çështjen penale të të pandehurit _____________________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni _________________, të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit ________________, për përjashtimin nga ndërmarrja e veprimeve procedurale, PP__, nr.______________, të datës_____________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, më datën _____________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR PËRJASHTIMIN E PROKURORIT**

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ________________________, përjashtohet nga ndërmarrja e veprimeve procedurale në çështjen penale PP__, nr.______________, kundër të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale _________________, nga neni ____________, të KPRK-së.

Lënda i dorëzohet në punë të mëtejme prokurorit të shtetit ________________, në ketë prokurori.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**A r s y e t i m**

Me kërkesën, PP__, nr.___________, të datës _____________, prokurori i shtetit në këtë prokurori, _________________, ka kërkuar që të përjashtohet nga ndërmarrja e veprimeve procedurale në çështjen penale, PP. nr. ___________________, kundër të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale _________________, nga

neni ___________, të KPRK-së, duke cekur si arsye se ai është i dëmtuar nga kryerja e veprës penale në këtë çështje.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit _____________, kam gjetur se:

Kërkesa është e bazuar dhe ai duhet të përjashtohet nga ndërmarrja e veprimeve procedurale në ketë çështje penale, sepse _________________________ (shëno arsyet e përjashtimit).

Nga sa u tha më lart, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në ____________**
**N.N.**
**_____________________________**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________
Më datë ____________

Duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _________________, për përjashtimin e prokurorit të shtetit ____________, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________, marr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR PËRJASHTIMIN E PROKURORIT**

APROVOHET kërkesa e avokatit ___________________________, i cili mbron të pandehurin ________________________, që prokurori i shtetit në këtë prokurori ________________, të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit prokurorial në çështjen penale, PP__, nr._________

Lënda i dorëzohet në punë të mëtejme prokurorit të shtetit në këtë prokurori _____________________.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Drejtoria ______________, në _____________, ka paraqitur kallëzim penal me numër të referencës ________________, më datën kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, të KPRK-së.

Më datë _______________, prokurori i shtetit në këtë Prokurori, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit______________.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, pas pranimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, ka caktuar seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit më datë ____________, në ora _______.

Para fillimit të seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit, mbrojtësi i të pandehurit, avokati _____________, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e prokurorit të shtetit ____________________, me arsyetim se ______________________________ ___________________________________________________.

Prokurori i shtetit __________________, pas pranimit të kërkesës për përjashtim, ka paraqitur deklaratë lidhur me këtë kërkesë dhe ka deklaruar se ____________________ ____________________________________________________________.

Kryeprokurori i shtetit i kësaj prokurorie ______________________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit si dhe deklaratës së prokurorit të shtetit _______________, gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar** dhe është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i prokurorit të shtetit ________________, nga ushtrimi i funksionit prokurorial në çështjen penale, PP. nr._________.

Përjashtimi i prokurorit bëhet për shkak se ____________________________________ ________________________________________________.

Në bazë të nenit __________, të KPPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.

**Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në ____________**
**N.N.**
_____________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit ________________, për përjashtimin e mbrojtësit të viktimës _______________, si dhe në pajtim me nenin ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR PËRJASHTIMIN E MBROJTËSIT**

APROVOHET kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit ______________________,avokatit ________________, për përjashtim të mbrojtësit të viktimave ___________________, ashtu që ai përjashtohet nga ushtrimi i funksionit të mbrojtësit të viktimës ________________, në çështjen penale PPRKR. Nr.______

**A r s y e t i m**

Në Prokurorinë Themelore në ____________________, Departamenti ____________, më datë ___________________, është paraqitur kallëzimi penal kundër të pandehurit ________________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni __________, të KPRK-së.

Pas identifikimit të viktimës së trafikuar _____________________ dhe arrestimit të të pandehurit ________________, Divizioni për mbrojtjen e viktimave, që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit, ka caktuar si mbrojtës të viktimës së trafikuar mbrojtësin _________________.

Mbrojtësi i të pandehurit ________________, avokati ________________, ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e mbrojtësit të viktimave ____________________, që në këtë

çështje penale mbron viktimën e trafikuar ________________, me arsyetimin se ai është _________________.

Prokurori i Shtetit ____________ që është duke i zhvilluar hetimet në këtë çështje penale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për përjashtim të mbrojtësit të viktimave _____________, gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar** dhe është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i mbrojtësit të viktimave ______________, nga ushtrimi i funksionit të mbrojtësit të viktimave, në çështjen penale PPRKR. nr._________, për viktimën _____________.

Sipas nenit _______________ të KPPK-së, mbrojtësi i viktimave përjashtohet kur është ___________________________________, meqenëse mbrojtësi i viktimave ________________, në rastin konkret është ______________, i viktimës _______________, e cila është identifikuar si viktimë e trafikuar në këtë çështje penale, nuk mund të jetë mbrojtës i kësaj viktime, dhe për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

____________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendim është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _____________, nëpërmjet kësaj prokurorie, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së tij.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/ Basic Prosecution Office ____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Departamentit të krimeve të rënda dhe Departamentit të përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në ___________, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________ marr këtë:

## A K T V E N D I M

Si Departament kompetent për të zhvilluar procedurën penale në çështjen penale PP__, nr.______, kundër të pandehurit ____________________, për shkak të veprës penale __________________, nga neni ______, i KPRK-së, CAKTOHET Departamenti për krime të rënda i kësaj prokurorie

## A r s y e t i m

Në Prokurorinë Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda, nga Policia e Kosovës – Drejtoria _____________, është paraqitur kallëzimi penal kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale ____________, nga neni ___________, të KPRK-së.

Pas pranimit të kallëzimit penal, prokurori i çështjes në Departamentin e krimeve të rënda ia ka dërguar Departamentit të përgjithshëm kallëzimin penal së bashku më shkresat tjera të bashkangjitura në kompetencë të mëtejme, duke konsideruar se për këtë çështje penale nuk është kompetent Departamenti i krimeve të rënda por Departamenti i përgjithshëm.

Prokurori i shtetit në Departamentin e përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në ____________, ka paraqitur kërkesë për të hapur konfliktin e kompetencës dhe për të vendosur se cili departament është kompetent për këtë çështje penale.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në ______________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit në Departamentin e përgjithshëm _____________ gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar,** sepse për të zhvilluar procedurën në këtë çështje penale, kompetent është Departamenti për krime të rënda i kësaj prokurorie.

Kërkesa është e bazuar për shkak se në bazë të nenit __________, të KPPK-së, si dhe nenit __________, të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, për çështjet penale ku është paraparë dënimi me burgim prej më tepër se ______ vite, kompetent për të vendosur është Departamenti për krime të rënda. Meqenëse të pandehurit i vihet në barrë vepra penale ___________, nga neni ________, të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi me burgim prej ________, deri _________, për të zhvilluar procedurën penale është kompetent Departamenti për krime të rënda e jo Departamenti i përgjithshëm i kësaj prokurorie.

**Kryeprokurori i**
**Prokurorisë Themelore**
**N.N.**
______________________

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**________________________**

**Adresa:________________**

**_________________________**

**Tel:__________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË _________________**
**PËR PROKURORIN __________________________**

Në bazë të nenit ______________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ____________________, paraqes këtë:

**NJOFTIM**
**PËR TËRHEQJE NGA MBROJTJA E TË PANDEHURIT**
**__________________________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetime, për shkak të veprës penale: __________________________, nga neni ____________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, i pandehuri ________________, më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marr parasysh se pas angazhimit tim si mbrojtës i të pandehurit në ketë çështje penale, ka ardhur deri te paraqitja e rrethanave të reja, të cilat nuk ishin të njohura më parë, në mes tjerash se ________________________________________________, në rastin konkret, unë nuk mund të jem mbrojtës i tij, ngase tani e tutje, më duhet të jem palë e dëmtuar në ketë çështje penale.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**
**N.N.**

**______________________**

**_____.nr.________**

**GJYKATA THEMELORE NË _______________ -** Departamenti _____________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________ si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________, nga neni ____________, i KPRK-së, duke vendosur lidhur më kërkesën e të dëmtuarit ________________________ për përjashtim të avokatit mbrojtës të të pandehurit ________________________, në bazë të nenit __________ të KPPK-së, më datën _______________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET kërkesa për përjashtim të avokatit __________________, nga ushtrimi i funksionit të mbrojtësit për të pandehurin _______________, në çështjen penale _____, nr.______.

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti për krime të rënda më datë _____________, është paraqitur Aktvendimi për fillimin e hetimeve të prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit se ai ka kryer veprën penale ____________, nga neni __________, i KPRK-së.

I dëmtuari _______________, pasi u njoh me fillimin e hetimeve dhe angazhimin e avokatit të të pandehurit _________________, ka paraqitur kërkesë për përjashtim të avokatit _________________. Avokati që në këtë çështje penale mbron të pandehurin _______________, paraqiti arsyetimin se __________________________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, _______________, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për përjashtim të mbrojtësit _______________, gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar** dhe së është e nevojshme që të bëhet përjashtimi i avokatit ________________, nga ushtrimi i funksionit të mbrojtësit në çështjen penale ______, nr._________, për të pandehurin _______________.

Ky aktvendim vjen për shkak se sipas nenit 56 të KPPK-së, mbrojtës nuk mund të jetë personi që ______________________________________________________________.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI __________________________**
**_____, nr._________ më datë _____________**

**Kryetari i gjykatës**
**N.N.**

**____________________**

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendim është e lejuar ankesa pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së tij.

________.nr.________/____

**GJYKATA THEMELORE NË _____________ Kryetari i Gjykatës** ___________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale _______________ nga neni _______________ i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së të pandehurit _________________, për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, me datën _______________, nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR CAKTIMIN E MBROJTËSIT ME SHPENZIME PUBLIKE**

Të pandehurit / të akuzuarit ____________________________ i CAKTOHET mbrojtësi ________________________, me shpenzime publike i cili do ta mbrojë të pandehurin deri në përfundim të procedurës penale

**A r s y e t i m**

Më datën ________________, kundër të pandehurit _________________, Prokuroria Themelore në _______________, ka nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve (ose ka ngritur aktakuzë) për shkak të veprës penale ___________________, nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, të pandehurit i është dërguar ftesa për t'u paraqitur në gjykatë, në gjykimin që do të mbahet më datën ________________, në ora __________, për të marrë pjesë si i pandehur /akuzuar në çështjen penale PPRKR. nr.___________, për shkak të veprës penale të lartpërmendur.

Më datën _________________, i pandehuri / ia akuzuari _________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e mbrojtësit më shpenzime publike deri në përfundim të procedurës penale dhe si arsyetim ka cekur __________________________________ ____________________________.

Gjithashtu, i pandehuri ka shprehur gatishmërinë se është i gatshëm që të __________ ____________________________________________________.

Kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dëshminë ___________________________________.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës së të pandehurit si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, gjen se:

**Kërkesa është e bazuar**.

Kërkesa është e bazuar nga shkaku se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se ____________________________________________________________. (shëno arsyet e aprovimit të kërkesës).

Mbrojtësi ___________________, është caktuar në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, bazuar në memorandumin për bashkëpunim, Nr.__________, të datës __________.

Mbrojtësi është i detyruar që t'i ofrojë mbrojtje profesionale efektive të pandehurit deri në përfundim të procedurës penale, ndërsa i pandehuri është i detyruar që ta njoftojë prokurorinë menjëherë nëse do të ndryshojnë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi.

Nga ato që u thanë më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**________, nr. _________, më datë ______________**

**Sekretarja juridike**
**N.N.**
__________________

**Kryetari i gjykatës,**
**N.N.**
__________________

**_______.nr.________/____**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________, -** Departamenti ___________________, Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale __________________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas ankesës së të pandehurit _________________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në ____________, PP__, nr. ____________, të datës_______________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, me datën ______________, mori këtë:

## A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të pandehurit ___________________, e paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në ______________, PP__, nr. ________________, të dt. _______________, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar VËRTETOHET.

## A r s y e t i m i

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim PP__, nr.________ me të cilin ka refuzuar kërkesën e të pandehurit _______________, për t'ia caktuar mbrojtësin me shpenzime publike.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë i pandehuri ____________, për shkak të ________________________________________________________, me propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e të pandehurit dhe t'i caktohet mbrojtësi me shpenzime publike ose i njëjti aktvendim të prishet dhe lënda t'i kthehet prokurorit të shtetit në rivendosje.

Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të të pandehurit dhe gjeti se:

**Ankesa nuk është e bazuar**.

Pretendimi i të pandehurit se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse ______________________________ ______________________________________________________________________ __________________________, është i pabazuar, sepse aktvendimi i kundërshtuar përmban arsye të qarta lidhur me gjendjen ekonomike dhe mundësitë e pagesës së shpenzimeve të mbrojtësit nga ana e të pandehurit.

Pretendimi i të pandehurit se ______________________________________________ ______________________ nuk mund të merren si të bazuara, sepse i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që mbështesin këtë pretendim e as ndonjë arsyeshmëri tjetër për pamundësinë e pagesës së mbrojtjes nga avokati.

Nga ato që u theksuan më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**_______, nr. _________, më datë ______________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake,**
_________________ _____________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së të pandehurit __________________, për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, në bashkëpunim më Odën e Avokatëve të Kosovës, më datën ____________________ nxjerr ketë:

**AKTVENDIM**
**PËR CAKTIMIN E MBROJTËSIT ME SHPENZIME PUBLIKE**

Të pandehurit _____________________________________, i CAKTOHET mbrojtësi ________________________, me shpenzime publike, i cili do ta mbrojë të pandehurin deri në përfundim të procedurës penale.

**A r s y e t i m**

Më datën ________________, kundër të pandehurit _________________, është nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve për shkak të veprës penale - Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 2, lidhur më paragrafin 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, të pandehurit i është dërguar ftesa për t'u paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit, më datën _______________, për të dhënë deklaratë lidhur më dyshimin se ka kryer veprën e lartcekur penale.

Më datën _________________, i pandehuri __________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, deri në përfundim të

procedurës penale dhe si arsyetim ka cekur ___________________(shëno arsyet e cekura nga i pandehuri në lidhje më paaftësinë e pagesës së shpenzimeve të mbrojtjes së tij/saj dhe provat mbështetëse).

Gjithashtu, i pandehuri ka shprehur gatishmërinë se është i gatshëm që të japë deklaratë lidhur me gjendjen e tij ekonomike, pasurinë e tij dhe pamundësinë për të përballuar shpenzimet për angazhim të mbrojtësit.

Kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dëshmitë______________.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës së të pandehurit si dhe në bashkëpunim më Odën e Avokatëve të Kosovës, gjen se:

Kërkesa është e bazuar.

Kërkesa është e bazuar për shkak se në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se ____________________(shëno arsyet në lidhje më paaftësinë e pagesës së shpenzimeve të mbrojtjes nga i pandehuri dhe provat mbështetëse).

Mbrojtësi __________________, është caktuar në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, bazuar në memorandumin për bashkëpunim, Nr._________ të datës __________.

Mbrojtësi është i detyruar që t'i ofrojë mbrojtje profesionale efektive të pandehurit deri në përfundim të procedurës penale, ndërsa i pandehuri është i detyruar që të njoftojë prokurorinë menjëherë nëse do të ndryshojnë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**_____.nr.____/______**

**Prokurorisë Themelore në ___________**
**Departamentit _____________________**
**P ë r:**

**Prokurorin _______________**

Kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit, të Prokurorisë Themelore në ___________, _____, nr._________, të datës ____________, në çështjen penale të të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale ___________________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në afatin ligjor, paraqes këtë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të _______________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa ime për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike ose aktvendimi të prishet dhe lënda t'i kthehet prokurorit të shtetit në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Kundër meje, janë duke u zhvilluar hetime për shkak veprës penale: ______________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datën______________, kam paraqitur kërkesë te prokurori i shtetit për të ma caktuar mbrojtësin me shpenzime publike, sepse nuk kam mundësi ekonomike për të paguar vetë shpenzimet për mbrojtës.

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim _____, nr.________, me të cilin ka refuzuar kërkesën time për të caktuar mbrojtësin me shpenzime publike, me arsyetim se _________________________________________________________.

Konsideroj se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban shkelje _________________, sepse _________________________________________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, konsideroj se gjyqtari i procedurës paraprake, do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_____________________

**PROKURORIA THEMELORE NË __________**
**PROKURORIT TË ÇËSHTJES__________________**

I nderuari z. Prokuror,

Më datën ____________________, kam pranuar ftesën që ma keni dërguar për t'u paraqitur në Zyrën tuaj, më datën _________________, në ora ________, për të dhënë deklaratë në çështjen penale, PP____, nr._________, lidhur me veprën penale ____________________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim deri në __________ vite.

Gjithashtu, më keni njoftuar se unë mund të angazhoj mbrojtës në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh se __________________________________________, kërkoj nga Ju që në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të ma caktoni një mbrojtës me shpenzime publike.

Unë jam i gatshëm që para jush, të japë deklaratë lidhur me gjendjen time ekonomike, pasurinë time dhe pamundësinë për t'i përballuar shpenzimet për angazhimin e mbrojtësit.

**I pandehuri**
**N.N.**

______________________

**GJYKATËS THEMELORE NË __________**
**KRYETARIT TË GJYKATËS z. __________________**

I nderuari z. Kryetar,

Më datën ____________________, kam pranuar ftesën që ma ka dërguar kryetari i trupit gjykues - gjyqtari ___________________, për t'u paraqitur në gjykatë, më datën_________________, në ora ________, në gjykimin tim si i akuzuar në çështjen penale ________, nr._________, lidhur me veprën penale ________________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për të cilën është parashikuar dënimi me burgim deri në ________________ vite.

Gjithashtu, më kanë njoftuar se unë, mund të angazhoj mbrojtës në këtë çështje penale

Duke marrë parasysh ________________________________________________, kërkoj nga ju që të në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të ma caktoni një mbrojtës me shpenzime publike, i cili do të më mbrojë gjatë kohës sa zgjatë procedura penale kundër meje.

Unë jam i gatshëm që para jush ose personit që ju e autorizoni, të japë deklaratë lidhur me gjendjen time ekonomike, pasurinë time dhe pamundësinë për përballuar shpenzimet për angazhim të mbrojtësit.

**I pandehuri**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së të pandehurit _______________, për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, nxjerr ketë:

**AKTVENDIM**
**PËR CAKTIMIN E MBROJTËSIT ME SHPENZIME PUBLIKE**

**REFUZOHET** kërkesa e të pandehurit _________________________, për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike

**A r s y e t i m**

Më datën ________________, kundër të pandehurit _______________________, është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve për shkak të veprës penale __________________, nga neni _________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, të pandehurit i është dërguar ftesa për t'u paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit më datën ______________, për të dhënë deklaratë lidhur me dyshimin se ka kryer veprën e lartcekur penale.

Më datën _________________, i pandehuri _______________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, deri në përfundim të procedurës penale dhe si arsyetim ka cekur ____________________________. (shëno arsyet e cekura)

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së të pandehurit, gjen se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Kërkesa nuk është e bazuar për shkaku se _______________________. (shëno arsyet e refuzimit të kërkesës)

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _________________, - Departamentit _____________, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së të pandehurit _______________, për shkarkimin e mbrojtësit me shpenzime publike, më datën ____________________ nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR SHKARKIMIN E MBROJTËSIT ME SHPENZIME PUBLIKE**[1]

Mbrojtësi _______________________, i caktuar me Aktvendimin PP__, nr.________, të datës ______________, për mbrojtjen e të pandehurit ________________, me shpenzime publike, shkarkohet nga detyra për të mbrojtur këtë të pandehur në ketë çështje penale.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

**A r s y e t i m**

Më datën ________________, kundër të pandehurit ___________________________, është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve për shkak të veprës penale - ____________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

---

[1] Aktvendim më formë të njëjtë mund të nxjerret edhe nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, kurse në procedurën e apelit nga kryetari i kolegjit të apelit të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme

Më datën _______________, të pandehurit i është dërguar ftesa për t’u paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit më datën _______________, për të dhënë deklaratë lidhur me dyshimin se ka kryer veprën e lartcekur penale.

Më datën ________________, i pandehuri _________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike deri në përfundim të procedurës penale dhe si arsyetim ka cekur ___________________________________ _________________________.

Gjithashtu, i pandehuri ka shprehur gatishmërinë se është i gatshëm që të japë deklaratë lidhur me gjendjen e tij ekonomike, pasurinë e tij dhe pamundësinë për përballuar shpenzimet për angazhim të mbrojtësit. Kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dëshminë _________________________________.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës së të pandehurit si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, Prokurori i shtetit kishte marrë Aktvendim PP.nr.___________, më datë _______________, për caktimin e mbrojtësit _____________________, me shpenzime publike.

Pas caktimit të mbrojtësit të lartcekur, gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, Prokurori i shtetit, është njoftuar nga i pandehuri ________________, se i njëjti tani ka një pozitë më të mirë materiale që ia mundëson angazhimin e mbrojtësit sipas dëshirës së tij me mjetet e tij financiare dhe se për mbrojtës dëshiron të ketë tjetër avokat e jo avokatin që i është caktuar sipas detyrës zyrtare.

Duke marrë parasysh shkresat e lëndës dhe shkresën e të pandehurit sipas të cilës i pandehuri dëshiron të angazhojë mbrojtës sipas dëshirës së tij dhe faktin se tani i njëjti e ka mundësinë financiare për të paguar shpenzimet për angazhimin e mbrojtësit, Prokurori i shtetit ka marrë aktvendim që të shkarkojë mbrojtësin ________________, i cili ishte caktuar sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike, sepse i pandehuri nuk ka më nevojë që të ketë mbrojtës me shpenzime publike

Komform nenit _________, të KPPK, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së të dëmtuarit _______________, për caktimin e përfaqësuesit me shpenzime publike, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, më datën ____________________, nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESIT ME SHPENZIME PUBLIKE[2]**

Të dëmtuarit _________________________, i CAKTOHET përfaqësuesi i autorizuar ________________________, avokat nga _________________, me shpenzime publike, i cili do ta përfaqësojë të dëmtuarin deri në përfundim të procedurës penale.

**A r s y e t i m**

Më datën ________________, kundër të pandehurit _________________, është nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve, për shkak të veprës penale _____________, nga neni _____________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, të dëmtuarit _________________, i është dërguar ftesa për t’u paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit, më datën _______________, për të dhënë deklaratë lidhur me dëmin që i është shkaktuar me veprën e lartcekur penale.

Më datën _________________, i dëmtuari __________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e përfaqësuesit me shpenzime publike deri në përfundim të procedurës penale dhe si arsyetim ka cekur se ___________________________________________

[2] Një formë e tillë e aktvendimit mund të nxjerr edhe Gjykata

____________________________. Kërkesën e tij, i dëmtuari e ka arsyetuar edhe më ____________________________________________________________.

Gjithashtu, i dëmtuari ka shprehur gatishmërinë se është i gatshëm që të japë deklaratë, lidhur me gjendjen e tij ekonomike, pasurinë e tij dhe pamundësinë për të përballuar shpenzimet për angazhim të përfaqësuesit - avokatit. Kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dëshminë për dëmet që i janë shkaktuar me veprën penale.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kërkesës së të dëmtuarit si dhe në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, gjen se:

**Kërkesa është e bazuar**.

Kërkesa është e bazuar për shkak se _________________________________________ ________________________________. (shëno arsyet e aprovimit të kërkesës).

Përfaqësuesi - avokati __________________, është caktuar në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, bazuar në memorandumin për bashkëpunim, Nr._________ të datës_________________.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar që t'i ofrojë përfaqësim profesional dhe efektiv të dëmtuarit, deri në përfundim të procedurës penale, ndërsa i dëmtuari është i detyruar që të njoftojë prokurorinë menjëherë nëse do të ndryshojnë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**_____.nr.____________**

**GJYKATA THEMELORE NË __________________,** Departamenti për krime të rënda, gjyqtari i procedurës paraprake, __________________, me sekretaren juridike ________________, në çështjen penale kundër të pandehurit ________________, për shkak të veprës penale ________________, nga neni _____________, i KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _____________, PP__, nr. _________, të datës. _____________, për gjobitjen e mbrojtësit të të pandehurit, në bazë të nenit ____________, të KPPK-së, me datën _________________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Me aprovimin e kërkesës së prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në _____________, mbrojtësit të të pandehurit ______________, av.______________, i shqiptohet gjoba në shumë prej _________ euro, gjobë të cilën duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi, në xhirollogarinë nr. __________________________, të kësaj gjykate.

Lidhur me gjobitjen e mbrojtësit të njoftohet edhe Oda e Avokatëve të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në _________________________, – Departamenti ________________, ka paraqitur kërkesën për shqiptimin e gjobës për mbrojtësin e të pandehurit _______________, av. ________________, për shkak se ai me veprimet e tij, është duke ndikuar qartë në zvarritjen e procedurës penale, duke iu shmangur ftesave të rregullta për të marrë pjesë në seancën për marrjen e deklaratës nga i pandehuri që është duke e mbrojtur.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i procedurës paraprake gjeti se:

Kërkesa e prokurorit të shtetit është e bazuar.

Ky aktvendim është i bazuar për shkak se sipas shkresave të lëndës, shihet që prokurori i shtetit i kishte dërguar _________________ herë thirrje të rregullt për mbrojtësin e të pandehurit _________________, av. _________________, për të marrë pjesë në seancën për marrjen e deklaratës së të pandehurit që është duke e mbrojtur, mirëpo ai asnjëherë nuk i është përgjigjur ftesës së rregullt dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, ndërsa i pandehuri _____________ ka insistuar që i njëjti mbrojtës të jetë prezentë gjatë kësaj seance dhe së nuk dëshiron që t'i caktohet ndonjë mbrojtës tjetër. Veprimet e tilla të mbrojtësit, konsiderohen si veprime që qartë kanë për qëllim zvarritjen e procedurës penale, për çka ai është gjobitur me shumën ______ euro.

Me rastin e shqiptimit të gjobës, gjyqtari ka pasur parasysh se i pandehuri gjendet në paraburgim dhe mbrojtja është e detyrueshme, dhe se çdo zvarritje mund të dëmtojë interesat e të pandehurit.

Në bazë të nenit ________, të KPPK–së, lidhur me gjobitjen e mbrojtësit, njoftohet edhe Oda e Avokatëve të Kosovës.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË __________**
**DEPARTAMENTI ____________________**
**GJYQATRI I PROCEDURËS PARAPRAKE**
**________.nr ______, më datë ____________.**

| **Sekretarja juridike** | **Gjyqtari i procedurës paraprake** |
|---|---|
| _________________ | ____________________________ |

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 3 (tri) ditësh nga koha e pranimit të kopjes së këtij aktvendimi.

**PKR. nr.______**

**GJYKATA THEMELORE NË** ______________, **-** departamenti _____________, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: ______________, kryetar dhe ____________ dhe ____________ anëtar, në çështjen penale kundër të pandehurit _____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________, nga neni ____________, të KPRK-së, duke vendosur në bazë të nenit __________, të KPPK, më datën _______________ vendosi që të:

**DËRGOHET**

**Për hetim në Prokurorinë Themelore në ______________________, Departamenti _____________, kopja e rastit penal, PKR. nr.________**

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Themelore në _______________, Departamenti ______________, është duke u zhvilluar shqyrtimi gjyqësor kundër të akuzuarit ________________, për shkak të veprës penale __________, nga neni _________, të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, është marrë edhe deklarata e dëshmitarit ______________, si dhe e ekspertit __________________, dhe me këtë rast, dëshmitari ka ndryshuar në tërësi deklaratat që kishte dhënë më herët para policisë dhe prokurorit të shtetit, ndërsa eksperti ka ndryshuar mendimin dhe konstatimin e tij lidhur me çështjen që i është besuar për ekspertim.

Duke konsideruar se në rastin konkret, dëshmitari dhe eksperti kanë kryer veprime që mund të paraqesin elemente të veprave penale nga neni ____________, të KPRK-së, është vendosur që një kopje e shkresave të lëndës, konform nenit ________, të KPPK-së t'i dërgohet për hetim prokurorit të shtetit në mënyrë që të hetohen arsyet e ndryshimit të deklaratave dhe ekspertizës nga ana e dëshmitarit dhe ekspertit, të cilat kanë ndikuar esencialisht në zhvillimin e deri tanishëm të procedurës penale si dhe në të drejtat dhe liritë e palëve në procedurë (të të akuzuarit dhe të dëmtuarit).

**GJYKATA THEMELORE në _________________**
**DEPARTAMENTI______________________**
**PRKR. NR.______, më datë ___________**

**Kryetari i trupit gjykues**
**N.N.**
**_________________________**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**PËR: DREJTORIN/ZYRTARIN E NGARKUAR TË KOMPANISË SË TELEFONISË MOBILE ______________**

**K Ë R K E S Ë**

**Për verifikimin e abonentëve të operatorit të telefonisë mobile ________________.**

Konform nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga punëtoret e autorizuar të operatorit të telefonisë mobile ____________________, në _____________, që zyrtarit të autorizuar të Policisë së Kosovës, _________________, t'i jepen të gjitha informatat me shkrim lidhur më çështjen se a kanë të regjistruar numra që i shfrytëzojnë abonentët, si në vijim: ______________, me numër personal ________________, ______________________ me numër personal ________________, dhe ________________, me numër personal____________.

Përmbajtja e kërkesës është konfidenciale dhe nuk duhet t'i zbulohet personave të paautorizuar.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI _____________________**
**PËR: GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas marrjes së kërkesës së Policisë së Kosovës – Drejtoria ________________, më numër të referencës ______________, të datës ______________, lidhur më zbulimin e të dhënave nga noterët e Kosovës dhe në pajtim me nenet _______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), paraqes këtë:

**KËRKESË PËR LËSHIMIN URDHERIT PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA NOTERËT E KOSOVËS**

**Për të pandehurit, në vijim:**

1. _________________________________, i lindur më datën ___________, në adresën _____________________________________, nr. personal _______________,

2. _________________________________, i lindur më datën ___________, në adresën _____________________________________, nr. personal _______________,

3. _________________________________, i lindur më datën ___________, në adresën _____________________________________, nr. personal _______________,

Të urdhërohet Oda e Noterëve të Kosovës, të bëj, zbulimin e të dhënave tek të gjithë noterët në territorin e Republikës së Kosovës, nëse të njëjtit kanë bërë ndonjë nga shërbimet e mëposhtme, nga data __________, deri më datën __________________.

1. Shërbime për çështje familjare.
2. Shërbime për çështje pronësore.
3. Shërbime për çështje ekonomike dhe të punës.
4. Vërtetimet, legalizimet dhe certifikatat tjera.
5. Ruajtje dhe depozitim të gjërave dhe dokumenteve.

Të dhënat të ofrohen përmes Odës së Noterëve, në një periudhë sa më të shkurtë të mundshme, por jo më larg se më datën _______________, me gjithë kopjet e dokumentacionit përcjellës të aktit noterial.

**A r s y e t i m i**

Pas pranimit të kallëzimit penal nga Policia e Kosovës, me numër të referencës ___________, të datës _____________, prokurori i shtetit, më datë ______________, ka marrë aktvendim, PP__.nr.________________, për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve ________________, _________________dhe ______________________, për shkak të veprës penale - _________________, nga neni _________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të autorizimit të lëshuar nga Prokuroria i Shtetit për verifikimin e prejardhjes së pasurisë, që buron nga vepra penale e lartcekur dhe e cila është në emër të të pandehurve apo familjarëve të tyre, si dhe personave të tjerë, Policia e Kosovës me datën ____________, ka bërë kërkesë tek Oda e Noterëve të Kosovës, për të bërë zbulimin e të dhënave në lidhje me çfarëdo akti noterial që figuron në emër të personave të lartcekur.

Pas marrjes së kërkesës nga Policia, Oda e Noterëve është përgjigjur si në vijim: _______________________________________________________________________.

Gjithashtu, në bazë të zbulimit të të dhënave financiare, me urdhëresën e gjykatës _____, nr.___________, të datës ___________, është vërejtur se të pandehurit kanë fshehur burimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Nga sa u tha më lart, në bazë të nenit _______, të KPPK-së, të gjitha organet publike detyrohen që prokurorit të shtetit, gjykatave dhe organeve tjera kompetente që marrin pjesë në procedurë penale, t'ju japin ndihmën e nevojshme, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale ose vendndodhjen e kryerësve, ndërsa në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, më kërkesën e gjykatës, institucionet dhe personat përgjegjës për mbajtjen e bazës së të dhënave, qoftë edhe pa pëlqimin e personave përkatës, i sigurojnë gjykatës të dhëna nga baza e tyre e të dhënave që i menaxhojnë, kur të dhënat e tilla janë të domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale.

Andaj, në bazë të neneve të lartcekura dhe duke marrë parasysh se në këtë çështje penale ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit ________________________, ________________________ dhe ________________________, kanë kryer veprat penale që ju vihen në barrë dhe faktin se informacionet e marra nga Oda e Noterëve të Kosovës, ka gjasa të ndihmojë në hetimin e veprave penale të kryera nga të pandehurit si dhe për verifikimin e prejardhjes së pasurisë së të pandehurve, i parashtroj kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake që të lëshojë urdhër me të cilin do të urdhërohet Oda e Noterëve të Kosovës, të bëj zbulimin e të dhënave tek të gjithë noterët në territorin e Republikës së Kosovës, nëse të pandehurit kanë bërë ndonjë nga shërbimet e cekura në dispozitiv të kësaj kërkese, nga data __________, deri më datën ____________.

**ZYRTARI ZBATUES I URDHRIT:**

Zyrtarët e policisë ________________ dhe _______________, janë të autorizuar si zyrtarë përgjegjës për zbatimin e urdhëresës. Zyrtari i autorizuar i policisë, mund të delegojë përgjegjësinë e vet te një tjetër zyrtar i policisë, nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tyre. Zyrtarët e policisë, zbatojnë urdhrin, jo më vonë se 15 ditë pas lëshimit të tij.

**KËRKESAT PËR RAPORTIM:**

Urdhëron që zyrtarët e policisë ose një tjetër zyrtar i policisë nën mbikëqyrjen e tyre, të raportojë te gjyqtari i procedurës paraprake që ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit i shtetit mbi zbatimin e këtij urdhri, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh nga data e lëshimit të urdhrit.

Lëshon tri kopje origjinale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Për Policinë e Kosovës – Drejtoria____________, në ______________ - sektorit të Hetimeve të integruara financiare**
**Zyrtarëve policorë: ______________________ dhe ___________________**

**AUTORIZIM**
**PËR VERIFIKIMIN E PREJARDHJES SË PASURISË**

Për shkak se hetimet e deri tanishme por edhe mungesa e dëshmitarëve apo dëshmive tjera që do të mund të vërtetonin prejardhjen e pasurisë ___________________, të cilën i pandehuri ____________________, e ka shfrytëzuar për të kryer veprën penale.

Për të verifikuar prejardhjen e pasurisë së lartcekur, Ju **autorizoj** që të merrni në pyetje personat që mund të kenë ndërlidhje më këtë banesë, duke përfshirë edhe anëtarët e familjes së të pandehurit _______________, sidomos personat për të cilët i pandehuri ________________, e ka autorizimin për xhirollogaritë e tyre bankare apo personat që kanë lidhje me pasurinë e lartcekur, pasuri e cila ia ka mundësuar të pandehurit kryerjen e veprës penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**Autorizim**
**Për verifikimin e identitetit dhe adresave si dhe për marrjen e deklaratave të dëshmitarëve**

Duke marrë parasysh hetimet e deritanishme, kërkoj nga ju që të bëni verifikimin e identitetit të personit me emrin ______________, si dhe adresës së tij. Gjithashtu, pas verifikimit, në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ju autorizoj që të merrni në pyetje në cilësi të dëshmitarëve ________________ dhe ________________ si dhe të merrni edhe dorëshkrimet e tyre, për t'i dërguar në Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe për t'i krahasuar ato dorëshkrime nga shkresat, faturat apo dokumentet tjera, lidhur me këtë çështje penale.

Gjatë marrjes në pyetje, është e nevojshme që të verifikohen numrat e telefonave që kanë përdorur dëshmitarët, prej cilës datë apo kohë i shfrytëzojnë ata numra të telefonit, takimet, kontaktet apo marrëveshjet e arritura në mes tyre dhe të pandehurve, rolin e tyre në përpilimin e shkresave - faturave apo dokumenteve tjera që lidhen me këtë rast, si dhe elementet tjera që janë të rëndësishme për këtë çështje penale.

Pas ndërmarrjes së veprimeve të sipërpërmendura, kërkoj nga ju që sa më parë, por më së largu deri më ________________, të paraqitni raport të veçantë lidhur më zbatimin e këtij autorizimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS**
**Departamentit për hetime**

## A U T O R I Z I M

Duke marrë parasysh zhvillimin e deritanishëm të hetimeve në çështjen penale PP__, nr._________, **Ju autorizoj** të bëni verifikimin e qarkullimit financiar si dhe kontrollin tatimor, për të pandehurit: _____________, dhe ___________, si dhe të bizneseve _____________________, me numër fiskal dhe ________________, me numër fiskal, _________ që të dyja me adresë: __________________, për periudhën kohore, nga data _____________, e deri më datën _____________.

Si bazë për tatim, duhet të merrni raportin lidhur me zbulimin e të dhënave financiare, të përpiluar nga Departamenti ____________ në Policinë e Kosovës (të bashkangjitur) për të pandehurit dhe bizneset e sipërpërmendura si dhe gjendjen në llogaritë bankare të këtyre të pandehurve dhe këtyre bizneseve që janë inkorporuar në këtë raport.

Raporti mbi verifikimin dhe kontrollin duhet të paraqitet në zyrën time, në Prokurorinë Themelore në _______________, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më larg se deri më datën ______________.

Gjithashtu, Ju autorizoj që të ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për të verifikuar dhe kontrolluar të dhënat e lartcekura.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_____________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Policisë së Kosovës – Departamenti _____________, në ____________**
**Për: Zyrtarin policor ______________________**

## A U T O R I Z I M
## PËR BASHKËPUNIM ME EUROPOL-in

Duke u bazuar në nenin __________, të KPPK-së dhe duke marrë parasysh ecurinë e deritanishme të hetimeve, në rastin penal kundër të pandehurve ___________________, etj, Ju autorizoj juve që të filloni bashkëpunimin me EUROPOL-in, në mënyrë që të siguroni informacione apo dëshmi lidhur me aktivitetin kriminal të të pandehurve në këtë rast penal.

Gjatë bashkëpunimit, të keni parasysh interesat e çështjes tonë penale si dhe të keni kujdes për çështjet që mund të jenë fshehtësi ligjore apo zyrtare.

Lidhur me këtë autorizim, më njoftoni dhe të paraqitni raport të veçantë, në Zyrën time, më së largu deri më datën ________________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**Policisë së Kosovës – Departamentit ________________, në _______________,**
**Hetuesit ____________________________ apo zyrtarit tjetër policor që është nën përgjegjësinë, mbikëqyrjen apo kontrollin e tij**

**A U T O R I Z I M**
**PËR FUTJEN E TË PANDEHURIT NË STOP - LISTË**

Sipas shkresës Tuaj, me numër të referencës _____________, të datës ____________, rezulton se i pandehuri _____________, nuk gjendet në Kosovë dhe se ai jeton në _______________, në adresë të panjohur, që do të thotë së ky i pandehur për momentin është i paarritshëm për organet e ndjekjes.

Duke marrë parasysh se i pandehuri jeton në ______________, por që sipas shkresës Tuaj, në ndërkohë vjen për ta vizituar edhe Kosovën, Ju autorizoj që të pandehurin _________________ ta futni në STOP LISTË në mënyrë që i njëjti të arrestohet, në bazë të nenit _______________, të Kodit të Procedurës Penale, kurdo që haset nga Policia, të njoftoni zyrtarët policor, posaçërisht policinë kufitare që atë ta ndalin dhe t'ju njoftojnë juve, në mënyrë që ju në bazë të AUTORIZIMIT tim, këtë të pandehur, ta merrni në pyetje apo ta sillni në Zyrën time për ta marrë deklaratën e tij.

Meqenëse në takimet tona, Ju më keni njoftuar se keni kontaktuar autoritet e _______________, lidhur me mundësinë e bashkëpunimit për këtë rast dhe për mundësinë e fillimit të një hetimi të përbashkët, kërkoj nga Ju që të më njoftoni urgjentisht për çdo veprim tuajin që ndërlidhet me këtë bashkëpunim që ka të bëjë më

të pandehurin _______________ dhe të paraqitni raport të veçantë lidhur me zbatimin e këtij autorizimi, më së largu deri më datë _______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Policisë së Kosovës – Departamenti ___________________, në _______________,**
**Zyrtarëve policorë: ______________________ dhe ___________________**

**AUTORIZIM**
**Për pjesëmarrje gjatë marrjes në pyetje të të pandehurve dhe dëshmitarëve nga autoritetet e _____________**

Në bazë të nenit ________, paragrafi _______, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, **Ju autorizoj** që të jeni të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të pandehurve dhe dëshmitarëve të involvuar në rastin "SKANDINAVIA", nga autoritetet në ______________, sipas marrëveshjes me autoritetet ______________.

Gjatë marrjes në pyetje nga autoritetet në ____________, duhet të marrin pjesë zyrtarët policorë: Kapiteni ______________, me numër të ID-së ___________, hetuesit _____________, me numër të ID _______________, dhe _______________, me numër të ID-së ________, të cilët janë duke punuar në rastin e lartcekur.

Në bashkëpunim me autoritetet e Suedisë, të kërkohet që gjatë marrjes në pyetje, të verifikohen numrat e telefonave që kanë përdorur të pandehurit dhe dëshmitarët, prej cilës datë apo kohë i shfrytëzojnë ata numra të telefonit, takimet, kontaktet apo marrëveshjet e arritura në mes të pandehurve, prejardhjen e narkotikëve, raportet me të pandehurit në ____________ dhe ____________, çmimet që i kanë paguar apo është dashur t'i paguajnë për narkotikët, rrugën nëpër të cilën ka kaluar apo është dashur për të kaluar sasia e narkotikut, si dhe çështje tjera që janë të rëndësishme për këtë rast penal.

Pas kryerjes së veprimeve të sipërpërmendura, kërkoj nga Ju që më së largu më datë ________________të paraqitni raport lidhur me zbatimin e këtij autorizimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – Drejtoria________________, në______________,**
**Togerit ______________,**

**AUTORIZIM**
**Për shkatërrimin e armëve të sekuestruara**

Pas pranimit të shkresës Tuaj, me numër të referencës, Nr:_________________, të datës _______________ dhe duke vepruar në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, **Ju autorizoj** juve apo zyrtarin policor që punon nën mbikëqyrjen apo kontrollin Tuaj, që të shkatërroni armët dhe municionin e konfiskuar nga të pandehurit _______________ dhe _______________, si në vijim:

1. ____________________ të konfiskuar nga i pandehuri ____________________,
2. ____________________ të konfiskuar nga i pandehuri ____________________.

Pas shkatërrimit të këtyre armëve dhe municionit, hartoni raport të veçantë dhe një kopje të raportit e dërgoni në Zyrën time, më së largu deri më datën ______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORIA_______________,**
**në ______________, Kapitenit _______________________,**

## AUTORIZIM PËR ZBULIMIN E TË DYSHUARIT N.N.

Më datë ____________________, Prokuroria Themelore në _____________, ka pranuar raportin informues nga Ju, me numër të referencës ___________________, kundër N.N. personit për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale _____________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Ju e keni njoftuar Zyrën e prokurorit të shtetit se i dyshuari, pas kryerjes së veprës penale, ka ikur nga vendi i ngjarjes, duke qenë i armatosur dhe se nuk dihet vendndodhja e tij.

Duke marrë parasysh se kanë kaluar _______ ditë nga kryerja e veprës penale dhe ende nuk dihet vendndodhja e të dyshuarit si dhe faktit se ai është i armatosur dhe mund të jetë i rrezikshëm për qytetarët, **Ju autorizoj** që të vazhdoni me ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të mundshme për të zbuluar vendndodhjen e të dyshuarit, të ndaloni të njëjtin nga fshehja ose arratisja, të zbuloni dhe të ruani gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mblidhni të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurën penale, duke përfshirë edhe mbledhjen e informatave nga personat e ndryshëm, kryerjen e kontrollit të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre, kufizimin e lëvizjes në zona të caktuara për kohën kur ky veprim është urgjentisht i nevojshëm, ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për të vërtetuar identitetin e personave dhe të sendeve, zbulimin,

mbledhjen, ruajtjen e gjurmëve dhe provave nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Për ndërmarrjen e çdo veprimi të lartcekur, dërgoni në Zyrën time raport konform nenit ____ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORISË_______________, në**
**_______________,**
**POLICIT HETUES __________________**

**A U T O R I Z I M**
**Për sigurimin e dëshmive - inçizimeve**

Duke marrë parasysh raportin Tuaj informues, me numër të referencës ______________, të datës __________, për sigurimin e video-inçizimeve nga salla "_________" e Hotelit "___________" që gjendet në lagjen "_____________" në ______________, rruga "______________" nr ______, për periudhën prej datës _____________, deri më datën _____________, në bazë të nenit __________, paragrafi ___________, nën paragrafi _______, të Ligjit për prokurorin e shtetit, **Nr. _____________, të datës ___________, Ju autorizoj** që nga pronari i këtij restoranti z.___________ të kërkoni këto video – inçizime dhe pastaj të njëjtat t'i krahasoni dhe analizoni dhe të paraqitni raport në Zyrën time, sa më shpejt që të jetë e mundur.

**Me respekt,**

_____________________

**Prokuror Special**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORISË ______________, NË ____________,**
**POLICIT HETUES __________**

**KËRKESË PËR DORËZIMIN E RAPORTIT PËR TË KALUARËN KRIMINALE TË TË PANDEHURIT _____________________**

Më datë ____________________, keni paraqitur kallëzim penal me numër të referencës ______________, kundër të pandehurit _________________, për shkak të dyshimit se ai ka kryer veprën penale ________________, nga neni ____________, i KPRK-së.

Duke marrë parasysh se në bazë të kallëzimit penal dhe shkresave tjera të bashkangjitura, rezulton se i pandehuri _________________, ka qenë edhe më parë nën hetime dhe i gjykuar për vepra penale, kërkoj nga ju që të përgatitni dhe dorëzoni në zyrën time raportin lidhur me të kaluarën kriminale të të pandehurit, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më larg se më datën _________________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS - DREJTORISË ____________________, në _________________, _________________, apo zyrtarit tjetër policor që është nën përgjegjësinë, mbikëqyrjen apo kontrollin Tuaj.**

**KËRKESË PËR DORËZIM TË RAPORTIT LIDHUR ME ZBATIMIN E AUTORIZIMIT TË DATËS _______________**

Më datën ________________, ju kam autorizuar që _____________________________ ______________________________.

Mëqënëse deri më tani, nuk kam marrë nga Ju, asnjë raport lidhur më zbatimin e autorizimit të lartcekur, kërkoj që të më informoni sa më shpejt që të jetë e mundur, por më së largu deri më datën _______________, lidhur me zbatimin e atij autorizimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_____________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS**
**BURGUT NË __________________**
**DREJTORIT _______________________**

**KËRKESË PËR DORËZIMIN E INCIZIMEVE DHE DOKUMENTACIONIT**

Më datë _________________, Prokuroria Themelore në ________________________, ka pranuar një kallëzim penal nga Policia e Kosovës, me numër të referencës ___________________, kundër ____________________, me shënime personale... _______________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale _____________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të Kallëzimit Penal dhe shkresave të bashkangjitura, kam gjetur se ju në objektet e burgut, keni të vendosur sistemin e incizimit me kamera, andaj, konform nenit _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga ju që t'i dërgoni në zyrën time të gjitha incizimet e videokamerave në CD, prej datës _____________, deri më datën _______________.

Të dhënat e kërkuara, duhet t'i dorëzoni, më së largu deri më datën ______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORISË ____________, NË __________,**
**POLICIT HETUES __________________**

## A U T O R I Z I M
## Për heqje nga STOP LISTA

Pas arrestimit dhe marrjes në pyetje të të pandehurit ________________, ju autorizoj që atë ta hiqni nga STOP LISTA. Tani, kanë pushuar arsyet e futjes në STOP LISTË, sepse ai është nën masën e paraburgimit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_____________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS**
**Departamentit ______________**
**Policit hetues ____________**

**KËRKESË PËR VERIFIKIMIN E ABONENTËVE**

Më datë ___________, ka arritur në Prokurorinë Themelore në __________________, kërkesa Juaj për masën e fshehtë të vëzhgimit dhe hetimit – regjistrimi i bisedave telefonike, kundër të pandehurve: ____________________ dhe __________________, për të cilët nuk keni ofruar të dhënat personale edhe pse i keni shënuar numrat e telefonave që besohet se ata i përdorin.

Meqenëse të gjithë numrat e cekur në kërkesën tuaj, janë numra që i përkasin operatorit të telefonisë mobile "_________", kërkoj nga ju që së pari t'i drejtoheni këtij operatori të telefonisë mobile, për të kërkuar të dhënat e personave që i kanë blerë këta numra dhe kohën kur janë blerë e pastaj të shikojmë mundësinë e zbatimit të masave të fshehta për këta numra, pavarësisht se kush është duke i përdorur ata numra, pasi që ekziston mundësia ligjore për masa të tilla edhe kundër personave që nuk ju dihet identiteti.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORISË ___________________,**
**NË ______________**
**Kapitenit _______________________**

**KËRKESË PËR VERIFIKIMIN E INFORMATAVE**

Më datë _______________, Prokuroria Themelore në _________________, ka pranuar një shkresë me informacione nga ______________________, me numër të referencës ___________________, kundër_____________________, me shënime personale... _______________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale _____________, nga neni _____________,_i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të shkresës së _____________, dhe shkresave që ia ka bashkangjitur, kam gjetur se kallëzimi penal nuk është i qartë sa i përket kohës dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale, andaj, konform nenit _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga ju që të mblidhni të dhëna shtesë, lidhur me dyshimin e arsyeshëm që i vihet në barrë të dyshuarit.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, duhet t'i kushtoni vëmendje kohës se kur është kryer vepra penale dhe mënyrës se si është kryer kjo vepër.

Nëse keni nevojë për të marrë në pyetje persona të ndryshëm, në cilësi të dëshmitarëve apo të dëmtuarve, ose për të kërkuar ndonjë dokumentacion nga persona ose institucione të ndryshme, Ju keni autorizimin tim që t'i kryeni edhe këto veprime.

Pas mbledhjes së të dhënave të kërkuara, paraqitni raport lidhur me të dhënat për plotësimin e kallëzimit penal, në bazë të nenit _______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, jo më larg se më datën _____________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS**
**DEPARTAMENTI PËR SIGURI PUBLIKE - NJËSISË PËR PLANIFIKIM PERMANENT**
**ZYRTARIT POLICOR ____________________**

**KËRKESË PËR SIGURIMIN E SEANCËS DËGJIMORE**

I nderuari: z. ________________________,

Dëshirojë t'ju njoftojmë se në çështjen penale, PP. Nr. ________ ndaj të pandehurit ___________________, i lindur më ______________, i dyshuar për veprën penale ________________________, është caktuar seanca dëgjimore e cila do të mbahet më datën _______________, në orën ______________, në Prokurorinë Themelore në ___________________, në zyrën nr. _________, kati i _________, rr. "___________", nr._______ në ________________.

Meqenëse bëhet fjalë për veprën penale _________________________ dhe kategorinë e _____________ (ulët, mesme ose të lartë) të sigurisë, kërkojmë nga ju që njësia juaj policore të marrë përsipër sigurimin e ambientit gjatë kohës së mbajtjes së seancës dëgjimore.

Ju lutemi, sigurohuni që zyrtarët e policisë të paraqiten në zyrën e seancës dëgjimore të lartpërmendur, para orës __________.

Ju lutemi, mos hezitoni të na kontaktoni në tel: ____________________, ose e mail adresën ____________________________, nëse ju nevojiten më shumë të dhëna apo qartësi për këtë çështje.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
____________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**POLICISË SË KOSOVËS – Drejtoria _________________, në _______________,**
**Kapitenit ________________________,**

**AUTORIZIM PËR PUBLIKIMIN E FOTOGRAFISË SË TË DYSHUARIT**

_____________________________ (shëno të dhënat personale të të dyshuarit)

Më datë ______________________, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka pranuar Kallëzimin Penal nga Ju, me numër të referencës ___________________________, kundër_____________________, me shënime personale _______________, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale ______________, nga neni _______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Ju e keni njoftuar Zyrën e prokurorit të shtetit se i dyshuari pas kryerjes së veprës penale, ka ikur nga vendi i ngjarjes, duke qenë i armatosur dhe se nuk dihet vendndodhja e tij.

Duke marrë parasysh se kanë kaluar ______ ditë nga kryerja e veprës penale dhe ende nuk dihet vendndodhja e të dyshuarit, si dhe faktit se ai është i armatosur dhe mund të jetë i rrezikshëm për qytetarët, **Ju autorizoj** që të publikoni fotografinë e të dyshuarit në të gjitha mjetet e informimit si dhe në Web faqen Tuaj të internetit, në mënyrë që të fillojë zbatimi efikas i procedurës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – Drejtoria___________________, në ______________**
**Kapitenit _______________________**

**AUTORIZIM PËR PUBLIKIMIN E FOTOGRAFISË SË TË DYSHUARIT N.N.**

Më datë_____________________, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar Raportin informues nga Ju, me numër të referencës ___________________, kundër ____________________, me shënime personale_______________, për shkak të dyshimit të bazuar se i dyshuari i panjohur ka kryer veprën penale _____________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Ju e keni njoftuar Zyrën e prokurorit të shtetit se i dyshuari pas kryerjes së veprës penale ka ikur nga vendi i ngjarjes, duke qenë i armatosur dhe se nuk dihet vendndodhja e tij.

Duke marrë parasysh se kanë kaluar __________ ditë nga kryerja e veprës penale dhe ende nuk dihet vendndodhja e të dyshuarit si dhe faktit se ai është i armatosur dhe mund të jetë i rrezikshëm për qytetarët, **Ju autorizoj** që të publikoni fotografinë e të dyshuarit në të gjitha mjetet e informimit si dhe në Web faqen tuaj të internetit, në mënyrë që të përcaktohet identiteti i i të dyshuarit dhe të fillojë zbatimi efikas i procedurës, si dhe të evitohet çdo rrezik për jetën e qytetarëve.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_____________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**Policisë së Kosovës – Drejtoria për __________________,**
**Policit hetues ______________,**

## AUTORIZIM
### Për publikimin e fotografisë së të dyshuarit

Më datë ____________________, kam pranuar nga Ju, informatën lidhur me kryerjen e veprës penale ____________________, nga neni _________, i KPRK-së dhe se nuk keni qenë në gjendje që të bëni identifikimin e identitetit të të dyshuarit, të cilin e kanë parë disa persona në vendin e ngjarjes dhe e kanë përshkruar edhe pamjen e tij, por nuk e dinë emrin dhe mbiemrin. Sipas informatës Tuaj, i dyshuari tani për tani gjendet në arrati dhe është i paarritshëm për policinë, mirëpo qytetarët mund të ndihmojnë në identifikimin e tij..

Duke marrë parasysh informatën Tuaj, si dhe përshkrimin e pamjes së të dyshuarit nga ana e dëshmitarëve**, ju autorizoj** që të publikoni fotografinë e të dyshuarit në të gjitha mjetet e informimit dhe të kërkoni nga qytetarët që ta njoftojnë policinë ose prokurorinë lidhur me identitetin dhe vendndodhjen e të dyshuarit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORIA ______________, NË ____________,**
**POLICIT HETUES ______________**

**AUTORIZIM**
**Për marrje në pyetje dhe kryerjen e identifikimit**

Më datë ____________________, kam pranuar nga Ju, informatën lidhur me të dyshuarin _____________, i cili sipas informatës Tuaj është i përfshirë në kryerjen e veprës penale __________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj **Ju autorizoj** që të merrni në pyetje të dëmtuarin /dëshmitarin ________________.

Gjatë marrjes në pyetje, t'i kushtoni kujdes pyetjeve si në vijim:
1.________________________________
2.________________________________
3.________________________________
4. Përshkrimi dhe identifikimi i të dyshuarit____________________

Përshkrim i të dyshuarit nga ana e të dëmtuarit/dëshmitarit, të konstatohet në procesverbal dhe pastaj të dëmtuarit/dëshmitarit t'i tregohen disa fotografi, ku në mesin e tyre duhet të jetë edhe fotografia e të dyshuarit _____________________, në mënyrë që i dëmtuari/ dëshmitari ________________ të bëjë identifikimin e tij. Për këtë identifikim, të hartoni procesverbal të veçantë, i cili duhet të jetë pjesë e procesverbalit për marrjen në pyetje të të dyshuarit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit __________________, avokatit ________________, të paraqitur kundër veprimit të Policisë së Kosovës – Departamenti ______________, për mosdorëzimin e shkresave të lëndës, më datën _____________________ nxjerr ketë:

## AKTVENDIM

REFUZOHET si i pabazuar kundërshtimi i mbrojtësit të të pandehurit _____________, avokatit ________________, të paraqitur kundër veprimit të Policisë së Kosovës – Departamenti ______________ për mosdorëzimin e shkresave të lëndës

## A r s y e t i m

Duke vepruar sipas autorizimit të prokurorit të shtetit PP__.nr.______________ të datës __________________, Policia e Kosovës – Departamenti _______________, ka marrë deklaratën e të pandehurit _____________________, në prezencën e mbrojtësit të tij, avokatit ________________.

Pas dhënies së deklaratës së të pandehurit para policit hetues, mbrojtësi i tij, avokati ________________, gojarisht ka kërkuar nga polici hetues që t'ja dorëzojë shkresat e lëndës si dhe ___________________, mirëpo polici hetues e ka refuzuar gojarisht një kërkesë të tillë të mbrojtësit, duke i dhënë edhe arsyetimin se ___________________ _________________________________.

Kundër veprimit të tillë të policit hetues, ka paraqitur kundërshtim mbrojtësi i të pandehurit __________________, - avokati ___________________, për shkak të

__________________, me arsyetim se _______________________________________
_____________________________________________________.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit, gjen se:

**Kundërshtimi është i pabazuar**.

Kundërshtimi është i pabazuar për shkak se në bazë të nenit _________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, shkresat e lëndës, vetëm prokurori i çështjes mund t'ua jep në dispozicion palëve, në këtë rast të pandehurit ose mbrojtësit të tij, e jo edhe zyrtarët e policisë.

Në rastin konkret, polici hetues kishte autorizimin nga Prokurori i çështjes vetëm për ta marrë deklaratën e të pandehurit por jo edhe t'i dorëzojë të pandehurit ose mbrojtësit të tij shkresat e lëndës, andaj në rastin konkret veprimi i policit hetues është i bazuar, ndërsa kundërshtimi i mbrojtësit të të pandehurit është i pa bazuar.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

Avokati: ________________
Adresa: __________________
Tel: _____________________

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**PROKURORISË THEMELORE NË ___________**
**DEPARTAMENTIT ___________________**
**P Ë R**
**PROKURORIN E SHTETIT _______________**

Kundër veprimeve të datës ___________________, të ndërmarra nga polici hetues ____________________ që punon në Drejtorinë _________________________, në ____________________, në rastin penal që mban numrin e referencës ___________, në afatin ligjor, paraqes këtë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të ____________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që Prokurori i shtetit të veprojë në pajtim me ligjin dhe të na njoftoj lidhur më veprimet e ndërmarra.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetime për shkak të veprës penale: _________________, nga neni _____________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka lëshuar autorizim për Policinë e Kosovës – Departamenti________________, policin hetues __________________ që ta marrë deklaratën nga i pandehuri _______________, të cilin unë e mbroj sipas autorizimit.

Gjatë dhënies së deklaratës nga ana e të pandehurit, i njëjti ka deklaruar se ___________________________________, mirëpo polici hetues _______________ ka bërë shkeljen e dispozitave të procedurës penale, sepse ______________________.

Konsideroj se sjellja e tillë e policit hetues paraqet shkelje _______________________ dhe se Prokurori i shtetit duhet të ndërmarrë masa ndaj policit, të parashikuara në nenin _____________, të KPPK-së.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, konsideroj se Prokurori i shtetit, do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

________________________

**Avokati**
**N.N.**

________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**_________________________**
**nga _____________**

**F T E S Ë**

Lidhur me kallëzimin penal që e keni paraqitur në këtë prokurori, më datë _______________, kundër të dyshuarit ________________, për shkak të veprës penale _________________, nga neni ________, të KPRK, ftoheni që më datë _______________, të vini në Prokurorinë Themelore në _______________, kati i parë, zyra nr._____ më datën __________, në mënyrë që të jepni informatat e nevojshme lidhur me ______________________________, në cilësinë e qytetarit që ka paraqitur kallëzimin penal.

Nëse për ndonjë arsye të justifikueshme nuk keni mundësi që të paraqiteni në datën e caktuar, ju lutem që të na njoftoni në telefonin ______________, për të caktuar datën e mundshme të paraqitjes suaj në këtë prokurori.

**Prokurori**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**PROCESVERBAL**
**MBI PRANIMIN GOJOR TË KALLËZIMIT PENAL**

I mbajtur më datë: _________________

Ka filluar në ora: _______________

Të pranishëm:

Prokurori i shtetit:________________,

Procesmbajtës:___________________

Paraqitësi i kallëzimit penal _______________________, me shënime personale si në vijim:__________________________________________________________________
______________________________________________________________________.

Paraqitësi i këtij kallëzimi penal, fillimisht është njoftuar si në vijim:

"Ky është një hetim penal. Ju jeni i detyruar të dëshmoni. Ju jeni i detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk e tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit _____, ose _____, të Kodit Penal. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit, si rezultat i përgjigjes në një pyetje, ju mund të angazhoni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën edhe me kujtesën tuaj sa më të saktë të përshkrimit të fakteve që ju mund t'i ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen

që iu është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja t'ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'ju ndihmojnë për t'u përgjigjur në pyetje sa më saktë, apo t'ju kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet ta kërkoni atë.

Gjithashtu, paraqitësi i këtij kallëzimi penal, është njoftuar se informatat e zbuluara në këtë dëgjim hetimor, nuk duhet të bëhen të ditura për asnjë person tjetër. Të gjitha informatat e zbuluara në këtë procedurë hetimore, duke përfshirë por pa u kufizuar, të gjitha raportet, deklaratat dhe shënimet personale të të pandehurve, dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, do të jenë të fshehta. Zbulimi i paautorizuar i këtyre informatave përbën vepër penale.

Pasi që paraqitësi i kallëzimit penal është pyetur se: A i kuptoni këto të drejta dhe ai është përgjigjur se i ka kuptuar këto të drejta dhe detyrime, paraqes këtë:

**KALLËZIM PENAL**

Kundër ____________________, me shënime personale _______________________.

Sepse, ekziston dyshimi se __________________ përshkrimi i gjendjes faktike (koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale si dhe kualifikimi juridik, duke përfshirë emërtimin e veprës penale dhe dispozitën e Kodit Penal)

Bashkangjitur me këtë kallëzim penal, paraqes edhe këto prova: __________________ ____________________________________.

Unë jam i dëmtuar me këtë vepër penale, kërkoj që i dyshuari të ndiqet penalisht dhe të dënohet sipas ligjit, po ashtu paraqes kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjithashtu, deklaroj se unë do të marrë pjesë si i dëmtuar/dëshmitar gjatë procedurës penale.

Lidhur me këtë çështje, nuk kam tjetër çka të deklaroj. Procesverbali më është lexuar me zë, e kuptoj dhe e pranoj si deklaratë time dhe pas leximit, nga ana ime, e nënshkruaj pa vërejtje.

**Përfundoi në ora: ___________ minuta.**

**Paraqitësi i kallëzimit penal**

____________________________

**Procesmbajtësi**
**N.N.**

__________________

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

## SHËNIM ZYRTAR

Gjatë orarit të punës, më datë _________________, në ora ________, në numrin zyrtar të telefonit _____________________, (ose numrin mobil) nga numri i telefonit _______________, ka thirrur një person i gjinisë mashkull/femër dhe është prezantuar si _________________, nga _________, adresa____________________.

Meqenëse personi i lartcekur, ka deklaruar se dëshiron që të paraqet kallëzim penal kundër __________________________, për shkak të veprës penale _________________, mirëpo nuk dëshiron që të paraqitet në lokalet e kësaj prokurorie, biseda telefonike me këtë person është incizuar me diktafon.

Para se të fillonte incizimi i bisedës, ky person është njoftuar për detyrimin e tij që të flas të vërtetën dhe për pasojat e paraqitjes apo lajmërimit të rrejshëm.

Incizimi i bisedës/paraqitja e kallëzimit penal, ka filluar në ora _____________, dhe ka përfunduar në ora _______________.

Pas analizës së kësaj deklarate, rezulton se ekziston dyshimi i arsyeshëm që i dyshuari ________________, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale __________, nga neni _____, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe se kjo deklaratë mund të konsiderohet si kallëzim penal gojor, mirëpo është e nevojshme që të kërkohet nga Policia e Kosovës, grumbullim i informatave shtesë, për të plotësuar këtë kallëzim penal.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

| | | |
|---|---|---|
| | Republika e Kosovës<br>**Republika Kosova – Republic of Kosovo**<br>Qeveria – Vlada – Government<br><br>Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs<br><br>Policia e Kosovës/Policija Kosova/<br>Kosovo Police | |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/<br>Generalna Policijska Direkcija/<br>General Police Directorate | |

| EMRI I TË DYSHUARIT (Mbiemri, Emri) | DATA dd/mm/vvvv | Nr. I RASTIT POLICOR |
|---|---|---|
| | | |

**TË DREJTAT E PERSONIT TË ARRESTUAR**
Nenet 167, 168, 169, 170 të KPP
**INFORMACION PËR TË DYSHUARIN**
**DHE NJOHJA E TIJ ME TË DREJTAT E VETA**

***NJOFTIM UDHËZUES PËR POLICINË***

***Ju DUHET t'ia lexoni*** ***<u>me zë</u>*** *të arrestuarit* ***Paragrafët me numër 1 - 8****. Lexojani edhe nëse personi i arrestuar thotë se mund t'i lexojë vetë – kërkohet me ligj që ju t'ia lexoni këta paragrafë me zë.*

*Pastaj, jepjani këtë formular të arrestuarit, në mënyrë që i arrestuari t'i lexojë vetë paragrafët numër 9 -15.* ***Nëse personi i arrestuar nuk mund të lexojë****, atëherë ju duhet t'ia lexoni përmbajtjen e tërë formularit me zë.*

***Ju duhet të lexoni me zë në një gjuhë që personi i arrestuar e kupton. Nëse është e nevojshme, përdorni një përkthyes dhe shënoni identitetin e përkthyesit.***

1. **JU JENI NËN ARREST,** data dhe ora e arrestimit tuaj është:

| **Data – Ora e Arrestimit Dita/Muaji/Viti 00:00 hrs** | / /20<br><br>**Ora :** | **Vendi i Arrestimit**<br>Lokacioni<br>Komuna | **Në**<br><br>**Komuna** |
|---|---|---|---|

2. <u>ARSYET E ARRESTIT:</u> Ju keni të drejtën që të njiheni Për arsyet e arrestimit tuaj në një gjuhë që e kuptoni.

3. E DREJTA E HESHTJES: JU KENI TË DREJTË TË HESHTNI dhe të mos t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje përveç dhënies së të dhënave mbi identitetin tuaj.

4. PËRKTHYESI: Ju keni të drejtë për ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, nëse nuk e kuptoni ose flisni gjuhën e përdorur nga polici i cili flet me juve ose nëse dëshironi të flisni me një polic.

5. AVOKATI MBROJTËS: Ju keni të drejtën e një avokatit mbrojtës dhe të caktimit të një avokati mbrojtës - nëse nuk keni mundësi të paguani shërbimin e tij, do t'ju caktohet një me detyrë zyrtare.

6. NJOFTIMI I FAMILJES: Ju keni të drejtën të njoftoni, ose t'i kërkoni policisë të njoftojë një anëtar të familjes ose ndonjë person tjetër të përshtatshëm që e zgjidhni ju, lidhur me vendin dhe arrestimin tuaj.

7. TRAJTIMI MJEKËSOR: Ju keni të drejtën e ekzaminimit mjekësor dhe të trajtimit mjekësor duke përfshirë edhe kurimin psikiatrik.

8. NËSE JENI SHTETAS I HUAJ: Ju keni të drejtën të njoftoni, ose policia mund të njoftojë dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit jeni ju, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare nëse ju jeni refugjat ose jeni nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare.

***NJOFTIM UDHËZUES PËR POLICINË: Pasi t'ia keni lexuar me zë të arrestuarit paragrafët e lartpërmendur 1 – 8, jepjani atij/asaj këtë formular për ta lexuar.***
(Lexoni me zë paragrafët tjerë nëse personi i arrestuar nuk mund t'i lexojë.)

9. I DYSHUARI NËN 18 VJEÇ – NJOFTIME: Nëse jeni më i/e vogël se 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, policia duhet ta njoftojë përfaqësuesin tuaj ligjor lidhur me arrestimin dhe vendin ku ndodheni nën arrest si dhe mbi çdo lloj ndryshimi të këtij vendi. Nëse ata nuk kanë mundësi ta njoftojnë përfaqësuesin, Policia duhet ta njoftojë Qendrën për punë sociale. Ky njoftim nuk mund të vonohet.

10. PARABURGIMI: Ju mund të qëndroni nën paraburgim deri në 48 (dyzet e tetë) orë nga koha e arrestimit nga policia, dhe vetëm në rastin kur një gjyqtar i procedurës paraprake jep urdhër për paraburgim, do të qëndroni në paraburgim, përndryshe duhet të liroheni.

11. RISHIKIMI I PARABURGIMIT NGA PROKURORI PUBLIK/POLICIA: Menjëherë pas arrestimit dhe jo më vonë se 6 (gjashtë) orë nga koha e arrestimit tuaj, prokurori i shtetit duhet t'ju lëshojë një vendim me shkrim mbi paraburgimin që do të përfshijë veprën penale për të cilën dyshoheni, bazat ligjore për paraburgimin tuaj dhe përse jeni në paraburgim.

12. KUSHTET E PARABURGIMIT: Ju duhet të mbaheni në paraburgim ndaras nga të

burgosurit e dënuar apo personat e paraburgosur; ju mund të mbaheni në paraburgim vetëm me persona të të njëjtës gjini, keni të drejtë për tre vakte ushqimi në ditë nëse jeni në paraburgim për më shumë se 12 (dymbëdhjetë) orë, dhe kur keni të drejtën që të keni të paktën tetë orë pushim të pandërprerë në çdo periudhë kohore prej 24 (njëzetekatër) orësh.

13. AVOKATI MBROJTËS: (Informacione të tjera) Keni të drejtën për NDIHMËN E MËNJËHERSHME TË NJË AVOKATI MBROJTËS, SIPAS ZGJEDHJES TUAJ.

   a. Nëse nuk keni një avokat mbrojtës, ose nuk mund t'i përballoni shpenzimet për të angazhuar një avokat mbrojtës, do t'ju caktohet një i tillë pa pagesë.

   b. Si alternativë, përfaqësuesi juaj ligjor ose anëtarët e familjes suaj, mund të angazhojnë një avokat për ju.

   c. Nëse nuk e dëshironi ndihmën e një avokati mbrojtës, atëherë, mund të hiqni dorë nga e drejta për të pasur një të tillë.

   d. Nëse dyshoheni për terrorizëm apo krim te organizuar, Prokurori Publik mund t'i kërkojë gjyqtarit të procedurës paraprake që të caktojë një tjetër avokat mbrojtës, për të zëvendësuar atë që keni zgjedhur ju për një periudhë më së shumti prej 48 (dyzet e tetë) orësh që nga koha e arrestimit.

14. KOMUNIKIMI ME AVOKATIN: Mund të komunikoni me avokatin mbrojtës në mënyrë private me shkrim ose gojarisht. Policia nuk mund të dëgjojë bisedat tuaja me avokatin mbrojtës, por mund t'ju mbikëqyrë gjatë kësaj kohe. Nëse policia ju merr në pyetje, mbrojtësi juaj mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

15. NJOFTIMI I FAMILJES: (Informacione të tjera) Policia duhet të njoftojë një anëtar të familjes tuaj ose një person tjetër të përshtatshëm që zgjidhni ju- për arrestimin tuaj, vendin ku mbaheni në paraburgim, si dhe çdo ndryshim të vendit ku mbaheni në paraburgim. Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë që ju zgjidhni, mund të vonohet më së shumti deri në njëzet e katër (24) orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk ka kur personi i arrestuar është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose tregon shenja të çrregullimit apo të paaftësisë mendore.

**DUKE NËNSHKRUAR MË POSHTË, VËRTETOJ SE KAM MARRË NJË KOPJE TË KËTIJ NJOFTIMI NË GJUHËN TË CILËN E KUPTOJ, E KAM LEXUAR ATË, DHE PËRMBAJTJA MË ËSHTË SHPJEGUAR ATY KU KA QENË E NEVOJSHME.**

| **EMRI dhe MBIEMRI (me shkronja shtypi)** | **NËNSHKRIMI** | **DATA dita/muaji/viti** |
|---|---|---|
| **I DYSHUARI:** | | **/ /20** |

| |
|---|
| ***NJOFTIM UDHËZUES PËR POLICINË***<br>*Nëse personi i arrestuar refuzon të nënshkruajë, mbajeni shënim refuzimin dhe çfarëdo lloj shpjegimi në këtë kuti këtu, dhe më pas, ju (polic) nënshkruani poshtë siç kërkohet nga kjo formë.*<br><br>Shpjegimi për refuzimin (nëse ka): |

| **DËSHMITARI / PËRKTHYESI** | | |
|---|---|---|
| **EMRIN** me shkronja të shtypit | **NËNSHKRIMI** | **DATA dita/muaji/viti** |
| **ZYRTARI I POLICISË:**<br><br>**PK#** | | **/ /20** |
| **PËRKTHYESI:**<br>**(nëse i është lexuar të dyshuarit)**<br>**Nr. LS** | I kam përkthyer me besnikëri pyetjet që iu bënë të dyshuarit dhe deklaratat që u dhanë. **Nënshkrimi:** | **/ /20** |

**SHPËRNDARJA: KOPJE PËR: TË PANDEHURIN**

**AVOKATIN E TË PANDEHURIT (nëse ka)**

**PROKURORIN E SHTETIT**
**Të dhënat policore për të arrestuarin**

| **Nënshkrimi ose shenjat e të dyshuarit** | **Nënshkrimi i Policit** |
|---|---|
| | |

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORIA _____________ NË _______________**
**Zyrtarit policor___________________**

**KËRKESË PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE SHTESË**

Më datë _____________________, keni paraqitur raport informues më numër të referencës ___________________, kundër _________________________ më shënime personale ___________________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm së i njëjti ka kryer veprën penale __________________ nga neni ______________ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të Raportit informues dhe shkresave që ja keni bashkangjitur këtij raporti, kam gjetur së ky raport nuk është i qartë sa i përket kohës dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale, andaj kërkoj nga ju që të mblidhni të dhëna shtesë lidhur më dyshimin e arsyeshëm që i vihet në barrë të dyshuarit. Gjatë mbledhjes së të dhënave duhet t'i kushtoni vëmendje kohës së kur është kryer vepra penale dhe mënyrës së si është kryer kjo vepër.

Nëse keni nevojë për të marrë në pyetje persona të ndryshëm në cilësi të dëshmitarëve ose të dëmtuarve, ose për të kërkuar ndonjë dokumentacion nga persona ose institucione të ndryshme, ju keni autorizimin tim që t'i kryeni edhe këto veprime.

Pas mbledhjes së të dhënave të kërkuara të njoftoni këtë prokurori më të gjeturat e juaja ose të paraqitni kallëzim penal në bazë të nenit ____________ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORIA _________________,**
**NË _________________**
**Kapitenit _______________________**

## KËRKESË PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PËR PLOTËSIMIN E KALLËZIMIT PENAL

Më datë _____________________, keni paraqitur kallëzim penal, me numër të referencës ___________________, kundër ________________________, me shënime personale ___________________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale _____________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të kallëzimit penal dhe shkresave që ja keni bashkangjitur, kam gjetur se kallëzimi penal nuk është i qartë sa i përket ___________________________, andaj, kërkoj nga ju që të mblidhni të dhëna shtesë lidhur me dyshimin e arsyeshëm që i vihet në barrë të dyshuarit.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, duhet t'i kushtoni vëmendje _____________________ ________________________________________.

Nëse keni nevojë për të marrë në pyetje persona të ndryshëm, në cilësi të dëshmitarëve apo të dëmtuarve, ose për të kërkuar ndonjë dokumentacion nga persona e institucione të ndryshme, ju keni autorizimin tim që t'i kryeni edhe këto veprime.

Pas mbledhjes së të dhënave të kërkuara, paraqitni plotësimin e kallëzimit penal, në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, jo më larg se më datën _____________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

| | | |
|---|---|---|
| | **Republika e Kosovës**<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br><br>Qeveria – Vlada – Government<br>Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs<br><br>**Policia e Kosovës - Policija Kosova - Kosovo Police** | |

**DREJTORIA ______________________________, në ________________,**
**Numri i rastit, ref.____________________**

**PROKURORISË THEMELORE**
**DEPARTAMENTIT ___________________,**

_______________

Konform nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqesim këtë:

## KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit: ______________________________ (shëno të dhënat personale).

**S E P S E**

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se ______________________________ (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Me këtë veprim, kishte kryer veprën penale ________________________, nga neni ________, të Kodit Penal të Republikës se Kosovës

**A r s y e t i m**

Më datë ________________, në ora ___________, Policia ka marrë informacion nga një qytetar se ____________________________________________________________
__________________________________________________.

Pas marrjes së informacionit të sipërpërmendur, Policia ka njoftuar dhe ka kërkuar nga prokurori _____________________ që ______________________________________
__________________________________________________.

Dyshimi i arsyeshëm se i dyshuari ka kryer veprën penale ________________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, rezulton nga ______________________________________________________________________.

Si provë materiale, lidhur me këtë rast janë ___________________________________.

Nga sa u tha më lart, nuk është kontestuese se i dyshuari ____________________, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ________________, nga neni _______________, të Kodit Penal të Republikës se Kosovës, andaj në këtë çështje penale, është e nevojshme që prokurori të marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, në mënyrë që të siguroj edhe provat tjera që mund të jenë të nevojshme për ngritjen e aktakuzës.

**Paraqitësit e kallëzimit penal**
**N.N.**
**Polic hetues**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u ____________/**
**Basic Prosecution Office ____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në bazë të nenit __________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr ketë:

**A K T V E N D I M**

**Ndaj të dyshuarit ________________________ (shëno të dhënat personale)**.

**HIDHET** kallëzimi penal - i patashtruar nga Policia e Kosovës – Drejtoria ____________, në Prishtinë, me numër të referencës ______________, të datës ____________, për shkak të veprave penale - ___________, nga neni _____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me veprën penale – ______________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Drejtoria ____________, në Prishtinë, - i ka paraqitur Prokurorisë Themelore në ________________, një raport informues, me të cilin ka njoftuar se të pandehurit ________________, __________________, __________________ dhe ____________________________ janë duke kryer disa veprime inkriminuese si në vijim:_____________________________.

Më datë ______________, Prokurori i shtetit në këtë çështje penale, në bazë të nenit _______, paragrafi ______, ka nxjerrë urdhër të përkohshëm për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit si vijon: regjistrimi i bisedave telefonike, përgjimi i telekomunikimeve, fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi me video-kamerë në vende publike, hetimi i fshehtë dhe shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes kundër të pandehurve _______________, ________________, ________________

dhe ______________, i cili urdhër është konfirmuar me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, PP_.nr._____________ të datës _______________.

Policia e Kosovës – Drejtoria ________________, në ___________________, më datë _______________, ka paraqitur kallëzim penal kundër të dyshuarve _____________, ______________ dhe ______________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale - __________, nga neni _____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me veprën penale – ______________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë _________________, Prokurori i shtetit, i nënshkruar më poshtë, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kundër të pandehurve _____________, ______________ dhe ______________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i kanë kryer veprat penale _________________ nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me veprën penale – __________________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, në të njëjtën datë, Policia ka paraqitur raport të veçantë në bazë të të cilit rezulton se i dyshuari __________________, nuk ishte i përfshirë në kryerjen e veprave penale të përfshira në kallëzimin penal.

Duke marrë parasysh raportin e policisë si dhe raportin e kontrollit që i është bërë shtëpive të të dyshuarve, me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, si dhe pas përfundimit të operacionit për arrestimin e të pandehurve __________________, ____________________ dhe __________________, rezulton se nga këta të pandehur është sekuestruar substanca narkotike e lartcekur, ndërsa në shtëpinë e të dyshuarit ________________, nuk është gjetur asgjë e dyshimtë.

Nga deklaratat e të pandehurve ___________________, ____________________ dhe ___________________, të dhëna në Prokurorinë e shtetit, më datë ______________, rezulton se këta të pandehur, nuk e njohin fare të dyshuarin me emrin _____________.

I dyshuari _________________, ishte edhe nën masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, mirëpo edhe nga raportet e Policisë, lidhur me këto masat të datës ______________, rezulton se i dyshuari _________________, nuk ishte i përfshirë në kryerjen e veprave penale për të cilat ishte i dyshuar

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, rezulton se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se i dyshuari ________________, i ka kryer veprat penale që i viheshin në barrë sipas kallëzimit penal e as ndonjë vepër tjetër që ndiqet sipas detyrës zyrtare, andaj është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr._________/_____
Prishtinë,
Më datë ______________

**Për Policinë e Kosovës – Departamenti______________, në __________,**
**Zyrtarit policor: ______________________**

## AUTORIZIM PËR VERIFIKIMIN E INFORMATAVE

I nderuari z.________________,

Sot, në Zyrën time, është paraqitur një informator, i cili më ka njoftuar se në "N.N." në ___________________, disa ___________, në bashkëpunim me zyrtarë të kompanive "____________" "______________" dhe "______________" janë duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, ashtu që (shëno veprimet e të dyshuarve), konsideroj se është e nevojshme që të filloni menjëherë procedurat për verifikimin e këtyre informatave dhe të më raportoni pa vonesë, por më së largu deri më datë ______________, lidhur me të gjeturat Tuaja.

Gjatë verifikimit të këtyre informatave, keni parasysh emrat e ____________ që kanë udhëtuar përmes agjencionit turistik "________________" më datat _______________, _____________, _________________ dhe ________________ për në _______________ dhe ______________, mënyrën se si është paguar udhëtimi dhe qëndrimi i tyre në këto dy shtete, kush i ka paguar shpenzimet dhe sa ka qenë shuma e pagesave, pastaj të merrni informatat nga intelegjenca financiare për gjendjen e llogarive bankare të atyre _______________, që kanë udhëtuar dhe qëndruar në ______________ dhe _____________ gjatë datave të sipërpërmendura.

Gjatë verifikimit, Ju keni autorizimin tim që të ndërmerrni edhe çdo veprim tjetër nga neni _________, të KPPK-së, që e shihni të nevojshme për verifikimin e këtyre informatave.

Emri i informatorit mund të bëhet i ditur për Juve, nëse ju keni nevojë për informata shtesë, mirëpo duhet ta keni parasysh vlerësimin e rrezikut për të.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI_______________________**
**P Ë R:**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shikimit të raporteve dhe informatave të Policisë së Kosovës - referenca nr. __________, të datës ______________ dhe materialeve të tjera që u janë bashkangjitur këtyre raporteve dhe në pajtim me nenin ______________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR MASËN E FSHEHTË TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT - REGJISTRIMI I BISEDAVE TELEFONIKE**

Duke përfshirë listën e numrave që kanë dërguar dhe pranuar thirrjet si dhe listën e numrave që kanë dërguar dhe pranuar SMS-at, për përudhën prej datës ____________, deri më datën __________.

**Kundër të pandehurve:**
**_______________________ (shënimet personale të te pandehurit)**
**_______________________ (shënimet personale të te pandehurit)**

**Përshkrimi i gjendjes faktike** (koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale si dhe kualifikimi juridik i veprës penale)

**A R S Y E T I M**

Policia e Kosovës, ka paraqitur pranë kësaj prokurorie kallëzimin penal, me numër të referencës ______________, kundër të pandehurve _________________________, dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprat penale ____________________ nga neni _______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ____________________, nga neni _________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datë ___________, Prokurori i shtetit, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: ______________________ dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprat _________________, nga neni ________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ________________, nga neni ___________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datë ____________, Policia e Kosovës, ka paraqitur kërkesë për masën e fshehtë për regjistrimin e bisedave telefonike, kundër të pandehurve _________ dhe _____________, duke dhënë si arsye se ______________________________________ ___________________________________________________________________.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së Policisë, konsideroj se në këtë çështje penale, është e nevojshme që të aplikohet masa e fshehtë teknike e vëzhgimit dhe hetimit, regjistrimi i bisedave telefonike, duke përfshirë listën e numrave me të cilët kanë bërë apo kanë pranuar thirrjet telefonike si dhe listën e numrave të telefonit që kanë dërguar apo pranuar SMS-a, në mënyrë që të merren informacionet e rëndësishme lidhur me lidhjet e këtyre të pandehurve si dhe për të zbuluar emrat e personave të ndryshëm që mund të jenë të përfshirë në kryerjen e veprës penale dhe kohën e thirrjeve. Këto informata pastaj mund të krahasohen me deklaratat e të pandehurve, dëshmitarëve dhe të dëmtuarve e gjithashtu edhe me _____________ ____________________________________________________________.

Nga shkresat e lëndës ___________________________________, rezulton dyshimi i bazuar se _____________________________________________________________ _______________________.

**URDHËRAT E MËPARSHËM:**

Për këta të pandehur, lidhur me këtë masë të fshehtë, nuk ka pasur urdhër të mëparshëm.

**BAZA LIGJORE:**

**Neni ____________, i KPPK-së**
Paragrafi _____. Regjistrimi i thirrjeve telefonike mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

Nën paragrafi ____, ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryej vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe

Nën paragrafi _______, informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Andaj, nga sa u tha më lart, në bazë të neneve _________, dhe _________, të KPPK-së, duke marrë parasysh se informacioni që mund të mirret duke përdorur masën e mësipërme të fshehtë për regjistrim të bisedave telefonike, mund të ndihmojë në hetimin e veprave penale, i cili informacion nuk mund të mirret me përdorimin e veprimeve të tjera hetimore, pa pasur apo pa krijuar vështirësi të paarsyeshme apo rreziqe të mundshme për të tjerët, me respekt kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake- lëshimin e urdhrit për masën e fshehtë:

- Regjistrim i bisedave telefonike, ashtu siç përcaktohet me anë të nenit ____, paragrafi ___, të KPPK-së, që do të thotë- sigurim i të dhënave të thirrjeve telefonike të bëra nga një numër i caktuar i telefonit.

Kundër të pandehurve: _________________ dhe ___________________.

Për numrat e telefonit ____________ dhe ______________ të cilët i shfrytëzon i pandehuri _________________.

Për pEriudhën kohore prej datës _______________ deri më datën ______________.

**ZYRTARI PËR ZBATIM TË URDHRIT:**

Zyrtari i policisë ______________, autorizohet si zyrtar përgjegjës dhe do të ketë përgjegjësinë për të siguruar përputhshmërinë e zbatimit të urdhrit me dispozitat e KPPK-së. Zyrtari policor mund të delegojë përgjegjësinë e tij te një tjetër zyrtar i policisë nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tij. Zyrtari i policisë fillon të zbatojë urdhrin jo më vonë se 15 ditë pas lëshimit të urdhrit.

**KËRKESAT PËR RAPORTIM:**

Urdhëron që zyrtari i policisë ________________, apo zyrtari tjetër i policisë nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tij, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e lëshimit të urdhrit, t'i raportojë gjyqtarit që e ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit të autorizuar.

Të lëshojë tri kopje origjinale të këtij urdhri.

**KOHËZGJATJA E URDHRIT:**

Urdhëri për fillimin e masës së përshkruar më lart, zgjatë jo më shumë se gjashtëdhjetë ditë nga dita e lëshimit të këtij urdhri.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NE ________________**
**DEPARTAMENTI____________________________**
**P Ë R**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të raporteve dhe informatave të Policisë së Kosovës – Drejtoria ____________, në _______________, referenca _______________, dhe materialeve të tjera që përmban kjo dosje dhe në pajtim me ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR MASËN E FSHEHTË TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT SHFRYTËZIM I MJETEVE PËR PËRCJELLJE TË VENDNDODHJES – GPS**

**Kundër: ________________________** (shëno të dhënat personale të të pandehurit ose pandehurve)

Ekziston dyshimi i bazuar se (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më këtë ka kryer veprën penale:
- __________________, nga neni _______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Policia e Kosovës – Drejtoria _____________, në _____________, ia ka paraqitur Prokurorisë Themelore në __________, një raport informues, më të cilin e ka njoftuar se ______________________.

Pas pranimit të këtij raporti, Policia e Kosovës, me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake ka kryer kontrollin e ____________________, në ______________, dhe gjatë këtij kontrolli, ka gjetur se _____________________________________________ _________________________________________________.

Duke marrë parasysh raportin e Policisë si dhe raportin e kontrollit që i është bërë _______________, me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, konsideroj se në këtë çështje penale duhet të aplikohen edhe masat tjera të fshehta hetimore, duke përfshirë edhe **shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes,** për shkak së ekziston dyshimi i bazuar se këta të pandehur, janë të përfshirë në kryerjen e veprave penale të lartcekura.

**URDHËRAT E MËPARSHËM:**

Për këta të pandehur lidhur me këtë masë të fshehtë nuk ka pasur urdhër të mëparshëm.

**BAZAT LIGJORE:**

**Neni _________ i KPPRK-së**
Paragrafi ___. Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, ndërhyrja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, **shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes**, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një vepre të korrupsionit apo hetimi i fshehtë- mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse:

Nën paragrafi ______, ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryejë vepër penale, nga neni ________, i këtij Kodi;

Nën paragrafi ______, informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara, me gjasë, do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Nga sa u tha më sipër dhe në bazë të neneve _____________, dhe ____________, të KPPK-së, prokurori i nënshkruar këtu, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të theksuara më lart dhe duke marrë parasysh se informacioni që mund të merret duke përdorur masën e fshehtë të theksuar lart për shfrytëzim të mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, mund të ndihmojë në hetimin e

veprave penale, informacion i cili nuk mund të merret me përdorimin e veprimeve të tjera hetimore pa pasur apo pa krijuar vështirësi të paarsyeshme apo rreziqe të mundshme për të tjerët.
- Shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes - GPS, ashtu siç përcaktohet me anë të nenit ____, paragrafi ______, të KPPRK-së, që do të thotë shfrytëzim nga zyrtari i autorizuar i policisë i mjeteve të cilat identifikojnë vendndodhjen e personit ose të objektit në të cilin është ngjitur.

a. Kundër të pandehurve: __________________ dhe ___________________.
b. Për t'u vendosur mjete për përcjellje të vendndodhjes – GPS, në mjetin transportues _______________, me ngjyrë ____________, me targa ____________ dhe rimorkio me targa _______________, sipas nevojës edhe në automjete tjera që shfrytëzohen nga të pandehurit nga qyteti i _____________, në drejtim të ___________________.

**ZYRTARI PËR ZBATIM TË URDHRIT:**

Zyrtarët e policisë, ______________ dhe _______________, autorizohen si zyrtarë përgjegjës dhe do të kenë përgjegjësinë për të siguruar përputhshmërinë e zbatimit të urdhrit me dispozitat e KPPK-së. Zyrtarët policorë, mund të delegojnë përgjegjësinë e tyre te një tjetër zyrtar i policisë, nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tyre. Zyrtarët e policisë fillojnë të zbatojnë urdhrin jo më vonë se 15 ditë pas lëshimit të këtij urdhri.

**KËRKESAT PËR RAPORTIM:**

Urdhëron që zyrtarët policor _____________ dhe ______________, apo zyrtari tjetër i policisë nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e lëshimit të urdhrit, t'i raportojnë gjyqtarit që ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit të autorizuar.

Të lëshojë tri kopje origjinale të këtij urdhri.

**KOHËZGJATJA E URDHRIT:**

Urdhëron që masa e përshkruar më lart, të mos tejkalojë gjashtëdhjetë ditë nga data e lëshimit të këtij urdhri.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATA THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTI ___________________________**
**PËRGJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të raportit dhe kërkesës së policisë për masa të fshehta: fotografim të fshehtë ose vëzhgim me video në vende publike, referenca nr. ________________, të datës ______________, dhe në pajtim me nenin ____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR MASËN E FSHEHTË TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT**

**FOTOGRAFIMI I FSHEHTË OSE VËZHGIM ME KAMERË (VIDEO) NË VENDE PUBLIKE**

**Kundër të pandehurve:**

**______________________ (shënimet personale të të pandehurit).**

**______________________ (shënimet personale të të pandehurit).**

**S E P S E**

**Përshkrimi i gjendjes faktike** (koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale si dhe kualifikimi juridik i veprës penale)

**A R S Y E T I M:**

Policia e Kosovës – Drejtoria _____________, në _____________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal më numër të referencës _______________, kundër të pandehurve _______________ dhe ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale ________________ nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ______________________, nga neni _____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë ___________, prokurori i shtetit, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: ______________________ dhe ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprat penale ________________ nga neni ____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ____________________, nga neni _____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake, më datë _____________, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, të datës ________, ka urdhëruar masën e fshehtë _____________, kundër të pandehurve _______________ dhe ______________.

Më datë ______________, Policia e Kosovës ka paraqitur raport lidhur me masën e fshehtë teknike të vëzhgimit dhe hetimit: ________________, kundër të pandehurve: ______________________ dhe ____________________, nga ky raport, rezulton se _________________________________, andaj policia ka kërkuar që kundër këtyre të pandehurve të aplikohet edhe masa e fshehtë teknike e vëzhgimit dhe hetimit: fotografimi i fshehtë ose vëzhgim me kamerë (video) në vende publike.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe raporteve të policisë për masën e fshehtë ___________________, rezulton se në këtë çështje penale, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale që u vihen në barrë, andaj është e nevojshme që të aplikohet edhe masa e fshehtë, fotografimi i fshehtë ose vëzhgim me kamerë (video), në vende publike, në mënyrë që të merren informacionet e rëndësishme lidhur me ____________________________.

Informacionet e tilla nuk mund të sigurohen më ndonjë mënyrë tjetër, sepse ________________________________________________________________________ _____________________________________________.

**BAZA LIGJORE:**

Neni _________, paragrafi ________, nën paragrafi _______, dhe ________, të KPPK-së.

Paragrafi ________. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare, mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

Nën paragrafi _______, ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare; dhe

Nën paragrafi _______, informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara, ka gjasë të ndihmojë në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Neni _____, paragrafi _____, nën paragrafi _____, dhe ____, pika _____, të KPPK-së.

Paragrafi_____, Urdhri nga neni ____, i këtij Kodi, mund të përdoret vetëm për hetimin e së paku një nga këto vepra të dyshuara penale:

Nën paragrafi _______, veprat penale të dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim; ose

Nën paragrafi _______, një apo më shumë nga veprat penale në vijim: pika ________, kontrabandimi me migrantë, në pajtim me nenin _____, të Kodit Penal

Neni ____, paragrafi ___, nën paragrafi ____, të KPPK-së.

Paragrafi _____, Gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit, mund të urdhërojë secilën nga masat e mëposhtme:

Nën paragrafi _______, fotografim të fshehtë ose vëzhgim me kamerë (video) në vende publike.

**Kërkesa të mëhershme për këtë masë, kundër të pandehurve të lartcekur, nuk ka pasur.**

Andaj, në pajtim me nenet e lartcekura, prokurori i nënshkruar, me respekt kërkon nga gjyqtari i procedurës paraprake, lëshimin e urdhrit për masën e fshehtë: Fotografim të fshehtë ose vëzhgim me kamerë (video) në vende publike, kundër të pandehurve: _______________, dhe _______________.

## ZYRTARI PËR ZBATIM TË URDHRIT:

Zyrtari i policisë, ______________, autorizohet si zyrtar përgjegjës dhe do të ketë përgjegjësinë për të siguruar përputhshmërinë e zbatimit të urdhrit me dispozitat e KPPK-së. Zyrtari policor mund të delegojë përgjegjësinë e tij te një tjetër zyrtar i policisë, nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tij. Zyrtari i policisë, fillon të zbatojë urdhrin jo më vonë se 15 ditë pas lëshimit të tij.

**KËRKESAT PËR RAPORTIM:**

Urdhëron që zyrtari i policisë _________________, apo zyrtari tjetër i policisë nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tij, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e lëshimit të urdhrit, t'i raportojë gjyqtarit që e ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit të autorizuar.

Të lëshohen tri kopje origjinale të këtij urdhri.

**KOHËZGJATJA E URDHRIT:**

Urdhëron që masa e përshkruar më lart, të mos tejkalojë fillimin e zbatimit mbi gjashtëdhjetë ditë nga data e lëshimit të urdhrit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**KOMPANISË SË TELEFONISË MOBILE – __________________,**
**NË ____________________,**

Bazuar në nenin ___________, të Kodit të Procedurës penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË**

Për nxjerrjen e tabelave telefonike dhe dorëzimin e tyre, në Prokurorinë Themelore në ___________, zyra nr. ______ të IMEI-të, si dhe dorëzimin e aparatit telefonik në të cilin është përdorur numri i telefonit ______________, po ashtu edhe hartografinë lidhur me këtë numër, për intervalin kohor nga data ____________, deri më datën ________________, pasi që është e nevojshme që të merren informatat për lëvizjen e personit që ka shfrytëzuar këtë numër.

**Baza Ligjore e kërkesës:**

Në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, është parashikuar detyrimi i organeve publike që të ndihmojnë prokurorin e shtetit. Sipas kësaj dispozite, detyrohen që prokurorit të shtetit, gjykatave dhe organeve tjera kompetente që marrin pjesë në procedurë penale t'u japin ndihmën e nevojshme, sidomos për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale ose vendndodhjen e kryerësve.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/**
**Basic Prosecution Office ____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**PËR: GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të raporteve dhe kërkesës së Policisë për masa të fshehta – përgjimi i telekomunikimeve, me numër të referencës nr. _____________, të datës _______________, dhe në pajtim me nenin _____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR MASËN E FSHEHTË TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE HETIMIT**

**Përgjimi i telekomunikimeve, duke përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet tjera elektronike, në formë të shkruar dhe elektronike – në CD**

Për numrat e IMEIT-së _____________, dhe ________________.

Kundër të pandehurve: ____________________________ (shëno të dhënat personale)**.**

Sepse ekziston dyshimi i bazuar se _______________________ (përshkruhet gjendja faktike: koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale).

- me këtë kanë kryer veprën penale:

_________________________ nga neni _____________________ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Policia e Kosovës - Drejtoria ____________________, në ________________, më datën ______________, ka paraqitur kallëzim penal, me numër të referencës ________________, në Prokurorinë Themelore të ______________________, kundër të pandehurve __________________, __________________, ___________________ dhe _____________, për shkak të dyshimit se në bashkëveprim, kanë kryer veprën penale ___________________________, nga neni ___________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore e _________________, më datën _______________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve të lartcekur, për shkak të dyshimit se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale ______________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Nga raportet e deritanishme, për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, rezulton se ______________________________________________________________ ________________________________________.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________** - departamenti _____________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit: ____________, për shkak të veprës penale ___________ nga neni ______ të KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në _____________PP__.nr._______/___ të datës _____________ për aprovim retroaktiv të urdhrit gojor për kontroll, në bazë të nenit _____________ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, me datën _______________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR APROVIM RETROAKTIV TË URDHRIT GOJOR PËR KONTROLL**

APROVOHET në mënyrë retroaktive urdhri gojor i datës __________________ për kontrollin e ___________________________ (shëno saktë të dhënat e personit të dyshuar / pandehur si dhe vendin e saktë ku është kryer kontrolli)

**A r s y e t i m**

Më datë ___________ prokurori i shtetit (ose policia e Kosovës) në Prokurorinë Themelore në ______________________, ka kërkuar që të lejohet kontrolli i shtëpisë, banesës dhe lokaleve të të dyshuarit ____________________, për shkak të dyshimit se i njëjti është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ________________________, nga neni ________ i KPRK-së

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, ka shqyrtuar kërkesën e sipërpërmendur dhe ka dhënë urdhër gojor për kontroll.

Ky veprim ndërmerret nga shkaku se sipas informatës së marrë nga Prokurori i shtetit si dhe nga vet Policia e Kosovës – Drejtoria ____________________________ në ________________ rezultonte se në rastin konkret bëhet fjalë për rrethana të ngutshme, ku urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merrej me kohë dhe ekzistonte rreziku real për vonesë, që mund të rezultonte me humbjen e provave, ose rreziku ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, sepse dyshohej se ____________________ __________________________________________________________________________, andaj duke u marrë për bazë këto rrethana dhe në bazë të nenit ___________, paragrafi _____, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përmes këtij Aktvendimi, konfirmoj në mënyrë retroaktive urdhrin gojor për kontroll të përshkruar më lartë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Gjykatësja e procedurës paraprake**
**N.N.**
**______________________**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT _________________________**
**GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në bazë të nenit 110, paragrafi 6, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes ketë:

**KËRKESË PËR APROVIM RETROAKTIV GJYQËSOR TË KONTROLLIT**

Të kryhet kontroll, në bazë të nenit _______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës në _________________, (shtëpi, banesë lokal etj) adresa _______________, më datën _________.

Kundër të pandehurit: _________________________________ (shënimet personale të të pandehurit)

Për shkak të veprës penale: ______________________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

**A r s y e t i m**

Gjatë marrjes së deklaratave të dy zyrtarëve të financave të _________________ (Ministri, Komunë, Kompanie etj.), është marrë informacioni se në këtë _______________, (institucion) gjenden disa dëshmi (shënime, paragona etj.) lidhur me pagesat që u janë bërë ____________, që kanë punuar në _______________, për ______________, të referuar në ______________________, dëshmi të cilat janë të

rëndësishme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale.

Më datën ________________, në bazë të autorizimit të prokurorit, Policia e Kosovës, ka shkuar në ______________________, për të kërkuar dëshmitë e lartcekura, mirëpo personat zyrtarë duke përfshirë edhe të pandehurin ____________________, kanë deklaruar se nuk i kanë këto dëshmi, andaj është paraqitur nevoja që të kryhet kontrolli urgjent nga policia në mënyrë që të mos zhduken këto dëshmi.

Lidhur me këtë nevojë urgjente të kontrollit, është njoftuar gjyqtarja e procedurës paraprake ____________________, nga e cila është kërkuar lëshimi i urdhrit gojor për kontroll dhe ajo e ka dhënë këtë urdhër.

Pas lëshimit të urdhrit gojor, nga ana e gjyqtares së procedurës paraprake, Policia e Kosovës, ka filluar zbatimin e urdhrit gojor për kontrollë në prezencë të mbrojtësit – përfaqësuesit të ________________, si dhe dëshmitarëve, dhe kontrolli ka rezultuar me sekuestrimin e ____________________________________________________________
__________________________.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më lart, me respekt, kërkoj nga Gjyqtarja e procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për aprovim retroaktiv të urdhrit të dhënë gojor për kontroll të lartcekur, në mënyrë që urdhri të jetë i ligjshëm dhe dëshmitë e sekuestruara të shërbejnë si prova të pranueshme në procedurën penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTIT _____________________**
**P Ë R:**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas rishikimit të raporteve të Policisë së Kosovës – sektori për hetimet e integruara financiare në Prishtinë - referenca ____________________, i datës _____________, dhe në pajtim me _______, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR SEKUESTRIMIN E PËRKOHSHËM**

Të shtëpisë që është në pronësi të pandehurit ___________________, e cila gjendet në ____________, (shëno adresën) si pasuri që i ka mundësuar kryerjen e veprës penale.

**Kundër të pandehurit: _________________(shëno të dhënat personale)**

Ekziston dyshimi i bazuar (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale).

Më këtë vepër, kishte për të kryer veprën penale:
- ______________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Me shkresën e Policisë së Kosovës – Departamenti ____________, nr. ____, i datës __________, Prokuroria është njoftuar se i dyshuari ____________, është i përfshirë

në kryerjen e veprës ____________________, nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh këtë shkresë të Policisë, Prokuroria Themelore në ____________ për këtë çështje penale, urgjentisht ka lëshuar urdhrat e përkohshëm për masat e fshehta ________________________, më datat ____________, dhe _____________, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është përfshirë në kryerjen e veprës penale të lartcekur dhe se pritja e lëshimit të urdhrit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, për këtë masë, mund të rrezikonte sigurimin e provave të rëndësishme, për këtë fazë të hetimeve.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën __________, nr.__________, të datës _________, ka konfirmuar urdhrat e lartcekura të Prokurorisë Themelore.

Nga raporti i Policisë së Kosovës – Drejtoria ___________, i datës __________, lidhur më zbatimin e urdhrave të lartcekura, rezulton si në vijim: ________________________ (shëno të gjeturat nga raportet e policisë).

Pas pranimit të raportit të policisë, Prokurori i shtetit, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit _____________, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale: ______________________, nga neni __________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ___________, duke vepruar në bazë të nenit ___________, të KPPK-së Policia e Kosovës – Drejtoria _________________, në ____________, pas njoftimit të prokurorit të shtetit dhe pas marrjes së urdhrit gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ______________________, në ________________ (shëno adresën), dhe ka sekuestruar______________________ (shëno saktë së çka është sekuestruar nga policia gjatë kontrollit).

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën __________, nr.__________, të datës ___________, ka konfirmuar aprovimin retroaktiv të kontrollit të lartcekur, të kryer nga Policia e Kosovës.

Fakti se shtëpia është në pronësi të të pandehurit ______________, që gjendet në ____________, (shëno adresën) është shfrytëzuar për kreyrjen e veprës penale që i vihet në barrë, pra për t'ia mundësuar kryerjen e veprës penale, ka rezultuar nga:________________________________________.

**BAZAT LIGJORE:**

**Neni _________, paragrafët _______, dhe _______, të KPPK-së**
Paragrafi ______. **Sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë** sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, **sende ose pasuri që kanë mundësuar**

**kryerjen e veprës penale**, ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin.

Paragrafi ______. Prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave apo parave. Kërkesa e tillë duhet të ceket me saktësi: sendet, pasurinë, provat apo paratë dhe duhet të përshkruajë si mund të jenë këto sende -prova të veprës penale, si këto sende, pasuri apo para që mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale, ose si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale. Sendet, pasuria, provat apo paratë - mund të sekuestrohen përkohësisht vetëm me urdhër të gjykatës.

Paragrafi _______. Ndërtesat apo prona e paluajtshme që sekuestrohet përkohësisht vendosen njoftimet e vëna në atë ndërtesë apo pronë të paluajtshme që njofton qytetarët se prona i është nënshtruar sekuestrimit të përkohshëm, që hyrja në të nuk është e lejuar dhe që ata që hyjnë pa leje mund t'i nënshtrohen arrestit.

Nga sa u tha më sipër, prokurori i nënshkruar më poshtë, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri _____________, ka kryer veprat penale të theksuara më lart dhe duke marrë parasysh se ka shfrytëzuar pasurinë e tij - _________________ (shëno adresën), e cila ia ka mundësuar kryerjen e veprës penale, i propozon gjyqtarit të procedurës paraprake sekuestrimin e përkohshëm të:

______________________ që është pronë e të pandehurit _____________, e cila gjendet në ____________ (shëno adresën), si pasuri që i ka mundësuar të pandehurit ________________, kryerjen e veprës penale - ______________________ nga neni ______________________ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, lidhur me veprën penale - __________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**________, nr._____/ ________**

**GJYKATA THEMELORE NË ____________________________** - Departamenti _______________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, _____________ dhe _____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, për sekuestrim të përkohshëm, më datën _______________, nxjerr këtë:

**URDHËR**
**PËR SEKUESTRIM TË PËRKOHSHËM**

Të pandehurit _____________________________________ (shëno të dhënat personale) i SEKUESTROHET PËRKOHËSISHT, pasuria________________, e cila gjendet në ____________, (shëno adresën), si pasuri që ia ka mundësuar kryerjen e veprës penale.

**A r s y e t i m**

Më datë ________________, prokurori i shtet, ka kërkuar që të bëhet sekuestrimi i përkohshëm i pasurisë ______________________________________, së të pandehurit ________________, e cila gjendet në ____________, (shëno adresën), si pasuri që i ka mundësuar kryerjen e veprës penale _____________, nga neni ______, i KPRK-së.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit për sekuestrim të përkohshëm, gjeti se: kërkesa është e bazuar.

Sipas shkresave të lëndës, rezulton se me shkresën e Policisë së Kosovës – Departamenti __________________, nr. ____, të datës ________________, Prokuroria ishte njoftuar se __________________________________________________________ _______________________________________________________________.

Duke marrë parasysh raportin njoftues të sipërpërmendur të policisë dhe faktin së kjo çështje penale kërkonte veprim urgjent, në mënyrë që të sigurohen provat e nevojshme dhe për t'iu shmangur mundësisë së zhdukjes së këtyre provave, Prokuroria Themelore në ______________, në ketë çështje penale, urgjentisht ka lëshuar urdhrat e përkohshëm për masat e fshehta më datat ____________, dhe ________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën _______, nr.__________, të datës _________, ka konfirmuar urdhrat e lartcekur të Prokurorisë Themelore.

Nga raporti i Policisë së Kosovës, i datës __________, lidhur me zbatimin e urdhrave të lartcekur, rezulton si në vijim: _______________________________(shëno të gjeturat nga raportet e policisë).

Më datën ___________, gjyqtarja e procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së prokurorisë ka lëshuar urdhrin për kontroll të shtëpisë dhe të lokaleve tjera të të pandehurit __________________, në ________________ (shëno adresën), ku ka gjetur dhe sekuestruar _____________________________.

Fakti se pasuria______________, është në pronësi të të pandehurit ______________, që gjendet në ____________ (shëno adresën) dhe është shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë, është vërtetuar nga ____________________________ _______________________________________________________________.

Nga sa u theksua më lart, rezulton se kjo pasuri ______________, ishte shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale që u vihet ne barrë të pandehurve në përgjithësi dhe në këtë rast, konsiderohet si pasuri që ka mundësuar kryerjen e veprës penale, andaj janë plotësuar kushtet ligjore nga neni __________, i KPPK-së që kjo pasuri të sekuestrohet përkohësisht deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Më vonë, do të vendoset për konfiskim të përhershëm ose jo.

**GJYKATA THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**_________ nr. _____/________ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** __________________

**Gjyqtari i procedurës paraprake** ______________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTI__________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shikimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit ______________, avokatit ______________, të datës ____________, të cilën e kam pranuar nga ana Juaj, më datë _____________, për të dhënë mendim lidhur me kthimin e sendeve të sekuestruara; parave, automjetit, dokumentacionit të banesës dhe një llaptopi, paraqes këtë:

**M E N D I M**

Kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit _____________, avokatit ______________, për kthimin e sendeve të sekuestruara, ________________________________, duhet të refuzohet, sepse __________________________, andaj derisa janë duke u kryer këto veprime dhe nuk vërtetohet prejardhja e këtyre aseteve, konsideroj se sendet e sekuestruara nuk duhet t'i kthehen të pandehurit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORIA_______________, NË ____________,**
**PËR POLICIN HETUESIN ______________**

**AUTORIZIM**
**Për kthimin e parave në Fondin e fshehtë të Policisë së Kosovës**

Pas zbatimit me sukses të masës së fshehtë teknike të vëzhgimit dhe hetimit – blerja e simuluar, e kryer më datën _______________, **Ju autorizoj** që paratë në shumë prej _________ euro (shih kërkesën tuaj të datës _____________ për kthimin e parave në fondin e fshehtë) të cilat janë marrë nga Fondi i fshehtë i Policisë së Kosovës, për të kryer blerjen e simuluar, në rastin PP__.nr._____________ (rasti juaj me numër të referencës ________), i njohur si rasti "______", kundër të pandehurve ______________, etj, t'i ktheni përsëri në Fondin e fshehtë të Policisë së Kosovës.

Pas dorëzimit të këtyre parave, të paraqitni pa vonesë raport në këtë prokurori.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**Policisë së Kosovës – Departamenti ____________________, në ________________,**
**Policit hetues ____________ apo zyrtarit tjetër policor që është nën përgjegjësinë, mbikëqyrjen apo kontrollin Tuaj.**

**A U T O R I Z I M**
**PËR KTHIMIN E SENDEVE**

Pas shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit _________________, av. _______________ për kthimin e sendeve të sekuestruara, **Ju autorizoj** që të pandehurit t'ia ktheni sendet, si në vijim:

1.____________________
2.____________________
3.____________________

Të gjitha shkresat e lartcekura, duhet të kopjohen dhe një kopje duhet të ruhet edhe më tutje nga policia, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa origjinalet duhet t'i kthehen të pandehurit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_______________________

**________.nr._____**

**GJYKATA THEMELORE NË _____________________________** - departamenti _______________, Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, _____________ dhe _____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në _______________, për shitjen e sendit të sekuestruar, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, me datën _______________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**MBI SHITJEN E SENDIT TË SEKUESTRUAR**

Shitet ___________________ (shëno të dhënat e plota të sendit që shitet)

**A r s y e t i m**

Më datë ___________, Prokurori i shtet, ka sjell aktvendimin për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit ______________________, për shkak të dyshimit të bazuar së i njëjti ka kryer veprën penale ____________________, nga neni ___________, i KPRK-së.

Në bazë të kërkesës së Prokurorit të shtetit, PP__, nr.________, të datës ___________, Gjyqtari i procedurës paraprake, më datë _________, ka marrë urdhër për sekuestrim të përkohshëm të ________________________________________________________________ _____________.
(shëno të dhënat e sendit të sekuestruar)

Meqenëse i pandehuri ka deklaruar se ky automjet nuk ishte i tij dhe se nuk e dinte emrin e pronarit të _____________________, Prokurori i shtetit, ka publikuar shpalljen në tabelën e shpalljeve të Kuvendit Komunal, në ___________________ dhe në tabelën e shpalljeve, në Kuvendin Komunal, në ____________. Me këtë shpallje në tabelë, është ftuar pronari i ______________ që në afat prej 1 (një) viti të paraqitet në zyrën e Prokurorit të shtetit, sepse në të kundërtën _____________, do të shitet dhe parat nga shitja do të barten në buxhet.

Meqenëse në afatin prej 1 (një) viti nga shpallja publike, pronari i _____________ të sipërpërmendur nuk është paraqitur, Prokurori i shtetit, më datë _________________, ka paraqitur në këtë gjykatë kërkesë më të cilën ka kërkuar që të bëhet shitja e _____________ të sipërpërmendur dhe paratë të barten në buxhet.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kërkesës së prokurorit, gjeti se:

Kërkesa është e bazuar.

Kjo kërkesë është e bazuar nga shkaku se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni _________, i KPPK-së, për shitjen e ______________ (shëno të dhënat e sakta të sendit që shitet), pasi që pronari i ____________, nuk është paraqitur në afatin ligjor prej 1 (një) viti nga dita e Shpalljes publike në tabelën e shpalljeve të Kuvendit Komunal në ____________ dhe në tabelën e shpalljeve në Kuvendin Komunal në ____________.

**GJYKATA THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**_______ nr. _____________ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** __________________

**Gjyqtari i procedurës paraprake,** ______________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Duke vendosur në bazë të nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, më datë _________________, paraqes këtë:

**SH P A LL J E**

Me të cilën i bëj thirrje, pronarit të automjetit ____________________, me tabela të regjistrimit ______________________, ngjyrë e ____________________, me numra të shasisë ________________________________, që të paraqitet në zyrën, nr. __________, në Prokurorinë Themelore në ___________________, në afat prej 1 (një) viti, afat që fillon nga data __________.

Nëse pronari i automjetit, nuk paraqitet në Prokurorinë Themelore në _____________, deri më datën ___________, automjeti i sipërpërmendur do të shitet dhe paratë e fituara nga shitja do të barten në buxhet.

Kjo shpallje, publikohet në tabelat e shpalljeve në ndërtesën e Kuvendit Komunal në ____________________, dhe në ndërtesën e Kuvendit Komunal në _______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**______________________**

**Adresa:________________**

**_______________________**

**Tel:__________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË _______________**
**PËR PROKURORIN _________________**

Në bazë të nenit ____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit __________________, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR SIGURIMIN E PROVËS – ____________________ E CILA GJENDET NË ________________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit ________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: __________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën _______________, i pandehuri _______________ më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh zhvillimin e deritanishëm të hetimeve dhe deklaratën e të pandehurit të dhënë para Prokurorit të shtetit, më datë __________________, kërkoj nga Prokurori i çështjes që të kërkojë nga __________________, që ta dorëzojë në Prokurorinë Themelore në ________________, te Prokurori i çështjes _____________, provën ____________________, e cila gjendet në _______________________.

Kjo provë _____________________, është shumë me rëndësi në këtë çështje penale, sepse ____________________________________________________________
____________________________.

Sipas deklaratës së të pandehurit, të datës ________________, që është dhënë para Prokurorit të shtetit, prova ______________, gjendet në objektin e _______________, kati ___________, në zyrën nr.___________, në ______________.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**

**______________________**

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**______________________**

**Adresa:________________**

**_______________________**

**Tel:__________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË _________________**
**PËR PROKURORIN __________________________**

Në bazë të nenit _____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ___________________, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR QASJE NË SHKRESAT E LËNDËS, PP__, nr.____________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit ________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: _____________________, nga neni ___________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Më datën _______________, i pandehuri _______________, më ka autorizuar që ta mbrojë në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga Prokurori i shtetit që është duke i zhvilluar hetimet në këtë çështje penale, të më lejoj qasjen në shkresat e lëndës ose materialet tjera, të cilat prokurori i ka në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, në mënyrë që unë dhe i pandehuri të kemi mundësinë që ta përgatisim mbrojtjen efektive dhe në bazë të dispozitave ligjore.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**____________________**

**Avokati**

**____________________**

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**________________________**

**Adresa:________________**

**_________________________**

**Tel:___________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË ___________________**
**PËR PROKURORIN ____________________________**

Në bazë të nenit ______________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ____________________, paraqes ketë:

**KËRKESË PËR MARRJEN E DEKLARATËS SË DËSHMITARIT ___________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetimet, për shkak veprës penale: ____________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, i pandehuri ________________, më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh zhvillimin e deritanishëm të hetimeve dhe vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje penale, e konsideroj si shumë të nevojshme që të ftohet për të dhënë deklaratë, në cilësi të dëshmitarit, edhe __________________, sepse ______________________________________________________________________ _________________.

Konsideroj se deklarata e këtij dëshmitari, mund të ndihmojë në zbardhjen e gjendjes faktike në këtë çështje penale dhe nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Dëshmitari __________________, jeton në këtë adresë: _________________________ dhe numri i tij i telefonit është: ___________________.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**

**______________________**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**Për Policinë e Kosovës – Departamenti______________, në __________,**
**Zyrtarëve policor: ______________________ dhe ___________________**

**AUTORIZIM**
**PËR MARRJEN NË PYETJE TË TË PANDEHURVE DHE DËSHMITARËVE**

Në bazë të nenit _________, paragrafi ______, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ju AUTORIZOJ që të merrni në pyetje të pandehurit si dhe dëshmitarët e identifikuar, në bazë të raporteve për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Gjatë marrjes në pyetje, është e nevojshme që të verifikohen numrat e telefonave që kanë përdorur të pandehurit dhe dëshmitarët, prej cilës datë apo kohë i shfrytëzojnë ata numra të telefonit, takimet, kontaktet apo marrëveshjet e arritura në mes të të pandehurve, prejardhjen e narkotikëve, raportet me të pandehurit në Norvegji dhe Suedi, çmimet që i kanë paguar apo është dashur t'i paguajnë për narkotikët, rrugën nëpër të cilën ka kaluar apo është dashur për të kaluar sasia e narkotikut, si dhe çështje tjera që janë të rëndësishme për ketë rast penal.

Pas marrjes në pyetje të të pandehurve dhe të dëmtuarve, por më së largu më datë _________________, të më njoftoni dhe të paraqitni raport lidhur më veprimet e ndërmarra, sipas këtij autorizimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Policisë së Kosovës**
**Drejtorisë për Hetimin e trafikimit me narkotikë**
**Hetuesit ______________ apo zyrtarit tjetër policor që është nën përgjegjësinë, mbikëqyrjen apo kontrollin Tuaj,**

## A U T O R I Z I M
## PËR MARRJEN E DEKLARATËS SË DËSHMITARIT

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në veçanti transkripteve të përgjimeve telefonike, **Ju autorizoj** që ta merrni në cilësinë e dëshmitarit, deklaratën e _________________, i lindur më ___________, nga fshati ______________, Komuna e______________.

Gjatë marrjes së deklaratës, të keni kujdes në mënyrë që të merrni informacione se a e njeh të pandehurin ______________, nëse njihen në mes veti, kur janë njoftuar, arsyen pse janë njohur apo takuar, a kanë pasur marrëveshje për ta dërguar djalin e këtij dëshmitari në shtetet e BE-së, si ka qënë marrëveshja, sa është dashur të bëhet pagesa dhe kur, cila ka qenë rruga nëpër të cilën ka kaluar djali i dëshmitarit deri në arritjen e tij në shtetet e BE-së si dhe çështjet tjera që lidhen me këtë rast.

Menjeherë pas marrjes së deklaratës, por më së voni deri më datën ______________, më njoftoni dhe më dorëzoni procesverbalin mbi marrjen e deklaratës në Zyrën time, pasi që të pandehurit janë në paraburgim dhe çështja është urgjente.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Më kërkesë të dëshmitarit ______________________, lëshoj këtë:

**V Ë R T E T I M**[7]

Më të cilin vërtetoj se dëshmitari ________________________, ka qenë në Prokurorinë Themelore në _______________, sipas ftesës së rregullt të kësaj prokurorie, më datën ______________, prej orës _________, deri ne ora ____________, për të dhënë dëshminë e tij lidhur me çështjen penale PP__, nr.____________.

Vërtetimi mund të shfrytëzohet vetëm për __________________, e jo për ndonjë qëllim tjetër.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

[7] Të njëjtën formë mund ta përdorë edhe gjyqtari.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë _____________

**TH I RR J E**
**PËR DËSHMITAR[8]**

Z.______________________ (shëno emrin, mbiemrin dhe profesionin e dëshmitarit dhe në rastet e nevojshme edhe të dhëna tjera).

Thirreni që të vini në Prokurorinë Themelore në ________________, Departamenti ________________, në zyrën nr.______________, më datë _____________, në ora _______, për të dhënë deklaratë në cilësinë e dëshmitarit, në çështjen penale kundër të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale __________________, nga neni _________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, detyroheni që t'i përgjigjeni thirrjes.

Në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mosparaqitja juaj e paarsyeshme, do të jetë shkas që t'ju detyrojmë të paraqiteni dhe mund të dënoheni me gjobë deri dyqindepesëdhjetë (250) euro për çdo mosparaqitje. Nëse ju paraqiteni, por pasi t'u jenë bërë me dije pasojat, refuzoni të dëshmoni pa arsyetim ligjor, mund të dënoheni me gjobë deri në dyqindepesëdhjetë (250) euro. Nëse edhe pas kësaj gjobe, refuzoni të dëshmoni, atëherë mund të burgoseni. Burgimi zgjat derisa nuk pranoni të dëshmoni apo derisa dëshmimi juaj bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë, por jo më shumë se një (1) muaj.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

[8] Kjo formë mund të shfrytëzohet edhe për thirrjen e ekspertit ose të dëmtuarit i cili duhet të njoftohet lidhur më të drejtën për kompensim të dëmit dhe për pasojat e mosparaqitjes lidhur më kërkesën për kompensim të dëmit.

**_______.nr._____**

**GJYKATA THEMELORE NË _____________** - departamenti _____________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit ____________, për shkak të veprës penale ___________, nga neni ______ i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit/avokatit ____________________ për shqyrtimin e pranueshmërisë së Procesverbalit mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit, me datën _______________, nxjerr këtë:

## A K T V E N D I M[9]

Më aprovimin e kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit ________________, Avokatit ____________________, shpallet si provë e papranueshme procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit e dhënë më datë _____________ para prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ______________.

## A r s y e t i m

Më datë ___________, mbrojtësi i të pandehurit ______________________________, avokati________________, ka kërkuar që Deklarata e të pandehurit, e dhënë më datë ___________________, para Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore, në _______________, të shpallet si provë e papranueshme, me arsyetim se të pandehurit nuk i janë lexuar të drejtat e tij, sipas nenit __________, lidhur me nenin __________, të KPPK-së dhe njëkohësisht, të pandehurit i është shkaktuar një lodhje e tepruar pasi që i njëjti është marrë në pyetje më tepër se 8 (tetë) orë pandërprerë.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, ka kërkuar të gjitha shkresat e lëndës nga prokurori i shtetit dhe pas shqyrtimit të tyre dhe vlerësimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, ka gjetur se kërkesa është e bazuar.

Ky aktvendim është sjell nga shkaku se sipas Procesverbalit mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit, rezulton qartë se ________________________________________ __________________________________.
(shëno arsyet e aprovimit të kërkesës)

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

---

[9] Kjo formë mund të shfrytëzohet në të gjitha rastet kur aprovohet kërkesa për pranueshmërinë e provës

**GJYKATA THEMELORE NË __________________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Gjykatësja e procedurës paraprake**
**N.N.**
**______________________________**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate.

**_______.nr._____/ _______**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________ - departamenti ______________,** Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit: ____________, për shkak të veprës penale ___________ nga neni ______ i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit në ____________________ PP__.nr.______/______, të datës _____________, për shqiptimin e dënimit me gjobë dhe detyrimin e dëshmitarit ________________ për t'u paraqitur në zyrën e Prokurorit, në bazë të nenit ______ të Kodit të Procedurës Penale, me datën _______________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR DENIMIN DHE DETYRIMIN E DËSHMITARIT[10]**

Me aprovimin e kërkesës së Prokurorit të Shtetit, në ______________ PP__. nr. ______/______, të datës _____________

Dëshmitarit _____________________ (shëno të dhënat personale) i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej ____________, të cilën shumë është i detyruar që ta paguajë në afat prej ____________, ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

Dëshmitari ________________, detyrohet që të paraqitet në Zyrën e Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë themelore, në ___________________, zyra nr._______, më datë ____________, në ora _________.

Mosparaqitja e dëshmitarit sipas këtij aktvendimi, ka si pasojë dënimin më gjobë në shumën prej ___________, për çdo mosparaqitje.

**A r s y e t i m**

Me datë ___________, Prokurori i Shtetit, në Prokurorinë Themelore, në ______________, ka paraqitur kërkesë, PP__ nr._______/______, për shqiptimin e dënimit më gjobë dhe detyrimin e dëshmitarit ________________ për t'u paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit, me datën _____________ në ora_______.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake, ka kërkuar të gjitha shkresat e lëndës nga Prokurori i shtetit dhe pas shqyrtimit të tyre, ka gjetur se kërkesa është e bazuar.

Ky aktvendim vjen për shkak se sipas shkresave të lëndës, rezulton qartë që dëshmitari ____________, ishte i ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e Prokurorit të çështjes dhe se i njëjti ishte paraqitur në zyrën e Prokurorit të shtetit por kishte refuzuar që të japë

[10] E njëjta formë mund të shfrytëzohet edhe për dënimin e dëshmitarit me burgim.

deklaratën e tij lidhur me këtë çështje penale dhe kishte deklaruar se nuk do t'u përgjigjet në të ardhmen ftesave të Prokurorit ________________________________ ____________________________________________________ (shëno edhe arsyet tjera nëse ka për aprovimin e kërkesës), andaj në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, nga neni ____________, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, për shqiptimin e dënimit me gjobë në shumën prej ____________, si dhe detyrimin e dëshmitarit __________________ që të paraqitet në Zyrën e Prokurorit të Shtetit për të dhënë deklaratë, lidhur me këtë çështje penale.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Gjykatësja e procedurës paraprake**
**N.N.**
**______________________________**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën së Apelit, në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate.

**____.nr.______**

**GJYKATA E APELIT NË ______________________________ -** Departamenti _______________, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: ___________ kryetar dhe _______________ e_____________ anëtarë, me sekretaren juridike ___________ si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale _____________, nga neni ___________, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së dëshmitarit ________________, të paraqitur kundër gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në ________________, _____, nr.__________, të datës ___________, më datën ______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e dëshmitarit _________________, e paraqitur kundër gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _________________________, _____, nr.__________ të datës __________, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në ________________, me aktvendimin _____, nr.__________, të datës _____________, ia ka shqiptuar dënimin me burg dëshmitarit ________________, për shkak të refuzimit të paarsyeshëm të dhënies së deklaratës lidhur me çështjen penale të të pandehurit ______________, të cilit i vihet në barrë vepra penale _____________, nga neni __________, të KPRK-së.

Kundër aktvendimit të lartcekur, dëshmitari _________________, ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të _______________, me propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ndaj të njëjtit të ndërpritet menjëherë masa e burgimit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe ankesës së dëshmitarit gjeti se:

**Ankesa nuk është e bazuar**

Ankesa nuk është e bazuar për shkak se gjyqtari i procedurës paraprake, ka vendosur drejtë kur në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se fletë kthesa, PPI. nr.__________ të datës _______________, shihet se dëshmitari _______________, është ftuar nga Prokurori i shtetit për të dhënë dëshminë e tij, më datë ________________, dhe se personalisht ai kishte nënshkruar fletëkthesën si dëshmi se e kishte pranuar thirrjen, mirëpo i njëjti nuk i është përgjigjur thirrjes dhe nuk ishte

paraqitur në zyrën e Prokurorit për të dhënë deklaratë dhe ketë mosparaqitje nuk e kishte arsyetuar.

Gjithashtu, Gjyqtari i procedurës paraprake, ka gjetur drejtë se sipas fletë kthesës, PPI. nr.___ të datës _______________, rezulton se dëshmitari _________________, përsëri ishte ftuar nga Prokurori i shtetit për të dhënë deklaratën e tij lidhur me këtë çështje penale dhe dëshmitari ishte paraqitur sipas kësaj thirrjeje, mirëpo nga procesverbali, PPI.nr.__________, që është mbajtur nga Prokurori i shtetit, më datë _________________, rezulton se ky dëshmitar edhe pse ishte paraqitur sipas thirrjes së rregullt, i njëjti ka refuzuar që të japë dëshminë e tij pa dhënë ndonjë arsyetim.

Në ketë çështje penale, janë të drejta konstatimet e Prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake se dëshmitari _________________, është dëshmitar okular dhe dëshmia e tij mund të ofrojë mjaft informacione që mund të dërgojnë deri te zbardhja e gjendjes faktike dhe mund të ndihmojë në gjetjen edhe të dëshmive tjera,

Gjykata e Apelit, konsideron se dëshmitari ka pasur për detyrë që të dëshmojë, komform nenit __________, paragrafi ________, të KPPK-së, andaj refuzimi i dhënies së dëshmisë pa asnjë arsyetim, lidhur me ketë çështje penale, paraqet bazë të mjaftueshme ligjore nga neni ________, paragrafi ________, i KPPK-së për të dënuar të njëjtin në kohëzgjatje prej një muaji, kështu që aktvendimi i Gjyqtarit të procedurës paraprake - është i drejtë, ndërsa pretendimi i dëshmitarit është i pabazuar.

Konstatimi i gjyqtarit të procedurës paraprake se nëse dëshmitari ______________, ndryshon qëndrimin e tij dhe dëshiron që të japë dëshminë e tij, gjatë kohës sa është duke vuajtur dënimin e shqiptuar sipas këtij aktvendimi, i njëjti do të lirohet menjëherë nga vuajtja e mëtutjeshme e dënimit. Dëshmitari mund të ndryshojë qëndrimin e tij, në çdo kohë gjatë vuajtjes së dënimit të shqiptuar dhe është e drejtë që nga kjo të përfitojë ndërprerjen e menjëhershme të dënimit më burgim.

Nga sa u theksua më lart, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS**
**DEPARTAMENTI __________________**
**____, nr.____________, datë ________________**

**Kryetari i Kolegjit**
**N.N.**
______________________

**_____.nr.________/____**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________, -** Departamenti __________________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale ______________, nga neni ______________, të KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në _______________, PP__, nr. ___________, të dt. _____________, për dënimin e dëshmitarit ______________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, me datën _______________, mori këtë:

## A K T V E N D I M[11]

Më aprovimin e kërkesës së prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në ____________________, dëshmitari _________________ (të shënohen të dhënat personale) DËNOHET me burgim në kohëzgjatje prej një muaji, duke filluar nga data ______________, deri më datën ______________.

### A r s y e t i m i

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka paraqitur kërkesë në ketë gjykatë, PP___, nr._____________, për dënimin me burg të dëshmitarit _____________, për shkak të refuzimit për të dhënë deklaratë, me arsyetim se _______________________ ____________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi shkresat e lëndës, kërkesën e prokurorit të shtetit dhe gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar.**

Në bazë të shkresave të lëndës, si: ________________________________, rezulton se dëshmitari _______________, nuk i është përgjigjur thirrjes dhe nuk ishte paraqitur në zyrën e prokurorit për të dhënë deklaratë, dhe ketë mosparaqitje nuk e kishte arsyetuar.

Sipas fletë kthesës PP___, nr. të datës _______________, rezulton se dëshmitari _________________, përsëri ishte ftuar nga prokurori i shtetit për të dhënë deklaratën e tij lidhur më ketë çështje penale dhe dëshmitari ishte paraqitur sipas kësaj thirrjeje, mirëpo nga procesverbali, PP__.nr.__________ që është mbajtur nga prokurori i shtetit, më datë _________________, rezulton se ky dëshmitar edhe pse ishte paraqitur sipas thirrjes së rregullt, ka refuzuar që të japë dëshminë e tij pa dhënë ndonjë arsyetim.

[11] Kjo formë e Aktvendimit, mund të përdoret edhe në rastin e shqiptimit të dënimit më gjobë ndaj dëshmitarit që nuk i është përgjigjur thirrjes së rregullt të prokurorit ose gjykatës dhe nuk e ka arsyetuar këtë mos përgjigje të tij.

Duke marrë parasysh faktin se dëshmitari ________________, është dëshmitar okular dhe dëshmia e tij mund të ofrojë informacione që mund të dërgojnë deri të zbardhja e gjendjes faktike dhe mund të ndihmojë në gjetjen edhe të dëshmive tjera, gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se ai e ka pasur për detyrë që të dëshmojë, komform nenit __________, paragrafi ________, të KPPK-së, andaj refuzimi i dhënies së dëshmisë pa asnjë arsyetim, lidhur me këtë çështje penale, paraqet bazë të mjaftueshme ligjore nga neni _________, paragrafi ________, të KPPK-së, për ta dënuar atë në kohëzgjatje prej një muaji.

Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi, gjyqtari ka marrë për bazë jo vetëm refuzimin e dëshmisë nga ana e dëshmitarit, por edhe mosparaqitjen e tij në prokurori, sipas thirrjes së parë të rregullt.

Nëse dëshmitari ______________, ndryshon qëndrimin e tij dhe dëshiron që të japë dëshminë e tij, gjatë kohës sa është duke vuajtur dënimin e shqiptuar, sipas këtij aktvendimi, ai do të lirohet menjëherë nga vuajtja e mëtutjeshme e dënimit.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**GJYQTARI I PROCEDURËS PARAPRAKE**
**_____, nr. _________ më datë ______________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake**

_________________ _____________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa pranë Kolegjit shqyrtues të kësaj gjykate, në afat prej 3 ditësh.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTIT _______________________**

**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenin ______, paragrafi ______, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes:

**KËRKESË PËR DËNIMIN ME BURG TË DËSHMITARIT**

**Kundër dëshmitarit:_______________________ (shëno të dhënat personale).**

**Shqiptohet dënimi me burgim, në kohëzgjatje prej një muaji, i cili do të fillojë nga data________________, deri më datën ________________.**

**ARSYETIM**

Në Prokurorinë Themelore të ___________________, janë duke u zhvilluar hetimet kundër të pandehurve ________________ dhe ______________, për shkak të dyshimit se të njëjtit kanë kryer veprën penale _____________________, nga neni _________, të KPRK-së.

Prokurori i shtetit, më datë ______________________, ia ka dorëzuar dëshmitarit ________________, thirrjen për t'u paraqitur në Zyrën e tij, për të dhënë dëshminë e tij, më datë _________________ dhe nga fletë kthesa, rezulton se ai personalisht e ka nënshkruar fletë kthesën si dëshmi se e ka pranuar thirrjen, mirëpo ai nuk i është

përgjigjur thirrjes dhe nuk është paraqitur në Zyrën e prokurorit për të dhënë deklaratë, duke mos e arsyetuar këtë mosparaqitje.

Prokurori i shtetit, këtij dëshmitari _________________, përsëri ia ka dorëzuar thirrjen për të dhënë deklaratën e tij, lidhur me këtë çështje penale, më datë _______________ dhe dëshmitari është paraqitur sipas kësaj thirrjeje, mirëpo siç mund të shihet nga procesverbali PPI. nr.__________ i datës __________________ që është mbajtur nga Prokurori i shtetit, rezulton se ky dëshmitar edhe pse është paraqitur sipas thirrjes së rregullt, ai ka refuzuar që të japë dëshminë e tij, pa dhënë asnjë arsyetim.

Duke marrë parasysh faktin se dëshmitari _________________, është dëshmitar i rëndësishëm dhe dëshmia e tij mund të ofrojë mjaft informacione që mund të dërgojnë deri te zbardhja e gjendjes faktike dhe mund të ndihmojnë në gjetjen edhe të dëshmive tjera, konsideroj se i njëjti ka pasur për detyrë që të dëshmojë konform nenit __________, paragrafi ________, të KPPK-së. Refuzimi i dhënies së dëshmisë pa asnjë arsyetim, lidhur me këtë çështje penale, paraqet bazë të mjaftueshme ligjore nga neni _________, paragrafi ________, të KPPK-së për të dënuar të njëjtin në kohëzgjatje prej një muaji.

Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi, gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë për bazë jo vetëm refuzimin e dëshmisë nga ana e dëshmitarit por edhe mosparaqitjen e tij në Prokurori, sipas thirrjes së parë të rregullt.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ____________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenet _________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqesë këtë:

**KËRKESË PËR SHQIPTIMIN E DËNIMIT ME GJOBË DHE DETYRIMIN PËR T'U PARAQITUR NË ZYREN E PROKURORIT[12]**

**Kundër dëshmitarit: ______________________ (shëno te dhënat personale).**

**A R S Y E T I M**

Policia Kufitare e Kosovës, më datën ___________________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve ________________, _____ _____ ______ dhe ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprat penale ________________, nga neni _________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datë ________________, prokurori i shtetit ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: ____________________, ______________________ dhe _________________ për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprat

[12] E njëjta formë mund të shfrytëzohet edhe në rastin e kërkesës për denim më burgim të dëshmitarit.

penale _______________, nga neni_________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë fazës së hetimeve, është parashikuar që të merret deklarata në cilësinë e dëshmitarit të ______________________, të cilit i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt tri ftesa për datat: _______________, ________________ dhe ________________.

Në të tri rastet, dëshmitari ___________________, i ka pranuar personalisht ftesat për t'u paraqitur në zyren e prokurorit të shtetit, për të dhënë deklaratën e tij në cilësi të dëshmitarit. Kjo vërtetohet nga fletë kthesat ku është vendosur data e pranimit me shkronja dhe me tekst si dhe nënshkrimi i dëshmitarit. Edhe pse ai një herë është paraqitur sipas ftesës, ka refuzuar që të japë dëshminë dhe pastaj pas pranimit edhe të ftesave tjera, asnjëherë nuk është paraqitur në zyren e prokurorit dhe nuk ka ofruar asnjë arsyetim për mosparaqitjen e tij.

Duke marrë parasysh refuzimin e dëshmisë si dhe mosparaqitjen e dëshmitarit, sipas ftesave të rregullta dhe mosarsyetimin e mungesës së tij, në këtë rast, janë plotësuar kushtet ligjore nga neni ___________, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës që gjyqtari t'i shqiptojë dëshmitarit ____________________, dënimin me gjobë në shumë prej _________, për secilën mosparaqitje, sipas ftesave të rregullta dhe njëkohësisht të urdhërojë dëshmitarin që të paraqitet në zyren e prokurorit, më së largu më datën _______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS - DREJTORISË PËR ________________**
**PËR: ZYRTARIN POLICOR___________________**

**KËRKESË PËR SJELLJEN E DETYRUESHME TË DËSHMITARIT**

Dëshmitari _________________, nga ________________, ka pranuar në mënyrë të rregullt disa thirrje për t'u paraqitur në prokurori, për të dhënë deklaratën e tij, lidhur me çështjen penale të të pandehurit ____________________, të cilit i vihet në barrë vepra penale ______________ _____, nga neni __________, i KPRK-së, mirëpo nuk i është përgjigjur asnjë thirrjeje dhe këtë nuk e ka arsyetuar në asnjë rast.

Për shkak të mosparaqitjes, sipas thirrjes së rregullt, në pajtim me nenin ___________, paragrafi __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga ju që ta sillni në mënyrë të detyrueshme, dëshmitarin _______________, nga _____________, komuna e ____________ (shëno të dhënat e sakta personale dhe adresën e dëshmitarit).

Dëshmitari duhet të sillet në Prokurorinë Themelore në _______________, zyra numër __________, më datën ______________, në ora _______________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u ____________/**
**Basic Prosecution Office ____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS**
**DREJTORISË PËR ________________**
**Z.________________________**

Në pajtim me nenin ______, paragrafi _____, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju dërgoj këtë:

**N J O F T I M**

**Lidhur me refuzimin e dhënies së deklaratës nga ana e dëshmitarit/zyrtarit të policisë së Kosovës _____________________________, në çështjen penale, PPI. Nr.______________**

I nderuari z. Drejtor,

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ______________, më datë _______________, ia ka dorëzuar dëshmitarit/zyrtarit të Policisë së Kosovës ________________, thirrjen për t'u paraqitur në zyrën e tij, për të dhënë dëshminë e tij, më datë _________________, dhe nga fletë kthesa rezulton se ai personalisht e ka nënshkruar fletë kthesën si dëshmi se e ka pranuar thirrjen, mirëpo ai nuk i është përgjigjur thirrjes dhe nuk është paraqitur në zyrën e prokurorit për të dhënë deklaratë dhe këtë mosparaqitje nuk e ka arsyetuar.

Prokurori i shtetit, këtij dëshmitari/zyrtarit të Policisë së Kosovës, përsëri ia ka dorëzuar thirrjen për të dhënë deklaratën e tij, lidhur me këtë çështje penale, më datë _______________, dhe dëshmitari është paraqitur sipas kësaj thirrjeje, mirëpo ai edhe

pse është paraqitur në zyrën e prokurorit, ka refuzuar që të japë dëshminë e tij pa dhënë asnjë arsyetim.

Duke marrë parasysh faktin se dëshmitari/zyrtari i Policisë së Kosovës ___________, është dëshmitar i rëndësishëm dhe dëshmia e tij mund të ofrojë mjaft informacione që mund të dërgojnë deri të zbardhja e gjendjes faktike dhe mund të ndihmojnë në gjetjen edhe të dëshmive tjera, konsideroj se ai ka për detyrë që të dëshmojë konform nenit __________, paragrafi ________, të KPPK-së, andaj refuzimi i dhënies së dëshmisë pa asnjë arsyetim lidhur me këtë çështje penale, paraqet një sjellje të papranueshme dhe të dëmshme jo vetëm për ketë çështje penale por edhe për imazhin e Policisë së Kosovës, andaj është e nevojshme që të merrni parasysh këtë sjellje të tij dhe sipas ligjit dhe akteve tjera nënligjore për Policinë të merrni edhe masat e nevojshme që ai të paraqitet në prokurori në zyrën time dhe të japë deklaratën e tij lidhur me këtë çështje penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit______________, si dhe në pajtim me nenin _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr këtë:

## A K T V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E EKSPERTIT SIPAS KËRKESËS SË MBROJTËSIT

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për caktimin e ekspertit të _______________________________, për ekzaminimin __________________, të të pandehurit _____________________.

## A r s y e t i m

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: ___________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Mbrojtësi i të pandehurit __________________, avokati ____________________, ka paraqitur kërkesë për caktimin e ekspertit të ___________________, për ekzaminimin ____________________, të të pandehurit _________________________, me arsyetim se ___________________________________.

Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur të mbrojtësit të të pandehurit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, prokurori i shtetit gjeti se:

**Kërkesa është e pabazuar.**

Kërkesa është e pabazuar për shkak se ________________________________ (shëno arsyet e refuzimit).

Nga sa u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
____________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në ________________, - Departamenti i ______________, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së tij.

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**________________________**

**Adresa:________________**

**_________________________**

**Tel:___________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË _________________**
**PËR PROKURORIN _________________________**

Në bazë të nenit ______________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ____________________, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR CAKTIMIN E EKSPERTIT TË NEUROPSIKIATRISË PËR EKZAMINIMIN PSIKIATRIK TË TË PANDEHURIT _____________________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak të veprës penale: ______________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, i pandehuri ________________, më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh gjendjen psikike të të pandehurit ___________________, dhe në bazë të dispozitës së nenit __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga Prokurori i shtetit, që të caktojë një ekspert të psikiatrisë për ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit, në mënyrë që të vërtetohet gjendja e tij psikike si dhe aftësia e tij për të kuptuar veprimet e tij në kohën e kryerjes së veprës penale.

Konsideroj se ky ekzaminim psikiatrik është i domosdoshme për të përcaktuar shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**

**______________________**

**________.nr._____**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________** - departamenti ______________, Gjyqtari i procedurës paraprake ______________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________ etj., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar pas kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit, __________________ avokatit ______________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit në Prokurorinë themelore në _____________ PPI.nr. __________të datës __________________ për caktimin e ekspertit, në bazë të nenit __________ të KPPK-së, me datën _______________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**[13]

APROVOHET si i bazuar kundërshtimi i mbrojtësit të të pandehurit ______________, avokatit _____________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në _____________ PP__.nr. __________të datës __________________, për caktimin e ekspertit, ashtu që i njëjti aktvendim prishet dhe lënda i kthehet të njëjtit Prokuror për rivendosje dhe caktim të ekspertit tjetër të pavarur dhe të paanshëm.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në ____________ PP__.nr. __________të datës __________________, është vendosur që të caktohet si ekspert ____________________ i cili duhet të kryejë ekspertizën lidhur me ____________________.

Kundër aktvendimit të sipër përmendur të Prokurorit të shtetit, më datë ____________ mbrojtësi i të pandehurit _______________, avokati __________________, ka paparaqitur kundërshtim, me arsyetim se eksperti i caktuar nga ana e Prokurorit ________________________________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit, gjeti se:

Kundërshtimi është i bazuar.

Ky aktvendim, vjen nga shkaku se ___________________________________________ (shëno arsyet e aprovimit të kundërshtimit).

[13] Kjo formë mund të përdoret për të gjitha rastet kur gjyqtari i procedurës paraprake vendos për aprovimin e kundërshtimit për caktimin e ekspertit

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr. _____________ më datë _______________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

_________________ _____________________________

**______.nr._____**

**GJYKATA THEMELORE NË ____________________________ -** departamenti ________________, Gjyqtari i procedurës paraprake ____________, me sekretaren juridike ___________, në lëndën penale kundër të pandehurit: ___________, etj. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________, nga neni _____________, i KPRK-së, duke vepruar pas kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit ________________, avokatit _______________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në _______________ PP______, nr. _________, të datës ________________. për caktimin e ekspertit, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, me datën ______________, nxjerr këtë:

## A K T V E N D I M[14]

REFUZOHET si i pabazuar kundërshtimi i mbrojtësit të të pandehurit ____________, avokatit ____________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ___________________, PP___, nr. _________, të datës _________________, për caktimin e ekspertit.

## A r s y e t i m

Me aktvendimin e Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në ____________, PP__, nr. _________, të datës _________________, është vendosur që të caktohet si ekspert ____________________________, i cili duhet të kryejë ekspertizën lidhur më ___________________.

Kundër aktvendimit të sipërpërmendur të Prokurorit të shtetit, më datë ___________, mbrojtësi i të pandehurit _________________, avokati ___________________, ka paparaqitur kundërshtim, më arsyetim se ____________________________________ _______________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kundërshtimit të mbrojtësit të të pandehurit, gjeti se:

Kundërshtimi nuk është i bazuar.

Ky kundërshtim vije nga shkaku se _______________________________________ _________________________ (shëno arsyet e refuzimit të kundërshtimit).

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

---

[14] Kjo formë mund të përdoret për të gjitha rastet kur gjyqtari i procedurës paraprake, vendos për refuzimin e kundërshtimit për caktimin e ekspertit

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________, nr. ____________, më datë ______________.**

**Sekretarja juridike**
**________________**

**Gjyqtari i procedurës paraprake,**
**___________________________**

**________.nr.________/____**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________ -** Departamenti __________________, Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni ______________, të KPRK-së, duke vepruar sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit ________________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP______. nr. ____________, të dt. _______________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, më datën _______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit _________________, e paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në _______________, PP___. nr. ____________, të dt. _______________, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim, PP____, nr.________, me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për caktimin e ekspertit të neuropsikiatrisë.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit ____________________________, - avokati ______________________, për shkak të ____________________, më propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ___________ ________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit dhe gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban ____________________________________________________________________________, nuk është i bazuar, sepse në aktvendimin e kundërshtuar, Prokurori i çështjes ka dhënën arsye të mjaftueshme, lidhur më kërkesën e mbrojtësit, duke iu përgjigjur çdo pretendimi të mbrojtësit për caktimin e ekspertit të ____________________.

Prokurori i çështjes, me të drejtë, ka theksuar në arsyetimin e aktvendimit të kundërshtuar se ____________________________________________________________ ______________________.

Nga ato që u theksuan më lart, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**________, nr. _________, më datë ______________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

_________________ ______________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke vepruar në bazë të nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK-ës), nxjerr ketë:

**AKTVENDIM**
**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE PËR EKSPERTIZË MJEKOLIGJORE**

_______________________, i besohet CAKTIMI i tre ekspertëve për të kryer ekspertizën lidhur me shkakun e vdekjes së pacientes ___________________

**A r s y e t i m**

E ndjera _________________, ka ndërruar jetë në spitalin privat ___________________, më datë _____________________.

Më datë _________________, është kryer autopsia e të ndjerës nga eksperti mjekoligjor ___________________, sipas të cilit vdekja ka ardhur si pasojë ____________________ ____________________________.

Duke marrë parasysh raportin e lartcekur të autopsisë, kërkoj nga ju që të caktoni tre ekspertë – ___________________, (shëno së të cilës fushë i përkasin ekspertët) për të dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre lidhur më shkakun e vdekjes së të ndjerës _____________________.

Gjatë ekspertizës, duhet të merren parasysh ne mes tjerash edhe rrethanat ___________ ___________________________________________________________________________.

Ekspertët duhet të eliminojnë çdo paqartësi që lidhet më autopsinë dhe shkakun e vdekjes.

Më rastin e caktimit të ekspertëve, duhet pasur kujdes që të mos caktohen si ekspertë mjekët që kanë qenë të arrestuar lidhur më rastin "____________" ose që kanë ndonjë lidhje me rastin e pacientes, tani të ndjerës ________________.

Gjatë ekspertizës, duhet të shfrytëzohen të gjitha shkresat e lëndës që gjenden në arkivin e ____________, lidhur me këtë rast.

Baza ligjore:

Komform nenin _______________ të KPPK-s, raporti i ekspertit duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
- përgjigjet për pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
- përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimi i provave që janë analizuar;
- përshkrimi i ekspertizës, duke përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet e parashtruara sipas këtij aktvendimi ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

Eksperti nuk shpreh në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë aktvendim nuk është i pranueshëm.

Detyrohet zyrtari i policisë së Kosovës – Departamenti ____________________, në __________________________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij që të dorëzojë këtë aktvendim në _________________, dhe t'i raportojë prokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Policisë së Kosovës – Departamenti ______________, në ____________, lidhur me kontrollin e shtëpive të të pandehurve _________________, dhe ________________, dhe materialeve të tjera që i janë bashkangjitur këtyre raporteve, për shkak të veprave penale - _____________, nga neni ___________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vepruar në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr këtë:

**Aktvendim**
**Për angazhimin e ekspertit**

**________________________________, i besohet CAKTIMI i një apo disa ekspertëve për të kryer ekspertimin e armës dhe municionit si në vijim:**

3. ___________________________________
4. ___________________________________

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës - Departamenti ______________________, në _____________, më datën _____________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve ______________, ________________ dhe ________________, për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën _______________, prokurori i nënshkruar më poshtë, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër këtyre të pandehurve, për veprat e lartcekura penale.

Më datën ____________________, duke vepruar në bazë të urdhëresës se gjyqtarit të procedurës paraprake ______, nr._______________, të datës _______________, Policia e Kosovës – Departamenti ______________, në ______________________, ka bërë kontrollin e shtëpive të të pandehurve ________________ dhe _______________, me ç'rast të i pandehuri ________________________, është gjetur dhe sekuestruar ________________________________________.

Duke marrë parasysh sekuestrimin e dëshmive të lartcekura gjatë kontrollit, është e nevojshme që të bëhet ekspertimi i këtyre dëshmive, në mënyrë që **të përcaktohet lloji dhe gjendja e tyre funksionale.**

Baza ligjore:

Konform nenit _______________ të KPPK-së, raporti i ekspertit duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
- përgjigjet për pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
- përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimi i provave që janë analizuar;
- përshkrimi i ekspertizës, duke përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet e parashtruara, sipas këtij aktvendimi, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

Eksperti nuk e shpreh në raport, mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Raporti i ekspertit, i cili nuk është në pajtim me këtë aktvendim, nuk është i pranueshëm.

Detyrohet zyrtari i policisë së Kosovës – Departamenti ___________________, në ______________, ________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që të dorëzojë këtë aktvendim në _________________ dhe t'i raportojë prokurorit të shtetit, lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Këshillë juridike:**
Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në ___________________, Departamenti ________________, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Policisë së Kosovës – Departamenti_________________, në _______________, dhe duke vepruar në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTIT TË GRAFOLOGJISË**

_____________________ i besohet CAKTIMI i një apo disa ekspertëve për të kryer ekspertimin si në vijim:

1.______________________________
2.______________________________
3.______________________________

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Departamenti _______________, në _______________, i ka paraqitur Prokurorisë Themelore në ________________, kallëzimin penal me numër të referencës ______________, kundër të pandehurit ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale - ________________, nga neni __________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________ gjyqtari i procedurës paraprake, ka lëshuar urdhrin për kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ________________. Ky urdher është leshuar pas kërkesës së prokurorit themelor të shtetit, urdhër i cili është zbatuar më datën

_______________, në ora ____________, nga Policia e Kosovës – Departamenti _____________, në _______________, e cila të njëjtën ditë i ka paraqitur raportin për kontrollin e kryer, gjyqtarit që ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit te shtetit.

Duke marr parasysh kallëzimin penal të policisë si dhe raportin e kontrollit që i është bërë shtëpisë së të pandehurit, rezulton se nga i pandehuri është sekuestruar _________ ___________________________________________________________________.

Duke marr parasysh sekuestrimin e dëshmive të lartcekura, gjatë kontrollit të urdhëruar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, konsideroj se është e domosdoshme që të kryhet ekspertimi i dëshmive të sekuestruara, në mënyrë që të vërtetohet se a janë dëshmitë origjinale apo të falsifikuara si dhe të përcaktohet se a është dorëshkrimi i të pandehurit _______________, në dokumentet ______________, andaj eksperti duhet të përgjigjet në pyetjet në vijim:

1.________________________________
2.________________________________
3.________________________________

Nga sa u tha më sipër, konform nenit _______________ të KPPK-së, raporti i ekspertit duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
- përgjigjet për pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
- përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimi i provave që janë analizuar;
- përshkrimi i ekspertizës, duke përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet e parashtruara sipas këtij aktvendimi ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

Eksperti nuk shpreh në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Raporti i ekspertit, i cili nuk është në pajtim me këtë aktvendim, nuk është i pranueshëm.

Detyrohet zyrtari i policisë së Kosovës – Departamenti ______________________, në ______________, ________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij që të

dorëzojë këtë aktvendim në ________________ dhe t'i raportojë prokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _____________ Departamenti ______________________, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Policisë së Kosovës – Departamenti __________________, në _____________, dhe duke vepruar në bazë të nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTIT PËR NARKOTIK**
**SUBSTANCA PSIKOTROPE DHE ANALOGE,**

________________________i besohet CAKTIMI i një apo disa ekspertëve për të kryer ekspertimin si në vijim:

Mostrën e marrë nga dëshmia D#1
Mostrën e marrë nga dëshmia D#2
Mostrën e marrë nga dëshmia D#3

Ekspertimi duhet të përcaktojë llojin dhe sasinë e substancës narkotike.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Departamenti_____________, në _____________, i ka paraqitur Prokurorisë Themelore në ____________, kallëzimin penal më numër të referencës ______________, kundër të pandehurit _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale - ________________, nga neni ____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën _____________, me aprovimin e kërkesës së prokurorit themelor të shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, ka lëshuar urdhrin për kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ________________, urdhër i cili është zbatuar më datën ___________, në ora _______, nga Policia e Kosovës – Departamenti_____________, në ___________, i cila të njëjtën ditë i ka paraqitur raportin për kontroll gjyqtarit që ka lëshuar urdhrin dhe prokurorit të shtetit.

Duke marrë parasysh kallëzimin penal të policisë si dhe raportin e kontrollit që i është bërë shtëpisë së të pandehurit, rezulton se nga i pandehuri është sekuestruar __________________.

Duke marrë parasysh sekuestrimin e dëshmive të lartcekura, gjatë kontrollit të urdhëruar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, konsideroj se është e nevojshme që të bëhet ekspertimi i këtyre dëshmive, në mënyrë që të përcaktohet lloji dhe sasia e substacës narkotike.

Baza ligjore:

Komform nenit _______________ të KPPK-së, raporti i ekspertit duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
- përgjigjet për pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
- përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimi i provave që janë analizuar;
- përshkrimi i ekspertizës, duke përfshirë fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike, janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin, që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet e parashtruara sipas këtij aktvendimi ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

Eksperti nuk shpreh në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Raporti i ekspertit, i cili nuk është në pajtim me këtë aktvendim, nuk është i pranueshëm.

Detyrohet zyrtari i policisë së Kosovës – Departamenti _____________________, në ______________, ________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që të dorëzojë këtë aktvendim në ________________, dhe t’i raportojë prokurorit te shtetit lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, te gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në __________________, - Departamenti ______________, në afat prej 3 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Policisë së Kosovës – Drejtoria ______________, në ______________, lidhur me kontrollin e shtëpisë së te pandehurit ______________, dhe materialeve tjera që i janë bashkangjitur këtij raporti, për shkak të veprave penale - ____________, nga neni _____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe ___________ nga neni ____________ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vepruar në bazë të nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTIT**

_______________________, i besohet CAKTIMI i një apo disa ekspertëve për të kryer ekspertimin e produkteve medicinale, si në vijim:

1. __________________
2. __________________
3. __________________

Komform nenit __________________, të KPPK-së,

1. Raporti i ekspertit duhet të përmban:
   1.1. të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
   1.2. përgjigjet lidhur me pyetjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit apo shkallën e dëmit të shkaktuar me vepër penale;
   1.3. përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;

1.4. përshkrimi i provave që janë analizuar;
1.5. përshkrimi për fotografitë relevante, vizatimet, tabelat përmbledhëse, radioskopinë, imazhet, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme;
1.6. shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
1.7. përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet në paragrafin 2. të këtij neni, ose që shpjegon përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

2. Eksperti nuk shpreh në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Detyrohet zyrtari i policisë së Kosovës – Drejtoria __________________________, në ______________ (shëno emrin e zyrtarit) ___________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që t'i dorëzojë të gjitha dëshmitë – në ___________________, (shëno emrin e institucionit ose ekspertit dhe adresën), për ekzaminim dhe t'i raportojë prokurorit lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Drejtoria _________________, më datën _______________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve _______________, ________________ dhe ______________, për shkak të dyshimit se ata kanë kryer veprën penale _____________nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Më datën ________________, Prokurori i nënshkruar më poshtë, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër këtyre të pandehurve për veprat e lartcekura penale.

Më datën _____________________, duke vepruar në bazë të urdhëresës se gjyqtarit të procedurës paraprake __________, nr.________________, të datës ________________, Policia e Kosovës – Drejtoria ________________________________, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ___________________, me ç'rast te i njëjti janë gjetur dhe sekuestruar produktet medicinale si në vijim: __________________________________ __________________________________________________________.

Duke marr parasysh sekuestrimin e dëshmive të lartcekura, gjatë kontrollit, konsideroj se është e nevojshme që të bëhet ekspertimi i këtyre dëshmive, në mënyrë që **të verifikohen produktet medicinale se çfarë përmbajtje kanë dhe a janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut.**

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në __________________, Departamenti _________________, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke vepruar në bazë të nenit ____________, paragrafi ___, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ës), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE PËR SUPER EKSPERTIZË**

**______________________, i besohet CAKTIMI i pesë ekspertëve për të kryer super ekspertimin lidhur më __________________.**

**A r s y e t i m**

I ndjeri ________________________, ka ndërruar jetë në spitalin ____________, më datë _____________.

Më datë __________________, është kryer autopsia e të ndjerit nga eksperti mjekoligjor ______________, sipas të cilit, vdekja ka ardhur si pasojë e _________________, me sugjerim që për ketë çështje të caktohet ________________, për të dhënë shpjegime lidhur me disa ndryshime të përshkruara në pikën **x** të raportit për autopsinë.

Në bazë të kërkesës së Prokurorisë Themelore në __________, drejtori i Klinikës së __________________, në SHSKUK – prof. dr._______________, ka nxjerrë vendim për caktimin e tre ekspertëve (prof. dr. _______________ Kryetar, Dr.sc. ____________, anëtar dhe Dr.sc. _____________ anëtar) për të dhënë mendimin profesional në lidhje me rastin e vdekjes së të ndjerit ________________.

Më datën _____________, Komisioni i përbërë prej tre ekspertëve, ka dhënë mendimin e vet, me numër të protokollit të SHSKUK nr._________. Mendimet e këtyre tre ekspertëve lidhur më shkakun e vdekjes ishin të ndryshme.

Duke marrë parasysh se tre anëtarët e grupit të ekspertëve kanë qëndrime të ndryshme, lidhur me shkakun e vdekjes së të ndjerit ___________________, kërkoj nga ju që të caktoni një grup tjetër të përbërë prej ____________, ekspertëve për të dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre lidhur me shkakun e vdekjes së të ndjerit.

Gjatë ekspertimit, duhet të merren parasysh veç tjerash:
1.________________________
2.________________________
3.________________________.

Më rastin e caktimit të ekspertëve, duhet pasur kujdes që të mos caktohen si ekspertë, mjekët që kanë konflikt interesi me të pandehurin ___________________ dhe të dëmtuarin _________________.

Gjatë ekspertimit, të shfrytëzohen të gjitha shkresat e lëndës që gjenden në arkivin e _____________, lidhur me këtë rast.

Konform nenit ____________, paragrafi ________, dhe ________, të KPPK-së, raporti i ekspertit duhet të përmbajë:
- të dhënat mbi identitetin e ekspertit dhe të dhënat mbi hetimin;
- përgjigjet ndaj pyetjeve të parashtruara në këtë aktvendim;
- përvoja dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimi i provave që janë analizuar;
- përshkrimi i ekspertizës, duke përfshirë fotografitë relevante, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me pyetjet e parashtruara me ketë aktvendim ose përse nuk është arritur të jepen përgjigje në ato pyetje.

Eksperti në raport, nuk shpreh mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

Zyrtari i Policisë së Kosovës, detyrohet – Drejtoria ____________, në _____________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që ta dorëzojë ketë aktvendim në ________________, drejtorit ______________, dhe t'i raportojë Prokurorit, lidhur me zbatimin e këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

Avokati: _______________
Adresa: ________________
Tel: ________________

____.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË __________**
**DEPARTAMENTIT _________________**
**P Ë R**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Kundër aktvendimit të Prokurorit të shtetit, të Prokurorisë Themelore në __________, _____, nr._________, të datës ____________, në çështjen penale të të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale __________________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në afatin ligjor, paraqes këtë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të ______________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit _______________, avokatit ________________ dhe të caktohet eksperti i ____________________________ ose i njëjti aktvendim të prishet dhe lënda t'i kthehet Prokurorit të shtetit në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: _________________, nga neni _____________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës (KPRK).

Mbrojtësi i të pandehurit ________________, avokati ______________, ka paraqitur kërkesë te Prokurori i shtetit, për të caktuar ekspertin e ________________________.

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim _____, nr.________, me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për caktimin e ekspertit të ______________________.

Prokurori i shtetit, në arsyetim, ka theksuar se ________________________________ ________________________________.

Konsideroj se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban shkelje _______________, sepse __________________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, konsideroj se gjyqtari i procedurës paraprake, do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

______________________

**Avokati**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________.

**INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE**

____________________

**KËRKESË PËR PLOTËSIMIN E MENDIMIT DHE KONSTATIMIT TË DHËNË NË SUPEREKSPERTIZËN, Nr. ____________, të datës ___________**

E/I nderuara znj/z.____________________,

Më datë ___________, ua kam dërguar aktvendimin, PP.nr. ________, të datës ______, për superekspertizë, lidhur me shkakun e vdekjes së të ndjerit __________________.

Më datë _________________, kam pranuar nga Ju superekspertizën mjekësore të nënshkruar nga 5 mjekë, anëtar të komisionit këshillues: dr.________________, dr.____________________, dr.______________________, dr.___________________ dhe dr.______________________, të cilët kanë konstatuar se në rastin konkret ____________________________________________________________________.

Mirëpo, duke ju referuar aktvendimit për superekspertizë dhe mendimit tuaj të dhënë në superekspertizë, konsideroj që komisioni këshillues duhet të përgjigjet edhe në pyetjet tjera që kanë qenë të përfshira në aktvendim, si më poshtë:

1. ____________________________

2. ____________________________

3. ____________________________ etj.

Nga sa u tha më sipër, kërkoj nga Ju që edhe një herë të shikoni materialet dhe dokumentacionin mjekësor dhe të jepni përgjigje edhe për këto pyetje, që ishin parashtruar në aktvendim, jo më larg se më datën ____________________.

Me respekt,

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**AGJENCISË KOSOVARE TË FORENZIKËS**
**Drejtorit _________________________**

**U R GJ E N C Ë**

I nderuari z. Drejtor,

Më datën ______________, kam nxjerr Aktvendim PP ________, nr._________ për ekzaminimin e ___________________________, që ishin sekuestruar nga të pandehurit: _____________________ dhe ______________________. Aktvendimi është dorëzuar në Agjencinë tuaj më datë ______________.

Meqenëse deri më tani nuk kam marrë mendimin dhe konstatimin e Agjencisë suaj, lidhur me këto ekzaminime, ju drejtohem me këtë urgjencë që të kërkoni nga ekspertët e angazhuar në ketë çështje, që të përfundojnë ekzaminimet e kërkuara sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më larg se deri më datën ___________, sepse kjo çështje penale është me paraburgim dhe si e tillë duhet të trajtohet më urgjencë.

Me respekt,

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT _________________________**
**GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në bazë të nenit _________, paragrafi ________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes ketë:

**KËRKESË PËR LËSHIMIN E URDHRIT PËR MARRJEN E MOSTRËS SË GJAKUT PËR EKZAMINIM**

Kundër të pandehurit: ______________________________ (shënimet personale të te pandehurit).

Sepse ekziston dyshimi _________________________ (shëno gjendjen faktike:kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale).

Më ketë vepër, kishte për të kryer veprën penale: _________________, nga neni ________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)

**A r s y e t i m**

Më datë ___________________, prokurori i shtet në Prokurorinë Themelore në ______________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: ______________________, _______________________ dhe __________________, për shkak të dyshimit të bazuar se të kanë kryer veprat penale _____________, nga neni

_________, paragrafi ___________, dhe ___ ____ _____, nga neni _________, paragrafët ___________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datë ____________, prokurori i shtetit e ka ftuar të pandehurin _______________, për të dhënë deklaratë lidhur me këtë çështje penale, Gjatë dhënies së deklaratës, i pandehuri ka deklaruar se gjurmët e gjakut që janë gjetur në vendin e ngjarjes nuk janë gjurmë që i përkasin gjakut të tij dhe nuk ka dijeni se të kujt mund të jenë të njëjtat gjurmë të gjakut, por nuk ka dhënë pëlqimin e tij që të japë gjakun si mostër për t'u vërtetuar pretendimi i tij – se a është gjaku i gjetur i tij apo i ndonjë personi tjetër në vendin e ngjarjes më datë _______________.

Duke marrë parasysh faktin se i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin e tij për të dhënë mostrën e gjakut, kërkoj nga ju që në bazë të nenit ________________, të KPPK-së, të lëshoni urdhër për marrjen e mostrës së gjakut nga i pandehuri __________________, e cila nevojitet për ekzaminim dhe për t'u vërtetuar gjendja reale në vendin e ngjarjes, më datën ___________________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**_______, nr._____/________**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________ -** Departamenti _______________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, PP__, nr. _________, të datës _________________, për caktimin e ekspertit, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, më datën _______________, nxjerr këtë:

**U R DH Ë R**
**PËR EKZAMINIM FIZIK**[15]

URDHËROHET ekzaminimi fizik i të pandehurit ___________________.

Detyrohet i pandehuri _______________ që të lejojë ekzaminimin fizik.

Ekzaminimin fizik duhet ta bëjë eksperti _______________________ (profesioni ose specializimi i ekspertit në fushën e mjekësisë)

Detyrohet eksperti _____________________, që të paraqesë raportin e ekzaminimit fizik në afat prej ________, ditësh/orësh nga dita/momenti e/i pranimit të këtij urdhri.

**A r s y e t i m**

Më aktvendimin e Prokurorisë Themelore në ________________________, PP__, nr. _____________, të datës ______________, ka filluar hetimi kundër të pandehurit ________________, për shkak të veprës penale – _______________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas fillimit të hetimeve, i pandehuri ________________, është thirrur nga prokurori i shtetit për të dhënë deklaratë dhe gjatë dhënies së deklaratës, është pyetur se a dëshiron që të japë pëlqimin e tij për ekzaminim fizik, për t'u verifikuar _______________ (plagët, gjurmët, etj.), mirëpo ai ka refuzuar që të japë pëlqimin e tij për ekzaminim fizik.

Meqenëse i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin e tij për ekzaminim fizik, më datë _______________, prokurori i shtetit, ka paraqitur në këtë gjykatë kërkesën për ekzaminimin fizik të të pandehurit me arsyetim se _____________________________.

[15] Kjo formë mund të përdoret për të gjitha rastet kur gjyqtari i procedurës paraprake vendos për aprovimin e kërkesës për caktimin e ekspertit në rastet kur nuk merret pëlqimi i personit për ekzaminim ose ekspertizë me dëshirë.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kërkesës së prokurorit të shtetit, gjeti se: kërkesa është e bazuar.

Kërkesa është e bazuar për shkak se në bazë të shkresave të lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri është përfshirë në kryerjen e veprës penale ________________, nga neni __________, i KPRK-së dhe se është përdorues i narkotikëve, fakt ky që mohohet nga i pandehuri, mirëpo sipas shkresave të lëndës, rezulton se ____________________________. Andaj, është e nevojshme që të urdhërohet ekzaminimi fizik i tij nga mjeku profesionist për t'u vërtetuar ose eliminuar dyshimet e ngritura lidhur me faktin se a është ai përdorues i narkotikëve ose jo. Ky urdhër është lëshuar për shkak se i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin për një ekzaminim fizik.

Caktimi mjekut/ekspertit _______________________, është bërë në bazë të ________ ___________, sipas të cilës dëshmohet se i njëjti është eksperti i ________________, se ka një përvojë të gjatë në këtë profesion dhe se në punën e tij nuk ka pasur ndonjë vërejtje serioze nga bordi etik i _____________, andaj raporti i tij lidhur më këtë ekzaminim fizik të të pandehurit pritet të jetë i drejtë dhe profesional.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij urdhri.

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**_________, nr.______/_______ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** __________________

**Gjyqtari i procedurës paraprake** ______________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Në bazë të nenit _________, paragrafi ________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, jap këtë:

**URDHER PËR KRYERJEN E AUTOPSISË SË TRUPIT TË PAJETË TË TË NDJERIT _____________________________**

**A r s y e t i m**

Më datë _______________, në ora ____________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ___________________, ka marrë informacion nga Policia e Kosovës – Drejtoria ____________________________, në ____________________________, se në ______________, në vendin e quajtur _____________, ka ndodhur një vrasje (mund të jetë vdekje në komunikacion etj.) ku i dyshuar është ________________, ndërsa është privuar nga jeta, tani i ndjeri ___________________.

Pas marrjes së këtij informacioni, prokurori i shtetit ka dalë në vendin e ngjarjes për të bërë shikimin e vendit të ngjarjes, ku ka qenë i pranishëm edhe mbrojtësi i të dyshuarit __________________, avokati __________________, dhe aty është gjendur edhe trupi i pajetë i të ndjerit ________________________.

Pas shikimit të vendit të ngjarjes, është tërhequr trupi i pajetë, tani të ndjerit ______________, dhe është dërguar në morgun e spitalit në ________________.

Duke marrë për bazë informatat e deritanishme, lidhur me këtë çështje penale si dhe rezultatet e shikimit të vendit të ngjarjes, lëshoj këtë urdhër për autopsi, në mënyrë që të vërtetohet shkaku i vdekjes së tani të ndjerit _______________.

Konform nenit ____________, paragrafi _________, të KPPK-së, raporti i autopsisë duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit që kryen autopsinë;
- përvojën dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimin e provave që janë analizuar;
- përshkrimin e fotografive relevante, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimi i ekspertit lidhur me shkakun e vdekjes së tani të ndjerit ___________________.

Eksperti nuk duhet të shprehë në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të dyshuarit.

Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë nen, nuk është i pranueshëm.

Detyrohet zyrtari i Policisë së Kosovës – Departamenti___________, në Prishtinë ________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që të dorëzojë këtë aktvendim në Institutin e Mjekësisë Ligjore në ________________, dhe t'i raportojë prokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e këtij urdhri.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Në bazë të nenit _________, paragrafi ________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, jap këtë:

**U R DH Ë R**
**PËR EKSPERTIM TOKSIKOLOGJIK**

Instituti për hulumtime toksikologjike në ______________, urdhërohet që të kryejë ekspertimin e materieve të dyshimta, të gjetura në kufomën e tani të ndjerit _________________________.

**A r s y e t i m**

Më datë ____________, në ora ____________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ______________, ka marrë informacion nga Policia e Kosovës se në ______________, në vendin e quajtur ______________, është gjetur trupi i pajetë i tani të ndjerit ________________, dhe dyshohet se bëhet fjalë për vdekje të dyshimtë.

Pas marrjes së këtij informacioni, prokurori i shtetit ka dalë në vendin e ngjarjes për të bërë shikimin e vendit të ngjarjes, dhe aty është gjendur edhe trupi i pajetë i tani të ndjerit _________________________.

Pas shikimit të vendit të ngjarjes, është tërhequr trupi i pajetë i tani të ndjerit ______________ dhe është dërguar në morgun e spitalit në ________________.

Duke marrë për bazë informatat e deritanishme, lidhur me këtë çështje penale si dhe rezultatet e shikimit të vendit të ngjarjes, e sidomos shenjat e gjetura në trupin e tani të

ndjerit _________________, lëshoj këtë urdhër për ekspertimin e materive të gjetura në kufomën e të ndjerit, në mënyrë që të vërtetohet shkaku i vdekjes së tij.

Konform nenit _____________, paragrafi __________, të KPPK-së, raporti i ekspertizës duhet të përmbajë:

- të dhënat mbi identitetin e ekspertit që kryen ekspertimin;
- përvojën dhe trajnimet e specializuara të ekspertit, arsyet pse këto janë relevante dhe sa është aktuale ajo përvojë apo ato trajnime;
- përshkrimin e provave që janë analizuar;
- përshkrimin e fotografive relevante, rezultatet laboratorike ose të dhënat tjera shkencore apo teknike që janë të rëndësishme.
- shpjegimin se praktikat analitike janë kryesisht të pranuara në fushën e ekspertit ose kanë bazë shkencore apo teknike; dhe
- përfundimin që paraqet mendimin e ekspertit lidhur me shkakun e vdekjes së tani të ndjerit ___________________.

Eksperti nuk duhet të shprehë në raport mendimin e tij lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të dyshuarit.

Raporti i ekspertit i cili nuk është në pajtim me këtë urdhër, nuk është i pranueshëm.

Nëse gjatë ekspertimit, gjenden materie të dyshimta në trupin e të ndjerit, atëherë sasia e materieve të përdorura duhet të përcaktohet kudo që të jetë e mundur dhe me rastin e analizave të materieve të dyshimta, eksperti duhet të përqendrohet në veçanti në përcaktimin e llojit, sasisë dhe efektit të materieve të gjetura.

Detyrohet zyrtari i Policisë së Kosovës – Departamenti _______________, në Prishtinë ________________, apo zyrtari tjetër nën mbikëqyrjen e tij, që të dorëzojë këtë aktvendim në Institutin për hulumtime toksikologjike në _________________, dhe t'i raportojë prokurorit të shtetit lidhur me zbatimin e këtij urdhri.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – DREJTORISË ____________, NË ____________,**
**POLICIT HETUES _________, EKSPERT PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE**

**KËRKESË PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT TË ANALIZAVE FINANCIARE**

Më datë _____________, pas disa kërkesave të mia për dorëzimin e raportit të kompletuar për analizën e të dhënave financiare, Ju keni dorëzuar në Prokurorinë Themelore në ____________________, raportin e analizave financiare, që është kërkuar, sipas urdhëresës së gjyqtarit të procedurës paraprake _____, nr.___________, të datës _____________________, lidhur me qarkullimet e dyshimta financiare të të pandehurve ________________, _______________ dhe ________________.

Urdhëresa e gjyqtarit të procedurës paraprake, ka përfshirë zbulimin e të dhënave financiare në institucionet financiare që veprojnë në Kosovë, si vijon:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Bankën Ekonomike
8. Unioni Financiar Prishtinë - Western Union
9. Money Gram

Meqenëse edhe në raportin e dytë që keni dorëzuar, më datë ________________, nuk e keni përfshirë analizën e të dhënave financiare lidhur më Bankat _________________, kërkoj nga ju që të plotësoni raportin tuaj edhe lidhur më këto institucione financiare dhe t'i jepni rëndësi të veçantë transfereve apo qarkullimit financiar që janë bërë në Bankën ____________________, pasi që sipas raportit të Qendrës së inteligjencës financiare, pikërisht transferet apo qarkullimi financiar në këtë institucion financiar, janë të dyshimta, sidomos ato që janë përfshirë në periudhën prej datës ________________, e deri në datën __________________.

Nëse keni nevojë për sqarim të ndonjë të dhëne nga Institucionet e lartcekura financiare, ju AUTORIZOJ që të merrni në pyetje edhe ndonjë zyrtar të këtyre Institucioneve për të sqaruar transferet apo qarkullimin financiar.

Duke qenë se janë shtjerrë të gjitha arsyet për vonesat e deri tanishme, për kompletimin e raportit të analizave financiare, kërkoj nga Ju që të veproni me urgjencë, dhe më së largu deri më datën _______________, të dorëzoni raportin e kompletuar. Kjo urgjencë është e nevojshme sepse është duke përfunduar afati i hetimeve dhe do të jetë e pamundur që të ndërmerren veprimet tjera procedurale që varen nga raporti i analizave financiare.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**_____.nr.________**

**GJYKATA THEMELORE NË _________________** – Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: ______________, kryetar, _______________ dhe _______________, anëtar, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale __________, nga neni __________, paragrafi ______, të KPRK-së, duke vepruar sipas ankesës së prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në _______________, PP___, nr. ___________, të dt. __________, e paraqitur kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, PPNKR-së, nr.____________, të datës ______________, më datën ____________________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në _______________, PP__, nr. ___________, e dt. __________, e paraqitur kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, PPNKR-së, nr.____________, të datës ______________.

**A r s y e t i m i**

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, Departamenti për Krimet e Rënda, ka paraqitur te gjyqtari i procedurës paraprake, kërkesën për mundësinë hetuese të veçantë – marrjen e deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit ____________________, me arsyetim se __________________________, dhe se është e nevojshme, ruajtja e kësaj deklarate si provë, duke marrë parasysh se ekziston rreziku i konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjyqtari i procedurës paraprake, me aktvendimin _____, nr.____________, të datës _________, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e prokurorit të shtetit.

Kundër aktvendimit të lartcekur të gjyqtarit të procedurës paraprake, ka paraqitur ankesë prokurori i shtetit, në Prokurorinë Themelore në ______________________, – Departamenti _____________, për shkak të __________________, me propozim që __________________ ose aktvendimi të prishet dhe lënda t'i kthehet gjyqtarit të procedurës paraprake në rivendosje.

Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të prokurorit të shtetit, gjeti se:

**Ankesa nuk është e bazuar.**

Sipas vlerësimit të kolegjit shqyrtues, gjyqtari i procedurës paraprake, ka vendosur drejt kur ka refuzuar kërkesën e prokurorit të shtetit për mundësinë hetuese të veçantë, sepse ________________________________________________________ (shëno arsyet e refuzimit).

Gjithashtu, gjyqtari i procedurës paraprake, ka vendosur drejt, kur ka konstatuar se në këtë çështje penale, bëhet fjalë për vepër penale ______________, nga neni __________, të KPRK-së, për të cilën parashikohet dënimi prej ___________, deri më____________ me burgim dhe kjo vepër nuk është përfshirë në dispozitën e nenit 90 të KPPK-së, ku janë parashikuar veprat penale për të cilat mund të aplikohet mundësia hetuese e veçantë, andaj pretendimet e prokurorit janë të pabazuara.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ___________**
**DEPARTAMENTI ____________________**
**KOLEGJI PËR SHQYRTIM**
**______ nr. _________ më datë _________________**

**Sekretarja juridike** **Kryetari i Kolegjit**

_________________ ______________________

**_________.nr.________**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________ -** departamenti ________________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale ______________, nga neni __________, të KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në ________________, PP___, nr. ________, të dt. __________, për mundësi hetuese të veçantë, në bazë të nenit _______, paragrafi _____, të KPPK-së, me datën ______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** APROVOHET kërkesa e prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në ___________________, për mundësi hetuese të veçantë – marrjen e deklaratës nga i dëmtuari/dëshmitari _______________**.**

**II.** CAKTOHEN si anëtarë të panelit, për mundësi hetuese të veçantë, gjyqtarët e kësaj gjykate ______________ dhe ___________________.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në _____________ – Departamenti _________________, ka paraqitur kërkesën për mundësinë hetuese të veçantë – marrjen e deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit ________________, me arsyetim se ai është shtetas i _____________________ dhe se është e nevojshme ruajtja e provës/deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit ____________, duke marrë parasysh se ekziston rreziku i konsiderueshëm që kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe rrethanën se në ketë çështje penale, bëhet fjalë për veprën penale _________________, nga neni _________, të KPRK-së.

Gjyqtari i procedurës paraprake, duke vepruar sipas nenit __________, paragrafi __________, të KPPK-së, shqyrtoi kërkesën e prokurorit dhe shkresat tjera të lëndës, të bashkangjitur kërkesës dhe gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar**.

Kjo kërkesë, është e bazuar për shkak se i dëmtuari/dëshmitari _________________, është shtetas i _______________, dhe nuk jeton në Kosovë, prandaj ekziston rreziku i konsiderueshëm se deklaratat e të dëmtuarit/dëshmitarit si provë nuk do të mund të merren gjatë shqyrtimit gjyqësor. Andaj, është e nevojshme që të caktohet seancë për mundësi hetuese të veçantë ku do të merret deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit lidhur

me pyetjet që do t'i bëhen nga palët dhe do t'i jepet mundësia e deklarimit lidhur me kërkesën pasurore-juridike si dhe kompensimin e dëmit.

Gjithashtu, në ketë çështje penale, bëhet fjalë për veprën penale _______________, nga neni __________, të KPRK-së, për të cilën parashikohet dënimi prej __________, deri më ____________ burgim.

Duke marr parasysh atë që u theksua më lartë, gjyqtari i procedurës paraprake, ka aprovuar kërkesën e prokurorit të shtetit dhe si anëtarë të panelit, ka caktuar dy gjyqtarë të kësaj gjykate: z. _________________ dhe z. ___________________.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**
**_____ nr.___________, më datë ________________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake**
_________________ ____________________________

**______, nr.___/___**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________ -** departamenti _______________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale ______________, nga neni __________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________, PP__, nr. ________, të dt. __________, për mundësinë hetuese të veçantë, në bazë të nenit _______, paragrafi _____, të KPPK-së, më datën ______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në ______________________________, për mundësi hetuese të veçantë – marrjen e ___________________________________________.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në ___________________, – Departamenti _______________, ka paraqitur kërkesën për mundësinë hetuese të veçantë – marrjen e deklaratës së të dëmtuarit – të dëshmitarit _________________________________, me arsyetim se ________________________________________ dhe është e nevojshme ruajtja e provës ___________________________________, duke marr parasysh se ekziston rreziku i konsiderueshëm që kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjyqtari i procedurës paraprake, duke vepruar sipas nenit __________, paragrafi __________, të KPPK-së, shqyrtoi kërkesën e prokurorit dhe shkresat tjera të lëndës të bashkangjitura me kërkesën dhe gjeti se:

**Kërkesa nuk është e bazuar**.

Kërkesa nuk është e bazuar për shkak se sipas shkresave të lëndës __________ _________________, andaj nuk ekziston rreziku i konsiderueshëm siç ka konstatuar prokurori i shtetit se __________________________ si provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjithashtu, në ketë çështje penale, bëhet fjalë për vepër penale _______________, nga neni __________, i KPRK-së, për të cilën parashikohet dënimi prej ___________ deri më____________ burgim dhe kjo vepër nuk është përfshirë në dispozitën e nenit ______________, të KPPK-së ku janë parashikuar veprat penale për të cilat mund të aplikohet mundësia hetuese e veçantë.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________**
**DEPARTAMENTI ______________________________**
**_______, nr.___________, më datë ________________**

**Sekretarja juridike** ___________________

**Gjyqtari i procedurës paraprake** ____________________________

**KËSHILLA JURIDIKE**:
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë pranë kolegjit shqyrtues të kësaj gjykate, brenda 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të kopjes së këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTIT _____________________**
**P Ë R**
**KOLEGJIN SHQYRTUES**

Kundër Aktvendimit të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake _____, nr.____________, të datës ____________, në afatin ligjor paraqes ketë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të ____________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet dhe të lejohet mundësia hetuese e veçantë – marrja e ____________________________, ose që aktvendimi të prishet dhe lënda t’i kthehet gjyqtarit të procedurës paraprake në rivendosje.

.

**A r s y e t i m**

Prokurori i shtetit, në Prokurorinë Themelore në ___________________, Departamenti _______________________, ka paraqitur te gjyqtari i procedurës paraprake, kërkesën për mundësinë hetuese të veçantë – marrjen e ________________, me arsyetim se _________________ dhe së është e nevojshme ruajtja e kësaj deklarate si provë, duke marrë parasysh se ekziston rreziku i konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjyqtari i procedurës paraprake, me aktvendimin ________, nr.____________, të datës ______________, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e prokurorit të shtetit.

Konsideroj se gjyqtari i procedurës paraprake me aktvendimin e kundërshtuar ka bërë shkelje ____________________________________________________________, sepse ________________________________________________________________________.

Ky konstatim i gjyqtarit të procedurës paraprake, nuk është i bazuar dhe mund të dëmtojë zhvillimin normal të hetimeve, sepse _________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, konsideroj se Kolegji shqyrtues do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/**
**Basic Prosecution Office ____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _________________**
**DEPARTAMENTI _____________________________**
**P Ë R: GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në bazë të nenit __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**K E R K E S Ë**
**PËR MUNDËSINË HETUESE TË VEÇANTË**

Marrjen e deklaratës së dëshmitares/viktimës, si në vijim: _____________**,** emri i babait _____________, emri i nënës _____________, e lindur më ____________ në _____________, numri i pasaportës _____________.

Adresa e viktimës së trafikuar, mund të sigurohet përmes policit hetues ___________, në DHTQNJ-në, në Prishtinë, me numër telefoni zyrtar _______________.

**A r s y e t i m**

Dëshmitarja/viktima e trafikuar _____________**,** më datën ____________, ka dhënë një deklaratë në cilësinë e dëshmitares dhe viktimës, para prokurorit të nënshkruar më poshtë, lidhur me çështjen penale kundër të pandehurve _____________, etj. për shkak të veprave penale: _________________________, nga neni_________, i Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Duke marrë parasysh se dëshmitarja – viktima e trafikuar në ketë çështje penale ________________**,** ka deklaruar se dëshiron të largohet nga Kosova dhe nuk është e

sigurt se do të mund të kthehet përsëri në Kosovë për të dhënë deklaratën e saj edhe në shqyrtimin gjyqësor. Në këtë rast, ekziston mundësia e marrjes në pyetje dhe ekziston rreziku potencial që kjo viktimë nuk do të mund të merret në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake që në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të caktojë seancën dhe ta marrë në pyetje, në cilësi të dëshmitares – viktimës, në një afat sa më shpejt të mundshëm. Deklarata e saj është shumë e rëndësishme për ketë çështje penale, ngase ajo ka njohuri për të pandehurit, viktimat tjera të trafikuara, mënyrën e trafikimit dhe për vendin se ku mund të merren provat lidhur me ketë çështje penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTIT _______________________**
**PËR GJYQTARIN KUJDESTAR TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

**N J O F T I M**

I nderuari z. Gjyqtar,

Në pajtim me nenin _________, paragrafi __________, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju njoftoj se sot, më datë ______________, në ora __________, jam njoftuar nga Policia e Kosovës - Departamenti __________________________, se në ___________________, në vendin e quajtur ________________, ka ndodhur një vepër penale ________________, ku kryes i kësaj vepre penale tani për tani është personi i panjohur.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit ___________, paragrafi _________, i KPPK-së ju njoftoj se Policia dhe Prokuroria e shtetit e kanë të pamundur që pa prezencën tuaj të kryejnë shikimin e vendit të ngjarjes, prandaj në ketë rast, ju duhet të merrni pjesë dhe të vëzhgoni kryerjen e shikimit të vendit të ngjarjes në mënyrë që rezultatet e kësaj procedure të jenë prova të pranueshme në procedurën penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Avokatit _______________________, nga __________________,**

**N J O F T I M**
**PËR RIKONSTRUKSIONIN E VENDIT TË NGJARJES**

I nderuari z. Avokat,

Pas marrjes së deklaratave nga ana e të pandehurit ______________, dhe dëshmitarëve ___________________, dhe __________________, deklarata të cilat janë gati në tërësi në kundërthënie në mes vete, lidhur me zhvillimin e ngjarjes në ditën kritike dhe lidhur me provat e gjetura në vendin e ngjarjes, më datën _________________, ku keni qenë prezentë edhe ju, në pajtim me nenin _________, paragrafi __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju njoftoj se më datë ______________, në ora __________, do të bëhet rikonstruksioni i vendit të ngjarjes, ku do të marrin pjesë i pandehuri __________________________, të cilin e mbroni Ju, sipas autorizimit, dëshmitarët ________________________, dhe ________________________, eksperti i kriminalistikës, z. ___________________________, dhe eksperti i mjekësisë ligjore z. ________________________.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit _________, paragrafi _________, të KPPK-së, Ju njoftoj se keni të drejtë që të merrni pjesë në rikonstruksionin e vendit të ngjarjes.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**z. _____________________________**
**Avokat nga _________________**

**N J O F T I M**

I nderuari z. Avokat,

Në pajtim me nenin _________, paragrafi __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju njoftoj se sot, më datë ______________, në ora __________, jam njoftuar nga Policia e Kosovës - Departamenti _________________________, se në ____________, në vendin e quajtur __________, ka ndodhur një vrasje dhe se kryes i dyshuar i kësaj vepre penale është ______________, të cilin e mbroni Ju, sipas autorizimit.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit ___________, paragrafi _________, të KPPK-së, ju njoftoj që Ju dhe i pandehuri, keni të drejtë të merrni pjesë në shikimin e vendit të ngjarjes.

Shikimi i vendit të ngjarjes, do të bëhet sot, më datë ____________, duke filluar nga ora ________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të detyrueshëm 3 mujor të shkresave të lëndës, PP__, nr.____________, në bazë të nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Kryeprokurori ____________________________, dhe prokurori ____________________________, më datë ________________ nxjerrin këtë:

**K O N S T A T I M**

Me të cilin konstatohet se në çështjen penale, PP__, nr.____________, hetimi duhet të mbahet i hapur dhe të vazhdohet me zhvillimin e mëtejmë të hetimeve.

| | |
|---|---|
| **Kryeprokurori i shtetit** | **Prokurori i shtetit** |
| **N.N.** | **N.N.** |
| ____________________ | ____________________ |

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

_________, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Në bazë të nenit _________________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshoj këtë:

## AKTVENDIM PËR PEZULLIMIN E HETIMIT

**Kundër të pandehurit: _____________________ (shëno të dhënat personale)**

**S E P S E**

**I.**

Ekziston dyshimi se _________________________ (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale për të cilën dyshohej i pandehuri).

- me këtë veprim, ka kryer veprën penale - _____________ nga neni _____________ të Kodit Penal të Republikës se Kosovës (KPRK),

**II.**

Ekziston dyshimi (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale për të cilën dyshohej i pandehuri).

- me këtë veprim, ka kryer veprën penale - _____________ nga neni _____________ të Kodit Penal të Republikës se Kosovës (KPRK),

**ARSYETIM:**

Policia e Kosovës – Departamenti _________________ në ______________ me datën ________________ i ka paraqitur kësaj Prokurorie kallëzimin penal me numër të referencës _____________, kundër të pandehurit ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale ____________ nga neni ____________ i Kodit Penal të Republikës se Kosovës (KPRK) dhe veprën penale ____________________nga neni __________________ i Kodit Penal të Republikës se Kosovës (KPRK).

Kallëzimit penal i janë bashkangjitur edhe: ____________________________.

Nga provat e Policisë që i janë bashkangjitur kallëzimit penal, të përmendura më sipër, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri _____________________________ më datë __________________________ (shëno kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale nën I).

Gjithashtu rezulton se ____________________ (shëno kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale nën II).

Sipas shkresës së policisë, me numër të referencës _____________________ të datës _______________, rezulton së i pandehuri ____________ nuk gjendet në Kosovë dhe se i njëjti jeton në _____________, që do të thotë së ky i pandehur për momentin është i paarritshëm për organet e ndjekjes dhe për këto arsye është i nevojshëm pezullimi i hetimeve.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit ____________ të KPPK-së, Prokurori i shtetit mund të pezullojë hetimin me aktvendim nëse i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë, nëse është arratisur ose **ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit.**

Andaj, duke marr parasysh atë që është theksuar më lartë, Prokurori i nënshkruar vendos:

1. Pezullimin e hetimit kundër të pandehurit ______________________ nga dita e sotme, __________.

2. Hetimi do të rifillojë pas eliminimit të pengesave të cilat e kanë shkaktuar pezullimin.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe në pajtim me nenin ________, paragrafi ________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR RIFILLIMIN E HETIMIT**

Kundër të pandehurit _____________________________ (shëno të dhënat personale).

Sepse ekziston dyshimi i bazuar se ______________________________.(përshkruaj gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më këtë ka kryer veprën penale **- ___________________________________,** nga neni __________, paragrafi ____, lidhur me paragrafin ____, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Më datë, ________________, është marrë aktvendimi për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit ____________ për shkak të veprës penale ________________, nga neni _________, paragrafi ____, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në _____________, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në ____________, të datës ___________**,** ka lëshuar urdhëresë, PPPKR ___________, më datën _____________, për ____________________________________________________, për të pandehurin __________________.

Meqenëse i pandehuri ________________, nuk i është përgjigjur disa thirrjeve të dërguara në adresën e tij, më datën ________________, prokurori i shtetit, – Drejtoria __________________, ka autorizuar Policinë e Kosovës për të vendosur në Stop Listë të pandehurin ______________________ që ai të ndalët kurdo dhe kudo që haset nga Policia e Kosovës, si dhe të sillet te prokurori për të dhënë deklaratë lidhur me këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh se i pandehuri ______________, sipas shkresës së policisë me numër të referencës ___________, të datës _____________, nuk gjendej në Kosovë por në ________________, më datën ________________, prokurori i shtetit ka marrë aktvendim për pezullimin e hetimeve.

Më datë _______________, i pandehuri _______________________, është kthyer nga ______________, përmes _________________ dhe gjatë kontrollimit, është kërkuar nga ai që të paraqitet në prokurori, dhe me këtë datë ky i pandehur është paraqitur në zyrën e prokurorit të çështjes për të dhënë deklaratën e tij lidhur me dyshimet për veprën penale që i vihet në barrë. Lidhur me ketë, është përpiluar procesverbali, ku është shënuar koha e rifillimit të hetimeve. Meqenëse i pandehuri ______________, është paraqitur në prokurori për të dhënë mbrojtjen e tij, në këtë rast janë eliminuar pengesat të cilat e kanë shkaktuar pezullimin e hetimeve.

Nga sa u tha më sipër, në bazë të nenit ___________, të KPPK-së, prokurori i shtetit ka rifilluar hetimin dhe një kopje të vërtetuar të këtij vendimi ia ka dërguar edhe gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në ________________, - Departamenti __________________.

Hetimet sipas këtij aktvendimi kundër të pandehurit ___________, rifillojnë prej datës ____________, në ora ___________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Në bazë të nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nxjerr këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR PUSHIMIN E HETIMEVE**

Pushojnë hetimet kundër të pandehurit _______________, (shënimet personale të te pandehurit).

Për shkak të veprës penale ____________________, nga neni _______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**A R S Y E T I M I**

Më datë ______________, në këtë prokurori, ka arritur një raport informues nga Policia e Kosovës me numër _________________, për shkak të dyshimit se i dyshuari __________________, është duke kryer veprat penale -____________________, nga neni _______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në bazë të raportit të lartcekur të Policisë, rezultonte se i dyshuari _____________, ka kryer veprimet si në vijim: _________________________________________________ ________________________________________________.

Më datë ______________, prokurori i shtetit ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit ________________________________, për shkak të veprës penale ____________________, nga neni _______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës Themelore të _______________, duke vepruar në bazë të kërkesës së prokurorit të datës ______________, ka lëshuar urdhëresën _____, nr._________, më datë ____________, për të kërkuar zbulimin e të dhënave financiare në të gjitha bankat e Kosovës si dhe ne institucionet tjera financiare për të pandehurin_____________.

Në bazë të raportit informues të Policisë, me numër të referencës ________________, të datës _______________, rezulton se i pandehuri __________________, nuk gjendet në Republikën e Kosovës dhe jeton me familjen e tij në ____________________.

Më datë ________________, prokurori i shtetit ka marrë aktvendim për pezullimin e hetimit, pasi që ekzistojnë rrethanat që përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të hetimit, pasi që i pandehuri ______________ nuk gjendet në Kosovë, ai jeton me familjen e tij në ________________.

Me datë _______________, prokurori i shtetit ka marrë aktvendim për rifillimin e hetimit, pasi që më të njëjtën datë, i pandehuri _______________, është kthyer nga ___________, në Kosovë dhe është paraqitur në prokurori.

Më datë __________________, i pandehuri ________________, ka dhënë deklaratën e tij dhe ka mohuar të gjitha veprimet inkriminuese që i janë vënë në barrë me aktvendimin për fillimin e hetimeve, duke theksuar se ___________________________ ________________________________________________________.

Më datë ______________, është marrë në pyetje edhe dëshmitari ________________, i cili ka deklaruar se ____________________________________________________ ________________________________________________________.

Pas marrjes në pyetje të të pandehurit _____________ dhe dëshmitarit ____________, si dhe pas shqyrtimit të të dhënave financiare, të nxjerra nga të gjitha institucionet financiare që veprojnë në Kosovës, rezulton se në veprimet e të pandehurit ________________, nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, sipas aktvendimit mbi fillimin e hetimeve, sepse __________________________________________________________.

Nga sa u tha më lart, është konstatim se në rastin konkret, nuk ka dëshmi që vërtetojnë ekzistimin e elementeve të veprave penale që i viheshin në barrë të pandehurit, e as elemente të ndonjë vepre tjetër penale, që ndiqet sipas detyrës zyrtare, andaj, ka pushuar hetimi kundër të pandehurit ______________________, konform nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**Arkivit të Prokurorisë**

Pas mbylljes së rastit, ua dërgoj shkresat e lëndës PP___, nr.____________, gjithsejtë __________ faqe, për t'i vendosur në Arkiv, për ruajtje të mëtejme.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTIT _______________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

**N J O F T I M**

Në pajtim me nenin _________, paragrafi __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju njoftoj se me aktvendimin, PP___, nr._________, të datës ____________, kanë pushuar hetimet kundër të pandehurit ______________, për shkak të veprës penale: ____________, nga neni ___, paragrafi ___, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sepse hetimet kanë treguar se në këtë rast, nuk ka dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë ekzistimin e dyshimit të bazuar se në veprimet e të pandehurit manifestohen elementet e veprës penale që i vihej në barrë, e as elemente të ndonjë vepre tjetër penale, që ndiqet sipas detyrës zyrtare.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pranimit të raporteve të Policisë së Kosovës – Drejtoria _____________________, në __________________, me numër të referencës _______________, të datave _______________, dhe _______________, ka nxjerrë ketë:

## RAPORT PËR MBYLLJE TË RASTIT

Mbyllet rasti i paraqitur me raportin njoftues të Policisë së Kosovës – Drejtoria në ________________, të datës ______________, me numër të referencës ___________, kundër: __________________, me shënime personale, si në vijim ________________ (shëno të dhënat personale).

I dyshuar për kryerjen e veprës penale:

______________________, nga neni _________, paragrafi _____, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Më datë _______________, Prokuroria Themelore në _____________, ka pranuar një raport njoftues nga Policia e Kosovës – Drejtoria në _________________, me numër të referencës ______________, sipas të cilit dyshohet se një person me emrin ________________, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale ________________, nga neni ____________ i KPRK-së.

Më datë __________________, Prokurori ka bërë kërkesë për masën e fshehtë teknike të vëzhgimit dhe hetimit, _________________, për të dyshuarin _________________.

Më datë ___________________, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në _____________, ka lëshuar një urdhër _____, nr.______, për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit - __________________________________.

Më datë ______________, Prokurori ka bërë kërkesë për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, _____________ dhe ________________, për të dyshuarin _________________, të cilën e ka miratuar gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në _____________, me urdhrin _____, nr._______, të datës_____ __________.

Policia e Kosovës, më datat ___________, _____________ dhe _____________, ka paraqitur raportet me numër të referencës ______________, me të cilat ka njoftuar prokuronin e çështjes se ndaj të dyshuarit _____________, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara nga prokuroria e shtetit dhe gjykata. Megjithatë, nuk ka arritur të sigurojë prova se i dyshuari _______________, merret me kryerjen e veprës penale _________________________, nga neni __________________, i KPRK-së dhe se duhet pushuar veprimet e mëtejme hetimore.

**PRANDAJ**

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, Prokurori i çështjes, ka ardhur në përfundim se në ketë çështje penale nuk ka asnjë provë që do të vërtetonte dyshimin e arsyeshëm ose të bazuar se nga ana e të dyshuarit _______________, është kryer vepra penale: ____________________, nga neni ____________, paragrafi ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, apo ndonjë vepre tjetër penale.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më lart, Prokurori i shtetit, ka mbyllur rastin, mirëpo në rast të paraqitjes së provave apo informatave të reja, do të rifilloj hetimi i çdo dyshimi për vepër penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**_______.nr._____**

**GJYKATA THEMELORE NË _____________________________** - departamenti __________________, Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: _____,____,___, etj. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së.

Duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në ______________, për vazhdimin e afatit të hetimeve, në bazë të nenit __________, të KPPK-së, me datën _______________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

Me aprovimin e kërkesës së Prokurorit të shtetit, lejohet VAZHDIMI i afatit të hetimeve kundër të pandehurve ________________, (shëno të dhënat e të pandehurve) edhe për 6 (gjashtë) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi, hetimet mund të zgjasin më së shumti deri më datën __________.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në _____________, PP___, nr. __________, të datës ______________, ka filluar hetimi kundër të pandehurit ________________, për shkak të veprës penale __________________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në _____________, PP__, nr. ___________, të datës ______________, është zgjeruar hetimi edhe kundër ___________ të pandehurve tjerë (shëno emrat dhe mbiemrat e të pandehurve kundër të cilëve është zgjeruar hetimi) për shkak të veprës penale _________________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë ________________, Prokurori i shtetit, ka paraqitur në këtë gjykatë, kërkesë për vazhdimin e afatit të hetimeve kundër të pandehurve: ________________, (shëno emrat dhe mbiemrat e të pandehurve) edhe për gjashtë muaj, respektivisht deri më datën ________________, me arsyetimin se pas zgjerimit të hetimeve, duhet marrë deklaratat e _________, të pandehurve që janë përfshirë në aktvendimin për zgjerimin e hetimeve dhe deklaratat e ____________, dëshmitarëve në mesin e të cilëve ka edhe të dëmtuar e që janë identifikuar gjatë fazës së hetimeve, se ka pranuar mbi _________ dëshmi, nga ________________, të cilat janë analizuar dhe në bazë të tyre të ndërmerren edhe veprimet tjera hetimore.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kërkesës së prokurorit, gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar**.

Kjo kërkesë është e bazuar nga shkaku se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni _________, i KPPK-së për vazhdimin e afatit të hetimeve edhe për gjashtë muaj, afat i cili nuk mund të zgjas më shumë se deri më datë ___________________.

Sipas kërkesës së Prokurorit të shtetit, deri në këtë fazë të hetimeve janë kryer shume veprime hetimore, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave të dëshmitarëve, të dëmtuarit dhe vet të pandehurve që ishin të përfshirë në aktvendimin për fillimin e hetimeve.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se më datë _____________, Prokuroria ka zgjeruar hetimet edhe për ______________ të pandehur dhe ka identifikuar mbi ___________ dëshmitarë dhe të dëmtuar, nga të cilët duhet marrë deklaratat.

Menjëherë pas zgjerimit të hetimeve dhe identifikimit të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, Prokurori ka filluar marrjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, ndërsa deri në ketë fazë janë marrë deklaratat e mbi ___________ personave në cilësi të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, ndërsa shumë shpejt pritet fillimi i marrjes së deklaratave të të pandehurve kundër të cilëve janë zgjeruar hetimet.

Gjithashtu nga kërkesa e Prokurorit, rezulton se nga ________________, janë pranuar mbi 650 dëshmi nga _______________ të cilat duhet të analizohen dhe varësisht nga rezultatet e këtyre analizave, mund të ketë edhe zgjerim tjetër të hetimeve.

Duke marrë parasysh se rasti i të pandehurit __________________, është pjesë e rastit "_____" si një rast mjaft i komplikuar, për shkak të natyrës specifike të veprimeve inkriminuese, ku janë zgjeruar hetimet edhe kundër ________________, të pandehurve dhe janë identifikuar mbi ____________ persona si dëshmitarë, në mesin e të cilëve ka edhe të dëmtuar, Gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur që në ketë çështje penale të autorizojë një vazhdim të hetimeve kundër të pandehurve ______________ (shëno emrat dhe mbiemrat e të pandehurve) edhe për 6 (gjashtë) muaj, afat i cili nuk mund të zgjasë më shumë se deri më datën ________________, në mënyrë që hetimet të zhvillohen pa pengesë dhe të sigurohen dëshmi që janë të domosdoshme për të marrë vendim të drejtë lidhur me këtë çështje penale.

Nga ato që u thanë më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI _______________________**
**________nr. _____________ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** | **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

_________________ | ______________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditësh, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ____________________________**
**GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

**Në bazë të nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:**

**KËRKESË PËR VAZHDIMIN E HETIMIT EDHE PËR _____________ MUAJ**

Kundër të pandehurit: _____________________ (shëno të dhënat personale).

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në _______________________, PP___ nr. _____________, të datës ______________, ka filluar hetimi kundër të pandehurit ______________________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Deri në këtë fazë të hetimeve, janë kryer shumë veprime hetimore, duke përfshirë edhe ________________________________________________________________________ ______________________________________.

Siç jeni në dijeni, Prokuroria Themelore në _______________, më datë ___________, ka zgjeruar hetimet edhe për _______, persona dhe ka identifikuar mbi ______, dëshmitarë dhe të dëmtuar, nga të cilët duhet marrë deklaratat.

Menjëherë pas zgjerimit të hetimeve dhe identifikimit të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, prokurori ka filluar marrjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, ndërsa deri në ketë fazë, janë marrë deklaratat e mbi ______________, personave në cilësi të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, ndërsa shumë shpejt pritet fillimi i marrjes së deklaratave të të pandehurve kundër të cilëve janë zgjeruar hetimet.

Gjithashtu, ju njoftoj se nga ________________, janë pranuar mbi ____________ dëshmi, të cilat duhet të analizohen dhe varësisht nga rezultatet e këtyre analizave, mund të ketë edhe zgjerim tjetër të hetimeve.

Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një rast mjaft të komplikuar, për shkak të natyrës specifike të veprimeve inkriminuese, ku janë të përfshirë ____________ të pandehur dhe mbi _____________ dëshmitarë dhe të dëmtuar, me respekt **kërkoj nga ju që të autorizoni një vazhdim të hetimeve kundër të pandehurit ______________ edhe për _____________ muaj respektivisht deri më datën _______________,** në mënyrë që hetimet të zhvillohen pa pengesë dhe të sigurohen dëshmi që janë të domosdoshme për të marrë vendim të drejtë lidhur me këtë çështje penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas marrjes së deklaratës nga i pandehuri _________________, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR NDËRPRERJEN E MASËS SË NDALIMIT**

**NDËRPRITET** masa e ndalimit kundër të pandehurit ______________________, i biri i _______________ dhe ______________, mbiemri i vajzërisë, _______________, i lindur më _____________________, në __________________, rruga _______________, nr._________, adresë në të cilën jeton, lëshohet menjëherë në liri.

**A R S Y E T I M**

Policia e Kosovës - Departamenti ___________________, më datën _______________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve ______________, _______________ dhe _______________ për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale _____________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Më datën _______________, prokurori, i nënshkruar këtu, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve për veprat penale të theksuara lart.

Në bazë të autorizimit të prokurorit PP. nr._________, të datës _______________, i pandehuri ______________ është arrestuar më datën _____________, në ora __________ dhe fillimisht është marrë në pyetje nga ana e policisë e pastaj nga ana e prokurorit. Gjatë dhënies së këtyre deklaratave, i pandehuri ________________, ka

deklaruar se ______________________ dhe ka premtuar se nuk do të ikë apo arratiset dhe se nuk do të përsërisë veprën penale.

Pas arrestimit të të pandehurit _________________, janë marrë edhe deklaratat e dëshmitarëve/të dëmtuarve: ________________ dhe _______________, të cilët kanë deklaruar se ____________________________________________________________
_________________________________________________.

Duke marrë parasysh deklaratën e të pandehurit dhe faktin se dëshmitarët apo të dëmtuarit, me të cilët ka të bëj ky i pandehur, janë marrë në pyetje, pasi arrestimit të tij, konsideroj se kanë pushuar arsyet ligjore për mbajtjen e mëtejme në ndalim apo në paraburgim të të pandehurit, andaj lëshohet menjëherë për t'u mbrojtur në liri.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Në pajtim me nenin _________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr këtë:

## A K T V E N D I M
## MBI NDALIMIN E TË PANDEHURIT

CAKTOHET MASA E NDALIMIT NË KOHËZGJATJE PREJ 48 (DYZETETETË) ORËVE, DUKE FILLUAR NGA DATA _______________, NË ORA ____________.

**Kundër të pandehurit:________________________________ (shëno të dhënat personale)**

Ekziston dyshimi i bazuar se ______________________________(shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale).

- me ketë veprim, ka kryer veprën penale: ____________________________ nga neni ______________ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Policia e Kosovës – Drejtoria ___________________, më datën ______________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve ________________, ________________ dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale ________________ nga neni _____________ i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë ________________, prokurori i shtet ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve ___________________, ___________________ dhe ________________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se të njëjtit kanë kryer veprat penale ___________________ nga neni ________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës).

Gjatë zhvillimit të hetimeve, janë urdhëruar dhe zbatuar masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit: ________________________________________, si dhe janë siguruar të dhënat nga ___________________________________________________ ______________________________________.

Policia e Kosovës, ka paraqitur raportet për zbatimin e masave të fshehta më datat ________________, ________________ dhe ________________, sipas të cilave rezulton se të pandehurit janë përfshirë në kryerjen e veprave penale të sipër përmendura.

Gjithashtu, dyshimi i bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale, rezulton edhe nga ______________________________________________________________________ _______.

**BAZA LIGJORE:**

**Neni ______i KPPK-së**
Nga sa u tha më lart, ka dyshim të bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.

**Neni ______ i KPPK-së**
I pandehuri ka rrezik të arratisjes, sepse rrethanat e këtij rasti penal tregojnë se ___________ _____ _______ ____________________________________________.

**Neni ______ i KPPK-së**
I pandehuri mund të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit.

Ky konstatim vije për shkak se ____________________________________________ ________________________.

**Neni _______ i KPPK-së**
Pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tyre personale, tregojnë rrezikun se i pandehuri mund të përsërisë veprën penale, duke marrë parasysh ________________________________________ ___________________________.

**Neni _______ i KPPK:**
I ndaluari mund të mbahet në masën e ndalimit më së shumti 48 (dyzetetetë) orë nga dita dhe ora e arrestimit.

**Hetimet vazhdojnë dhe duhet të ndërmerren veprimet në vijim**

_____________________________________________, varësisht nga këto rezultate, do të ndërmerren veprimet tjera hetimore.

Te gjitha këto veprime hetimore, është e nevojshme që të ndërmerren për t'i zbuluar dhe për t'i hetuar lidhjet ekzistuese të të pandehurve.

**Deri më tani, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme, për të shpejtuar zbatimin e procedurës**.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më lart, në pajtim me nenin ________________, të KPPK-së prokurori i nënshkruar ka caktuar masën e ndalimit kundër të të pandehurit **___________________,** në kohëzgjatje prej 48 orëve, duke filluar nga data _________, në ora __________, kur është bërë arrestimi i tij.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa te Gjyqtari i Procedurës paraprake të Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në afat prej 24 orëve nga momenti i pranimit të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**POLICISË SË KOSOVËS – Departamentit _______________, në _______________,**
**Zyrtarëve policorë: ____________________ dhe _________________**

**Në bazë të nenit ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr ketë:**

## AUTORIZIM PËR ARRESTIM

**Kundër të pandehurit: ____________________(shëno shënimet personale)**

Ekziston dyshim i bazuar se ky i pandehur, është i përfshirë në kryerjen e veprave të mëposhtme penale, të cilat ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare.

**______________________, nga neni _______________**, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me veprën penale,

_____________________, neni ______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

### Arsyetim

Kundër të pandehurit _______________, etj. janë duke u zhvilluar hetimet për shkak të dyshimit se ai ka kryer veprat penale ____________________, nga neni _________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), lidhur me veprën penale ___________, nga neni ___________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Në bazë të provave të siguruara deri në këtë fazë të procedurës, siç janë: Raportet __________________________, rezulton dyshimi i bazuar se ai ka kryer veprat penale të përshkruara më lart.

Duke marr parasysh se në këtë çështje penale ekzistojnë rrethanat për caktimin e ndalimit ________________________(rrethanat janë të ngjashme me rrethanat për caktimin e paraburgimit – andaj shëno dhe arsyeto secilën rrethanë që ndikon në caktimin e ndalimit).

Sipas këtij Autorizimi, arrestimi nuk mund të zgjasë më tepër se 6 (gjashtë) orë.

Në momentin e arrestimit, i dyshuari duhet që të njoftohet se gëzon këto të drejta në bazë të nenit ___________________, të KPPK.

- të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
- të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij;
- t’i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit;
- të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t’i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;
- për arrestimin e tij- të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër, sipas zgjedhjes së tij; dhe
- të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Ju duhet që të njoftoni menjëherë prokurorin e shtetit që ka dhënë këtë autorizim, lidhur me arrestimin e të dyshuarit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

________________________

**_____, nr._____/______**

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI_______________________**

Në bazë të nenit __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ju dërgojmë këtë:

**TH I RR J E**

__________________________ (emri, emri i babës dhe mbiemri) nga _____________, rruga ______________, nr.________.

Thirreni që më datën ______________, në ora ___________, të paraqiteni në Gjykatën Themelore në ______________, në sallën nr._________, në cilësinë e të pandehurit / të akuzuarit për shkak të veprës penale ______________, nga neni_______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Ju paralajmërojmë se në rast të mosparaqitjes, do të lëshohet urdhërarrest dhe do të silleni në gjykatë forcërisht.

Ju keni të drejtë të angazhoni mbrojtës dhe se mbrojtësi juaj mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes suaj në pyetje/në gjykim.

Në rast se ju ndryshoni adresën tuaj, duhet menjëherë ta njoftoni gjykatën për çdo ndryshim të adresës ose për qëllimin e ndryshimit të vendqëndrimit, në të kundërtën, do të lëshohet urdhërarrest dhe do të silleni në gjykatë forcërisht.

Në rast se ju nuk jeni në gjendje t'i përgjigjeni thirrjes, për shkak të sëmundjes ose pengesës tjetër të paevitueshme, ju duhet ta njoftoni Gjykatën për vendin se ku gjendeni ose/dhe që të shtyhet marrja e juaj në pyetje/gjykimi.

**Gjyqtari**
**N.N.**

______________________

| | | |
|---|---|---|
| | Republika e Kosovës<br>**Republika Kosova – Republic of Kosovo**<br>Qeveria – Vlada – Government<br><br>Ministria e Punëve të Brendshme<br>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs | |
| | Policia e Kosovës/Policija Kosova/<br>Kosovo Police<br><br>Drejtoria përhetimin e narkotikëve____________<br>Njësia në ________________ | |

**MEMORANDUM ZYRTAR / SLUŽBENI MEMORANDUM /**
**OFFICIAL MEMORANDUM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| PËR:<br>ZA:<br>TO: | Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës | Data:<br>Datum:<br>Date: | __________ |
| PËRMES:<br>PREKO:<br>THROUGH: | ___________________<br>Mbikëqyrës ekipi në DHTN- ____________ | Nr. i referencës<br>___________________ | |
| PREJ:<br>OD:<br>FROM: | _____________________<br>Hetues në DHTN ___________ | Nr. i rastit<br>___________________ | |
| LËNDA:<br>PREDMET:<br>SUBJECT: | Dorëzimi i thirrjes | | |

I nderuari z. Prokuror,

Pas marrjes së autorizimit Tuaj për dorëzimin e thirrjes për të pandehurin ___________, i lindur më datë_______________, në fshatin _____________, tani me vendbanim në _____________________, ne kemi shkuar në adresën e vendbanimit dhe aty kemi takuar bashkëshorten e tij _____________________. Ajo ka deklaruar se bashkëshorti i saj/i pandehuri _______________, nuk gjendet në shtëpi sepse ka shkuar për të punuar në botën e jashtme, në ___________________ dhe se nuk do të kthehet në Kosovë deri më datën __________________.

Bashkëshortes së të pandehurit i është dorëzuar thirrja dhe është kërkuar nga ana e saj që ta njoftojë të pandehurin lidhur me thirrjen e dorëzuar dhe nëse kthehet, të paraqitet në Stacionin policor në _______________, ose në zyrën tuaj.

Me respekt,

**____, nr._____/ _______**

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________________ -** Departamenti _______________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, _____________ dhe _____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________ për lëshimin e urdhërarrestit, më datën _______________, nxjerr këtë:

**URDHËRARREST**

Kundër të pandehurit ____________________________ (shëno të dhënat personale të të pandehurit).

Detyrohet Policia e Kosovës – Drejtoria ________________, në ___________, që këtë urdhërarrest t'ia dorëzojë të pandehurit dhe të kërkojë që i pandehuri të shkojë me ta.

Nëse i pandehuri e refuzon pranimin e këtij urdhërarresti, atëherë policia duhet ta dërgojë forcërisht në Prokurorinë Themelore në ______________, Departamenti ______________, në zyrën nr.________, më datën ____________, në ora _________.

**A r s y e t i m**

Më datë ____________________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: _______________________ dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale _________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe __________________________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas fillimit të hetimeve, prokurori i shtetit i ka dërguar thirrje të rregullta të pandehurit për t'u paraqitur në prokurori, për të dhënë deklaratën e tij lidhur më veprat penale që i vihen në barrë, në datat __________________, _____________________ dhe __________________. Në të gjitha rastet, sipas fletë kthesave i pandehuri kishte pranuar personalisht thirrjet e prokurorit.

Më datë _________________, prokurori i shtetit, ia ka paraqitur kësaj gjykate kërkesën PP__, nr.___________, për lëshimin e urdhërarrestit, me arsyetim se i pandehuri është duke mos ju përgjigjur thirrjeve të rregullta të prokurorit dhe në asnjë rast nuk është duke i arsyetuar mosparaqitjet e tij.

Gjyqtari i procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit, gjeti: kërkesa është e bazuar.

Sipas shkresave të lëndës, rezulton se më datat _______________, _______________ dhe ____________, prokurori i shtetit i ka dërguar të pandehurit ________________, thirrje të rregullta për t'u paraqitur në prokurori për të dhënë deklaratë lidhur me dyshimin për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktvendimit për fillimin e hetimeve. Mirëpo, i pandehuri, edhe pse sipas fletëkthesave për pranim–dorëzimin e thirrjeve, i ka pranuar thirrjet në mënyrë të rregullt, nuk është paraqitur në prokurori dhe në asnjë rast nuk e ka arsyetuar mosparaqitjen e tij.

Gjithashtu, në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: __________ ____________________________________, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri __________________, ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, sipas aktvendimit për fillimin e hetimeve.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më sipër, gjyqtari i procedurës paraprake, gjen së lëshimi i këtij urdhërarresti është i domosdoshëm, në mënyrë që i pandehuri të detyrohet për t'u paraqitur në prokurori dhe për të dhënë deklaratë, andaj për ketë arsye detyrohet Policia e Kosovës – Departamenti ________________, në ___________, që ketë urdhër t'ia dorëzojë të pandehurit dhe të kërkojë që i pandehuri të shkojë me ta. Nëse i pandehuri këtë e refuzon, atëherë Policia duhet ta dërgojë të pandehurin forcërisht në Prokurorinë Themelore në ______________, Departamenti _______ _______, në zyrën nr. __________, më datën ________________, në ora _________.

**GJYKATA THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**_______, nr. _____________ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** ____________________

**Gjyqtari i procedurës paraprake** ________________________________

**_____.nr._________**

**GJYKATA THEMELORE NË** ______________________________, Departamenti ________________, gjyqtari i procedurës paraprake _________________, me procesmbajtësen ____________, në çështjen penale kundër të pandehurit __________________, për shkak të veprës penale ______________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorisë Themelore në _____________, PP___, nr.___________, të dt. ____________, për Caktimin e masës së ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, me dt. ______________, mori këtë:

## A K T V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E MASËS SË NDALIMIT PËR T'IU AFRUAR VENDIT OSE PERSONIT TË CAKTUAR

Kundër të pandehurit: _______________________ (shëno të dhënat personale) i cili gjendet në arrest prej dt. ___________, në ora _______.

**CAKTOHET** masa e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, ashtu që të pandehurit _______________________, i ndalohet që t'i afrohet _________________, (shëno të dhënat e personit të mbrojtur më ketë masë) si dhe shtëpisë së _________________________ (shëno adresën e shtëpisë) në afërsi prej 500 metra.

Kjo masë, sipas këtij aktvendimi, do të zgjasë një muaj, duke filluar nga data __________________, në ora _________________.

Në rast të mosrespektimit të kësaj mase, të pandehurit do t'i zëvendësohet kjo masë me masën e paraburgimit

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në ______________, ka bërë kërkesën, PP___, nr.______, të dt.___________, për caktimin e masës së ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, kundër të pandehurit ________________, për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale ________________, nga neni ____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake, e ka mbajtur seancën e dëgjimit, dhe në këtë seancë, prokurori i shtetit ka mbrojtur kërkesën me shkrim për caktimin e masës së ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar.

Propozimin për caktimin e masës së ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit te caktuar, e kanë kundërshtuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, duke konsideruar se _______________________________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, i ka analizuar arsyet mbi caktimin e masës së ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar dhe ka gjetur se kërkesa e prokurorit të shtetit është e bazuar.

Kjo masë vjen për shkak se gjatë seancës së dëgjimit lidhur me masën e propozuar, është vërtetuar dyshimi i bazuar që i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, kusht ky që kërkohet me dispozitën e nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Ky dyshim është vërtetuar në bazë të ___________________________________.

Gjithashtu, në këtë çështje penale, janë plotësuar edhe kushtet tjera ligjore nga neni _______________, të Kodit të Procedurës Penale, që të dyshuarit t'i shqiptohet masa e ndalimit për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, duke marrë për bazë rrethanën se në këtë çështje penale, duhet të dëgjohen: i dëmtuari _______________, dëshmitarët: ________________________________ dhe _____________________, pastaj rrethanën se _________________________, andaj duhet caktuar këtë masë, sepse ekziston rreziku se mund të pengojë zhvillimin normal të hetimeve duke ndikuar në të dëmtuarin dhe dëshmitarët si dhe mund të përsërisë veprën e njëjtë penale.

Nga sa u tha më lart, konform nenit ____________, të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ___________________**
**DEPARTAMENTI_____________________________**
**____, nr.__________, dt. ____________.**

**Gjyqtari i procedurës paraprake**
**N.N.**
_____________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa pranë kolegjit penal të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në afat prej 24 orësh nga koha e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

**____.nr.___________**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________** - Departamenti ________________, gjyqtarja e procedurës paraprake ____________________, në çështjen penale kundër të pandehurit _________________, për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni ____________________, të KPPK-së, dhe kanosja nga neni ______________, të KPRK-së, duke vendosur për kërkesën e Prokurorisë Themelore në __________________, për caktimin e masës paraqitje në stacion policor, PP___, nr.______________, të dt.______________, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit, me dt. ________________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Kundër të pandehurit _______________________ (Shënimet personale të pandehurit), urdhëron masen

**PARAQITJE NË STACIONIN POLICOR**

**I.** Masa paraqitje në stacionin policor i caktohet të pandehurit __________________, në kohëzgjatje prej një muaji, prej dt. _____________, deri më dt. ______________.

**II.** I pandehuri, obligohet të paraqitet në stacionin policor në _______________, çdo të hënë, në ora ___________.

**III.** Detyrohet, stacioni policor në ____________________, ta verifikojë zbatimin e kësaj mase dhe në rast të mosrespektimit të saj, ta informojë gjyqtaren e procedurës paraprake të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në _______________, ka bërë kërkesë për caktimin e masës, paraqitje në stacionin policor kundër të pandehurit ____________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale: __________________, nga neni _______________, të KPRK-së dhe kanosja nga neni ____________, të KPRK-së.

Në seancën e dëgjimit, prokurori i shtetit __________________, ka mbrojtur kërkesën e ushtruar, duke konsideruar se janë përmbushur kushtet për caktimin e masës: paraqitje në stacionin policor, nga neni _______________, të KPPK-së, sepse ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari, i ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe se ekziston rreziku që i pandehuri nese mbetet në liri mund të ikë.

Propozimin për caktimin e masës paraqitje në stacionin policor, nuk e kanë kundërshtuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, av. ______________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, ka analizuar arsyen mbi caktimin e masës paraqitje në stacionin policor, dhe ka gjetur se kërkesa e prokurorit të shtetit është e bazuar.

Kërkesa është e bazuar për shkak se gjatë seancës së dëgjimit për caktimin e masës se propozuar, është vërtetuar ekzistimi i dyshimit të bazuar që i pandehuri i ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Ky dyshim është vërtetuar në bazë të ______________________________. Andaj, kjo paraqet bazën ligjore të paraparë me nenin ________________, të KPPK-së, për caktimin e kësaj mase.

Gjithashtu, ekziston edhe baza ligjore për caktimin e masës paraqitje në stacionin policor, konform nenit ______________, të KPPK-së, ngase ekziston rrethana e bazuar se i pandehuri do të fshihej ose arratisej në ndonjë vend tjetër, për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, pasi që ai ______________________________________________. Andaj, bazuar në këto rrethana, caktimi i masës paraqitje në stacionin policor, si masë e sigurisë së prezencës së të pandehurit deri në përfundim të procedurës penale, është më se i nevojshëm.

Nga sa u tha më lartë, konform e nenit ____________ të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E THEMELORE NË _____________**
**DEPARTYAMENTI _________________________**
**____ nr.__________, dt. ______________.**

**Gjykatësja e procedurës paraprake**
**________________________________**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa pranë Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate, në afat prej 24 orëve nga koha e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

**________.nr._________**

**GJYKATA THEMELORE NË _______________ -** Departamenti ____________, Gjyqtari i procedurës paraprake ____________, me sekretaren juridike ___________, në lëndën penale kundër të pandehurit ____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale ___________________, nga neni ___________, të KPRK-së, duke vepruar sipas propozimit të mbrojtësit të te pandehurit av. ________________, për zëvendësimin e masës së paraburgimit me dorëzani dhe pëlqimit të prokurorit të shtetit në Prokurorinë themelore në __________, PP__, nr. ___________, të dt. ____________, në bazë të nenit ________________, të KPPK-së në prezencë të prokurorit të shtetit____________, të pandehurit ____________________ dhe mbrojtësit të tij me autorizim, avokatit ___________________, me datën ______________, mori këtë:

## A K T V E N D I M

**I.** Me aprovimin e propozimit të mbrojtësit të të pandehurit, ___________, avokatit __________, të datës __________ zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e dorëzanisë**.**

**II.** Kundër të pandehurit **Ndërpritet menjëherë paraburgimi** dhe kundër tij, **caktohet masa e dorëzanisë,** në shumën_____________________, të cilën duhet ta paguajë menjëherë në buxhetin e gjykatës.

**III.** Nëse i akuzuari nuk i përgjigjet ftesave të prokurorisë ose gjykatës, mjetet e caktuara në dorëzani, do të derdhen në fondin për kompensimin e viktimave, ndërsa atij do t'i caktohet menjëherë paraburgimi.

**IV.** Të pandehurit i konfiskohet përkohësisht dokumenti i udhëtimit,,pasaporta nr.__________,

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në _______________, Departamenti _________________, ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit të PP. nr. ___________, të dt. ___________, kundër të pandehurit __________, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________, nga neni ________________, i KPRK-së.

Paraburgimi për të pandehurin është caktuar me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake _____, nr.____________, të datës ______________ dhe i është vazhduar me aktvendimin e datës __________ edhe për dy muaj, respektivisht deri më datën ________________.

Mbrojtësja e të pandehurit _______________, avokatja _____________, ka paraqitur propozimin për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e dorëzanisë, më datë ____________, ashtu që i pandehuri në emër të dorëzanisë do të dorëzojë shumë prej ___________________________.

Prokurori i shtetit, në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, me shkresën PP__. _____________, të datës _____________, ka dhënë pëlqimin që të pandehurit ______________, t'i zëvendësohet masa e paraburgimit me masën e dorëzanisë.

Gjyqtari i procedurës paraprake, duke vepruar sipas këtij propozimi, në bazë të nenit _______________, të KPPK-së, shqyrtoi mundësinë që i pandehuri të lirohet nga paraburgimi me dorëzani dhe gjeti se:

Janë plotësuar kushtet ligjore për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e dorëzanisë, sepse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale dhe se baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë. I pandehuri premton se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do ta braktisë vendqëndrimin e tij.

Në këtë çështje penale edhe më tutje ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale _________________, nga neni ________________, të KPRK-së, i cili dyshim rezulton nga _____________________________________________________ ____________________________________________.

Ky dyshim i bazuar mund të vërtetohet edhe nga _____________________________ ___________________________________________________.

Gjithashtu, si bazë për këtë vendim, është baza ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni ___________, të KPPK-së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme, të cilat tregojnë rrezikun e ikjes duke marrë parasysh se _______________________________________ ________________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se kanë pushuar bazat ligjore nga neni _______________, të KPPK-së për paraburgim, sepse ___________________________ _____________________________________________________.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit _____________, të KPPK-së, gjyqtari i procedurës paraprake gjeti se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zëvendësimin e paraburgimit si masë më e rëndë, me masën e dorëzanisë si masë më e butë, për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale, duke marrë parasysh edhe premtimin e të pandehurit se do t'i përgjigjet ftesave të prokurorisë. Gjykatësi mori parasysh edhe rrethanën se nga i njëjti është konfiskuar përkohësisht edhe dokumenti i udhëtimit/pasaporta, si një veprim shtesë për sigurinë e premtimit të të pandehurit se nuk do të largohet nga vendi ose t'u shmanget ftesave të rregullta.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________, nr.____________ më datë ___________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake**
**_________________** **____________________________**

**KËSHILLA JURIDIKE**:
Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate, brenda 24 orëve nga koha e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTIT ____________________**
**P Ë R**
**GJYKATËN E APELIT NË _____________**

Kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake PP___.nr.____________ të datës ____________, për të pandehurit it___________________ dhe _____________, nëafat ligjor paraqesë ketë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të _______________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e prokurorit të shtetit, për vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurve _______________, dhe _________________, edhe për një muaj, respektivisht deri më datën ______________, ose aktvendimi të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjyqtarit të procedurës paraprake në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Prokurori i shtetit, më datë ________________, ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e paraburgimit edhe për një muaj kundër të pandehurve ______________________ dhe __________________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake _____________________________, me aktvendimin _________________, të datës ___________________, kundër të pandehurve ______________________ dhe __________________, ka ndërprerë masën e paraburgimit dhe këtyre të pandehurve ua ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej një muaji, respektivisht deri me datën ___________________.

Si arsyetim, për ndryshimin e masës së paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak, gjykata ka marrë:_______________________________________________________.

Konsideroj se aktvendimi i Gjyqtares së procedurës paraprake, duhet të ndryshohet ose prishet, sepse _______________________________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u tha, konsideroj se Gjykata e Apelit do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT ______________________**
**P Ë R**
**GJYKATËN E APELIT NË PRISHTINË**

Kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, të Gjykatës Themeore në _____________, Departamenti _________________, _______, nr. _________, të datës ___________, në afatin ligjor, paraqes këtë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të ________________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të prishet dhe lënda t'i kthehet Gjyqtarit të procedurës paraprake në rivendosje apo ta ndryshojë të njëjtin ashtu që: kundër të pandehurve: ________________ dhe ___________________, të zgjatet paraburgimi, jo më shumë se _______________ muaj, brenda afateve të parapara në nenin __________, paragrafi ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, (KPPK) respektivisht deri me datën _____________.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake, të Gjykatës Themelore, Departamenti për __________________, në ______________ _______, nr.____/____,

të datës ___________, është zevendesuar masa e paraburgimit me masën e dorëzanisë ashtu që për të pandehurit ________________ dhe ________________ është caktuar dorëzania për secilin veç e veç, në shumë prej ___________ euro, si dhe u janë marrë pasaportat.

Konsideroj se aktvendimi i kundërshtuar është nxjerrë në kundërshtim më nenin ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sepse sipas kësaj dispozite, i pandehuri mund të lirohet nga paraburgimi me dorëzani vetëm kur: _______________________________________________________________ ______________________________________________.

Siç është theksuar nga ana e prokurorit të nënshkruar më poshtë, në seancën dëgjimore të thirrur nga gjyqtari i procedurës paraprake, në këtë çështje penale edhe më tutje ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit, si më poshtë:

**Neni ________, paragrafi ______, nënparagrafi _______, pika ______, të KPPK-së:**
Ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit i kanë kryer veprat penale të lartcekura që ndiqen sipas detyrës zyrtare: ________________, nga neni ________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe kjo rezulton nga _______________________ ___________________________.

Nga bisedat telefonike dhe SMS-të, shihet qartë se _____________________.

Gjithashtu, në bazë të raporteve për sendet e konfiskuara, rezulton se ________.

**Neni _________, paragrafi ________, nënparagrafi _________, pika ______, të KPPK-së:**
Ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se të pandehurit do të fshihen apo arratisen, sepse ____________________________________________________________ ____________________________________________________________.

**Neni _________, paragrafi ________, nënparagrafi _________, pika ______, të KPPK-së:**
Ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se të pandehurit mund t’i asgjësojnë, fshehin, ndryshojnë, ose falsifikojnë provat e veprës penale ose do të ndikojnë në të dëmtuarit, dëshmitarët ose të pandehurit, sepse ___________________________.

**Neni _________, paragrafi ________, nënparagrafi _________, pika ______, të KPPK-së:**
Ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se ata do të përsërisin veprën penale duke marrë parasysh ____________________________________________________ ___________________________________________________.

**Neni ________, paragrafi ________, të KPPK-së:**

Mëqenëse masat tjera, të parapara në nenin ___________, paragrafi ________, të Kodit të Procedurës Penale, duke përfshirë edhe dorëzaninë e pranuar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurve, për te parandaluar përsëritjen e veprave penale dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës penale, konsideroj se paraburgimi për të pandehurit _________________ dhe ____________________, për momentin është e vetmja masë adekuate, për të siguruar praninë e të pandehurve në procedurën penale.

Duke i marrë parsysh ato që u theksuan më lart, konsideroj se Gjykata e apelit do të veprojë sipas propozimit të dhënë më sipër, në këtë ankesë.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT ______________________**
**P Ë R**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenin ________, paragrafi _____, nënparagrafët ______, dhe nenin ______, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR CAKTIMIN E MASËS SË DORËZANISË DHE KONFISKIMIN E PASAPORTËS**

**Kundër të pandehurit: ______________________ (shëno shënimet personale të të pandehurit).**

Ekziston dyshimi i bazuar se ___________________ (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale).

- me ketë vepër, kishte për të kryer e veprat penale ______________, nga neni ______, paragrafi _______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**A R S Y E T I M I**

Prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ________________, pas pranimit të kallëzimit penal nga Policia e Kosovës – Drejtoria ____________, në ____________, referenca _____________, të datës ______________, më datën ______________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, kundër të pandehurit ___________, për shkak

të dyshimit se ai ka kryer veprën penale _________________, nga neni __________, paragrafi __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës Themelore në __________________, më urdhëresën _________, nr. ___________, më datat __________, në bazë të kërkesë së Prokurorit të shtetit, të datës ___________, ka lëshuar urdhër për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, për të pandehurin: ______________.

Sipas raportit të Policisë së Kosovës për zbulimin e të dhënave financiare, me numër të referencës _____________, të datës ___________, rezulton ______________________ ____________________.

Gjatë kontrollit të banesës dhe lokalit të te pandehurit _______________, që është kryer në bazë të urdhrit të gjyqtarit të procedurës paraprake _______________, nr. __________, i datës _________, janë sekuestruar _______________________________ _______________________________________.

Më datë ____________, i pandehuri ______________________, ka dhënë deklaratë në prokurori dhe ka deklaruar se _____________________________________________ _______________________________________.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në veprimet e të pandehurit ________________, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të kësaj kërkese dhe se është e nevojshme që të caktohet masa e dorëzanisë dhe të konfiskohet pasaporta, në mënyrë që të zhvillohen hetimet në mënyrë të papenguar dhe të grumbullohen provat e nevojshme, duke përfshirë edhe __________.

Duke marrë për bazë nenin ____, paragrafi __, nën paragrafi _____, dhe ___, të KPPK-së, gjykata mund të urdhërojë që i pandehuri të mbrohet në liri me dorëzani ose të lirohet nga paraburgimi me dorëzani kur: Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprat penale dhe se baza e vetme për paraburgim është frika se i pandehuri mund të ikë. I pandehuri premton se nuk do të fshihet ose pa leje nuk do të braktisë vendqëndrimin e tij, kërkoj që ndaj tij të caktohet masa e dorëzanisë, sepse _______________________________________________________________.

Meqenëse në bazë të nenit ____, të KPPK-së, dorëzania gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzaninë, konsideroj se dorëzania në shumën ___________euro ose pasuria e pa luajtshme mbi këtë vlerë, do të ishte masë adekuate për sigurimin e pranisë së këtij të pandehuri në procedurën penale, dhe nuk do të ikë. Me aktvendim të gjykatës, duhet të caktohet që vlera e dhënë si dorëzani, të derdhet në fondin për kompensimin e viktimave.

Kjo bëhet për shkak se ____________________________________________________ ________________________________.

Nga sa u tha më sipër, me respekt i kërkoj Gjyqtarit të Procedurës Paraprake që kundër të pandehurit: ____________, të caktojë masën e dorëzanisë, ashtu që i pandehuri të japë shumën e parave ________________ euro apo të lërë si hipotekë pasuri të pa luajtshme siç janë shtëpitë apo tjetër pasuri me vlerë mbi _______________ euro si dhe të bëjë konfiskimin e pasaportës së të pandehurit me numër _______________, lëshuar më datë _____________, nga ___________________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas pranimit të kërkesës së të pandehurit ____________________, dhe mbrojtësit të tij – avokat _________________, për zëvendësimin e masës së paraburgimit me ndonjë masë tjetër alternative për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, jap këtë

**P Ë L Q I M**

Që masa e paraburgimit kundër të pandehurit ___________________, të zëvendësohet me masën e dorëzanisë, ashtu që i pandehuri duhet të japë si dorëzani shumën prej ____________ euro apo të ofrojë si dorëzani shtëpi, banesë apo paluajtshmëri tjetër mbi këtë vlerë dhe njëkohësisht të dorëzojë në gjykatë edhe dokumentet e udhëtimit.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit ___________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak të veprës penale _____________________, nga neni __________, paragrafi ______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale - ________________, nga neni _______, paragrafi ____, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në ___________, duke aprovuar kërkesën e prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _____________, me

aktvendimin e fundit ______, nr.______________, të datës _____________, ia ka vazhduar paraburgimin të pandehurit _________________, i cili do të zgjasë deri më datën __________________.

I pandehuri ________________, dhe mbrojtësi i tij__________________, më datë ______________, kanë paraqitur kërkesë të përbashkët për ndërprerjen e paraburgimit apo zëvendësimin e masës së paraburgimit me ndonjë masë tjetër alternative për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale.

Duke marrë parasysh hetimet e deritanishme, deklaratat e dëshmitarëve dhe të të gjithë të pandehurve, rezulton se kanë ndryshuar rrethanat që kanë ndikuar në caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit kundër të pandehurit __________________, andaj, konsideroj se masa e paraburgimit mund të zëvendësohet me masat tjera alternative, që në ketë rast duhet të jetë dorëzania. Të pandehurit, mund t'i caktohet masa e dorëzanisë dhe ai duhet të japë si dorëzani shumën prej _____________ euro apo të ofrojë si dorëzani shtëpi, banesë apo paluajtshmëri tjetër mbi këtë vlerë dhe njëkohësisht të dorëzojë në gjykatë edhe dokumentet e udhëtimit, pasi që edhe kjo masë mund të jetë e mjaftueshme, që i pandehuri të mos ikë dhe të mos i shmanget thirrjeve të prokurorisë apo gjykatës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _________________**
**PËR GJYKATËN E APELIT NË ___________________**

Lidhur me ankesën e mbrojtësit të të pandehurit __________, avokatit ___________, në afat ligjor, paraqesë këtë:

## PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS

Me aktvendimin ____________________, nr.________, të datës ____________, është vazhduar paraburgimi kundër të pandehurve: __________________ edhe për një muaj, respektivisht deri më datën ___________.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit, ___________, avokati ______________________, për shkak të _____________________________, dhe _____________________, me propozim që ankesa të aprovohet dhe ndaj të pandehurit __________, të ndërpritet paraburgimi ose t'i zëvendësohet me ndonjë masë tjetër.

Konsideroj se ankesa e mbrojtësit të të pandehurit ___________, është e pabazuar, sepse ajo nuk ka vënë në dyshim asnjërën nga bazat për të cilat është vazhduar masa e paraburgimit.

Në këtë rast, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ______________, ka kryer veprat penale për të cilat është duke u zhvilluar hetimi. Ky dyshim, rezulton nga ________________________________________________________________________ ____________________________________________.

Rrethanat e këtij rasti penal, tregojnë se ka rrezik të fshehjes apo arratisjes së të pandehurit _______________________, sepse _________________________________
_________________________________.

Në këtë rast edhe pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit _______________________, se nuk ekziston baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga neni _______, par.___, nën par. _______, pika ___, nuk është i bazuar sepse ____________________________
_____________________________________________.

Pretendimi tjetër i mbrojtësit të të pandehurit ____________, se ky i pandehur nuk do të përsërisë veprën penale, nuk është i bazuar, sepse ____________________________
___________________. Andaj, duke marrë parasysh ato që u thanë më lart**,**

**P R O P O Z O J**

Që ankesa e mbrojtësit të të pandehurit ______________, të refuzohet si e pabazuar dhe aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit ________, nr.___________, të datës ___________, të vërtetohet.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

_____/______

**GJYKATA THEMELORE NË** ______________________________, Departamenti ________________, gjyqtari i procedurës paraprake _______________, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në ___________, PP__, nr.___________, të dt. ____________, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, kundër të pandehurit ______________, për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale ______________, nga neni ______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, pas mbajtjes së seancës së dëgjimit më datën ______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR CAKTIMIN E ARRESTIT SHTËPIAK**

Kundër të pandehurit: _____________________(shëno të dhënat personale).

**I.** I caktohet masa e arrestit shtëpiak të pandehurit ______________________, në kohëzgjatje prej një muaji, e cila masë do të fillojë prej dt. _____________, deri më dt. _____________, në ora ________.

**II.** I pandehuri ________________, me vendbanim në ____________________, obligohet të qëndrojë në shtëpinë e tij dhe në asnjë mënyrë nuk guxon të largohet nga shtepia/banesa pa leje të gjykatës.

**III.** Detyrohet Policia e Kosovës, Stacioni policor në _____________, ta verifikojë zbatimin e kësaj mase dhe në rast të mosrespektimit të saj, ta informojë gjyqtarin e procedurës paraprake të kësaj gjykate.

**IV.** Në rast të mosrespektimit të kësaj mase, të pandehurit do t'i zëvendësohet kjo masë me masën e paraburgimit

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në ______________, ka bërë kërkesën, PP___, nr.________, të dt.___________, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, kundër të pandehurit _______________, për shkak të dyshimit të bazuar se e ka kryer veprën penale ________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjyqtari i procedurës paraprake, e ka mbajtur seancën e dëgjimit dhe në këtë seancë, prokurori i shtetit ka mbetur pranë kërkesës me shkrim për caktimin e masës së arrestit shtëpiak.

Propozimin për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, nuk e kanë kundërshtuar i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, duke konsideruar se masa e propozuar është adekuate dhe e pranueshme.

Gjyqtari i procedurës paraprake, i ka analizuar arsyet mbi caktimin e masës së arrestit shtëpiak dhe ka gjetur se kërkesa e prokurorit të shtetit është e bazuar.

Kjo kërkesë është e bazuar për shkak se gjatë seancës së dëgjimit, lidhur me masën e propozuar, është vërtetuar dyshimi i bazuar që i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, kusht ky që kërkohet me dispozitën e nenit ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Ky dyshim është vërtetuar në bazë të ____________________________________.

Gjithashtu, në ketë çështje penale, janë plotësuar edhe kushtet tjera ligjore nga neni _______________, i Kodit të Procedurës Penale, që atij t'i shqiptohet masa e arrestit shtëpiak, duke marrë për bazë rrethanën se në këtë çështje penale, duhet të dëgjohen: i dëmtuari _______________, dëshmitarët: _____________ dhe ______________, pastaj rrethanën se ___________________________, andaj po të gjendej i pandehuri në liri, ekziston rreziku se mund të pengojë zhvillimin normal të hetimeve dhe mund të përsërisë veprën e njëjtë penale.

Nga sa u tha më lart, konform nenit _____________, të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI _________________________**
**______, nr.__________**
**Më datë ___________.**

**Gjyqtari i procedurës paraprake**

_____________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa pranë kolegjit penal të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në afat prej 24 orësh nga koha e dorëzimit të këtij aktvendimi.
Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/ Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT ______________________**
**PËR: GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenet ________, paragrafët _______ dhe _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes:

**KËRKESË PËR VAZHDIMIN E MASËS SË ARRESTIT SHTËPIAK**

Kundër të pandehurit: __________________ (shëno shënimet personale të të pandehurit)

Sepse ekziston dyshimi i bazuar se ____________________________ (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën kryerjes së veprës penale).

Me këtë veprim, kishin për të kryer veprën penale _______________, nga neni_____, paragrafi _______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Policia e Kosovës – Drejtoria __________________, në ___________________, më datën _________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të dyshuarve:_____________ dhe ____________, për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale ______________, nga neni ______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë _____________________, prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në _________________________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: __________________ dhe ___________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprën penale ______________, nga neni _________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Pas marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, janë kryer veprimet hetimore si në vijim: ____________________________________________________________________ _______________________.

Nga dëshmitë e sipërpërmëndura, rezulton dyshimi i bazuar se të pandehurit _________________ dhe ___________________, kanë kryer veprën penale që u vihet në barrë, andaj ekziston baza ligjore për vazhdimin e arrestit shtëpiak, konform nenit _________, paragrafi ____, nën paragrafi ______, të KPPK-së

Gjithashtu, edhe më tutje ekziston baza ligjore për vazhdimin e arrestit shtëpiak, nga neni ____, paragrafi ________, nën paragrafi ___________, pika ______, të KPPK-së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se _____________________________ ________________________.

Në këtë çështje penale, ekziston edhe baza ligjore nga neni _____________, paragrafi ________, nën paragrafi ______, pika _________, të KPPK-së, për vazhdimin e arrestit shtëpiak, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se ai do të pengojë zhvillimin normal të procedurës duke ndikuar në dëshmitarë dhe bashkëpjesëmarrës. Këto rrethana rezultojnë nga ________________________________________________ _________________________________________________________________.

Për vazhdimin e arrestit shtëpiak, ekziston edhe baza ligjore nga neni ________, paragrafi ______, nën paragrafi ___________, pika _______, të KPPK –së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se i pandehuri do të përsërisë veprën penale, duke marrë parasysh ________________________________________________________ _____________________________________________________________________.

Sipas nenit _____, paragrafi ___, të KPPK-së, është parashikuar se përveç nëse ky nen parasheh ndryshe, dispozitat e këtij Kodi mbi paraburgimin përshtatshmërisht zbatohen lidhur me caktimin, kohëzgjatjen, vazhdimin dhe pushimin e masës nga ky nen, konsideroj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak.

Prokurori i shtetit, përmes kësaj kërkese, njofton gjyqtarin e procedurës paraprake se hetimet vazhdojnë dhe duhet të ndërmerren veprimet në vijim: ___________________ ___________________________________________________.

Nga sa u tha më sipër, me respekt, kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake që:

1. Kundër të pandehurit: ___________, të vazhdohet masa e arrestit shtëpiak, brenda afateve të parapara në nenin ________, paragrafët __________, dhe

_______, nenin _________, paragrafët ________, dhe _______, nën paragrafi ___________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, por jo më shumë se _________ muaj, respektivisht, deri më datën __________ dhe

2. Të informojë të pandehurin dhe avokatin e tij mbrojtës me propozimin për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak, jo më vonë se tri ditë para skadimit të masës së paraburgimit, të vazhduar me aktvendimin e fundit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _______________**
**DEPARTAMENTIT ______________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

**NJOFTIM LIDHUR ME MOSZBATIMIN E MASËS SË ARRESTIT SHTËPIAK NGA I PANDEHURI _____________________**

I nderuari z. Gjyqtar,

Sot, më datë ______________, në ora ________, kam pranuar në zyrën time një shkresë nga ana e Policisë së Kosovës, në Prishtinë – Drejtoria _______________, në _____________, nr.____________, me të cilën jam njoftuar se i pandehuri ____________, ka shkelur detyrimet e tij që kanë dalë nga aktvendimi juaj ____, nr.__________, i datës ______________, për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, sepse më datën _________________, dhe më datën ________________, i pandehuri ______________, sipas Policisë, ka dalë jashtë vendit të caktuar për qëndrim gjatë kohës sa është në arrest shtëpiak, duke dalë i lirë në qytetin e ______________, dhe ne nuk jemi në dijeni se a e ka bërë këtë i pandehuri me lejen tuaj apo nuk e ka respektuar Aktvendimin për caktimin e arrestit shtëpiak.

Nëse i pandehuri ___________________, ka shkelur detyrimin e tij të paraparë me aktvendimin tuaj, për caktimin e arrestit shtëpiak, konsideroj se kundër tij duhet të caktohet menjëherë paraburgimi.

Për më shumë, shih shkresën e Policisë, me numër të referencës __________ të datës __________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

________________________

_______.nr.__________

**GJYKATA THEMELORE NË ____________________________**, - Departamenti për krime të rënda, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale __________________, nga neni _______________, të KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës për caktimin e masës së paraburgimit të Prokurorisë Themelore në ___________, PP___.nr. ___________________, në bazë të nenit _____________, të KPPK-së në prezencë të prokurorit të shtetit_____________, të pandehurit _____________, dhe mbrojtësit të tij, avokatit _____________, më datën ____________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT**

Kundër të pandehurit: ____________________________(shëno të dhënat personale)

CAKTOHET masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, masë e cila, sipas këtij aktvendimi, do të zgjasë nga data ___________, në ora _____________, deri me datën _________, në ora ___________.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në _____________________ – Departamenti ____________, ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit të PP____.nr. __________ të dt. _____________ kundër të pandehurit ___________ për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ______________nga neni _____________ të KPRK-së.

Gjyqtari i procedurës paraprake, duke vepruar sipas kërkesës së lartcekur, ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën prokurori i shtetit ka mbetur pranë kërkesës për caktimin e paraburgimit duke argumentuar secilën bazë ligjore, ndërsa i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kanë kundërshtuar kërkesën e prokurorit, duke theksuar se nuk ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës së prokurorit të shtetit, për caktimin e paraburgimit dhe kundërshtimeve të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, gjyqtari i procedurës paraprake, gjeti se kërkesa e prokurorit të shtetit është e bazuar.

Në këtë çështje penale, ekziston baza ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni ______________, të KPPK-së, sepse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale ____________, nga neni ________________, i KPRK-së, ky dyshim rezulton nga: ____________________________________________________________

______________________________________________________________________
__________________________________.

Nga bisedat telefonike dhe sms-të, shihet qartë se _____________________________
_______________________________________________________________.

Ky dyshim i bazuar mund të vërtetohet edhe nga: ____________________________.

Gjithashtu, ekziston baza ligjore për caktimin e paraburgimit, nga neni ___________, të KPPK-së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme, të cilat tregojnë rrezikun e ikjes, duke marrë parasysh se në rastin konkret _____________________________________
__________________________________________.

Gjyqtari i procedurës paraprake, vlerëson se po të gjendej i pandehuri në liri, mund ta pengojë rrjedhën normale të procedurës penale, duke ndikuar në dhënien e deklaratave nga ana e të dëmtuarave apo dëshmitarëve - __________________________________
______________________, të cilët do të dëgjohen nga ana e prokurorit, lidhur me këtë çështje penale, andaj këto rrethana paraqesin bazën ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni _______________________, të KPPK-së.

Pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale, tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej, (shëno arsyet në mënyrë specifike për ekzistimin ndonjërës nga këto rrethana) andaj kjo paraqet edhe bazën ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187, par. 1 nënpar. 1.2, pika 1.2.3 të KPPK-së.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, ka shqyrtuar edhe pretendimet e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, që ndaj tij të aplikohen masa tjera përkatësisht masa e ____________________________________, me anë të së cilës, do të arrihej i njëjti qëllim që do të arrihej edhe me masën e paraburgimit, mirëpo sipas vlerësimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, aplikimi i masave tjera nga neni _____________________, të KPPK-ës, do të ishin të pamjaftueshme për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë procedurës penale dhe për të parandaluar ikjen apo arratisjen, ndikimin në të dëmtuarat/dëshmitarët dhe përsëritjen e veprës penale.

Nga sa u theksua më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI __________________________**
**________, nr.__________ më datë ________________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake**

_________________ _____________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqitet ankesë pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, brenda 24 orëve nga koha e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenet ___________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes ketë:

**KËRKESË PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT**

**Kundër të pandehurit: _______________________ (shëno të dhënat personale).**

**S e p s e**

Ekziston dyshimi i bazuar se ________________(shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale).

- me këtë vepër, kishte për të kryer veprën penale: ______________________ nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

**A R S Y E T I M**

Policia e Kosovës – Drejtoria __________________, në _____________, më datën _______________, i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve ________________, ________________ dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale _______________, nga neni __________, të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Më datë _______________, Prokurori i shtet ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurve: _____________________, ____________________ dhe _________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ata kanë kryer veprën penale _________________, nga neni_______, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjatë zhvillimit të hetimeve, janë urdhëruar nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe janë zbatuar nga Policia e Kosovës, masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit: __________________________________________, si dhe janë siguruar të dhënat nga _________________________________________________________________________ _____________________________________________________.

Konsideroj se në këtë çështje penale, ekziston baza ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni ________________, sepse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri _______________, ka kryer veprat e lartcekura penale.

Dyshimi i bazuar, rezulton nga: ____________________________________________ ________________________________________.

Gjithashtu, ekziston baza ligjore për caktimin e paraburgimit edhe nga neni _________, i KPPK-së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme, të cilat tregojnë rrezikun e ikjes duke marrë parasysh se _________________________________________.

Prokurori i shtetit, konsideron se po të gjendej i pandehuri në liri, mund ta pengojë rrjedhën normale të procedurës penale, duke ndikuar në dhënien e deklaratave nga ana e të dëmtuarve/dëshmitarëve ___________________, si dhe ndaj dëshmitarëve _________ të cilit do të dëgjohen nga ana e prokurorit lidhur me këtë çështje penale, andaj këto rrethana paraqesin edhe bazën ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni _______________________, të KPPK-së.

Gjithashtu, për caktimin e paraburgimit ekziston edhe baza ligjore nga neni _________ të KPPK-së, sepse ___________________________________________.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së kërkesës për caktimin e paraburgimit, ka shqyrtuar edhe mundësinë e shqiptimit të masave tjera të parapara në nenin ________________, të Kodit te Procedurës Penale të Kosovës, mirëpo ka gjetur se masat tjera do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Andaj, konsideroj se paraburgimi është masa më adekuate për të siguruar praninë e të pandehurit ne procedurën penale, e cila masë mund të zgjasë më së shumti një muaj, nga dita e arrestimit në bazë të aktvendimit të parë.

Prokurori i shtetit, përmes kësaj kërkese, gjithashtu, njofton gjyqtarin e procedurës paraprake se është parashikuar që sa më parë të merren në pyetje të pandehurit dhe dëshmitarët apo të dëmtuarit si dhe të analizohen raportet për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit që janë urdhëruar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake apo

prokurori special. Varësisht nga këto rezultate, të ndërmerren veprimet tjera hetimore, për të zbuluar dhe për të hetuar lidhjet ekzistuese të të pandehurve.

Nga sa u tha më lart, në pajtim me nenin __________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prokurori i nënshkruar, me respekt, i kërkon Gjyqtarit të Procedurës Paraprake që:
Të caktojë paraburgimin kundër të pandehurit __________________, jo më shumë se **1 (një) muaj** brenda afateve të parapara në nenin ____________, të KPPK-së, respektivisht **deri më datën ___________ në ora ______________.**

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/ Basic Prosecution Office ____________**

PP__.nr.______
Në _____________
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ___________**
**DEPARTAMENTI _________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenin _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR NDËRPRERJEN E PARABURGIMIT**

Kundër të pandehurit: ________________ (shënimet personale të te pandehurit).

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës themelore në ____________________, nr.______________, të datës ______________, është caktuar paraburgimi kundër të pandehurit _________________, në kohëzgjatje prej një muaji, duke filluar nga data ____________________, deri më datën ______________.

Paraburgimi ndaj të pandehurit, është caktuar në bazë të nenit _____________, të KPPK-së, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale ________________, nga neni ______, i KPRK-së dhe nëse gjendet në liri, mund të pengojë zhvillimin normal të hetimeve duke ndikuar në dëshmitarët ____________ _______________ dhe _________________.

Meqenëse si arsye për caktimin e paraburgimit, ka qenë arsyeja e dëgjimit të dëshmitarëve ____________________ dhe __________________, të cilët tani kanë

dhënë deklaratat e tyre në prokurori, në këtë rast, kanë pushuar arsyet për të cilat ishte caktuar paraburgimi kundër të pandehurit ______________, andaj kërkoj që kundër tij të ndërpritet paraburgimi dhe ai të lëshohet menjëherë për t'u mbrojtur në liri, në procedurë të rregullt.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________
Më datë _____________

**SHËRBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS**
**QENDRËS SË PARABURGIMIT NË ____________**

**KËRKESË PËR SJELLJEN E TË PANDEHURIT ___________________**

I nderuari z. Drejtor ___________________,

Kërkoj nga ju, që t'i autorizoni zyrtarët e shërbimit tuaj, që ta sjellin të pandehurin __________________, i lindur më datë _______________, për të dhënë deklaratën e tij lidhur me veprën penale __________________________________, të KPRK-së, në Prokurorinë Themelore në __________________, më datën _________________, në ora __________.

Gjatë transportit të të pandehurit, duhet të keni parasysh shkallën e _____________ (ulët, mesme ose të lartë) të sigurisë.

Gjithashtu, duhet të keni parasysh se i pandehuri ________________, nuk duhet të jetë në kontakt me të pandehurin / it _________________, të cilët janë të dyshuar/pandehur në të njëjtën çështje penale.

Meqenëse seanca dëgjimore pritet të zgjasë më shumë se ____________ orë, ju lutem të siguroni drekë për të pandehurin (duke ja dorëzuar atë përcjellësve të tij).

Pas përfundimit të seancës dëgjimore / për dhënien e deklaratës, i pandehuri të kthehet përsëri në qendrën tuaj të paraburgimit.

Ju lutemi, mos hezitoni të na kontaktoni në tel: ________________ ose email adresën ______________________, nëse ju nevojiten më shumë të dhëna apo qartësi për këtë çështje.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTIT _______________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Në pajtim me nenet ______, paragrafët _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes:

**KËRKESË PËR ZGJATJEN E PARABURGIMIT**

**Kundër të pandehurve: _______________________ (shëno të dhënat personale).**

Ekziston dyshimi i bazuar se __________________________________ (shëno kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më ketë kishin për të kryer veprën penale: ________________, nga ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**ARSYETIM**

Më datë ____________, Policia e Kosovës – Departamenti __________________, - i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve __________________ dhe _______________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale ____________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kallëzimit të lartcekur penal, Policia ia ka bashkangjitur: ______________________.

Në bazë të kërkesës së Prokurorit të shtetit, PP_____, nr.________/___ të datës _______________, gjyqtari i procedurës paraprake, më datën ____________, ka mbajtur seancën për caktimin e paraburgimit, pas së cilës, ua ka caktuar paraburgimin të pandehurve ______________ dhe _______________, në kohëzgjatje prej një muaji, respektivisht deri më datën ______________.

Të gjitha provat e lartcekura, dëshmojnë se në këtë çështje penale, së paku në ketë fazë të procedurës, dëshmojnë se të pandehurit ishin përfshirë në kryerjen e veprave penale që ju vihen në barrë, e që janë specifikuar gjatë seancës për caktimin e paraburgimit, sepse ________________________ (shëno dhe arsyeto provat që mbështesin dyshimin e bazuar), andaj ekziston baza ligjore nga neni ________, paragrafi __________, i KPPK–së, sepse ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit ______________ dhe ________________, kanë kryer veprat penale të përshkruara në dispozitiv të kësaj kërkese.

Gjithashtu, ekziston edhe baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga neni ______, paragrafi _____________, nënparagrafi ____________, pika _______, të KPPK–së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se të pandehurit do të fshihen ose do të ikin për t'ju shmangur përgjegjësisë penale.

Këto rrethana, janë si në vijim:__________________________________, andaj kjo bazë ligjore vazhdon të ekzistojë edhe më tutje, sepse në procedurën e deritanishme, nuk ka asnjë rrethanë tjetër që do të tregonte mosekzistimin e saj.

Për vazhdimin e paraburgimit, ekziston edhe baza ligjore, nga neni _________, paragrafi _____, nënparagrafi __________, pika __________, të KPPK-së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se ai do të pengojë zhvillimin normal të çështjes, sepse:_______________________________________________.

Nëse të pandehurit gjenden në liri, do të mund të pengojnë zhvillimin normal të hetimeve, duke _______________________________________________________, andaj edhe kjo bazë ligjore, vazhdon të ekzistojë edhe më tutje dhe nuk ka ndonjë rrethanë të re që do të tregonte mosekzistimin e saj.

Në fund, duhet theksuar se ekziston edhe baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga neni ___________, paragrafi _________, nënparagrafi _____, pika _______, të KPPK–së, sepse ekzistojnë rrethanat e posaçme që tregojnë se të pandehurit do të përsërisin veprën penale, bazuar në peshën e veprës penale, mënyrën në të cilën është kryer dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale.

Rrethanat e posaçme për përsëritje të veprës penale, janë si në vijim: ______________ _________________________, andaj edhe lidhur me këtë bazë, nuk ka ndonjë rrethanë të re e cila do të ndikonte në ndërprerjen e paraburgimit.

Prokuroria ka shqyrtuar edhe dispozitën e nenit __________, paragrafi ________, nënparagrafi _____, të KPPK–së, mirëpo ka gjetur se masat tjera të parapara në nenin ________, paragrafi ________, i Kodit të Procedurës Penale, do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurve _____________ dhe ___________ dhe për të parandaluar ikjen e tyre, ndikimin në dëshmitarë apo të dëmtuarit dhe bashkëpjesmarrës, përsëritjen e veprave penale. Andaj, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës penale, konsideroj se zgjatja e paraburgimit për të pandehurit e lartcekur është masa më adekuate, për të siguruar praninë e tyre në procedurën penale.

Të gjitha veprimet e mundëshme për të shpejtuar zbatimin e procedurës, deri më tani, janë ndërmarrë, mirëpo në procedurën hetimore në vazhdim, duhet të analizohen edhe dëshmitë tjera të siguruara para dhe pas arrestimit të të pandehurve dhe varësisht nga këto analiza dhe rezultate, të ndërmirren edhe veprimet tjera hetimore.

Gjithashtu, në fazën e hetimeve, në vazhdim është e nevojshme që ________________ _________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më sipër dhe në pajtim me nenin ________, paragrafët _____________ të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), për shkak se ekziston baza ligjore për një masë të tillë, duke pasur parasysh se hetimet kanë filluar dhe se të gjitha veprimet e arsyeshme për të shpejtuar procedurën janë ndërmarrë me kohë, me respekt kërkoj nga gjyqtarja e procedurës paraprake që:

1. Kundër të pandehurve: ______________ dhe ______________ të zgjatet paraburgimi, brenda afateve të parapara në nenin ____________, paragrafi ____, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, por jo më shumë se një muaj, respektivisht, deri më datën _________.
2. Të informojë të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës me propozimin për vazhdimin e paraburgimit, jo më vonë se tri ditë para skadimit të paraburgimit, të vazhduar me aktvendimin e fundit.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTIT _______________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas pranimit të kërkesave nga mbrojtësit e të pandehurve, për ndryshimin e masës së sigurisë së pranisë së të pandehurve në procedurën penale, konform nenit _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes,

**KËRKESË PËR MBAJTJEN E SEANCËS DËGJIMORE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË MBROJTËSVE LIDHUR ME PARABURGIMIN**

**Kundër të pandehurve: ____________________ (sheno të dhënat personale)**

**S E P S E**

Ekziston dyshimi i bazuar se _______________________ (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

- me këtë veprim kishin për të kryer veprën penale: _________________, nga neni _________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës).

**ARSYETIM**

Më datë __________, Policia e Kosovës – Departamenti ___________________, - i ka paraqitur kësaj prokurorie kallëzimin penal kundër të pandehurve _________________ dhe _______________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale

_____________, nga neni ____________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Kallëzimit të lartcekur penal, Policia ia ka bashkangjitur: ________________________ _______________________________________________________.

Në bazë të kërkesës së Prokurorit të shtetit, PP.nr.______/___ të datës _____________, gjyqtari i procedurës paraprake, më datën ____________, ka mbajtur seancën për caktimin e paraburgimit, pas së cilës ua ka caktuar paraburgimin të pandehurve _______________, dhe ________________, në kohëzgjatje prej një muaji, respektivisht deri më datën ______________.

Të gjitha provat e lartcekura, dëshmojnë se në ketë çështje penale, së paku në ketë fazë të procedurës, dëshmojnë se të pandehurit ishin përfshirë në kryerjen e veprave penale që ju vihen në barrë, e që janë specifikuar gjatë seancës për caktimin e paraburgimit, sepse _______________________ (shëno dhe arsyeto provat që mbështesin dyshimin e bazuar).

Pas caktimit të paraburgimit, janë marrë deklaratat e dëshmitarëve _______________, ______________________ dhe _______________________, deklaratat e të pandehurve _________________ dhe _______________.

Mbrojtësit e të pandehurve __________________ dhe __________________, avokatët _______________ dhe _________________, kanë paraqitur kërkesa për ndryshimin e masës së paraburgimit me ndonjë masë tjetër alternative, duke përfshirë: _________________________________________.

Meqenëse, deri në këtë fazë të hetimeve, janë kryer shumë veprime hetimore dhe janë paraqitur edhe rrethana të reja lidhur me masat për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë penale, kërkoj që të caktohet seanca dëgjimore, ku mbrojtësit do të kenë mundësinë e saktësimit të kërkesave të tyre për të shqyrtuar masën e paraburgimit dhe eventualisht ndryshimin e kësaj mase me masat tjera, ndërsa ne si prokurori do të kemi mundësinë e dhënies së mendimit lidhur me kërkesat e tyre.

**BAZA LIGJORE**

**Neni _______ paragrafi _______ i KPPK**

**Mbikëqyrja e paraburgimit nga gjykata**

Paragrafi _____________. Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore, mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me nenin 188, paragrafët 3, 4, 5, dhe 6. të këtij Kodi, nëse në shikim të parë, me ankesë vërtetohet se:

Nën paragrafi ________, arsyet për paraburgim, nga neni ________, i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja.

Paragrafi _______. Seancat dëgjimore ose vizitat, nga ky nen, mbahen brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i ankesës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**______ nr. ________/ _________**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTI ___________________________**

**P R O C E S V E R B A L**
**I SEANCËS DËGJIMORE PËR PARABURGIMIN**

I përpiluar në Gjykatën Themelore në _______________, më datën _____________,

Duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ____________________, PP__, nr__________, të datës ______________, për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit _______________, për shkak të veprës penale: ______________, të KPRK-së.

**TË PRANISHËM JANË:**

Gjyqtari i procedurës paraprake, __________________________

Procesmbajtës, ______________________

Prokurori i Shtetit, ___________________

I pandehuri, ______________________

Mbrojtësi i të pandehurit, ______________________

Seanca filloi në ora _____________.

I pandehuri _____________________, me shënime personale _______________________ _______________,

I pandehuri është ndaluar më datën _______________, në ora _____________, kurse është sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, më datën ________________, në ora _________.

Në pajtim me nenin ________, të KPP-së, i pandehuri njoftohet me të drejtat e tij në gjuhën amtare për arsyet e arrestimit; se ka të drejtë të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij; se do t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet seanca dëgjimore për caktimin e paraburgimit; se mund të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike; se për arrestimin e tij mund të lajmërojë ose të kërkojë që të lajmërojë anëtarin e familjes ose

ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij dhe se mund të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Pas njoftimit me të drejtat e lartcekura, i pandehuri deklaron se për mbrojtës ka angazhuar avokatin _________________, i cili është prezent (në rastet kur mbrojtësi angazhohet nga familja ose sipas detyrës zyrtare, i pandehuri duhet të deklaroj se: pajtohem që mbrojtës i imi të jetë avokati ______________, i caktuar sipas detyrës zyrtare ose i angazhuar nga familja ime).

I pandehuri deklaron se ka lajmëruar anëtarët e familjes për arrestimin e tij, se i është ofruar kontroll dhe trajtim mjekësor, por nuk ka pasur nevojë për kontroll dhe trajtimin e tillë.

**Deklarimi i palëve lidhur më kërkesën për caktimin e paraburgimit:**

Prokurori i shtetit __________________, nga Prokuroria Themelore ______________, lidhur me kërkesën për caktimin e paraburgimit, deklaron se mbetet në tërësi pranë kërkesës për caktimin e paraburgimit dhe shton se: ______________________________
_______________________________________________________________________________
_________________________________________.

Mbrojtës i të pandehurit - avokati ______________________________, deklaron se: ________________________________________.

I pandehuri _______________________, deklaron se: _____________________________
________________________________________.

Pas dëgjimit të palëve, lidhur me arsyet e caktimit dhe mos caktimit të paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, konstaton se seanca mori fund.

Procesverbali është lexuar me zë, palët deklarojnë se nuk kanë vërejtje ndaj përmbajtjes së procesverbalit dhe atë e nënshkruajnë pa vërejtje.

Seanca përfundoi në ora _____________.

Prokurori i Shtetit: ______________

Mbrojtësi: ___________________

I pandehuri: ________________

**V ë r t e t o j n ë:**

| **Procesmbajtësi/ja,** | **Gjyqtari i procedurës paraprake** |
|---|---|
| ______________________ | ______________________________ |

**_______, nr.____/ _____**

**GJYKATA THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTI ________________________**

**P R O C E S V E R B A L**
**I SEANCËS DËGJIMORE PËR CAKTIMIN E MASËS PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT**

I përpiluar më datën ____________, në Gjykatën Themelore në _______________, pas pranimit të kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në ___________, për caktimin e arrestit shtëpiak, (konform nenit _____, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës – nëse nuk ka propozim nga prokurori)

**TË PRANISHËM JANË:**

Gjyqtari i procedurës paraprake, ________________________

Procesmbajtës, ____________________

Prokurori i shtetit, _________________

I pandehuri, ____________________

Mbrojtësi i të pandehurit, ____________________

Seanca fillon në ora ____________.

I pandehuri ____________________, me shënime personale ______________________ _______________,

I pandehuri është ndaluar më datën ______________, në ora ____________, kurse është sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, më datën _______________, në ora ________.

Në kuptim të nenit ____, të KPP-së, i pandehuri njoftohet me të drejtat në gjuhën e tij, për arsye të arrestimit; se ka të drejtë të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij; se do t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet seanca dëgjimore për caktimin e paraburgimit; se mund të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike; se për arrestimin e tij mund të lajmërojë ose të kërkojë që të lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij dhe se mund të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Pas njoftimit me të drejtat e lartcekura, i pandehuri deklaron se për mbrojtës ka angazhuar avokatin ________________, i cili është prezent (në rastet kur mbrojtësi angazhohet nga familja ose sipas detyrës zyrtare, i pandehuri duhet të deklarojë se pajtohem që mbrojtës i imi të jetë avokati ______________, i caktuar sipas detyrës zyrtare ose i angazhuar nga familja ime).

I pandehuri deklaron se ka lajmëruar anëtarët e familjes për arrestimin dhe ndalimin e tij, se i është ofruar kontrolli dhe trajtimi mjekësor, por nuk ka pasur nevojë për kontroll dhe trajtimin e tillë.

Deklarimi i palëve lidhur me kërkesën për caktimin e arrestit shtëpiak:

Prokurori i Shtetit _________________, nga Prokuroria Themelore ______________, lidhur me kërkesën për caktimin e arrestit shtëpiak, deklaron se mbetet në tërësi pranë kërkesës së tij dhe shton se __________________________________________________ ____________________________________.

Mbrojtës i të pandehurit - avokati _________________, deklaron se e kundërshton kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e arrestit shtëpiak sepse në këtë çështje penale, nuk ka dëshmitar për t'u dëgjuar, nuk ka mundësi që të asgjësojë apo dëmtojë provat, ngase të gjitha provat tani janë në dispozicion të prokurorit të shtetit e as nuk do të përsëritë veprën penale.

I pandehuri ______________, deklaron se "mbështes fjalën e mbrojtësit tim dhe dua të shtoj se i premtoj gjykatës se nuk do të fshihem ose largohem nga vendqëndrimi pa lejen e gjykatës dhe si dëshmi që do të mbaj premtimin tim, unë do të dorëzoj në gjykatë pasaportën time dhe çdo dokument tjetër që kërkohet nga gjykata".

Pas dëgjimit të palëve, lidhur me arsyet e caktimit dhe mos caktimit të arrestit shtëpiak, si dhe premtimit të të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin pa lejen e gjykatës, gjyqtari i procedurës paraprake, njofton të pranishmit se aprovohet premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin. Si masë për sigurimin e pranisë së tij në procedurën penale, paralajmëron të pandehurin se ndaj tij mund të caktohet paraburgim po që se shkel këtë premtim dhe njëkohësisht nga ai konfiskon dokumentin e udhëtimit – pasaportën nr.________________, të lëshuar nga MPB në Prishtinë, më datë _____________.

Gjyqtari i procedurës paraprake konstaton që palët nuk kanë propozime tjera dhe se seanca mori fund.

Procesverbali është lexuar me zë, palët deklarojnë se nuk kanë vërejtje ndaj përmbajtjes së procesverbalit dhe atë e nënshkruajnë pa vërejtje.

Seanca përfundoi në ora _____________.

Prokurori i shtetit: ______________

Mbrojtësi: ___________________

I pandehuri: ________________

**V ë r t e t o j n ë:**

| **Procesmbajtësi/ja,** | **Gjyqtari i procedurës paraprake** |
|---|---|
| ______________________ | _____________________________ |

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

## P R O C E S V E R B A L

**Për ballafaqimin e dëshmitarëve: ________________ dhe _________________**

I përpiluar më datë _______________, në Prokurorinë Themelore në _____________, lidhur më çështjen penale, PP__, nr.____________, të të pandehurit ______________, për shkak të veprës penale ___________, të KPRK-së.

Të pranishëm:

Prokurori i shtetit: ________________ Procesmbajtësja: _________________

Dëshmitari: ___________________ Dëshmitari: _____________________

**Seanca filloi në ora ____________.**

|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Numri i kartelës identifikuese** | **NJËSIA** | **Nr.** | **Numri i kartelës identifikuese** | **NJËSIA** |
| 1 | **PK #** | | 6 | **PK #** | |
| 2 | **PK #** | | 7 | **PK #** | |
| 3 | **PK #** | | 8 | **PK #** | |
| 4 | **PK #** | | 9 | **PK #** | |
| 5 | **PK #** | | 10 | **PK #** | |

| |
|---|
| **Deklaratat shtesë:** *Nëse personi vullnetarisht dorëzon sendet që kërkohen, ndonjë deklaratë ose kundërshtim i pronarit ose banorëve pranishëm dhe ndonjë deklaratë relevante nga cilido person i pranishëm në kontrollë:* |

| | | |
|---|---|---|
| **Dëshmitari nr. 1**<br><br>**(Emri dhe mbiemri)** | **Ju keni të drejtë t'i bëni vërejtje përmbajtjes së procesverbalit të këtij kontrollit (Neni 243, par. 2). A keni ndonjë kundër-shtim?**<br>(Rretho PO ose JO dhe nënshkruaj këtu) | **PO / JO nëse po deklaro vërejtjet:**<br><br>**Nënshkrimi:** |
| **Dëshmitari nr. 2**<br><br>**(Emri dhe mbiemri)** | | **PO / JO nëse po deklaro vërejtjet:**<br><br>**Nënshkrimi:** |

| **FUNDI DHE NËNSHKRIMI I KONTROLLIT** | | | |
|---|---|---|---|
| **Përkthyesi** | **(Nënshkrimi)** | **Komandanti Operativ i Policisë**<br><br>**PK #** | **(Nënshkrimi)** |
| **Mbajtësi /ja i/e procesverbalit**<br><br>**PK #** | **(Nënshkrimi)** | **KOHA E MBARIMIT** | **:** |
| | | **DATA E FUNDIT** | |
| **Banori / Pronari**<br><br>**(Emri dhe mbiemri)** | **Ju keni të drejtë të merrni një dokument për sendet e konfiskuara. Unë kam marrë një kopje për sendet e konfiskuara, më datën e shënuar më lart (rretho përgjigjet) PO / JO** | | **(Nënshkrimi)** |

**SHPERNDARJA E KOPJEVE PËR:**

**PROKURORIN E SHTETIT (dorëzimi i kopjes te prokurori bëhet brenda 12 orëve nga kontrolli, sipas nenit 245)**

**GJYKATËSIT QË URDHROI BASTISJEN (nëse bastisja bëhet sipas urdhrit të gjykatësit)**

**DOSJES SË POLICISË**

**PRONARIT TË PRONËS / BANORIT OSE PËRFAQËSUESIT OSE KRYETARIT TË ENTITETIT PUBLIK**

| | | |
|---|---|---|
| | Republika e Kosovës<br>**Republika Kosova – Republic of Kosovo**<br>Qeveria – Vlada – Government<br><br>Ministria e Punëve të Brendshme<br>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs<br><br>Policia e Kosovës/Policija Kosova/<br>Kosovo Police | |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/<br>Generalna Policijska Direkcija/<br>General Police Directorate | |

**Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda**
**Nr. i rastit:**
**Data:**
**Vendi:**

**PROCESVERBAL**
**PËR IDENTIFIKIMIN E PERSONIT PËRMES FOTOGRAFISË**

I përpiluar nga ________________________, polic hetues, në ____________________, në Prishtinë më datën ____/____/________, lidhur me rastin nr. __________________, i cili ka të bëj me veprën penale _____________________________________________

**Të pranishëm janë**: ______________________________ ______________________
(Zyrtarët Policorë & ID etj.) (Dëshmitari)

**Identifikimi filloi në ora: __________.**

1. Dëshmitari është njoftuar me dispozitat e nenit 120. të KPP-së, që ka të bëj me procedurat e identifikimit të personave dhe sendeve se:

   - Shikimi i disa fotografive të personave, nuk do të thotë apo nuk nënkupton se i dyshuari ka qenë i identifikuar apo është arrestuar nga Policia.
   - Personi që ka qenë i përfshire në incident, mund të jetë apo mos të jetë në fotografit të prezantuara
   - Nuk je i detyruar të zgjedhësh ndonjë person në fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e njeh personin, ashtu sikurse të thuash që e njeh.
   - Personi që ka qenë i përfshirë në incident, mund të ketë pamje të ndryshme nga ajo në fotot e prezantuara tani, sepse, nga koha kur e ka parë atë, flokët, mjekra dhe rrobat mund të kenë ndryshuar.

U njoftova me procedurat e identifikimit ________________________.
(Nënshkrimi i dëshmitarit)

2. Dëshmitari bëri përshkrimin e personit: _____________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
______________________________________________________________________.

3. Dëshmitarit iu treguan fotografitë e 6 (gjashtë) personave të ndryshëm, dhe pas shikimit të tyre, me shprehjen e vullnetit të lirë, deklaroi: ______________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
_______________________________________________________________________
______________________________________________________________________.

4. Shtojcë: Pjesë përbërëse e këtij procesverbali janë fotografitë e 6 personave të ndryshëm, të vendosura në faqen 2 dhe 3 të këtij procesverbali.

**Identifikimi përfundoi në ora**: _________.

DËSHMITARI: | ZYRTARI POLICOR

__________________________ | __________________________

(Nënshkrimi i dëshmitarit) | (Nënshkrimi i zyrtarit policor)

FOTOGRAFITË E 6 PERSONAVE TË NDRYSHËM

**________.nr.1/15**

**GJYKATA THEMELORE NË ____________________________**, **-** Departamenti ________________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit ________________, avokatit ______________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në ________________, PP___, nr. ____________, të dt. _______________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, me datën _____________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET ankesa e mbrojtësit të të pandehurit ___________________, avokatit _________________, e paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në _____________________, PP__, nr. ____________, të dt. _______________, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim, PP__, nr.________, me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për të pasur qasje në shkresat e lëndës dhe për t'ia dorëzuar kopjet e dëshmive që gjenden në lëndën PP. nr._________________, me arsyetim se _____________________________ __________________________________.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit __________________________, avokati ___________________________, për shkak të __________________________, më propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit dhe t'i lejohet qasje në shkresat e lëndës, PP__, nr.________________ ose i njëjti aktvendim të prishet dhe lënda t'i kthehet Prokurorit të shtetit në rivendosje.

Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit dhe gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban __________________________________________________, është i pabazuar, sepse aktvendimi i kundërshtuar përmban arsye të qarta lidhur me kufizimin e qasjes së mbrojtësit të të pandehurit në shkresat e lëndës.

Prokurori i shtetit, ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me shkaqet që mund të rrezikojnë personat e përfshirë në këtë çështje penale, nëse mbrojtësi i të pandehurit ka qasje në shkresat e lëndës, duke sqaruar se ________________________________ ________________________________________________________________.

Aktvendimi i prokurorit është i bazuar në dispozitën e nenit _________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, sipas të cilës dispozitë, jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, Prokurori publik i siguron mbrojtësit materialet ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit, andaj mbrojtësit e të pandehurve do të kenë mundësinë që t'i kenë në disponim të gjitha materialet e siguruara gjatë hetimeve, komform kësaj dispozite ligjore, jo më vonë se nga ngritja e Aktakuzës.

Gjithashtu, sipas dispozitës së nenit ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prokurori i shtetit, mund t'i refuzojë mbrojtjes shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale që shikimi, kopjimi ose fotografimi i tyre, mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve, andaj në rastin konkret, Prokurori i shtetit, ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit në shkresat e lëndës dhe pranimin e kopjeve të shkresave të lëndës, ndërsa ankesa e mbrojtësit kundër këtij aktvendimi është e pabazuar.

Nga sa u theksua më lart, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**_______, nr. _________, më datë _____________**

**Sekretarja juridike** | **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

________________ | ____________________________

| | | |
|---|---|---|
| | Republika e Kosovës<br>**Republika Kosova – Republic of Kosovo**<br>Qeveria – Vlada – Government<br><br>Ministria e Punëve të Brendshme<br>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova<br>Ministry of Internal Affairs<br><br>Policia e Kosovës/Policija Kosova/<br>Kosovo Police | |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/<br>Generalna Policijska Direkcija/<br>General Police Directorate | |

| **DATA dd/mm/vvvv** | **RASTI POLICOR Nr.** | **RASTI NË PROKURORI Nr.** |
|---|---|---|
| | | |

| **Emri i të dyshuarit (emri, mbiemri)** | **Datëlindja e të dyshuarit** (dd/mm/vvvv) |
|---|---|
| | |

## PROCESVERBAL I MARRJES NË PYETJE TË TË DYSHUARIT

## INFORMACION PËR TË DYSHUARIN DHE NJOHJA E TË DREJTAVE TË DHËNA PARA MARRJES NË PYETJE

| | | |
|---|---|---|
| ☐ | **Intervista do të zhvillohet sipas autorizimit të prokurorit (në rast se ka autorizim)** | Emri dhe Mbiemri i Prokurorit Publik:<br>Data/Koha e besimit:<br>Mënyra e lënies në besim: |
| ☐ | **Apo marrja në pyetje do të zhvillohet pa autorizimin e prokurorit, në pajtim me nenin 73, par.3, të KPP-së** | |

| **AVOKATI MBROJTËS, nëse është i pranishëm** | |
|---|---|
| Nëse avokati mbrojtës është i pranishëm, emri i tij është (me germa shtypi):<br><br>Adresa e Zyrës: | Nënshkrimi i avokatit mbrojtës:<br><br>Nr. i Tel. të Zyrës/Shtëpisë.:<br><br>Nr. i Tel Celular: |

| PËRFAQËSUESI LIGJOR, nëse është i pranishëm (prindi ose kujdestari ose Qendra për Punë Sociale) | |
|---|---|
| Nëse përfaqësuesi ligjor është i pranishëm:<br>(EMRI ME GERMA SHTYPI):<br>**Prindi* – Kujdestari* – Qendra për Punë Sociale***<br><br>Adresa e zyrës/shtëpisë: | NËNSHKRIMI i përfaqësuesit ligjor të të pandehurit:<br><br>Nr. i tel. të zyrës/shtëpisë:<br><br>Nr. i tel. celular: |

| **Ju dyshoheni se keni kryer veprën-at penale të mëposhtme:** | | |
|---|---|---|
| **Emri i veprës penale/përshkrimi /Data e veprës penale dd/mm/vvvv** | | **Neni i KPP-së** |
| 1. | | |
| 2. | | |
| 3. | | |

| **NJOFTIMI I TË DREJTAVE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Paralajmërimi, të Drejtat & Heqja Dorë nga të Drejtat** | **PO / JO** | **Nënshkrim ose inicialet** |
| **1** | **Jeni i detyruar t'i raportoni prokurorit, policisë, ose gjykatës, për çdo ndryshim të adresës suaj ose të vendbanimit aktual.** | **NJOFTIM** | |
| **2** | **Ky është një hetim penal i veprave që ju mund t'i keni kryer. Ju keni të drejt të jepni deklaratë, po ashtu, keni të drejt të heshtni dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin tuaj. Ju keni të drejt të mos e fajësoni veten tuaj. Nëse ju zgjedhin të jepni deklaratë apo të përgjigjeni në pyetje, ju do të jeni nën betim. Informatat e dhëna mund të përdorën si dëshmi në gjykatë. Nëse keni nevojë për përkthyes, do t'ju sigurohet falas. Nëse besoni se ju mund ta fajësoni veten apo të afërmin tuaj si rezultat i përgjigjeve ndaj pyetjes, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Ju keni të drejt të keni mbrojtës dhe të konsultoheni me të para dhe gjatë marrjes në pyetje. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkoni që pyetja t'ju bëhet ndryshe. Nëse keni nevojë për** | **NJOFTIM** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet ta kërkoni atë. Nëse nuk i kuptoni këto të drejta, konsultohuni me mbrojtësin tuaj.** | | |
| **3** | **Më është dhënë një kopje e fletës së informacionit me titull "Të Drejtat e një personi të arrestuar" në gjuhën që e kuptoj.** *Nëse i dyshuari gjendet ne arrest.* | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **4** | **A jeni në gjendje të dëgjoni dhe flisni?** | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **5** | **A dëshironi të keni ndihmën e një përkthyesi?** | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **6** | **Në qoftë se nuk keni mundësi të përballoni shpenzimet e avokatit mbrojtës për ndihmë ligjore, atëherë do t'ju sigurohet një avokat mbrojtës falas.** | **NJOFTIM** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **7** | **A dëshironi të keni avokat mbrojtës gjatë kësaj deklarate?** (Përveç kur avokati mbrojtës duhet patjetër te jetë prezent, sipas nenit 57 & 58 të KPP-së) | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **8** | **A dëshironi ta autorizoni avokatin e pranishëm që t'ju mbrojë juve gjate kësaj deklarate?** (nëse është avokati i pranishëm) | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **9** | **Mund të kërkoni prova në favor të mbrojtjes suaj. Në rast se hiqni dorë nga e drejta juaj për të heshtur, mund ta shfrytëzoni këtë rast për të kundërshtuar bazat për dyshimin kundër jush, dhe për të deklaruar fakte në favorin tuaj.** | **NJOFTIM** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit:* |
| **10** | **A dëshironi të jepni deklaratë.** | **PO / JO** | *Nënshkrimi i të Dyshuarit* |
| **11** | **Çdo marrje në pyetje e të pandehurit nga policia ose prokurori i shtetit incizohet audio ose video, në pajtim me nenin 208, ose 209, të KPK-së.<br>Në rastet kur praktikisht kjo është e pamundur, procesverbali me shkrim i marrjes në pyetje shënohen arsyet pse marrja në pyetje nuk ka mund të incizohet në audio ose video.** | *Shëno arsyet:* | |
| **12** | **Emri i përkthyesit dhe nr. i KI** (nëse ka) | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 13 | **BETIMI I PËRKTHYESIT** | **Unë do t'i përkthej me besnikëri pyetjet që do t'i drejtohen të pandehurit si dhe deklaratat që do të jepen prej tij ose saj.** | ***Nënshkrimi i Përkthyesit*** |

| **TË DHËNAT PERSONALE TË TË DYSHUARIT**<br>*Në bazë të informatave të dhëna me gojë nga i dyshuari.* | | | |
|---|---|---|---|
| **Mbiemri** | | **Data e lindjes DD/MM/VVVV** | |
| **Emri** | | **Vendlindja** | |
| **Pseudonimi/ Nofka** | | **Lloji i letërnjoftimit/ Numri** | |
| **Emri i të atit** | | **Di shkrim / Lexim?** | |
| **Emri i nënës** | | **Profesioni & Punëdhënësi** | |
| **Mbiemri i vajzërisë së nënës** | | **Adresa e vendbanimit** | |
| **Gjendja familjare** | | | |
| **Gjendja financiare (Gjendja ekonomike) (e lartë/mesatare/e ulët)** | | **Niveli më i lartë i arsimit** | |
| **Të ardhurat personale (Euro/Vit)** | | **Kombësia-Etnia** | |
| **A keni qenë i pandehur në ndonjë procedurë tjetër penale, <u>në zhvillim e sipër</u> lidhur me <u>ndonjë vepër tjetër penale?</u>** | **<u>NËSE PO</u>: shënoni këtu hollësitë për secilin rast:** | **Nënshtetësia** | |
| | | **Telefoni fiks dhe mobil** | |

<table>
<tr><th colspan="4">FILLIMI I INTERVISTËS</th></tr>
<tr><td>FILLIMI I INTERVISTËS<br>dd/mm/vvvv,<br>00:00hrs</td><td></td><td>VENDI</td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2">EMRAT E PERSONAVE TË PRANISHËM</td><td colspan="3">PROKURORI I SHTETIT:</td></tr>
<tr><td>POLICIA:</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="4">Të dyshuarit, pasi iu lexuan të drejtat e tij, sipas KPP-së, në prani të avokatit mbrojtës, deklaron:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:<br><br>Pyetje:<br>Përgjigje:</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th colspan="3">FUNDI I INTERVISTËS ME DEKLARATAT E TË DYSHUARIT</th></tr>
<tr><td>Përfundimi i marrjes në pyetje:<br>dd/mm/vvvv në orën 00:00</td><td>Ora:</td><td>NËNSHKRIMI i të Dyshuarit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Jam në dijeni se kam të drejtë ta lexoj raportin me shkrim të marrjes në pyetje që m'u ka bërë ose mund të më lexohet me zë në rast se nuk jam në gjendje të lexoj, dhe kam të drejtë të bëj korrigjime në rast se deklarata ime nuk është regjistruar me saktësi.</td><td></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Vërtetoj se ky procesverbal i intervistës sime apo i deklaratës sime të bashkangjitur, ku është vënë nënshkrimi në secilën faqe, është i vërtetë dhe i saktë në bazë të njohurive të mia, për pyetjet që mu parashtruan.** | |

| **EMRI me Shkronja Shtypi (Mbiemri, Emri)** | **DEKLARATA** | **NËNSHKRIMI** | **DATA dd/mm/vv** |
|---|---|---|---|
| **Emri i përkthyesit:**<br><br>**Numri i LS-së:** | **Unë i përktheva me besnikëri pyetjet që iu drejtuan të dyshuarit si dhe deklaratat që ai/ajo dha.** | | |
| **Emri i policit ose i Prokurorit të shtetit që drejtoi marrjen në pyetje:** | **Kjo deklaratë pasqyron në mënyrë të saktë marrjen në pyetje/intervistën e të dyshuarit i cili ka vënë nënshkrimin në secilën faqe.** | | |
| **Emri i policit dëshmitar:** | **Kjo deklaratë pasqyron në mënyrë të saktë marrjen në pyetje/intervistën e të dyshuarit i cili ka vënë nënshkrimin në secilën faqe.** | | |
| **Emri i policit dëshmitar:** | **Isha i pranishëm kur është bërë intervista.** | | |

*I dyshuari apo avokati mbrojtës ka të drejtë që ta shikojë këtë deklaratë në çdo kohë gjatë hetimit në rast se ata e kërkojnë një gjë të tillë* (Neni 213, par. 4, i KPP-së).

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u _____________/ Basic Prosecution Office ____________**

PP___, nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit _________________, avokatit _______________, si dhe në pajtim me nenin ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**PËR QASJE NË SHKRESAT E LËNDËS**

APROVOHET si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të te pandehurit _______________, avokatit ______________, për të shikuar, kopjuar ose fotografuar shkresave e lëndës që gjenden në zotërim, ruajtje ose nën kontroll të Prokurorit të shtetit, në çështjen penale PP__, nr.__________.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurve ____________________ dhe ___________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: __________________________, nga neni ______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ____________, nga neni _________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Mbrojtësi i të pandehurit __________________, avokati ____________________, ka paraqitur kërkesë për t'iu mundësuar qasje dhe për t'ia dorëzuar kopjet e dëshmive që gjenden në lëndën penale PP___, nr._______________.

Pas shqyrtimit të kërkesës së lartcekur të mbrojtësit të të pandehurit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, Prokurori i shtetit gjeti se:

**Kërkesa është e bazuar.**

Kjo kërkesë është e bazuar për shkak se ________________________ (shëno arsyet që mbështesin kërkesën e mbrojtësit).

Nga sa u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në __________ / Osnovno Tužilaštvo u ____________/**
**Basic Prosecution Office ____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të kërkesave të mbrojtësve të te pandehurve __________________, dhe _____________, si dhe në pajtim me nenin ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nxjerr ketë:

## A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara kërkesat e mbrojtësve të te pandehurve _____________ dhe _________________, për të shikuar, kopjuar ose fotografuar shkresat e lëndës që gjenden në zotërim, ruajtje ose nën kontroll të Prokurorit të shtetit, në çështjen penale PP__, nr.__________.

## A r s y e t i m

Kundër të pandehurve _____________________ dhe ______________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: __________________, nga neni ______________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe _____________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës).

Mbrojtësi i të pandehurit __________________, avokati _____________________ dhe mbrojtësi i të pandehurit _________________, avokati __________________, kanë paraqitur kërkesa për t'u mundësuar qasje dhe për t'ua dorëzuar kopjet e dëshmive që gjenden në lëndën penale PP.nr._______________.

Pas shqyrtimit të kërkesave të lartcekura të mbrojtësve të të pandehurve dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, Prokurori i shtetit gjeti se:

Kërkesat janë të pabazuara.

Kërkesat janë të pabazuara për shkak se ________________________ (shëno arsyet e refuzimit).

Komform nenit ________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, prokurori publik i siguron mbrojtësit materialet ose kopjen e tyre të cilat janë në posedim, në kontroll ose në mbrojtje të tij jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit, andaj mbrojtësit e të pandehurve do të kenë mundësinë që te kenë në disponim të gjitha materialet e siguruara gjatë hetimeve, komform kësaj dispozite ligjore jo më vonë se ngritja e aktakuzës.

Mbrojtësit e të pandehurve _____________ dhe _____________, do te jenë të informuar në çdo rast, për veprimet hetimore të ndërmarra nga prokurori i shtetit, sipas kërkesës së tyre apo të pandehurve që i përfaqësojnë, për aq sa nuk do të rrezikohet qëllimi i hetimit, jeta ose shëndeti i njerëzve.

Nga sa u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_____________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa te gjyqtari i procedurës paraprake, në Gjykatën Themelore në ________________, - Departamenti i _______________, në afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

Avokati: ________________
Adresa: _________________
Tel: ____________________

_____.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ___________**
**DEPARTAMENTIT __________________**
**P Ë R**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Kundër Aktvendimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore të Shtetit, në __________, ______, nr._________, të datës ____________, në çështjen penale të të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale __________________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në afatin ligjor paraqes këtë:

**A N K E S Ë**

Për shkak të _______________________________________________________ dhe

**P R O P O Z O J**

Që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit _______________, avokatit ________________ dhe t'i lejohet qasje në shkresat e lëndës ____, nr.________________ ose i njëjti aktvendim të prishet dhe lënda t'i kthehet Prokurorit të shtetit në rivendosje.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetime për shkak veprës penale: _________________, nga neni _____________, i Kodit Penale të Republikës së Kosovës (KPRK).

Mbrojtësi i të pandehurit ________________, avokati ______________, ka paraqitur kërkesë te Prokurori i shtetit për të pasur qasje dhe për t'ia dorëzuar kopjet e dëshmive që gjenden në lëndën _____, nr._______.

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marrë aktvendim ____, nr.________, me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për të pasur qasje në shkresat e lëndës dhe për t'ia dorëzuar kopjet e dëshmive që gjenden ne lëndën ____, nr._________________, me arsyetim se ___________________________.

Konsideroj se aktvendimi i prokurorit të shtetit, përmban shkelje ________________, sepse ____________________________________.

Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, konsideroj se gjyqtari i procedurës paraprake do të vendosë si në propozimin e cekur më lart.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

______________________

**Avokati**
**N.N.**

______________________

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**______________________**

**Adresa:_________________**

**_______________________**

**Tel:___________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË __________________**
**PËR PROKURORIN ___________________________**

Në bazë të nenit _____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ___________________, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR DORËZIMIN E KOPJEVE TË SHKRESAVE TË LËNDËS PP__, nr.____________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit ________________, janë duke u zhvilluar hetimet për shkak veprës penale: ___________________, nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, i pandehuri ________________, më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga Prokurori i shtetit që të më dorëzojë kopjet e shkresave të lëndës, PP__, nr.___________, në mënyrë që unë dhe i pandehuri të kemi mundësinë që ta përgatisim mbrojtjen efektive dhe të propozojmë nxjerrjen e provave nga ana jonë.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**

**______________________**

**PP__, nr.____________**

**Avokati**

**________________________**

**Adresa:________________**

**_________________________**

**Tel:___________________**

**PROKURORISË THEMELORE NË _________________**
**PËR PROKURORIN _________________________**

Në bazë të nenit ______________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, si mbrojtës i të pandehurit ____________________, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR NJOFTIM**
**LIDHUR MË VEPRIMET E NDËRMARRA NË LËNDËN, PP__, nr.____________**

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit _________________, janë duke u zhvilluar hetime për shkak veprës penale: ____________________, nga neni ____________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datën ________________, i pandehuri ________________, më ka autorizuar që ta mbroj në këtë çështje penale.

Duke marrë parasysh dispozitën e nenit __________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkoj nga Prokurori i shtetit që të më njoftoj për çdo veprim të ndërmarrë, e posaçërisht në rastet kur mbahen seancat dëgjimore të personave të përfshirë në këtë çështje penale në cilësinë e të pandehurve, të dëmtuarve ose dëshmitarëve, në mënyrë që unë dhe i pandehuri të kemi mundësinë që ta përgatisim mbrojtjen efektive dhe në bazë të dispozitave ligjore.

**Mbrojtësi i të pandehurit**

**______________________**

**Avokati**

**______________________**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

## SHËNIM ZYRTAR

Avokatit/të pandehurit/ të dëmtuarit ___________________________________, më datë __________________, para lejimit të shikimit të shkresave të lëndës PP__, nr._______________, të të pandehurit _________________, për shkak të veprës penale _____________________, nga neni __________________, i TËRHIQET VEREJTJA, duke u bazuar në nenin _________________, të ligjit ________________, shkresat janë konfidenciale, sepse në këtë çështje, kemi të bëjmë me:

1. Shkresa të lëndës që kanë të bëjnë me të mitur;
2. Shkresa dhe veprime para se të vendoset lidhur me kallëzimin penal;
3. Shkresa dhe veprime para se të vendoset lidhur me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve;
4. Veprime hetimore gjatë hetimeve.

Andaj, avokati __________________, është i detyruar që të ruajë fshehtësinë e këtyre informatave të marra nga shikimi i këtyre shkresave të lëndës, në veçanti përmbajtjen e veprimeve hetimore që janë ndërmarrë si dhe të dhënat personale të personave që janë përmendur në këto shkresa të lëndës, në të kundërtën, çdo zbulim i këtyre shkresave, paraqet vepër penale nga neni _________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

| **Avokati/i pandehuri/i dëmtuari** | **Prokurori i Shtetit** |
|---|---|
| **N.N.** | **N.N.** |
| _______________________________ | _______________________________ |

**_________.nr.________/____**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________, -** Departamenti ___________________, Gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurit_____________, për shkak të veprës penale _______________, nga neni ______________, të KPRK-së, duke vepruar sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit _________________, të paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP____, nr. ____________, të dt. _______________, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, më datën ______________, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit _________________, e paraqitur kundër aktvendimit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP____, nr. ____________, të datës _______________, ndërsa aktvendimi i kundërshtuar VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Prokurori i shtetit, më datë ____________, ka marr aktvendim, PP__, nr._________, më të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit _______________, për marrjen e provës ____________________.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të pandehurit __________________________, - avokati __________________________, për shkak të _______________________, me propozim që aktvendimi i kundërshtuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesa e tij për t'u marrë prova e propozuar ose aktvendimi i kundërshtuar të prishet dhe lënda t'i kthehet prokurorit të çështjes në rivendosje.
Gjyqtari i procedurës paraprake, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të të pandehurit dhe gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimi i Prokurorit të shtetit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse në arsyetimin e aktvendimit të kundërshtuar nuk janë dhënë arsye lidhur me rëndësinë e marrjes së provës _______________, nuk është i bazuar, sepse në aktvendimin e kundërshtuar, prokurori i çështjes ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me rëndësinë e provës së propozuar, duke theksuar se në këtë çështje penale, janë dëgjuar ___________ dëshmitarë dhe të gjitha deklaratat e tyre kanë sqaruar në mënyrë të mjaftueshme gjendjen faktike, duke treguar në detaje se ___________________________, ndërsa prova e propozuar nuk paraqet asnjë relevancë lidhur me këtë çështje penale, andaj, pretendimi i mbrojtësit të

të pandehurit se prova e propozuar do të ndihmonte në zbardhjen e kësaj çështjeje penale, pa treguar se si mund ta bëjë këtë, nuk është i bazuar dhe për ketë arsye, me të drejtë, është refuzuar kërkesa e tij nga Prokurori i çështjes.

Nga ato që u theksuan më lart, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**______, nr. ________, më datë ______________**

**Sekretarja juridike** **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

_________________ ______________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP___.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË _____________**
**DEPARTAMENTIT ________________________**
**PËR GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas marrjes në pyetje të të dyshuarve, si dhe në pajtim me nenet _____________________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR LËSHIMIN E URDHRIT PËR DËSHMITAR BASHKËPUNUES**

**Kundër të dyshuarit: _____________________________ (shënimet personale të te dyshuarit).**

**I dyshuar për veprën penale:**

**________________, nga neni nga neni __________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

**ARSYETIM**

Më datë __________________, Policia e Kosovës i ka paraqitur kësaj prokurorie raportin informues, me numër të referencës __________, me të cilin ka njoftuar se disa zyrtarë nga _______________, janë përfshirë në kryerjen e veprave penale ___________________, nga neni ______________, dhe ______________, nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Më datë ______________, gjyqtari i procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, të datës ______________, ka nxjerrë urdhër _________, nr. __________, për masën e fshehtë teknike të vëzhgimit dhe hetimit: ___________________, kundër të pandehurve _____________________________ dhe _____________________________.

Më datë ________________, Policia e Kosovës, ka paraqitur raport me numër të referencës ____________, lidhur me masën e fshehtë _________________, raport nga i cili rezulton se _____________________________________________________ _______________________________________.

Më datë _________________, prokurori i shtetit ka paraqitur edhe kërkesën për masën e fshehtë _____________________, kundër të pandehurve _______________, dhe _______________, kërkesë të cilën e ka aprovuar edhe gjyqtari i procedurës paraprake, me urdhëresën _________, nr. ___________, datë _____________.

Më datë ______________, Policia e Kosovës, ia ka paraqitur kësaj prokurorie raportin lidhur me zbatimin e masës së fshehtë _______________________, raport nga i cili rezulton se ____________________________________________________________ _______________________________________.

Nga transkriptet që i janë bashkangjitur këtij raporti, shihet se i dyshuari _____________________, më datën ______________, ka komunikuar me të dyshuarin __________________, si në vijim ___________________________________________ ___________________________________.

Më datën ______________, në zyrën e prokurorit të nënshkruar më poshtë, është paraqitur i dyshuari _________________ dhe ka shprehur dëshirën e tij që të japë deklaratë lidhur më këtë çështje penale. Gjatë dhënies së deklaratës, edhe pse ishte i njoftuar se nuk ishte i detyruar që ta inkriminojë vetveten apo të afërmit e tij, i njëjti ka shprehur vullnetin e tij që të flasë të vërtetën dhe të tregojë krejt atë që di lidhur me ketë çështje penale dhe se dëshiron që të jetë dëshmitar bashkëpunues.

Në deklaratën e tij, i dyshuari ________________ ka deklaruar ___________________ _________________________________________________________________________ ______________________________________________ (të shënohet deklarata).

Duke marrë për bazë deklaratat e dëshmitarëve, të të pandehurve, si dhe kërkesën e të dyshuarit _______________, që të bëhet dëshmitar bashkëpunues, konsideroj se ky i dyshuar duhet t'i tregojë edhe gjykatës arsyen se pse dëshiron që të jetë dëshmitar bashkëpunues dhe se çka mund t'i ofrojë prokurorisë dhe gjykatës me deklaratën e tij, që mund të jetë e rëndësishme për këtë çështje penale, pra që shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurën penale dhe drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet ligjore që i dyshuari ___________________, të shpallet dëshmitar bashkëpunues nëse ai i ofron arsye gjykatës se do të dëshmojë të vërtetën për faktet që shpijnë drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurën penale dhe ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.

Gjithashtu, për shkak të ndjeshmërisë së rastit, është e nevojshme që për shkaqe të sigurisë, në bazë të nenit ______________________, gjykata pas pranimit të kësaj kërkese, të urdhërojë fshehtësinë lidhur me pretendimet faktike të përfshira në këtë kërkesë dhe në deklaratën e të pandehurit, që do të japë para gjyqtarit të procedurës paraprake, në mënyrë që të mos vihet në rrezik jeta e të pandehurit si dëshmitar bashkëpunues dhe të afërmve të tij.

**BAZA LIGJORE:**

**A. Neni _____ i KPPK-së**
Paragrafi _____. Sipas këtij kapitulli, shprehja "dëshmitar bashkëpunues" do të thotë i dyshuari ose i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe i cili pritet të dëshmojë në gjykatë kur:

Nën paragrafi _______, ka gjasa të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër;

Nën paragrafi ______, ka gjasa të **shpjerë drejt zbardhjes së të vërtetës** në procedurën penale;

Nën paragrafi _______, **është bërë vullnetarisht** dhe në marrëveshje të plotë **për të dëshmuar të vërtetën** në gjykatë;

Nën paragrafi _______, është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë; ose

Nën paragrafi _______, mund të shpjerë drejt **ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë** të veprës penale.

**B. Neni ________ i KPPK-së**
Paragrafi _______, Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë me shkrim pranë gjykatës për të urdhëruar që personi të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Kërkesa përfshin deklaratën e veçantë të pretendimeve faktike nga prokurori i shtetit.

Paragrafi _______, Prokurori i shtetit mund të bëjë kërkesë të arsyetuar për urdhër që pretendimet faktike në deklarim **të mbahen të fshehta** nga palët tjera dhe mbrojtësit e tyre.

**C. Neni _____________, i KPPK-së**
Paragrafi ____, Urdhri përcakton:

Nën paragrafi _______, veprat penale, me përshkrimin e veprimeve dhe të kualifikimit të tyre për të cilat urdhërohet ndalimi i fillimit ose i vazhdimit të procedurës penale apo shqiptimi i dënimit;

Nën paragrafi _______, ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për vepër penale të përcaktuar në urdhër;

Nën paragrafi _______, natyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues; dhe

Nën paragrafi _______, kushtet për revokimin e urdhrit.

Nga sa u tha më lart, në bazë të neneve ____________, dhe _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, pas mbajtjes së seancës së mbyllur ku mund të marrin pjesë prokurori i shtetit, dëshmitari bashkëpunues dhe mbrojtësi i tij, kërkoj me respekt nga gjyqtari i procedurës paraprake, të:

5. Lëshojë urdhër për dëshmitar bashkëpunues: Për të dyshuarin _________________, i dyshuar për veprën penale ____________, nga neni ____________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

dhe

6. Urdhërojë fshehtësinë lidhur me pretendimet faktike të përfshira në ketë kërkesë dhe në deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ______________**
**DEPARTAMENTIT __________________**
**GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe kërkesës së Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, nr.____________, të datës _______________, në bazë të nenit ______________________ të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe nenit ________, të ligjit nr.___________, për Administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, paraqes këtë:

**KËRKESË PËR SHITJEN E AUTOMJETEVE TË SEKUESTRUARA, SI NË VIJIM:**

_________________ e markës "_________________", ngjyrë të __________, me tabela të regjistrimit __________________, pronë e të pandehurit ______________, ______________ e markës "_______________", më ngjyrë të _________________, me tabela të regjistrimit _________________, pronë e të pandehurit ______________.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Drejtoria ________________________, në ________________, më datë ____________________, i ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në ________________- Departamentit ________________, më numër të referencës ____________________, kundër të pandehurve ________________, ________________ dhe ________________, për shkak të dyshimit se ata kanë kryer veprën penale ___________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në _______________, pas marrjes së kallëzimit penal, më datë _____________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, PP__.nr.____________, pasi që ka gjetur se në ketë rast, bëhet fjalë për veprën penale - ________________, nga neni ______________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së hetimeve, janë marrë në pyetje edhe të pandehurit, ______________, __________________ dhe ________________, janë zbatuar masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, siç janë: _______________________, është bërë _______________, janë siguruar edhe provat tjera me të cilat vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën e lartcekur penale që ju vihet në barrë.

Gjatë kontrollit dhe arrestimit të të pandehurve ____________________________, ________________________ dhe __________________________, Policia e Kosovës ka sekuestruar, në mes tjerash edhe __________ e markës "________________", ngjyrë të ____________, me tabela të regjistrimit _________________, pronë e të pandehurit _____________, dhe _________________, e markës "______________", më ngjyrë të __________________, me tabela të regjistrimit ___________________, pronë e të pandehurit _____________.

Duke marrë parasysh faktin se _____________e sekuestruara, tani gjenden në depon e Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe se procedura penale mund të zgjasë, për shkak të numrit të madh të të pandehurve të përfshirë në ketë çështje penale, si dhe procedurave për bashkëpunim ndërkombëtar me Republikën e _____________, konsideroj se qëndrimi i _______________, të sekuestruara, për një kohë më të gjatë në depot e Agjencisë mund të ndikojë që të humbet vlera e tyre. Për ketë arsye, është e nevojshme që të bëhet shitja e tyre, kështu do të ruhen mjetet nga kjo shitje dhe të mos vije deri te dëmtimi i palëve në procedurë.

**BAZA LIGJORE:**

Në bazë të nenit __________________, të KPPK-së, prokurori i shtetit mund të kërkojë, dhe Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, është përgjegjëse për ekzekutimin e këtyre masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë, duke përfshirë tjetërsimin e pasurisë, nga paragrafi ___________, të këtij neni, ndërsa në bazë të paragrafit ______, të këtij neni, për pasurinë e cila shpejt humb vlerën ose që është plotësisht e zëvendësueshme, prokurori i shtetit mund të kërkojë masë të arsyeshme që do të parandalonte humbjen e vlerës apo shpenzimet e panevojshme të mirëmbajtjes. Përpjekjet nga ky paragraf, mund të përfshijnë shitjen e pasurisë sipas vlerës së saj aktuale në treg, përzierjen e pasurisë ose përpunimin e të lashtave apo materialeve në produkte.

Gjithashtu, sipas paragrafit ____, të këtij neni, shitja e pasurisë nga ky nen, zbatohet në pajtim me nenin ___, të Ligjit nr. __________, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, sipas të cilit në paragrafin _______, thuhet se me propozim të Agjencisë, prokurori apo organi tjetër kompetent, kërkon nga gjykata të vendosë për shitjen e një pasurie që është e zëvendësueshme dhe mund ta humbë vlerën

në rast të magazinimit ose shpenzimet e magazinimit janë joproporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. Ndërsa sipas paragrafit ________, gjykata njofton palët në procedurë dhe Agjencinë lidhur me vendimin për shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe sipas paragrafit _______, po të këtij neni, pas pranimit të vendimit të gjykatës kompetente, lidhur me shitjen e pasurisë, Agjencia zhvillon procedurën për shitjen e pasurisë, në pajtim me ligjet në fuqi.

Andaj, duke u bazuar në nenin _________________, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, si dhe nenit _____________, të Ligjit nr.____________, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, me respekt, i kërkoj gjyqtarit që të lejojë shitjen e automjeteve të sekuestruara, si në dispozitiv të kësaj kërkese.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_______________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në _____________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTI ________________________**
**PËR: GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të raportit të Policisë së Kosovës – Drejtoria ________________, në ____________, referenca ________________, dhe materialeve të tjera që përmban kjo çështje penale dhe në pajtim me nenin _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), paraqes këtë:

## KËRKESË PËR URDHËR NDALUES

Kundër të pandehurve:________________, ________________ dhe ______________ ________________ (shëno të dhënat personale të të pandehurve, duke përfshirë edhe numrat e xhirollogarive bankare nëse është e mundur)

Sepse ekziston dyshimi i bazuar (shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më këtë vepër kishin për të kryer veprën penale _____________________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Më shkresën e Policisë së Kosovës – Drejtoria ____________, nr. ____, të datës __________, prokuroria është njoftuar se i pandehuri ____________, është i përfshirë si pjesë e grupit kriminal të organizuar për kryerjen e veprës penale

______________________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh këtë raport të Policisë dhe faktin se kjo çështje penale kërkonte veprim me urgjencë, në mënyrë që të sigurohen provat e nevojshme dhe për t'ju shmangur mundësisë së zhdukjes së këtyre provave, Prokuroria Themelore e ___________, në ketë çështje penale, urgjentisht ka lëshuar urdhrat e përkohshëm për masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit ______________________, më datat ____________ dhe _____________, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ______________________, së bashku me të pandehurit ______________ dhe _________________, janë të përfshirë në kryerjen e veprave penale të lartcekura dhe se pritja e lëshimit të urdhrit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, për ketë masë, mund të rrezikonte sigurimin e provave të rëndësishme në këtë fazë të hetimeve.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën ____________,.nr.__________, të datës _________, ka konfirmuar urdhrat e lartcekur të Prokurorisë Themelore.

Nga raporti i Policisë së Kosovës – Drejtoria______________, Nr.________, i datës __________, lidhur me zbatimin e urdhrave të lartcekur, rezulton si në vijim: ______________________________________________________________________
(shëno të gjeturat nga raportet e policisë).

Më datën __________________, gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën ____________, nr.__________, të datës __________, ka lëshuar urdhër për kontrollin e shtëpisë dhe lokaleve tjera të të pandehurit ________________________, urdhër i cili është zbatuar nga Policia e Kosovës më datë ______________.

Më datën ________________, prokurori i shtetit, ka nxjerr urdhër të përkohshëm ndalues për ngrirjen e aseteve kundër të pandehurve _____________________ dhe _____________________.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në veprimet e të pandehurve: __________________, _________________ dhe ________________, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të kësaj kërkese dhe se është e nevojshme që të zhvillohen hetimet, në mënyrë që të grumbullohen provat e nevojshme, duke përfshirë edhe të dhënat financiare të të pandehurve për të verifikuar qarkullimin e mjeteve financiare nëpër institucionet financiare, për të verifikuar përfitimet financiare. Andaj është e nevojshme që të lëshohet edhe urdhri ndalues i cili duhet të ketë efektin për çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin i/e cili/a menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj, në pajtim me urdhrin ndalues. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin ndalues, duhet të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Duke marrë parasysh se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit ______________, _________________ dhe ________________, kanë kryer veprat penale siç parashihet

në nenin _______________, të KPPK-së dhe faktin se të pandehurit mund të nxjerrin nga xhirollogaritë e tyre në institucionet financiare dhe shfrytëzojnë asetet/parat që dyshohet se janë fituar me kryerjen e veprave penale të lartcekura, kërkoj nga ju që të nxirrni urdhër ndalues:

1. Kundër të pandehurve ______________, _________________ dhe ____________, duke përfshirë ndalimin e çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të të pandehurve në institucionet financiare, si në vijim:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Bankën Ekonomike

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
______________________

**______, nr._____/_______**

**GJYKATA THEMELORE NË ________________ -** departamenti _____________, gjyqtari i procedurës paraprake ___________________________, me sekretaren juridike ________________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, ______________ dhe ______________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, për lëshimin e urdhrit afatgjatë ndalues, pas mbajtjes së shqyrtimit, më datën _______________, nxjerr këtë:

**URDHËR AFATGJATË NDALUES**

URDHËROHEN Institucionet financiare:
1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

Që kundër të pandehurve: ______________________, _______________________ dhe _______________________ (shëno të dhënat personale të të pandehurve, duke përfshirë edhe numrat e xhirollogarive bankare) të ndalojnë çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarive bankare, duke përfshirë tërheqjen e parave dhe aseteve tjera në ruajtje.

Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin ndalues.

Urdhri për ndalim vlen për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Urdhri për ndalim skadon pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit ose nëse xhirollogaritë e të pandehurve (shumat e parave në këto xhirollogari) nuk ceken në aktakuzë.

**A r s y e t i m**

Më datën _________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në _____________, ka paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhrit ndalues kundër të pandehurve __________, _________________ dhe _________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit, gjeti se:

Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se:

Nga raporti i Policisë së Kosovës – Drejtorisë _______________, në __________, i datës _____________, lidhur me zbatimin e masave të fshehta, rezulton si në vijim: _____________ (shëno të gjeturat nga raportet e policisë)

Më datën __________, duke vepruar në bazë të nenit __________, të KPPK-së, Policia e Kosovës pasi që kishte marrë urdhrin gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ____________, në _______________ (shëno adresën), ku ka gjetur dhe sekuestruar_______________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën _____, nr.__________, të datës __________, ka konfirmuar aprovimin retroaktiv të kontrollit të lartcekur të kryer nga Policia e Kosovës.

Më datën ________________, prokurori i shtetit ka nxjerrë urdhër të përkohshëm ndalues për ngrirjen e aseteve kundër të pandehurve __________, _______________ dhe ____________________ dhe të:___________________.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në veprimet e të pandehurve: pandehurve _________________, ________________ dhe _______________, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të kësaj kërkese dhe se është e nevojshme që të zhvillohen hetimet. Hetimet do të sigurojnë provat e nevojshme, duke përfshirë edhe _______________________, në mënyrë që të verifikohen përfitimet financiare. Prandaj, është e nevojshme që të lëshohet ky urdhër ndalues i cili duhet të ketë efektin për çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin i/e cili/a menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin ndalues. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin ndalues duhet të ndërmerr hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Duke marrë parasysh se në këtë rast ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit _____________, ________________ dhe _______________, kanë kryer veprat penale siç parashihet ne nenin ______________________, të KPPK-së dhe faktin se të pandehurit mund të tërheqin nga institucionet financiare dhe shfrytëzojnë asetet – parat që dyshohet së janë fituar më kryerjen e veprave penale të lartcekura, gjyqtarja e procedurës paraprake lëshon këtë urdhër ndalues:

Kundër të pandehurve _____________, ________________ dhe ______________, ashtu që u ndalohet tërheqja e parave nga xhirollogaritë bankare dhe aseteve tjera në ruajtje ne institucionet financiare si në vijim:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Sekretarja juridike**
**__________________**

**Gjyqtari i procedurës paraprake**
**______________________________**

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij urdhri ndalues, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit.

**______, nr.______**

**GJYKATA THEMELORE NË ______________ - departamenti ______________,** gjyqtari i procedurës paraprake ________________________, me sekretaren juridike ___________________, në lëndën penale kundër të pandehurve: _________________, ______________ dhe ______________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni _____________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në _______________, për lëshimin e urdhrit ndalues, me datën _______________, nxjerr këtë:

**URDHËR I PËRKOHSHËM NDALUES**

URDHËROHEN Institucionet financiare:
1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

Që kundër të pandehurve: ______________________, ______________________ dhe ______________________ (shëno të dhënat personale të të pandehurve, duke përfshirë edhe numrat e xhirollogarive bankare), t'u ndalojnë çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të xhirollogarive bankare, duke përfshirë tërheqjen e parave dhe aseteve tjera në ruajtje.

Institucionet e sipërpërmendura financiare, nuk janë përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e tyre në pajtim me këtë urdhër ndalues.

Urdhri për ndalim, vlen për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Urdhri për ndalim ngrinë të gjitha xhirollogaritë dhe asetet tjera të ruajtura në këto institucione financiare, të të pandehurve për një afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e lëshimit të këtij urdhri.

Në afat prej 3 (tre) javësh nga dita e lëshimit të këtij urdhri, caktohet shqyrtimi i kërkesës për ndalim afatgjatë të tërheqjes së parave dhe aseteve tjera të ruajtura në këto institucione financiare.

**A r s y e t i m**

Më datën _______________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ______________, ka paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhrit ndalues kundër të pandehurve _______________, ________________ dhe _________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit, gjeti se:

Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se:_________________________________________.

Më datën ___________, duke vepruar në bazë të nenit ___________, të KPPK-së, Policia e Kosovës – Drejtoria _______________, në _____________, pasi që kishte marrë urdhrin gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit _____________, në ________________ (shëno adresën), ku ka gjetur një laborator për përpunimin e narkotikut.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën ________, nr.__________, të datës ___________, ka konfirmuar aprovimin retroaktiv të kontrollit të lartcekur, të kryer nga Policia e Kosovës.

Gjatë kontrollit të lartcekur, Policia ka sekuestruar si në vijim: _________________. (shëno saktë së çka është sekuestruar nga policia gjatë kontrollit).

Më datën _________________, prokurori i shtetit ka nxjerrë urdhër të përkohshëm ndalues, për ngrirjen e aseteve, kundër të pandehurve: ______________________, ____________________ dhe _______________________.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në veprimet e të pandehurve: ______________, _________________ dhe ________________, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të këtij urdhri. Është e nevojshme që të lëshohet edhe urdhri ndalues i cili duhet të ketë efektin për çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin i/e cili/a menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruara në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin ndalues. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin ndalues duhet të ndërmerrë hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Duke marrë parasysh se në këtë rast, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit ______________, _________________ dhe ________________, kanë kryer veprat penale siç parashihet ne nenin _________________, dhe faktin se të pandehurit mund të tërheqin nga institucionet financiare dhe shfrytëzojnë asetet – parat që dyshohet se janë fituar me kryerjen e veprave penale te lartcekura, gjyqtarja e procedurës paraprake, lëshon këtë urdhër të përkohshëm ndalues:

Të pandehurve ______________, _________________ dhe ________________, u ndalohet tërheqja e parave nga xhirollogaritë bankare dhe aseteve tjera në ruajtje në institucionet financiare, në afat prej 30 ditësh nga lëshimi i këtij urdhri, nga institucionet financiare, si në vijim:

1. Pro Credit Bank

2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

Shqyrtimi i kërkesës për ndalim afatgjatë, do të mbahet brenda tre (3) javësh nga dita e pranimit të këtij urdhri dhe të pandehurit kanë mundësinë që të marrin pjesë në shqyrtim për të paraqitur argumentet e tyre për heqjen e kësaj ngrirjeje.

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Sekretarja juridike** — **Gjyqtari i procedurës paraprake**

________________ — __________________________

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__, nr.______
Në ______________,
Më datë _____________

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të raporteve e informatave të Policisë së Kosovës – Drejtoria ___________________, në ________________, referenca ________ ________ dhe materialeve të tjera që përmban kjo çështje penale dhe në pajtim me nenin ______________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshoj këtë:

## URDHËR PËR NGRIRJEN E PËRKOHSHME TË ASETEVE

Kundër të pandehurve ___________________________, ___________________________ dhe ____________________________ (shëno të dhënat personale të të pandehurve).

SEPSE ekziston dyshimi i bazuar se____________________(shëno gjendjen faktike: kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale)

Më ketë vepër, kishte për të kryer veprën penale:

- ______________, nga neni _____________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Më raportin informues të Policisë së Kosovës – Drejtoria e _________________, në ______________, me numër të referencës ____________________, kjo prokurori është njoftuar se të pandehurit __________________, _________________ dhe ___________ ________, janë të përfshirë si pjesë e grupit kriminal të organizuar në kryerjen e veprës penale____________________, nga neni__________________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Raportit të sipërpërmendur, Policia ia ka bashkëngjitur dëshmitë si në vijim: ________ _________________________________________________________________.

Duke marrë parasysh këtë raport informues, dëshmitë e bashkangjitura si dhe faktin që kjo çështje penale kërkon veprim me urgjencë në mënyrë që të ngrihen përkohësisht llogaritë bankare si dhe asetet tjera që e shfrytëzojnë të pandehurit _________________, _________________ dhe _______________, sepse dyshohet që janë fituar me kryerjen e veprës penale. Ekziston dyshimi i bazuar se ata janë përfshirë në kryerjen e veprës penale të përshkruar më lart dhe se pritja e lëshimit të urdhrit nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake, për ketë masë mund të rrezikojë sigurimin e provave të rëndësishme për këtë fazë të hetimeve.

**BAZA LIGJORE:**

**Neni ____, paragrafët __________, dhe __, të KPPK-së**

Paragrafi _______. Nëse hetimi është autorizuar për vepër penale nga neni ___, i këtij Kodi, prokurori i shtetit mund të lëshojë urdhër për ndalimin e shitjes, shkëmbimit të pronësisë ose tërheqjen nga llogaria të cilitdo send të përshkruar në paragrafin __, ose __, të këtij neni.

Paragrafi ____. Çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete, të cilat janë:

Nën paragrafi ____, të ardhura nga vepra penale nën hetim; ose

Nën paragrafi ____ përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim.

Paragrafi ____. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen ka efektin e mëposhtëm:

Nën paragrafi ____ çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin nga ky nen, menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj, në pajtim me urdhrin nga ky paragraf.

Nën paragrafi ____, cilado palë tjetër që pranon urdhrin nga ky nen, duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Paragrafi ____. Urdhri i prokurorit të shtetit nga ky nen, mund të lëshohet vetëm një herë dhe është i vlefshëm vetëm për ____, orë nga koha e lëshimit të urdhrit.

Paragrafi ____. Në urdhrin e prokurorit të shtetit, përshkruhet ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme, llogaria financiare ose aseti dhe i urdhëron pranuesit e urdhrit që të ndalojnë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për _____, orë nga koha e lëshimit të urdhrit. Në urdhër ceket koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhrit.

Paragrafi _____. Urdhri nga ky paragraf, mund të lëshohet nga prokurori i shtetit nëse ai i paraqet kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhër ndalues nga neni ____, i këtij Kodi për asetin e përcaktuar në urdhër.

Nga sa u tha më sipër, duke marrë parasysh se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit _____________, ________________ dhe _______________, kanë kryer veprat penale siç parashihet në nenin ___, paragrafi __, nën paragrafi ___, dhe nënparagrafi ______, të KPPK-së dhe faktin se të pandehurit mund të nxjerrin dhe shfrytëzojnë asetet – parat që dyshohet së janë fituar më kryerjen e veprave penale të lartcekura, nxjerr urdhër për ngrirjen e përkohshme të aseteve:

1. Kundër të pandehurve ____________________, ______________________ dhe __________________, duke përfshirë llogaritë bankare në institucionet financiare, si vijon:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike
8. Institucionet tjera financiare

Çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin, menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare që është evidentuar në emër të të pandehurve të lartcekur.

Ky urdhër vlen vetëm ___, orë duke filluar nga data ___________, në ora _________, deri më datën __________, në ora ____________.

**ZYRTARI ZBATUES NË EKZEKUTIMIN E URDHRIT:**

Zyrtari i policisë _______________, hetues në ______________, është i autorizuar si zyrtar përgjegjës për zbatimin e urdhëresës. Zyrtari i autorizuar i policisë, mund ta delegojë përgjegjësinë e tij te një zyrtar tjetër i policisë, nën mbikëqyrjen apo kontrollin e tij.

**KËRKESAT PËR RAPORTIM:**

Urdhëron që zyrtari i policisë _______________, hetues në _____________, ose një tjetër zyrtar i policisë gjyqësore, nën mbikëqyrjen e tij, të raportojë mbi zbatimin e këtij urdhri, te gjyqtari i procedurës paraprake që ka lëshuar urdhrin dhe te prokurori i shtetit.

Lëshon tri kopje origjinale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

______, nr.______/__________

**GJYKATA THEMELORE NË ______________________________ -** departamenti ________________, gjyqtari i procedurës paraprake _____________, me sekretaren juridike ____________, në lëndën penale kundër të pandehurve: ____________, _____________ dhe _____________, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ______________, i KPRK-së, duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, në Prokurorinë Themelore në _______________, për sekuestrim të përkohshëm, më datën _______________, nxjerr këtë:

**URDHËR NDALUES**

URDHËROHEN Institucionet financiare:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

Që kundër të pandehurve: ________________, ________________ dhe ___________ ___________ (shëno të dhënat personale të të pandehurve, duke përfshirë edhe numrat e xhirollogarive bankare) të ndalojnë çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarive bankare.

Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me këtë urdhër ndalues.

Urdhri për ndalim vlen për të tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Urdhri për ndalim nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pushimit të hetimit ose nëse xhirollogaritë e të pandehurve (shumat e parave në këto xhirollogari) nuk ceken në aktakuzë.

**A r s y e t i m**

Më datën ________, prokurori i shtetit në Prokurorinë Themelore në ______________, ka paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhrit ndalues kundër të pandehurve _______________, ________________ dhe _________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së prokurorit të shtetit, gjeti se:

Kërkesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se: ________________________________________.

Më datën __________, duke vepruar në bazë të nenit __________, të KPPK-së, Policia e Kosovës, pasi që kishte marrë urdhrin gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake, ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurit ____________, në _______________, (shëno adresën), ku ka gjetur dhe ka sekuestruar _____________ ___________ (shëno saktë së çka është sekuestruar nga policia gjatë kontrollit).

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën ________, nr.__________, të datës ___________, ka konfirmuar aprovimin retroaktiv të kontrollit të lartcekur të kryer nga Policia e Kosovës.

Më datën ________________, prokurori i shtetit ka nxjerrë urdhër të përkohshëm ndalues për ngrirjen e aseteve kundër të pandehurve ___________, ________________ dhe _____________________.

Nga sa u tha më lart, rezulton se në veprimet e të pandehurve: _____________, ___________________ dhe __________________, manifestohen elementet e veprave penale si në dispozitiv të këtij urdhri dhe se është e nevojshme që të lëshohet edhe urdhri ndalues i cili duhet të ketë efektin për çdo bankë apo institucion financiar që pranon urdhrin i/e cili/a menjëherë ndalon çfarëdo aktiviteti të mëtejmë të llogarisë bankare të përshkruar në urdhër. Banka nuk është përgjegjëse ndaj mbajtësit të llogarisë bankare për veprimet e saj në pajtim me urdhrin ndalues. Cilado palë tjetër që pranon urdhrin ndalues duhet të ndërmarrë hapat e arsyeshëm për t'iu bindur urdhrit.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit ______________, _________________ dhe ________________, kanë kryer veprat penale siç parashihet në nenin ____________________, të KPPK-së dhe faktin se të pandehurit mund të nxjerrin nga institucionet financiare dhe shfrytëzojnë asetet – paratë që dyshohet se janë fituar me kryerjen e veprave penale të lartcekura, gjyqtarja e procedurës paraprake, lëshon këtë urdhër ndalues:

1. Kundër të pandehurve ______________, _________________ dhe ________________, duke përfshirë llogaritë bankare të të pandehurve, në institucionet financiare:

1. Pro Credit Bank
2. NLB Prishtina
3. Raiffeisen Bank
4. BpB- Banka për Biznes
5. TEB
6. BKT – Banka Kombëtare Tregtare
7. Banka Ekonomike

**GJYKATA THEMELORE NË ________________**
**DEPARTAMENTI ______________________**
**________ nr.__________, dt. ______________.**

**Sekretarja juridike**
**_________________**

**Gjyqtari i procedurës paraprake**
**____________________________**

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij urdhri ndalues, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PP__.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

**GJYKATËS THEMELORE NË ____________**
**DEPARTAMENTIT ____________________**
**P Ë R**
**GJYQTARIN E PROCEDURËS PARAPRAKE**

Pas rishikimit të raporteve të Policisë së Kosovës – Sektori për hetimet e integruara financiare në Prishtinë - referenca _____________________________________, i datës ______________ dhe në pajtim me nenin _____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, paraqes këtë:

**Kërkesë për masën e përkohshme, për sigurinë e pasurisë së sekuestruar**

**Kundër të pandehurit: _______________________________________ (shëno shënimet personale)**

Ekziston dyshimi i bazuar se ____________________________________ (shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dh e kryerjen e veprës penale)

Më ketë vepër, kishte për të kryer veprën penale:

- ________________, nga neni __________________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,

**ARSYETIM:**

Policisë së Kosovës – Drejtoria ________________, në ______________, më datë __________________, i ka paraqitur Kallëzim Penal në Prokurorinë Themelore në ______________- Departamentit ______________, me numër të referencës __________________, në _____________, kundër të pandehurve ______________, _______________ dhe _______________, për shkak të dyshimit se ata kanë kryer veprën penale _______________, nga neni ___________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Themelore në _______________, pas marrjes së kallëzimit penal më datë ____________, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, PP____.nr.___________, pasi që ka gjetur se në ketë rast, bëhet fjalë për veprën penale - ______________, nga neni ___________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjatë procedurës së hetimeve, janë marrë në pyetje edhe të pandehurit, ______________, __________________ dhe ________________, janë zbatuar masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit, siç janë: _________________________, është bërë ekspertimi i sendeve të sekuestruara nga të pandehurit, janë siguruar edhe provat tjera me të cilat vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën e lartcekur penale që ju vihet në barrë.

Gjatë kontrollit dhe arrestimit të te pandehurve ______________, _________________ dhe ________________, Policia e Kosovës ka sekuestruar në mes tjerash edhe veturën e markës "________________" ngjyrë të __________, me tabela të regjistrimit _________________, pronë e të pandehurit _____________, veturën e markës "______________" më ngjyrë të ________________ me tabela të regjistrimit _________________, pronë e të pandehurit _____________.

Më datën ___________________, duke vepruar në bazë të nenit _____________, të KPPK-së, Policia e Kosovës – Drejtoria __________________, në __________________, pas njoftimit të prokurorit dhe pasi që nga prokurori ishte njoftuar edhe gjyqtarja e procedurës paraprake, e cila ka dhënë urdhrin gojor, policia ka bërë kontrollin e shtëpisë së të pandehurve: _________________ dhe ______________ në __________________, ku ka gjetur ____________________________________.

Gjyqtarja e procedurës paraprake, me urdhëresën _______________, të datës _______________, ka lëshuar urdhrin për konfirmimin e urdhrit gojor, për kontrollin e shtëpisë së të pandehurve _____________ dhe _____________ në ________________.

Gjatë kontrollit të lartcekur, Policia ka sekuestruar nga i pandehuri ______________ sendet si në vijim: ______________________________________________________ ________________________________________.

Fakti se shtëpia që është në pronësi të të pandehurit _______________, që gjendet në ____________ rruga "__________________" nr._____, është shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë, është vërtetuar nga raporti i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit __________, numër __________________, të datës ______________, si

dhe foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, nga deklarata e të pandehurit __________________, i cili ka deklaruar se ____________________________.

Më datën ________________, gjyqtari i procedurës paraprake, ka lëshuar urdhër për sekuestrimin e përkohshëm të shtëpisë që është ne pronësi të të pandehurit _____________, ndërsa në bazë të raportit të Policisë së Kosovës, nr.______________, të datës ______________, rezulton se Policia, ka zbatuar urdhëresën e lartcekur të gjyqtarit të procedurës paraprake për sekuestrimin e përkohshëm të shtëpisë që është në pronësi të të pandehurit __________________.

Duke marrë parasysh se pasuria e sekuestruar përkohësisht, ka gjasa të konsiderueshme se nuk do të jetë e mundur të konfiskohet në përfundim të procedurës penale ose së do të përdoret në kryerjen e veprës së ngjashme penale, konsideroj se masa e përkohshme për sigurinë e pasurisë - është e nevojshme, sepse kjo pasuri, mund të tjetërsohet apo të përdoret për të kryer vepër të ngjashme penale nëse nuk merren masa mbrojtëse.

Nga sa u tha më lart, në bazë të nenit ______________, të KPPK-së, prokurori i nënshkruar këtu, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se i pandehuri ________________, ka kryer veprat penale të theksuara më lart dhe duke marrë parasysh se ka shfrytëzuar pasurinë e tij – shtëpinë ne _______________, rruga "_______________", nr.____________, dhe kjo pasuri ia ka mundësuar kryerjen e veprës penale, i propozon gjyqtarit të procedurës paraprake:

Të nxjerrët urdhër për masën e përkohshme për sigurinë e pasurisë nga neni _______, të KPPK-së, për:

shtëpinë që gjendet në ___________________, rruga "________________________", nr.____________, që është pronësi e të pandehurit ______________, si pasuri që i ka mundësuar të pandehurit kryerjen e veprës penale______________, nga neni __________, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**KËRKESË E TË PANDEHURIT PËR MARRJEN E PROVËS**
**- në bazë të nenit 216 të Kodit të Procedurës Penale -**

Për:

**PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË**

Nr. i referencës: ______________

Nga i pandehuri N. N.

**KËRKESË E TË PANDEHURIT PËR MARRJEN E PROVËS**
**- në bazë të nenit 216, të Kodit të Procedurës Penale -**

Në bazë të nenit 216, par. 1 dhe par. 2 nën paragrafi 2.3, të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri NN me këtë parashtresë, kërkon nga prokurori i shtetit që të marrë provën konkrete: konstatimin dhe mendimin e ekspertit të grafologjisë se nënshkrimi në kontratën e prezantuar si provë në lidhje me këtë çështje penale, a është nënshkrim i tani të pandehurit ose jo.

Kjo provë do të merret me angazhimin e ekspertit të grafologjisë.

I pandehuri kërkon marrjen e kësaj prove sepse eksperti i grafologjisë do të konstatojë që kontrata e prezantuar si provë në këtë çështje penale, nuk është e nënshkruar nga i njëjti dhe se kjo provë do të jetë shfajësuese për të.

Prishtinë,
8.11.2015

**I pandehuri**
**N. N.**
**Rruga “Prishtina” nr. 2, Prishtinë**

**KËRKESË E TË PANDEHURIT PËR MARRJEN E PROVËS E CILA GJENDET JASHTË KOSOVËS**
**- në bazë të nenit 216 dhe 219 të Kodit të Procedurës Penale -**

Për:

**PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË**

Nr. i referencës: ______________

Nga i pandehuri N. N.

**KËRKESË E TË PANDEHURIT PËR MARRJEN E PROVËS E CILA GJENDET JASHTË KOSOVËS**
**- në bazë të nenit 216 dhe 219 të Kodit të Procedurës Penale -**

Në bazë të nenit 216 par. 1 dhe par. 2 nën paragrafi 2. 3, si dhe të nenit 219 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri NN me këtë parashtresë kërkon nga prokurori i shtetit që të marrë provën konkrete: dëshminë e dëshmitarit i cili gjendet jashtë Kosovës në lidhje me veprimet e tij, tani të pandehurit, në ditën kritike, tani i dëmtuari kishte pësuar lëndime trupore.

Kjo provë, do të merret në rrugë diplomatike nëpërmes të Ministrisë së Drejtësisë ashtu që do t'i kërkohet autoritetit të shtetit ku dëshmitari tani e ka vendqëndrimin-vendbanimin, ashtu që në procedurë ligjore do të thërret dëshmitarin dhe t'i parashtroi pyetjet që do t'i adresohen nga prokurori i shtetit.

I pandehuri kërkon marrjen e kësaj prove sepse kjo dëshmi është me rëndësi për të dëshmuar pafajësinë e tani të pandehurit.

Prishtinë,
8.11.2015

**I pandehuri**
**N. N**
**Rruga "Prishtina" nr. 2, Prishtinë**

**Aktvendimi për refuzimin e kërkesës për marrjen e provës**
**- në bazë të nenit 216 par. 4 të KPP-së -**

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
PP. Nr.
Datë, 5.11.2015

Në bazë të nenit 216, par. 4 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së të pandehurit N. N, të datës 5. 11. 2015, për marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit S. S. i cili aktualisht gjendet jashtë Kosovës, më datën 6. 11. 2015, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET kërkesa e të pandehurit N. N. për marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit S. S. i cili aktualisht gjendet jashtë Kosovës.

**Arsyetim**

I pandehuri N.N., më datën 5.11.2015, i është drejtuar prokurorit të shtetit me kërkesë që të merret prova e cila konsiston në dëgjimin e dëshmitarit S. S i cili aktualisht gjendet jashtë Kosovës. I pandehuri në kërkesë pretendon se kjo provë do të ishte shfajësuese për të. Marrja e kësaj prove duhej të bëhej në rrugë diplomatike sepse dëshmitari i cili propozohet të dëgjohet është shtetas i shtetit të huaj dhe vendbanimin e ka në shtetin e huaj.

Prokurori i shtetit, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së të pandehurit për dëgjimin e dëshmitarit S. S, konstatoi se i pandehuri N. N nuk e ka bërë të besueshme se dëshmitari S. S i propozuar të dëgjohet ka njohuri për rastin e të cilat do të ishin me rëndësi në drejtim të vërtetimit të përgjegjësisë penale të tani të pandehurit dhe kërkesa në fakt është e orientuar vetëm në drejtim të zvarritjes së procedurës penale.

Prandaj, për arsyet e theksuara më lartë, u vendos si në dispozitiv.

**Prokurori i shtetit**

______________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, i pandehuri ka të drejtë ankese brenda afatit prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Ankesa i drejtohet gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore të Prishtinës-nëpërmes kësaj prokurorie.

**KËRKESË E TË DËMTUARIT PËR KOMPENSIMIN E DËMIT TË SHKAKTUAR ME VEPËR PENALE**
**- në bazë të nenit 286 të Kodit të Procedurës Penale -**

Për:

**PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË**

Nr. i referencës: ______________

Nga i dëmtuari N. N.

**KËRKESË E TË DËMTUARIT PËR KOMPENSIMIN E DËMIT TË SHKAKTUAR ME VEPËR PENALE**
**- në bazë të nenit 286 të Kodit të Procedurës Penale -**

Në bazë të nenit 218 të Kodit të Procedurës Penale, në çështjen penale të tani të pandehurit NN i dëmtuari A:A me këtë parashtresë parqet kërkesë pasurore-juridike që konsiston në kompensimin e dëmit material dhe jo material që tani i pandehuri NN i ka shkaktuar me veprën penale për të cilën janë duke u zbatuar hetimet.

I dëmtuari e njofton prokurorin e shtetit se tani i pandehuri në ditën dhe kohën e theksuar në vendimin për zbatimin e hetimeve duke drejtuar automjetin e tij në shkelje të Ligjit për Komunikacionin Rrugor, në udhëkryqin e rrugëve "Agim Ramadani" dhe Sheshit "Bill Klinton" duke mos respektuar rregullat e lëvizjes në udhëkryq sipas semaforëve, kishte hyrë në udhëkryq në dritën e kuqe dhe kështu e kishte goditur veturën të cilën ishte duke e drejtuar tani i dëmtuari AA, me ç rast vetura e të dëmtuarit ishte dëmtuar për vlerën prej 10.000,00 €, dhe po ashtu i dëmtuari kishte pësuar lëndime trupore për shërimin e të cilave kishte paguar 2.000,00 €. Po ashtu i dëmtuari për kohën e shërimit dhe të pa aftësisë për punë që kishin zgjatur 3 muaj ishte i penguar që të ushtronte profesionin e tij prej mjeshtrit të pajisjeve elektroteknike për çka kishte pësuar humbje prej 500,00 €

Prandaj i dëmtuar kërkon nga prokurori i shtetit që në aktakuzën ndaj tani të pandehurit të përfshijë edhe kërkesën e të dëmtuarit AA, për kompensimin e dëmit material në vlerë prej 13.500,00 € me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së kërkesës e deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Prishtinë,
8.11.2015

**I dëmtuari**
**A. A**
**Rruga "Prishtina" nr. 2, Prishtinë**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda-Gjyqtari i Procedurës Paraprake**
**GJ. P. P. Nr. ______/20___**

**PROCESVRBAL NGA SEANCA DËGJIMORE LIDHUR KËREKSËN PËR MASË MBROJTËSE PËR DËSHMITARIN**
**(në bazë të nenit 221, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurë Penale)**

Seanca dëgjimore mbahet në datën________________ 20__, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Krime të Rënda.

Përbërja e gjykatës: Nga gjyqtari i procedurës paraprake N. N-në vazhdim gjykata.

Procesmbajtës-zyrtarja ligjore N. N.

Në bazë të nenit 221 par. 3 të KPP-së kjo seancë dëgjimore është e mbyllur për publik.

Gjykata konstaton se në seancën e sotme dëgjimore prezantojnë:

1. Prokurori i Shtetit N. N,
2. Dëshmitari, N. N. Dhe
3. Mbrojtësi i të pandehurit.

Objekt i shqyrtimit në këtë seancë dëgjimore është kërkesa e prokurorit të shtetit për caktimin e masës mbrojtëse: Urdhër anonimitet

Gjyqtari i njofton palët me përbërjen e gjykatës dhe i fton palët që të deklarohen se a kanë ndonjë vërejtje në përbërje të gjykatës.

Palët nuk kanë vërejtje në përbërje të gjykatës.

Gjyqtari i njofton palët me përmbajtjen e kërkesës së ushtruar nga prokurori i shtetit për caktimin e masës mbrojtëse-urdhër për anonimitet për dëshmitarin N. N, dhe fton: prokurorin e shtetit, dëshmitarin dhe mbrojtësin e të pandehurit që të paraqesin komentet e tyre-informata shtesë lidhur me pretendimet e tija për arsyeshmërinë e caktimit të masës mbrojtëses-urdhrit për anonimitet.

Prokurori i shtetit deklaron se mbetet pranë kërkesës që për dëshmitarin N. N të caktohet masa mbrojtëse-urdhri për anonimitet duke theksuar arsyet përse kjo masë duhet të caktohet:

**Shënohet deklarata e prokurorit të shtetit:**

**Dëshmitari N. N. për të cilin prokurori i shtetit kërkon të caktohet masa e mbrojtjes deklaron:**

**Mbrojtësi i të pandehurit deklaron:**

Palët nuk kanë tjetër për të shtuar.

Gjyqtari shpall seancën dëgjimore të përfunduar.

Përfundoi në ora______.

**Vërtetojnë:**

| | | |
|---|---|---|
| **Procesmbajtësi,** | | **Gjyqtari,** |
| ________________ | | ________________ |
| **Dëshmitari,** | **Prokurori i shtetit** | **Mbrojtësi i të Pandehurit** |
| ________________ | ________________ | ________________ |

**URDHËRESË**
**PËR MASA MBROJTËSE-ANONIMITET NGA I PANDEHURI**
**- sipas nenit 223 par. 1 dhe 3 të KPP-së -**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**GJ. P. P-KR. Nr______/2016**

Në bazë të nenit 223, par. 1 dhe 3, të Kodit të Procedurës Penale, gjykata lëshon këtë:

**URDHËRESË**
**PËR MASA MBROJTËSE-ANONIMITET NGA I PANDEHURI**

1. Për dëshmitarin N. N. i cili pritet të dëshmoi në çështjen penale të tani të pandehurit __________________, në drejtim të veprës penale ______________nga neni_____, të KP të RK-së, URDHËROHET masa mbrojtëse si në vijim:

    1. Shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit dhe të çdo informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar dëshmitarin.

    2. Caktimin e pseudonimit për dëshmitarin N. N. ashtu që i njëjti në të ardhmen do të evidentohet si: “.........”.

    3. Urdhërohet mbrojtësi i të pandehurit që të mos zbulojë identitetin e dëshmitarit N. N, dhe që të mos zbulojë asnjë material që mund të zbulojë identitetin e dëshmitarit.

**Gjyqtari**

______________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këse urdhërese mund të ushtrohet ankesë në kolegjin shqyrtues të kësaj gjykate, brenda afatit prej 48 orëve, nga dita e marrjes së urdhëresës.

## Aktvendim për pezullimin e procedurës penale nga Prokurori i shtetit - neni 230 par. 1 të KPP-së -

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
P. P. Nr.
Datë, 24.1.2016

Në bazë të nenit 230 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale prokurori i shtetit, me rastin e vendosjes në lidhje me procedimin në çështjen penale të tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale: ___________________, nga neni _______, të KP të RKS-së, pas dëgjimit të dëmtuarit S. S. më datën 24.1.2016, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. Ndaj të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale: ________________________, nga neni _________, të RKS-së, PEZULLOHET ndjekja penale.

II. I pandehuri N. N. është i obliguar që brenda afatit prej gjashtë muajsh të përmbush detyrimet e tij sipas zotimit se do të kompensoj dëmin material të shkaktuar ndaj tani të dëmtuarit në lartësi prej 2.500,00 €.

III. I pandehuri duhet ta njoftojë prokurorin e shtetit për përmbushjen e zotimit të dhënë.

IV. Pas pranimit të njoftimit për përmbushjen e zotimit, prokurori i shtetit me vendim të veçantë do të hedh kallëzimin penal, dhe konsiderohet _________________.

V. Nëse i pandehuri N. N nuk vepron sipas pikës II të këtij aktvendimi, prokurori i shtetit do të rifillojë ndjekjen penale.

### Arsyetim

Polica e Republikës së Kosovës më datën 1.11.2015 ka ushtruar kallëzimin penal kundër tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale ______________________, nga neni ________, të RKS-së.

Sipas nenit 230, par. 1 të KPP-së për vepra për veprën penale për të cilën është iniciuar procedura penale ndaj tani të pandehurit lejohet pezullimi i ndjekjes penale për kohë të caktuar dhe nën kushte të caktuara.

Prokurori i shtetit në aplikim të nenit 230, par. 1 të KPP-së ka njoftuar të pandehurin dhe palën e dëmtuar se ekzistojnë mundësitë ligjore që në lidhje me këtë çështje penale

me pajtimin e palës së dëmtuar dhe me premtimin e të pandehurit për kompensimin e dëmit material, mund të pezullohet ndjekje penale për një periudhë kohore deri në gjashtë muaj duke e paralajmëruar të pandehurin me pasojat e mos përmbushjes së zotimeve të dhëna.

I pandehuri në përgjigjen e tij të dhënë prokurorit të shtetit me parashtresën e datës _____________2015, ka deklaruar se është i gatshëm që të kompensojë dëmin material të shkaktuar ndaj tani të dëmtuarit, në lartësi prej 2.500,00 €.

I dëmtuari S. S me parashtresën e datës ______________2015, ka dhënë pëlqimin që ndaj tani të pandehurit të pezullohet ndjekja penale në pritje që i njëjti të përmbush zotimet e dhëna.

Prokurori i shtetit në aplikim të nenit 230, par. 1 dhe 2 në respektim të vullnetit të dëmtuarit dhe duke shpresuar se edhe i pandehuri do të përmbush zotimin e dhënë, vendosi për pezullimin e përkohshëm të ndjekjes penale.

Pas njoftimit në lidhje me përmbushjen e zotimit, prokurori i shtetit do të hedh kallëzimin penal me çka edhe pushohet procedura penale.

Nëse i pandehuri dështon të përmbush zotimin e dhënë, prokurori i shtetit do të rifilloj ndjekjen penale.

**Prokurori i shtetit**

____________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesa brena afatit prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Ankesa i drejtohet gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore të Prishtinës-nëpërmes kësaj prokurorie.

**Vërejtje:** Në rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, neni 230, i KPP-së, për pezullim të ndjekjes penale nuk mund të aplikohet.

**Aktvendim për heqje dorë nga ndjekja penale**
**Neni 231 i Kodit të Procedurës Penela-së lidhur me nenin 29, 30, 34 par. 2, nenit 77, dhe 78 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës**

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
P. P. Nr.
Datë, 24.1.2016

Në bazë të nenit 231, par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit, me rastin e vendosjes në lidhje me procedimin në çështjen penale të tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale:__________________, nga neni_______, të KP të RKS-së, më datën 24.1.2016, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Ndaj të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale:__________________, nga neni______, të RKS-së, HEQ DORË nga ndjekja penale për arsye se gjykata mund ta lirojë nga dënimi të pandehurin dhe prokurori i shtetit çmon se vetëm gjykimi pa sanksion nuk është i nevojshëm, përkatësisht për arsye se tani i pandehuri është penduar sinqerisht për veprën penale dhe ka kompensuar dëmin dhe prokurori i shtetit çmon se sanksioni penal nuk është i arsyeshëm.

**Arsyetim**

Polica e Republikës së Kosovës më datën 1.11.2015, ka ushtruar kallëzimin penal kundër tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale ______________________, nga neni ________, të RKS-së.

Nga deklarata e tani të pandehurit N. N, e dhënë në polici, vërtetohet se i njëjti vullnetarisht ka heq dorë nga kryerja e veprës penale dhe i ka zbuluar policisë njohuritë për marrëveshje për kryerje të veprës penale.

Në bazë të nenit 34, par. 2 të KP të RK-së, "*Gjykata mund ta zbusë dënimin ose ta lirojë nga dënimi personin i cili është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse personi i tillë, vullnetarisht heq dorë nga marrëveshja; vullnetarisht ndërmerr veprime për parandalimin e ekzistencës së vazhdueshme të bashkimit kriminal ose të kryerjes së veprës penale në pajtim me qëllimet e saj; ose vullnetarisht ia zbulon policisë njohuritë e marrëveshjes në kohën kur vepra penale e planifikuar ende mund të parandalohet*".

Prokurori i shtetit konsideron se janë plotësuar kushtet për heqje dorë nga ndjekja penale ndaj tani të pandehurit N. N, në aplikim të nenit 231, par. 1. 1 dhe 1. 2 të KPP-së.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prokurori i shtetit**

______________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesa brena afatit prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Ankesa i drejtohet gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore të Prishtinës-nëpërmes kësaj prokurorie.

**Vërejtje:** Kjo formë e të vepruari është e mundur vetëm kur bëhet fjalë për vepra penale për të cilën sipas KP të RK-së gjykata mund ta lirojë kryesin e veprës penale nga dënimi, dhe për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me gjobë ose me burg deri në një vit.

**Procedura e ndërmjetësimit**
**(Neni 232 i KPP-së)**

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
P. P. Nr.
Datë, 24. 01. 2016

Në bazë të nenit 232, par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit, me rastin e vendosjes në lidhje me procedimin në çështjen penale të tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale:__________________, nga neni_______, të KP të RKS-së, më datën 24.1.2016, vendosi për:

## DËRGIMIN E KALLËZIMIT PENAL PËR NDËRMJETËSIM

I. Në çështjen penale të tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale: ___________________, nga neni _________, të RKS-së, kallëzimi penal dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prishtinë për ndërmjetësim.

II. Ndërmjetësimi do të bëhet nga ndërmjetësi i pavarur në aplikim të nenit 232, par. 2 dhe 3 dhe 5 të KPP-së.

III. Kohëzgjatja për ndërmjetësim është tre (3) muaj nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

IV. Ndërmjetësi detyrohet që ta njoftoi prokurorin e shtetit lidhur me rezultatet e ndërmjetësimit.

### Arsyetim

Polica e Republikës së Kosovës më datën 1.11.2015, ka ushtruar kallëzimin penal me shenjën _____________, kundër tani të pandehurit N. N., për shkak të veprës penale _____________________, nga neni ________, të RKS-së.

Duke marrë parasysh llojin dhe natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër, personalitetin e kryesit dhe faktit se i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, prokurori i shtetit konsideron se ky kallëzim penal mund të dërgohet te ndërmjetësuesi i pavarur me qellim që të tentohet ndërmjetësimi në mes të tani të pandehurit dhe të dëmtuarit.

Në bazë të nenit 232, par. 3 të ë KP të RK-së, marrëveshja nëpërmes të ndërmjetësimit mund të arrihet “vetëm me pëlqimin e të pandehurit dhe të dëmtuarit".

Prokurori i shtetit konsideron se janë plotësuar kushtet për dërgimin e kallëzimit penal për ndërmjetësim në bazë të nenit 232, par. 1 të KPP-së.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

_________________________

**Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë**
**(Neni 233 i KPP-së)**

PROKURORIA THEMELORE E PRISHTINËS
P. P. Nr.
Datë ___________2015

Në bazë të nenit 233, të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së) sipas iniciativës së prokurorit të shtetit, pas negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në mes të palëve negociuese: prokurori i shtetit _____________________ me autorizimin e kryeprokurorit të ____________________________ dhe të pandehurit _____________ ____________i përfaqësuar nga mbrojtësi ____________________, kanë arritur këtë:

**MARRËVESHJE**
**PËR PRANIMIN E FAJËSISË**

Pranimi i fajësisë,

1. I pandehuri ________________________, me të dhëna personale si në shkresa të lëndës e pranon fajësinë për :

   1.1. Veprën penale ___________________________________ të përfshirë në pikën 1 të dispozitivit të aktakuzës PP. nr. ____________________, dt. _________ 2015,

   1.2. Veprën penale ___________________________________ të përfshirë në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës PP. nr. ____________________, dt. _________ 2015, dhe

   1.3. Veprën penale ___________________________________, të përfshirë në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës PP. nr. ____________________, dt. _________ 2015 të përfshirë në pikën 3 të aktakuzës.

Rekomandimi për dënimin individual për secilën vepër penale,

Palët në negocimin e marrëveshjes për pranimin fajësisë janë pajtuar që gjykatës t'i rekomandohen këto dënime individuale për secilën vepër penale për të cilën pranohet fajësia, si dhe për dënimin unik të cilin gjykata duhet ta shqiptoi nëse e pranon këtë marrëveshje:

Për veprën penale nën pikën 1.1 të aktakuzës si dhe të kësaj marrëveshje propozohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej __________ vjet i cili do të mbahet pas

plotëfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënimi me gjobë në lartësi prej _______€, i cili do të paguhet brenda afatit prej ________ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit-në të kundërtën do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë të caktohet një ditë burgim, deri në maksimumin e lartësisë së dënimit me gjobë i cili mund të zëvendësohet me dënimin me burg, ndërsa pjesa tjetër e dënimit me gjobë e cila nuk mund të zëvendësohet me dënimin me burg do të zbatohet procedura e përmbarimit të detyruar sipas LPP-së.

Për veprën penale nën pikën 1.2 të aktakuzës si dhe të kësaj marrëveshje propozohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej _________ vjet i cili do të mbahet pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënimi me gjobë në lartësi prej _______€ i cili do të paguhet brenda afatit prej ______ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit-në të kundërtën do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë të caktohet një ditë burgim, deri në maksimumin e lartësisë së dënimit me gjobë i cili mund të zëvendësohet me dënimin me burg, ndërsa pjesa tjetër e dënimit me gjobë e cila nuk mund të zëvendësohet me dënimin me burg do të zbatohet procedura e përmbarimit të detyruar sipas LPP-së.

Për veprën penale nën pikën 1.3 të aktakuzës si dhe të kësaj marrëveshje propozohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej _________ vjet i cili do të mbahet pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe dënimi me gjobë në lartësi prej _______€ i cili do të paguhet brenda afatit prej ________ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit-në të kundërtën do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë të caktohet një ditë burgim, deri në maksimumin e lartësisë së dënimit me gjobë i cili mund të zëvendësohet me dënimin me burg, ndërsa pjesa tjetër e dënimit me gjobë e cila nuk mund të zëvendësohet me dënimin me burg, do të zbatohet procedura e përmbarimit të detyruar sipas LPP-së.

Rekomandimi për dënimin unik për të gjitha veprat penale të përfshira në aktakuzë.

Palët në negocimin e marrëveshjes për pranimin fajësisë janë pajtuar që gjykatës t'i propozohet shqiptimi i dënimit unik për të gjitha veprat penale ashtu që do të pandehurit _________________i shqiptohet dënimi unik dënime me burg në kohëzgjatje prej ____vjet në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data___________, e deri në ditën e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej ___________€, i cili do të paguhet brenda afatit prej ______ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit-në të kundërtën do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë të caktohet një ditë burgim, deri në maksimumin e lartësisë së dënimit me gjobë i cili mund të zëvendësohet me dënimin me burg, ndërsa pjesa tjetër e dënimit me gjobë e cila nuk mund të zëvendësohet me dënimin me burg do të zbatohet procedura e përmbarimit të detyruar sipas LPP-së.

Rekomandimi për kompensimin e dëmit material për palën e dëmtuar.

Palët në negocimin e marrëveshjes janë pajtuar që i pandehuri t'i kompensojë të dëmtuarit dëmin material të shkaktuar me veprën penale në lartësi prej ___________€ brenda afatit prej _____ nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Rekomandimi për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Palët në negocimin e marrëveshjes janë pajtuar se dobia pasurore e përfituar me vepër penale përbëhet prej ngastrës kadastrale me nr. ____________ sipas fletës poseduese _____________, KK ___________ dhe një objekti banesor të ndërtuar në këtë ngastër kadastrale e cila gjendet në Lagjen ____________ rruga ______________, nr. _____ me sipërfaqe prej ________m2 dhe kjo pasuri e paluajtshme TË KONFISKOHET, dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit i dorëzohet Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e cila vepron brenda Ministrisë së Drejtësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Mundësia për refuzimin e marrëveshjes,

Palët janë pajtuar që nëse njëra palë dështon në kryerjen e obligimeve të marra sipas kësaj marrëveshje, pala tjetër do të tërhiqet nga marrëveshja dhe çështja do t'i adresohet gjykatës për shqyrtim dhe vend. Nëse prokurori i shtetit vlerëson se i pandehuri ka dhënë informata të rreme, kjo do të konsiderohet si shkelje e marrëveshjes nga i pandehuri.

Palët janë në dijeni se nëse gjykata nuk e pranon këtë marrëveshje, çështja penale do të vazhdohet me shqyrtim dhe vendosja nga gjykata, dhe se asnjë deklaratë që është prezantuar gjatë negocimit të marrëveshjes, nuk do të konsiderohet si provë në shqyrtimin gjyqësor.

Heqja dorë e palëve nga të drejtat e tyre në procedurë.

Palët janë pajtuar se do të heqin dorë nga e drejta për shqyrtim të rregullt gjyqësor si dhe nga e drejta për ankesë ndaj aktgjykimit nëse gjykata pajtohet me rekomandimet për lartësinë e dënimit.

Deklarimi i palëve për ndonjë marrëveshje tjetër dhe në lidhje me kushtet e negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Palët janë pajtuar që kjo marrëveshje si dokument është i vetmi që mund të jetë i pranueshëm dhe nuk do të ketë premtime, kushtëzime apo plotësime të termave tjerë të më vonshme.

I pandehuri e pranon se e kupton natyrën dhe pasojën e pranimit të fajësisë, se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftuara me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova materiale të çështjes të paraqitura në aktakuzë e të cilat nuk i konteston, dhe nuk ka pretendime se në lidhje

me çështjen penale sipas aktakuzës nuk ka ndonjë rrethanë nga neni 253, par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Nënshkrimi i palëve në këtë marrëveshje:

| | |
|---|---|
| **I pandehuri,** | **Mbrojtësi,** |
| ___________________ | ___________________ |

**Vërtetojnë:**

| | |
|---|---|
| **Kryeprokurori,** | **Prokurori i Shtetit,** |
| ___________________ | ___________________ |

P. nr. _______/20___

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PROCESVERBAL NGA SEANCA DËGJIMORE**
**NË LIDHJE ME PRANIMIN E MARRËVESHJE MBI PRANIMIN E FAJËSISË**
**(konform nenit 233 të KPP-së)**

I mbajtur në datë dt. ___. ___. 20__

Përbërja e gjykatës: Në këtë çështje penale konform nenit _____ të KPP-së, Gjykata Themelore e Prishtinës, përbëhet nga gjyqtari individual ____________________.

Procesmbajtëse është ____________________.

Palët në këtë procedurë penale janë:

Paditës: Prokuroria Themelore në Prishtinë

**I akuzuari:**
______________________________

Mbrojtësi i të akuzuarit:
Av. ________________ sipas autorizimit.

I dëmtuari,
______________________________

Përfaqësuesi i të dëmtuarit:
Av. _________________________________

Çështja e cila shqyrtohet në këtë seancë:

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë PP. nr. _______/2011 e dt. ___. ___. 20__, për veprat penale:1. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni _____, par. 2 të KPK-së.

Sipas aktakuzës PP. nr. ______/2011 të dt. ___. ___. 20___

Fillimi i seancës në ora 10:00

Gjyqtari hap seancën dëgjimore, kumton lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e trupit gjykues duke theksuar emrin dhe mbiemrin e gjyqtarëve dhe të procesmbajtëses, dhe i pyet palët se a kanë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues.

Palët nuk kanë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues.

Në bazë të nenit 233, pika 14 të KPP-së, seanca dëgjimore në lidhje me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë është publike.

Gjykata konstaton se në seancën e sotme prezantojnë:

Përfaqësuesi i akuzës, Prokurori i shtetit ____________________________,

I akuzuari _________________ dhe mbrojtësi i tij, Av. _________________.

I dëmtuari _________________ dhe përfaqësuesi i tij, av. _______________.

Ftohet i akuzuari për verifikimin e identitetit të tij.

I akuzuari _________________ me nofkën "_______________" nga i ati __________ dhe nëna _____________________ e gjinisë _________________ i lindur në dt. ______________ në Prishtinë ku edhe jeton, rruga "Lidhja e Prizrenit" nr. _____, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, nuk është i martuar, në gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 0000000000, në paraburgim gjendet nga data 18.1.2013.

Gjyqtari e fton të akuzuarin që me vëmendje të përcjellë zbatimin e seancës dëgjimore dhe e udhëzon se mund të refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë para se gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, e njofton se në rast se marrëveshja nuk pranohet nga gjykata - deklarata e të akuzuarit e dhënë në takimin paraprak të mbajtur për të negociuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, do të konsiderohen të pa pranueshme si dëshmi gjatë shqyrtimit kryesor ose në ndonjë procedurë tjetër.

Gjyqtari e udhëzon të dëmtuarin se ka të drejtë që të paraqes deklaratë mbi kërkesën pasurore juridike para se gjykata t'i shqiptojë dënimin të pandehurit sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Ftohet prokurori publik që të deklarohet (të prezantoi pikëpamjet e tij) në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë, sipas aktakuzës me numër si më lartë.

Prokurori i shtetit deklaron:

Do të doja që në këtë seancë të paraqes Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP. nr. _______/20___ në dt. ___. ___. 20___ që e kemi arritur me tani të akuzuarin dhe me mbrojtësin e tij.

Paraqes këtë marrëveshje dhe me respekt kërkoj nga gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ashtu sikurse është pranuar nga palët e të cilën e kemi prezantuar.

Ftohet i dëmtuari që të paraqet deklaratë lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, av. __________________, deklaron se paraqesin kërkesë pasurore juridike të cilën do ta realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

Ftohet i akuzuari që të deklarohet në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë PP. nr. ______/20____.

I akuzuari _________________ deklaron: Mbetem pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të dt ____. ____. 20___ dhe nuk kam diçka për të shtuar.

Ftohet mbrojtësi i të akuzuarit që të paraqet (të prezantoi pikëpamjet e tijë) në lidhje me marrëveshjen e negociuar mbi pranimin e fajësisë sipas aktakuzës me numër si më lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. _______________ deklaron: E mbështes deklarimin e të mbrojturit tim në lidhje me marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë. I mbrojturi im është i vetëdijshëm lidhur me atë çka ka pranuar, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës janë të pranueshme dhe për këtë i mbrojturi im është në dijeni. Prandaj i propozoj gjykatës që të pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Në bazë të nenit 233, pika 18 të KPP-së, gjykata përcakton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftuara me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të çështjes penale e cila shqyrtohet e të cilat i përfshinë aktakuza, dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë në nenin 253, të KPP-së.

Kjo gjykatë, është e bindur SE JANË PLOTËSUAR të gjitha kushtet e parapara në nenin 233, pika 18 të KPP-së, prandaj konform nenit 233, pika 21 të KPP-së, merr këtë:

**AKTVENDIM**

PRANOHET MARRËVESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË PP. NR. _________/20___ e dt. ____. ____. 20___.

KJO MARRËVESHJE DO TË VENDOSET NË SHKRESAT E LËNDËS DHE ËSHTË PJESË PËRBËRESE E SHKRESAVE TË LËNDËS P. nr. ______/20____

**Gjykata cakton dt. ____. ____. 20__ kur palët do të prezantojnë deklaratat e tyre në lidhje me dënimin**

Seanca dëgjimore publike në këtë çështje penale vazhdon me deklarimet e palëve në lidhje me dënimin.

Ftohet përfaqësuesi i akuzës që të deklarohet në lidhje me dënimin.

Prokurori i shtetit deklaron: Mbetem pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin sikurse është evidentuar në këtë marrëveshje.

Ftohet mbrojtësi i të akuzuarit Av. ____________________ që të deklarohet në lidhje me dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. ________________, deklaron: Faktet e prezantuara nga prokuroria qëndrojnë, dhe mbështes marrëveshjen për pranimin e fajësisë edhe për sa i përket dënimit ndaj të mbrojturit tim.

Ftohet i akuzuari _________________ që të deklarohet në lidhje me dënimin.

I akuzuari ___________________ deklaron: Mbetem në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Palët nuk kanë diçka tjetër për të shtuar.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se seanca dëgjimore publike në lidhje me Marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka përfunduar dhe i paralajmëron palët se vendimi do të shpallet të njëjtën ditë, në ora 11:00

Seanca përfundoi në ora 10:40

**Vërtetojnë,**

**Procesmbajtësja,** **Gjyqtari,**

______________ __________________

**Aktgjykimi i cili mund të merret pasi që Gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë (neni 229, par. 2 të KPK-së)**

Pas përfundimit të seancës për Pranimin e Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, PP. nr. _____/20___ të dt. __. __. 20__ për shkak të veprave penale: 1. Blerja, Posedimi dhe Shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e Narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229, par. 2 të KPK-së gjykata në dt. ___. ____. 20___ mori dhe publikisht shpalli këtë:

**NË EMËR TË POPULLIT**
**AKTGJYKIM**

I

I akuzuari _______________, me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

1. Me qellim që vetes t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, pa autorizim ka mbajtur dhe shitur narkotik të llojit Marihuana, ashtu që në dt. 18.1.2011 rreth orës 16:00, në Prishtinë, te Stadiumi i qytetit, policia ka ndaluar tani të akuzuarin ___________________ dhe me rastin e kontrollimit, në trupin e tij, kanë gjetur substanca narkotike të llojit Marihuanë në peshë prej 90 gram e paketuar në 43 qese të najlonit dhe me rastin e kontrollimit të shtëpisë së tani të akuzuarit, policia ka gjetur edhe 1057 gram substancë narkotike po ashtu e llojit Marihuanë e që sasia e përgjithshme e substancave narkotike e gjetur dhe sekuestruar te tani i akuzuari ______________ është 1147 gram (njëmijë e njëqind e dyzet e shtatë gram).

- me këtë, ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e Narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni ____, par. ___ të KPK-së,

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të nenit ______________, par. 2 nën par. ___________, par. ___ KP të RK-së, nenit ______, pika _____ të KPP-së, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP: nr. ____/20___ të dt. ___. ___. 20___, të akuzuarin _______________ e gjykon me:

**DËNIM ME BURG DHE DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarit _______________, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej një (1)) vjet të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe dënimin me

gjobë në lartësi prej njëmijë euro (1.000,00 €) të cilin do ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në dënimin me burg të shqiptuar, të akuzuarit, i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data ___.___.20___ e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit _________________.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit të caktuar, ky dënim do të inkasohet në procedurë të përmbarimit të detyruar.

Nga i akuzuari _________________konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë në peshë prej njëmijë e njëqind e dyzetë e shtatë gram (1.147 gr.).

Obligohet i akuzuari _______________- që të kompensojë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 100,00 € (njëqind euro) brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

| |
|---|
| Kur ka të dëmtuar:<br>I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil. |

Në bazë të nenit ________ par. 1 dhe par. 2 nën paragrafi ______ dhe nenit _______, par. 5, të KP të RK-së, si dhe të nenit ______ të KPP-së, kjo gjykatë merr këtë:

**AKTVENDIM**

Ndaj tani të akuzuarit __________________, vazhdohet paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit P. nr. ______/20___ të dt. __. __. 20__ deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se koha e dënimit e shqiptuar në aktgjykimin e shkallës së parë.

Koha e kaluar në paraburgim sipas këtij vendimi, të akuzuarit i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Arsyetimi i shkurtër për vazhdimin e paraburgimit:

Kjo gjykatë konsideron se ekziston rreziku që sikur tani i akuzuari të gjendej në liri do të përsëriste veprën penale për të cilën është akuzuar.

Sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, palët janë pajtuar që ndaj tani të akuzuarit ___________________ pas shpalljes së aktgjykimit mos të ndërpritet paraburgimi.

**Vërtetojnë,**

**Procesmbajtësja,** **Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,**

_______________ _______________________________

PKR. Nr. _______/2015

## Shpallja e aktgjykimit

Gjykata konstaton se aktgjykimi P. nr. _______ /20___ i dt. ___. ___. 20___, është shpallur publikisht në dt. _________, në ora _________, në prezencë të ___________ ________________________________________.

Pas shpalljes së aktgjykimit, kryetari i trupit gjykues ka paraqitur arsyetimin e shkurtër.

Kryetari i trupit gjykues i ka udhëzuar palët për të drejtën në ankesë.

**Vërtetojnë,**

**Procesmbajtësja,** **Gjyqtari,**

______________ __________________

**Procedura për shpalljen e personit dëshmitar bashkëpunues**
**(Neni 236 i KPP-së)**

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
P. P. Nr.
Datë, 24. 01. 2016

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

Në bazë të nenit 236, par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit, me rastin e vendosjes në lidhje me procedimin në çështjen penale të tani të pandehurit N. N. për shkak të veprës penale:___________________, nga neni_______, të KP të RKS-së, më datën 24.1.2016 paraqet

**KËRKESË PËR SHPALLJEN E PERSONIT DËSHMITAR BASHKËPUNUES**

Prokurori i shtetit kërkon nga gjykata që i pandehuri __________________me numër personal____________________________, të shpallet dëshmitar bashkëpunues për arsye se:

1. Ka gjasa se dëshmia e të pandehurit të parandalojë vepra tjera penale nga personi tjetër,
2. Ka gjasa se dëshmia e të pandehurit do të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurë penale, dhe
3. Ka gjasa se dëshmia e të pandehurit do të shpie drejtë ndjekjes së suksesshme të kryerësve të tjerë të veprës penale.

**Arsyetim**

Në çështjen penale të tani të pandehurit _______________________, prokurori i shtetit ka ndërmarrë veprimet hetimore dhe mbi bazën e deklarimeve të deritanishme të tani të pandehurit ka ardhur në përfundim se shpallja e tani të pandehurit dëshmitar bashkëpunues, është në interes të procedimit të drejtë të çështjes dhe në interes të drejtësisë sepse i pandehuri ka mundësi që të prezantojë dëshmi se persona të tjerë mund të kryejnë vepra penale, dëshmi për zbardhjen e të vërtetës në procedurën penale, përkatësisht se dëshmia e këtij të pandehuri do të shpie drejtë ndjekjes së kryerësve të tjerë të veprës penale.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**

______________________

**Procedura për ngritjen e aktakuzës**
**(neni 240, 241, dhe 242 të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
PROKURORI I SHTETIT
PROKURORIA THEMELORE E PRISHTINËS
- Departamenti për Krime të Rënda -
PP. nr. _______. 2016
Datë 09. 02. 2016

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**

Në bazë të nenit 240, 241 dhe 242 të KPP-së, ngritet:

**A K T A K U Z Ë**

Kundër të pandehurit (ose të pandehurve):

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri | |
| Emri dhe mbiemri i babës | |
| Emri i nënës-mbiemri i vajzërisë | |
| Numri personal i identifikimit | |
| Kombësia | |
| Nënshtetësia | |
| Data e lindjes | |
| Vendlindja, Komuna, Shteti | |
| Statusi familjar | |
| Përgatitja profesionale-niveli i arsimit | |
| Profesioni | |
| Të ardhurat personale ose të ardhura tjera | |
| Gjendja ekonomike | |
| E kaluara kriminale-procedura tjera penale | |
| Numri i telefonit | |
| E mail adresa | |

Sepse:
Në datën _______________________ në Prishtinë - duke vepruar në cilësinë e personit zyrtar,_____________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

______________________________________________________________________
___________________________________________________________,

- me çka ka kryer (apo në bashkëveprim kanë kryer) veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 (nëse është në bashkëveprim edhe lidhur me nenin 31) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prandaj, i propozohet gjykatës që të caktojë shqyrtimin gjyqësor-duke filluar me shqyrtimin fillestar, ku do të ftohen:

1. Prokuroria Themelore e Prishtinës-Departamenti për Krime të Rënda duke u thirrut në numrin e aktakuzës si më lartë,
2. Palën e dëmtuar në këtë çështje penale, ______________________.
3. Të pandehurin – në adresën e theksuar më lartë, dhe mbrojtësin e tij av. _________________________.
4. Dëshmitarët:

| Nr. rend | Emri dhe mbiemri | Adresa e vendbanimit-numri i telefonit |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |

Të lexohen provat materiale të bashkëngjitura në 4 dosje, të evidentuara me nr. prej 1-4:

Dosja 1.

| Nr. rendor | Emërtimi i dokumentit dhe nga kush është krijuar-data |
|---|---|
| | |

Dosja 2.

| Nr. rendor | Emërtimi i dokumentit dhe nga kush është krijuar-data |
|---|---|
| | |

Prokurori i Shtetit, me këtë aktakuzë:

Propozon që:

1. Ndaj tani të pandehurit i cili gjendet në paraburgim, të vazhdohet masa e paraburgimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor,

2. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe njëherësh gjykata të obligojë të pandehurit që të dëmtuarës t'i kompensojë dëmin material të shkaktuar me vepër penale në lartësi prej___________€ brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar, si dhe

3. Të konfiskohet dobia pasurore të cilën i pandehuri e ka realizuar si rezultat i veprës penale të kryer e cila përbëhet prej:

    3.1. Një ngastre kadastrale me sipërfaqe prej 01.50,11 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese me nr. _________KK Prishtinë, dhe

    3.2. Një shtëpie për banim me sipërfaqe prej ______m2, si dhe ngastra kadastrale me sipërfaqe prej 00,05,00 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese me nr. _______KK Prishtinë në të cilën është ndërtuar kjo shtëpi.

Prokurori i shtetit e njofton gjykatën se ka përmbush obligimin ndaj të pandehurit (të pandehurve) dhe mbrojtësve, konform nenit 244 të KPP-së.

**Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda më datën _______________ ka autorizuar Policinë e Kosovës-Drejtorinë për Hetimin e Korrupsionit DHKEK në Prishtinë për ndërmarrjen e veprimeve hetimore.

Policia e Kosovës - Drejtoria për Hetimin e Korrupsionit DHKEK në Prishtinë, në datën ___________________, ka dorëzuar në Prokurorinë Themelore të Prishtinës kallëzimin penal me shenjën _________________________, kundër tani të pandehurit (ose të pandehurve).

Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktvendimit PP. nr. _______________/2015, ka filluar hetimet kundër tani të pandehurit (ose të pandehurve) në drejtim të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 (nëse është në bashkëveprim edhe lidhur me nenin 31) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Aktvendimi për fillimin e hetimeve kundër tani të pandehurit (ose të pandehurve) është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamentit për Krime të Rënda - përkatësisht gjyqtarit të procedurës paraprake në datën ________________2015.

Gjatë fazës së hetimeve janë siguruar këto prova materiale:

***Specifikohen të gjitha provat materiale me përshkrimin se çka vërtetohet me këto prova materiale dhe arsyetimin se si janë siguruar këto prova dhe përse janë të pranueshme.***

Gjatë fazës së hetimeve nga prokurori janë dëgjuar edhe dëshmitarët, deklaratat të cilëve i bashkëngjiten kësaj aktakuze.

Dëshmitari _______________________ në datën ________________, para prokurorit të shtetit dhe në prezencë të ___________________________ veç tjerash ka deklaruar se:

***Në arsyetim të aktakuzës prezantohen deklarimet e dëshmitarëve në versionin origjinal- ashtu sikurse janë thënë dhe arsyetimin e prokurorit të shtetit përse kjo***

***deklaratë është me relevancë për vërtetimin e gjendjes faktike përkatësisht për të vërtetuar përgjegjësinë penale të tani të pandehurit.***

***Nëse ka kontradikta në deklarime të dëshmitarëve, duhet të elaborohen këto kontradikta dhe prokurori të shpjegojë se cila deklaratë ka më shumë rëndësi dhe përse duhet t'i falet besimi.***

Sa i përket kërkesës pasurore-juridike dhe konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, apo që është rezultat i veprës penale:

***Prokurori i shtetit në aktakuzë përfshinë edhe kërkesën pasurore-juridike të dëmtuarit me arsyetimin se përse gjykata duhet ta aprovojë këtë kërkesë, si dhe paraqet propozimin me arsyet përse gjykata duhet të vendos për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.***

***Dhe në fund të arsyetimit të aktakuzës, prokurori i shteti arsyeton kërkesën për vazhdimin - përkatësisht caktimin-e paraburgimit ndaj të pandehurit ose të pandehurve.***

**Prokuroria Themelore**
**në Prishtinë,**
**Prokurori**

______________________

**Shqyrtimi fillestar**
**(neni 245, 246 dhe 248 i KPP-së)**

***Procedimi i çështjes penale në seancën fillestare kur i pandehuri e pranon fajësinë dhe gjyqtari konstaton se janë plotësuar kushtet për pranimin e fajësisë.***

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. Nr. _______/2016**

## PROCESVERBAL

Nga shqyrtimi fillestar i mbajtur në datën ____________ 2016

Përbërja e gjykatës: nga kryetari i trupit gjykues-gjyqtari ____________________, në seancë fillestare si gjyqtar individual.

Procesmbajtës: Zyrtari ligjor ____________________________.

Prezantojnë:

1. Prokurori i Shtetit: _____________________________________,

2. I pandehuri, _________________________________________,

3. Mbrojtësi i të pandehurit av. ______________________________.

*(shprehimisht nuk është e ndaluar prezenca e të dëmtuarit, prandaj nëse është ftuar i dëmtuari konstatohet edhe prezenca e të dëmtuarit)*

Palët njoftohen me përbërjen e gjykatës dhe pyetën se a kanë vërejtje.

Palët nuk kanë vërejtje në përbërje të gjykatës.

**Objekt i shqyrtimit është aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me shenjën PP. nr. _____________/2015**

Gjyqtari verifikon të dhënat personale të pandehurit –sipas aktakuzës pa ndryshime dhe plotësime.

Konform nenit 246, par. 1 të KPP-së gjyqtari e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në lidhje me çështjen penale-përkatësisht që të mos përgjigjet në pyetje, dhe nëse deklarohet për këtë çështje nuk ka për detyrë që të inkriminojë vetveten ose të afërmit, as që të pranojë fajësinë, se ka të drejtë që të mbrojtjen ta

paraqet vet ose nëpërmes të ndihmës juridike të paraqitur nga mbrojtësi i tij, të kundërshtoi aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Gjyqtari konstaton se e drejta e prokurorit në mbrojtje është respektuar dhe se prokurori ka përmbush detyrimet konform nenit 244 të KPP-së.

Gjyqtari e fton prokurorin e shtetit që të lexoi aktakuzën.

Prokurori i shtetit ____________________ lexoi aktakuzën PP. nr. ___________ 2015.

Gjyqtari e fton të pandehurin _________________________ që të deklarohet se a e kupton aktakuzën dhe a ka nevojë që prokurori i shtetit të shpjegoi aktakuzën.

I pandehuri___________________________, deklaron se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe se nuk ka nevojë për shpjegime shtesë.
***(nëse ka më shumë të pandehur në një çështje penale të gjithë të pandehurit duhet të ftohen individualisht që të deklarohen se a e kanë kuptuar aktakuzën dhe a kanë nevojë për shpjegime shtesë)***

Gjyqtari konstaton se i pandehuri ______________________________, e ka kuptuar aktakuzën dhe e fton që të deklarohet se e pranon ose jë fajësinë.

Në këtë fazë të procedimit - pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata mund të gjendet në dy situata gjatë shqyrtimit të çështjes në seancën fillestare:

I pandehuri____________________________________, deklaron se e pranon fajësinë sipas aktakuzës (nëse ka më shumë pika të aktakuzës konstatohet se për cilat pika e pranon fajësinë).

Gjyqtari e pyet të pandehurin _______________________ se a e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, se ky pranim a është vullnetar dhe a është konsultuar me mbrojtësin e tij para se të deklarohej për pranimin e fajësisë dhe se a ka nevojë për konsultime shtesë.

I pandehuri deklaron se e kuptoi natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë dhe se paraprakisht jam konsultuar me mbrojtësin tim.

Gjykata e pyet mbrojtësin e të pandehurit se a ka ndonjë koment në lidhje me deklarimin e të mbrojturit të tij-tani të pandehurit ___________________________ për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaron (*shënohet deklarata e mbrojtësit*).

Gjykata e fton prokurorin e shtetit që të deklarohet në lidhje me pranimin e fajësisë nga tani i pandehuri ___________________________________.

Prokurori i shtetit deklaron (shënohet deklarata e prokurorit të shtetit).
*(Nëse në seancë fillestare prezanton i dëmtuari gjyqtari do të kërkoi edhe mendimin e të dëmtuarit në lidhje me deklarimin e të pandehurit për pranimin e fajësisë)*

Në bazë të nenit 248, par. 1 nën paragrafi 1. 1 deri 1. 4, të KPP-së gjyqtari,

Përcakton se:

- tani i pandehuri ______________________________, e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,

- pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftuara me mbrojtësin e tij,

- pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe dëshmitë e dëshmitarëve të paraqitur nga prokurori,

- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, dhe

- nuk ka asnjë rrethanë nga neni 250, par. 1 nën paragrafi 1.1 deri 1.4 të KPP-së që e ndalon ndjekjen penale.

Në bazë të nenit 248, par. 4 të KPP-së, gjyqtari merr këtë:

**A K T V E N D I M**

PRANOHET pranimi i fajësisë nga i pandehuri ______________________________ për shkak të veprës penale _______________________________ nga neni _______________, të KPP-së.

Shqyrtimi fillestar vazhdon me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari cakton datën_________________________, për shqiptimin e dënimit dhe për shpalljen e aktgjykimit në këtë çështje penale.

**Vërtetojnë,**

**Zyrtari ligjor,**
__________________

**Gjyqtari individual,**
________________________

**Prokurori i shtetit,**
_________________

**I dëmtuari,**
___________________

**I pandehuri,**
__________________

**Mbrojtësi i të pandehurit,**
________________________

**Marrja e vendimit për dënimin gjatë shqyrtimit fillestar kur i pandehuri e ka pranuar fajësinë.**
**(Neni 248 par. 4 i KPP-së)**

PKR. Nr. ____________/2015
Datë____________2015
Në bazë të nenit _____________________________të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nenit__________________, të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari gjatë shqyrtimit fillestar në datën_____, merr këtë:

**A K T GJ Y K I M**

Ndaj të pandehurit _______________________________, me të dhëna personale si në shkresa të lëndës, i cili në seancën fillestare të mbajtur në datën _______________, ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni ________________________, sepse: "shënohet dispozitivi i aktakuzës"

Shqiptohet,

**Dënimi kryesor**
**Dënim me burg**

Ashtu që gjykata i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej __________ vjet, të cilin do ta mbaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri______________________________, është i obliguar që të dëmtuarit ____________________ti kompensoi dëmin material dhe jo material të shkaktuar me vepër penale në lartësi prej __________€, brenda afatit prej ___________ nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Ndaj të pandehurit ______________________________, shqiptohet edhe,

**Dënimi plotësues**
**- konfiskim i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale -**

Ashtu që nga i pandehuri ______________________________ konfiskohet dobia pasurore e përfituar me vepër penale-përkatësish dobia pasurore e cila është rezultat i veprës penale e cila përbëhet prej: (*shënohet dobia pasurore e cila konfiskohet*).

Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar për administrimin me këtë pasuri.

Obligohet i pandehuri __________________________ që të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej __________€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 200,00 €, brenda afatit prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Në bazë të nenit ________________të KPP-së, gjyqtari merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Ndaj të pandehurit __________________________, pas shpalljes së aktgjykimit P. nr. ______________ me të cilin i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej _________ vjet, VAZHDOHET PARABURGIMI nga data e shpalljes së aktgjykimit e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.
*(në alternativë: nëse i pandehuri në ditën e shpalljes së aktgjykimit gjendet në paraburgim dhe gjyqtari konstaton se kanë pushuar arsyet dhe shkaqet për të cilat i ishte caktuar masa e paraburgimit, merr aktvendim për ndërprerje të paraburgimit dhe urdhëron lirimin e të pandehurit menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit)*

**Vërtetojnë,**

**Zyrtari ligjor,** **Gjyqtari individual,**

_________________ ______________________

**Shpallja e aktgjykimit**
**(në fazën e shqyrtimit fillestar-konform nenit 366 të KPP-së)**

Gjyqtari konstaton se aktgjykimi PKR. Nr. _________/2015 i datës_____________, është_____, shpall publikisht në datën_________________2015, në prani të palëve.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjyqtari ka prezantuar arsyetimin e shkurtër dhe palët janë njoftuar për të drejtën në ankesë.

**Vërtetojnë,**

**Zyrtari ligjor,** **Gjyqtari,**

__________________ ________________________

**Shqyrtimi fillestar**
**(neni 245, 246 dhe 248 i KPP-së)**

***Procedimi i çështjes penale në seancën fillestare kur i pandehuri nuk e pranon fajësinë***

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. Nr. _______/2016**

## PROCESVERBAL

Nga shqyrtimi fillestar i mbajtur në datën ____________ 2016

Përbërja e gjykatës: nga kryetari i trupit gjykues-gjyqtari _____________________, në seancë fillestare si gjyqtar individual.

Procesmbajtës: zyrtari ligjor ____________________________.

Prezantojnë:

1. Prokurori i Shtetit:_____________________________________,
2. I pandehuri, __________________________________________,
3. Mbrojtësi i të pandehurit, av. ______________________________.

*(shprehimisht nuk është e ndaluar prezenca e të dëmtuarit, prandaj nëse është ftuar i dëmtuari konstatohet edhe prezenca e të dëmtuarit)*

Palët njoftohen me përbërjen e gjykatës dhe pyetën se a kanë vërejtje.

Palët nuk kanë vërejtje në përbërje të gjykatës.

**Objekt i shqyrtimit është aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me shenjën PP. nr. _____________/2015**

Gjyqtari verifikon të dhënat personale të pandehurit - sipas aktakuzës pa ndryshime dhe plotësime.

Konform nenit 246, par. 1 të KPP-së gjyqtari e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në lidhje me çështjen penale-përkatësisht që të mos përgjigjet në pyetje, dhe nëse deklarohet për këtë çështje nuk ka për detyrë që të inkriminojë vetveten ose të afërmit, as që të pranoi fajësinë, se ka të drejtë që të mbrojtjen ta

paraqet vet ose nëpërmes të ndihmës juridike të paraqitur nga mbrojtësi i tij, të kundërshtoi aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Gjyqtari konstaton se e drejta e prokurorit në mbrojtje është respektuar dhe se prokurori ka përmbush detyrimet konform nenit 244 të KPP-së.

Gjyqtari e fton prokurorin e shtetit që të lexojë aktakuzën.

Prokurori i shtetit __________________, e lexoi aktakuzën, PP. nr. ____________ 2015.

Gjyqtari e fton të pandehurin __________________________ që të deklarohet se a e kupton aktakuzën dhe a ka nevojë që prokurori i shtetit të shpjegojë aktakuzën.

I pandehuri ______________________________, deklaron se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe se nuk ka nevojë për shpjegime shtesë.

***(nëse ka më shumë të pandehur në një çështje penale të gjithë të pandehurit duhet të ftohen individualisht që të deklarohen se a e kanë kuptuar aktakuzën dhe a kanë nevojë për shpjegime shtesë)***

Gjyqtari konstaton se i pandehuri ______________________________, e ka kuptuar aktakuzën dhe e fton që të deklarohet se e pranon ose jo fajësinë.

I pandehuri deklaron se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Konform nenit 245, par. 6 të KPP-së gjyqtari e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin e tij se para shqyrtimit të dytë mund të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesin kërkesën për hedhjen e aktakuzës nëse konsiderojnë se aktakuza është e ndaluar ligjërisht ose për shkak të mos përshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Afati për dorëzimin e kundërshtimeve është 30 ditë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale.

Lidhur me caktimin e shqyrtimit të dytë do të vendoset pas pranimit të kundërshtimeve të palëve ndaj provave apo të kërkesës për hedhjen e aktakuzës.

Në bazë të nenit 193, par. 1 të KPP-së, dhe sipas propozimit të prokurorit të shtetit për vazhdimin e masës së sigurisë ndaj tani të pandehurit _____________________, ndaj të cilit sipas vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake me shenjën GJPP. Nr. _________/2015, i është caktuar masa e paraburgimit, gjyqtari në këtë shqyrtim fillestar merr këtë:

**AKTVENDIM**

Ndaj të pandehurit __________________________ me të dhëna personale sikurse në shkresat e lëndës, VAZHDOHET masa e sigurisë për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin gjyqësor me PARABURGIM në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, duke filluar nga data ______________ e deri në datën ______________.

Gjykata në çdo 2 muaj do të shqyrtojë nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe do të marrë aktvendim për heqje ose vazhdim të paraburgimit.

Shqyrtimi fillestar përfundoi në ora ___________.

**Vërtetojnë,**

**Zyrtari ligjor,** ___________________

**Gjyqtari,** ________________________

**Prokurori i shtetit,** ___________________

**I dëmtuari,** ___________________

**I pandehuri,** ___________________

**Mbrojtësi i të pandehurit,** ________________________

**Vendimi lidhur me kërkesën për hedhjen e aktakuzës**
**(Neni 250, par. 3, të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues N. N me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit A. A. i akuzuar sipas aktakuzës PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale ________________________, nga neni __________, par. ____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së të pandehurit (ose mbrojtësit të pandehurit), për hedhjen e aktakuzës, në datën ____________, merr këtë:

## AKTVENDIM

REFUZOHET kërkesa e të pandehurit ____________________________, për hedhjen e aktakuzës me shenjën PS______________2015, të datës___________2015, si e pa bazuar.

Në këtë çështje penale, do të vazhdohet me procedimin sipas kësaj aktakuze.

## Arsyetim

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës sipas aktakuzës PS. Nr. ___________ 2015, e ka akuzuar tani të pandehurit _____________________________ për shkak të veprës penale:_________________________________, nga neni __________, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri i lartpërmendur, para shqyrtimit të dytë, ka kërkuar hedhjen e aktakuzës bazuar në nenit 250, par. 1 nën paragrafi 1.3 të KP të RK-së, me arsyetimin se ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Konform nenit 250, par. 2 të KPP-së, gjykata i ka dhënë mundësinë prokurorit të shtetit që të përgjigjet në lidhje me kërkesën e të pandehurit për hedhje të aktakuzës.

Prokurori i shtetit me parashtresën e datës _______________ ka dhënë mendimin se kërkesa e të pandehurit nuk është e bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet sepse nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në ngritjen e aktakuzës, përkatësisht brenda afatit të parashkrimit relativ e që në këtë rast është 2 vjet nga dita e kryerjes së veprës penale janë ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të ndjekjes penale dhe nuk ka parashkrim relativ e as absolut të ndjekjes penale.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për hedhje të aktakuzës konstatoi se kërkesa e të pandehurit është e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Sipas shkresave të lëndës, përkatësisht kallëzimit penal, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbaleve për marrje në pyetje të tani të pandehurit dhe aktakuzës, vërtetohet se kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën sanksioni penal është i paraparë dënim me burg deri në _____ vjet.

Parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit __________ të KP të RK-së për vepër penale është ____ vjet nga koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa parashkrimi absolut, në bazë të nenit ___________ të KP të RK-së është ______ vite nga dita e kryerjes së veprës penale.

Prandaj, në bazë të nenit 250, par. 3 të KPP-së, gjykata vendosi që të refuzojë kërkesën e të pandehurit për hedhjen e aktakuzës për arsyet e theksuara më lartë.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Kryetari i trupit gjykues,**
**gjyqtari**

__________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi i pandehuri mund të ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.

**Aktvendim për shpalljen e provës si të pa pranueshme**
**(neni 249 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues N. N me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit A. A. i akuzuar sipas aktakuzës PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale ________________________nga neni__________, par. ____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së mbrojtësit të pandehurit, av.______________, për papranueshmëri të provës, në datën____, merr këtë:

## AKTVENDIM

APROVOHET kërkesa e mbrojtësi të tani të pandehurit________________, av. _______________, për papranueshmëri të provës ashtu që deklarimi i të pandehurit në polici në procesverbalin me shenjën:_____________________ shpallet provë e papranueshme sepse është marrë në kundërshtim me nenin 73, par. 1 të KPP-së.

Kjo deklaratë do të mbyllet dhe do të veçohet nga shkresat e lëndës dhe mund të shqyrtohet vetëm në procedurë sipas ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.

## Arsyetim

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës sipas aktakuzës PS. Nr. ___________ 2015, e ka akuzuar tani të pandehurit _______________________________ për shkak të veprës penale: ______________________________________, nga neni __________ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Mbrojtësi i të pandehurit të lartpërmendur, para shqyrtimit të dytë, ka kërkuar shpalljen e deklaratës së të pandehurit të dhënë në polici në procesverbalin me shenjën _________________ dt. ____________ me arsyetimin se kjo deklaratë nuk mund të pranohet si provë sepse është marrë në kundërshtim me nenin 73, par. 1 të KPP-së

Konform nenit 249, par. 2 të KPP-së gjykata i ka dhënë mundësinë prokurorit të shtetit që të përgjigjet në lidhje me kërkesën e të pandehurit për shpalljen e provës si të papranueshme.

Prokurori i shtetit me parashtresën e datës _______________ ka dhënë mendimin se kërkesa e mbrojtësit të pandehurit nuk është e bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet sepse me rastin e marrjes së deklaratës nga i pandehuri në datën ____________, policia ka vepruar konform nenit 73, par. 1 të KPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për shpalljen e deklaratës së të pandehurit të dhënë në polici sipas procesverbalit ____________________ konstatoi se kërkesa e mbrojtësit të pandehurit është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas procesverbalit me shenjën _________________ të datës ____________, rezulton se deklarata e tani të pandehurit _________________, nuk është marrë në pajtim me nenin 73, par. 1 lidhur me nenin 92, të KPP-së sepse hetimi i fshehtë në kohën e zhvillimit të bisedës me të pandehurin nuk ishte autorizuar.

Në bazë të nenit 249, par. 4 të KPP-së provat e papranueshme mbyllen dhe veçohen nga shkresat e lëndës

Prandaj, në bazë të nenit 249 par. 3 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Kryetari i trupit gjykues,**
**gjyqtari**

_________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr. _________ 2016

**PROCESVERBAL**
**NGA SHQYRTIMI I DYTË**
**Mbajtur në datën_________2016**

Përbërja e gjykatës: Gjyqtari individual-kryetari i trupit gjykues, __________________

Procesmbajtës: zyrtari ligjor-procesmbajtës, ___________________________________

Prezantojnë: Prokurori i shtetit ___________________________________

I pandehuri ________________________________________

Mbrojtësi i të pandehurit-av. __________________________

Filloi në ora: ___________.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se mbrojtësi i të pandehurit nuk është deklaruar se ka pretendime për të paraqitur prova në lidhje me nenin 256, par. 1 nën paragrafi 1 deri 3 të KPP-së.

Kryetari i trupit gjykues i njofton palët se mbrojtësi i të pandehurit ka paraqitur kërkesë për hedhje të aktakuzës me arsyetimin se ndjekja penale për veprën penale për të cilën është ushtruar kjo aktakuzë nuk mund të ndërmerret më tutje për shkak se ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes.

Prokurori i shtetit është deklaruar në lidhje me parashtresën e mbrojtësit të pandehurit dhe i ka propozuar gjykatës që ta refuzoi kërkesën.

Kryetari i trupit gjykues, në bazë të nenit 254, par. 3 të KPP-së merr këtë:

**AKTVENDIM**

APROVOHET kërkesa e të pandehurit ____________________________, për hedhjen e aktakuzës, ashtu që HEDHET aktakuza me shenjën PS ________________ 2015, të datës ___________ 2015.

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit të lartpërmendur në drejtim të veprës penale _____________________ për shkak se ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

I dëmtuari __________________________, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga shpenzimet publike.

Përfundoi në ora ____________.

**Vërtetojnë,**

**Procesmbajtësi,**

___________________

**Gjyqtari individual-**
**kryetari i trupit gjykues,**

______________________

**Prokurori i shtetit,**

___________________

**Mbrojtësi i të pandehurit,**

_______________________

**I pandehuri,**

______________________

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues N. N me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit A. A. i akuzuar sipas aktakuzës PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale ____________________________, nga neni _________, par. ______ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së të pandehurit (ose mbrojtësit të pandehurit) për hedhjen e aktakuzës, në datën _________, merr këtë:

**AKTVENDIM**

APROVOHET kërkesa e të pandehurit _____________________________, për hedhjen e aktakuzës, ashtu që HEDHET aktakuza me shenjën PS _________________2015, të datës ___________ 2015.

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit të lartpërmendur në drejtim të veprës penale ___________________________ për shkak se ka kaluara afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

I dëmtuari ___________________________, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga shpenzimet publike.

**Arsyetim**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës sipas aktakuzës PS. Nr. ___________ 2015, e ka akuzuar tani të pandehurit _______________________________ për shkak të veprës penale: ______________________________________, nga neni __________ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri i lartpërmendur, para shqyrtimit të dytë, ka kërkuar hedhjen e aktakuzës bazuar në nenit 250, par. 1 nën paragrafi 1. 3, të KP të RK-së me arsyetimin se ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Konform nenit 250, par. 2 të KPP-së gjykata i ka dhënë mundësinë prokurorit të shtetit që të përgjigjet në lidhje me kërkesën e të pandehurit për hedhje të aktakuzës.

Prokurori i shtetit me parashtresën e datës ________________, ka dhënë mendimin se kërkesa e të pandehurit nuk është e bazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet sepse nga koha e kryerjes së veprës penale e deri në ngritjen e aktakuzës, përkatësisht brenda

afatit të parashkrimit relativ e që në këtë rast është 3 vjet nga dita e kryerjes së veprës penale janë ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të ndjekjes penale dhe nuk ka parashkrim relativ e as absolut të ndjekjes penale.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për hedhje të aktakuzës konstatoi se kërkesa e të pandehurit është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Sipas shkresave të lëndës, përkatësisht kallëzimit penal, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbaleve për marrje në pyetje të tani të pandehurit dhe aktakuzës, vërtetohet se kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën sanksioni penal është i paraparë dënim me burg deri në _______ vjet.

Parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit ___________ të KP të RK-së, për vepër penale është _____ vjet nga koha e kryerjes së veprës penale, ndërsa parashkrimi absolut, në bazë të nenit ___________ ë KP të RK-së është ______ vite nga dita e kryerjes së veprës penale.

Nga sa u tha më sipër rezulton se në këtë çështje deri më tani nuk ka arrit parashkrimi i ndjekjes penale.

Prandaj, në bazë të nenit 250, par. 3 të KPP-së gjykata vendosi që të refuzojë kërkesën e të pandehurit për hedhjen e aktakuzës për arsyet e theksuara më lartë.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Kryetari i trupit gjykues,**
**gjyqtari**

__________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr. _________2016

**PROCESVERBAL**
**NGA SHQYRTIMI PËR PËRCAKTIMIN E VLEFSHMËRISË SË PROPOZIMEVE**
**Mbajtur në datën_________2016**

Përbërja e gjykatës: Gjyqtari individual-kryetari i trupit gjykues, __________________

Procesmbajtës: zyrtari ligjor-procesmbajtës, __________________________________

Prezantojnë: Prokurori i shtetit ___________________________________

I pandehuri ________________________________________

Mbrojtësi i të pandehurit-av. __________________________

Filloi në ora: ___________.

Kryetari i trupit gjykues i përkujton palët se në shqyrtimin e dytë të mbajtur në datën __________, për shkak të nderlikushmërisë së rastit dhe nevojës për kohë shtesë për verifikim të dhënave të paraqitura në kërkesa të palëve për hedhje të aktakuzës, është vendos që të mbahet shqyrtimi për përcaktimin e vlefshmërisë së propozimeve.

Kryetari i trupit gjykues i njofton palët me kërkesën për hedhje të aktakuzës të ushtruar nga mbrojtësi i të pandehurit.

Prokurori i shtetit është deklaruar në lidhje me parashtresën e mbrojtësit të pandehurit dhe i ka propozuar gjykatës që ta refuzoi kërkesën.

Palët nuk kanë diçka tjetër për të shtuar.

Kryetari i trupit gjykues, i njofton palët se vendimin në lidhje me kërkesën për hedhje të aktakuzës, do ta nxjerr brenda afatit prej tre (3) javë, nga dita e mbajtjes së këtij shqyrtimi.

Palëve do t'u dërgohet vendimi në formën e shkruar.

Përfundoi në ora ____________.

**Vërtetojnë,**

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi,** | **Gjyqtari individual-<br>kryetari i trupit gjykues,** |
| ____________________ | ________________________ |

**Prokurori i shtetit,**

____________________

| | |
|---|---|
| **Mbrojtësi i të pandehurit,** | **I pandehuri,** |
| ________________________ | ________________________ |

REPUBLIKA E KOSOVËS
PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
PP. Nr. _________/2016

Në bazë të nenit 264, lidhur me nenin 90, të KPP-së, në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________________________, i dyshuar për shkak të veprës penale ___________________________, nga neni __________ të KPP-së (vepër kjo që bënë pjesë në veprat penale të listuara në nenin 90 të KKP-së), me rastin e vendosjes për ngrirje të përkohshme të aseteve, në datën ___________ 2015, lëshon këtë:

**URDHËR PËR NGRIRJE TË PËRKOHSHME TË ASETEVE**

I. Të pandehurit __________________ I NDALOHET shitja përkatësisht tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme e cila përbëhet prej ngastrës kadastrale me sipërfaqe prej 00,05,00 ha, fleta poseduese me nr. ________________, për Komunën Kadastrale _______________, si dhe shtëpia e ndërtuar në këtë ngastër kadastrale P+0+4 me sipërfaqe prej 900 m2.

II. Ky urdhër vlen shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit. Urdhri është lëshuar në datë 20.2.2016 në ora 15:00

III. Këtë urdhër do ta zbatojë Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës.

IV. Gjyqtarit të procedurës paraprake njëkohësisht i dorëzohet kërkesa për urdhër ndalues.

**Arsyetim**

Në çështjen penale të tani të pandehurit _________________________, e cila është në fazën e hetimeve deri më tani është arritur që të sigurohen prova me të cilat prokurori i shtetit pretendon të argumentoi se pasuria e paluajtshme si në pikën I të kësaj urdhërese, është krijuar me vepër penale dhe si e tillë duhet të konfiskohet.

Për shkak të rrezikut të tjetërsimit të kësaj pasurie, dhe me qellim të parandalimit me kohë të çdo veprimi që do të rezultonte me bartjen e së drejtës së pronësisë te ndonjë person tjetër, prokurori i shtetit vendosi që të lëshojë urdhëresën për ngrirje të përkohshme të aseteve, në aplikimin e nenit 264 të KPP-së, dhe njëherësh të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake lëshimin e urdhrit ndalues.

**Prokurori i shtetit**

_______________________

**Kërkesa e prokurorit të shtetit për urdhër ndalues**
**(neni 265 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
PP. Nr. _________/2016

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda-Gjyqtarit të Procedurës Paraprake**
**Gj. PP. Nr. _________/2016**

Në bazë të nenit 265, par. 1 lidhur me nenin 264, të KPP-së, në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________________, i dyshuar për shkak të veprës penale ______________________________ nga neni __________ të KPP-së (vepër kjo që bënë pjesë në veprat penale të listuara në nenin 90 të KKP-së), prokurori i shtetit, paraqet këtë:

**KËRKESË PËR URDHËR NDALUES TË ASETEVE**

Në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________________, i dyshuar për shkak të veprës penale ____________________________, nga neni __________, të KP të RK-së, prokurori i shtetit më datën _____________ 2016 ka lëshuar urdhër për ngrirje të përkohshme të aseteve që përbëhen prej ngastrës kadastrale me sipërfaqe prej 00,05,00 ha, fleta poseduese me nr. ______________ për Komunën Kadastrale _______________ si dhe shtëpia e ndërtuar në këtë ngastër kadastrale P+0+4 me sipërfaqe prej 900 m2. Ky urdhër vlen shtatëdhjetë e dy (72) orë nga koha e lëshimit. Urdhri është lëshuar në datë 20.2.2016 në ora 15,00. Këtë urdhër do ta zbatojë Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës.

Në bazë të nenit 265 par. 1 të KPP-së, prokurori i shtetit i kërkon gjyqtarit të procedurës paraprake që brenda afatit të caktuar të lëshoi urdhër ndalues për asetet e theksuara më lartë.

Prokurori i shtetit, kërkesës i bashkëngjiti:

1. Kopjen e urdhrit për ngrirjen e përkohshme të pasurisë së paluajtshme me shenjën _____________ dt. _________ 2016.

2. Kontratën mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme me shenjën _______________, nga e cila vërtetohet se këtë pasuri tani i pandehuri e kishte blerë gjatë kohës për të cilën dyshohet se e kishte kryer veprën penale.

3. Ka arsye për të besuar se tani i pandehuri do të përpiqet që urgjentisht të tjetërsojë këtë pasuri-qoftë edhe me veprime fiktive juridike-me qellim që kjo pasuri t'i shmanget konfiskimit pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Personat që mund të kenë interes pasuror në këtë pasuri të paluajtshme, mund të jenë vëllezërit e të pandehurit me të cilët jeton në bashkësi familjare që janë:

1. ____________________________________________ me adresë të vendbanimit në: ___________________________.

2. ____________________________________________ me adresë të vendbanimit në: ___________________________.

Këta persona duhet të thirren në shqyrtimin për konfirmimin e ndalimit për tjetërsimin e pasurisë që do të mbahet nga gjykata.

**Prokurori i shtetit**

______________________

**Vendimi për urdhër ndalues**
**(Neni 265 par. 3 të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
KR. GJPP. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit të procedurës paraprake N. N me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit A. A. ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet sipas aktvendimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me shenjën PS. Nr. __________/2015, të dt. _________ për shkak të veprës penale ___________________ nga neni __________ par. ____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me rastin e vendosjes sipas kërkesës të ushtruar nga prokurori i shtetit PS. Nr. __________ dt. për urdhër ndalues –ngrirje të aseteve, më datën ___________, lëshon këtë:

**URDHËR NDALUES**
**PËR NGRIRJE TË PËRKOHSHME TË ASETEVE**

I. NDALOHET shitja dhe bartja e të drejtës së pronësisë në pasurinë e paluajtshme e cila evidentohet në emër të ________________________ nga _________________, sipas fletës poseduese nr. __________ për Komunën Kadastrale _______________.

II. Ky urdhër ndalues vlen për periudhën kohore prej 30 ditëve nga dita e lëshimit.

III. Këtë urdhër ndalues do ta zbatoi Shërbimi për kadastër dhe gjeodezi në Komunën e Prishtinës.

IV. Caktohet shqyrtimi për konfirmimin e urdhrit ndalues për këtë pasuri të paluajtshme e që do të mbahet në datën ________________ *(vërejtje - brenda 3 javësh nga dita e lëshimit të urdhrit për ngrirje të përkohshme të aseteve).*

V. I pandehuri dhe të gjithë personat që kanë interes në pasurinë e paluajtshme për të cilën do të mbahet shqyrtimi për urdhër ndalues njoftohen se:
"Pasuria e përcaktuar në urdhrin ndalues është e ngirë për tridhjetë ditë. Shqyrtimi është caktuar. Nëse pretendoni të kundërshtoni ngrirjen e kësaj pasurie, ju duhet të merrni pjesë në shqyrtim dhe të keni mundësinë të paraqitni argumentet tuaja për heqjen e kësaj ngrirje. Ndalimi afatgjatë i kësaj pasurie mund të urdhërohet në këtë shqyrtim dhe kjo prek të drejtën tuaj në këtë pasuri.

**Arsyetim**

Prokuroria e shtetit-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës i është drejtuar kësaj gjykate-gjyqtarit të procedurës paraprake me kërkesën PS. Nr. ___________ 2015, me të cilën ka kërkuar lëshimin e urdhrit ndalues për ngrirjen e përkohshme të aseteve-pasurisë së paluajtshme e cila evidentohet në emër të __________________________ sipas fletës poseduese ______________ për KK Prishtinë.

Prokurori i shtetit, kërkesës i ka bashkëngjit: kopjen e urdhrit për ngrirje të përkohshme të aseteve PS. Nr. _______________ dt. __________ 2015, përshkrimin e provave të artikulueshme që e arsyetojnë urdhrin, përshkrimin e arsyeve që urdhri ndalues të ndaloj shitjen, dhe identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në pasurinë e paluajtshme për të cilën është kërkuar urdhri ndalues.

Me rastin e vendosjes sipas kërkesës së prokurorit të shtetit –gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi se kjo kërkesë është e ushtruar në bazë të nenit 265, par. 1 dhe 2, par. 2. 1 deri 2. 4 dhe vendosi që ta aprovojë kërkesën dhe lëshoi urdhrin ndalues si më lartë.

Prandaj, në bazë të nenit 265, par. 3, 5, 6, 7, 8, 9, nën paragrafi 9. 1 dhe 9. 2, të KPP-së gjykata vendosi si më lartë.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Gjyqtari i procedurës paraprake,**

__________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër kësaj urdhërese mund të ushtrohet kundërshtimi brenda afatit prej 24 orëve nga koha e pranimit. Kundërshtimi i adresohet Kolegjit shqyrtues të kësaj gjykate.

**Procesverbal nga shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë**
**(Neni 266 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
Gjyqtari i procedurës paraprake
GJ. P. P. Nr. __________/2016

**PROCESVERBAL**
**Nga shqyrtimi për konfirmimin e ndalimit të pasurisë.**
**Mbajtur në datën_____________2016**

Përbërja e gjykatës: Gjyqtari i procedurës paraprake _____________________________
Procesmbajtës-zyrtari ligjor __________________________________

Prezantojnë:

Prokurori i shtetit, prokurori në PS ___________________________________.

I pandehuri _____________________, dhe mbrojtësi-avokati ____________________

Personat që kanë interes në pasurinë e cila është objekt i urdhrit ndalues:

1. ________________________________,

2. ________________________________.

Prezanton edhe interpreti gjyqësor ________________________________________

Objekt i shqyrtimit: Kërkesa e prokurorit të shtetit për urdhër afatgjatë ndalues, me shenjën PS. Nr. _______________ 2015 dt. ________________.

Filloi në ora ______________.

Gjyqtari i procedurës paraprake e hap seancën e shqyrtimit për konfirmimin e ndalimit të pasurisë, konstaton se prezantojnë të gjitha palët e ftuara, i njofton të gjithë të pranishmit me kërkesën për lëshimin e urdhrit ndalues dhe i fton palët, si dhe personat e interesuar që të paraqesin pretendimet dhe provat e tyre me të cilat e mbështesin përkatësisht e kundërshtojnë lëshimin e urdhrit ndalues për pasurinë e paluajtshme.

Prokurori i shtetit deklaron: (shënohet deklarata e prokurorit të shtetit) dhe prezanton provat në mbështetje të urdhrit ndalues.

I pandehuri deklaron (shënohet deklarata e të pandehurit) dhe prezanton provat me të cilat i argumenton pretendimet e tij se përse e konsideron kërkesën e prokurorit të shtetit si të pa bazuar.

Personi i interesuar për këtë pasuri të paluajtshme deklaron (shënohet deklarata e personave të interesuar për atë pasuri të paluajtshme) dhe i prezanton provat me të cilat i argumenton pretendimet e tij se përse konsideron se kërkesa e prokurorit të shtetit për ndalimin afatgjatë të kësaj pasurie është e pa bazë sepse ky urdhër do të prekë edhe interesat e personave të tjerë.

Palët nuk kanë diçka tjetër për të shtuar.

Gjyqtari e shpall të përfunduar shqyrtimin për konfirmimin e ndalimit të pasurisë së paluajtshme të përfunduar dhe i njofton palët se vendimi do të merret brenda afatit ligjor dhe do të dërgohet për të gjitha palët në formën e paraparë me ligj.

**Vërtetojnë,**

**Procesmbajtësi,** **Gjyqtari i procedurës paraprake,**

_________________ _________________

**I pandehuri,** **Mbrojtësi i të pandehurit,**

_________________ _________________

**Personi i interesuar,**

_________________

**Vendimi për urdhër ndalues afatgjatë**
**(Neni 266 par. 5 të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
KR. GJPP. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit të procedurës paraprake N. N, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N, në çështjen penale të tani të pandehurit A. A, ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet sipas aktvendimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me shenjën PS. Nr. _______/2015, të dt. __________, për shkak të veprës penale ____________________, nga neni __________, par. ____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës të ushtruar nga prokurori i shtetit PS. Nr. __________ dt.____ për urdhër ndalues - ngrirje të aseteve, më datën ___________, lëshon këtë:

**URDHËR NDALUES**
**PËR NGRIRJE TË ASETEVE DERI NË PËRFUNDIMIN**
**E SHQYRTIMIT GJYQËSOR**

I. NDALOHET shitja dhe bartja e të drejtës së pronësisë në pasurinë e paluajtshme e cila evidentohet në emër të ___________________________ nga _______________, sipas fletës poseduese nr. __________ për Komunën Kadastrale _______________.

II. Ky urdhër ndalues vlen deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor.

III. Nëse pasuria e paluajtshme për të cilën është lëshuar ky urdhër afatgjatë nuk përfshihet me aktakuzë gjyqtari individual përkatësisht kryetari i trupit gjykues pas pranimit të aktakuzës mund të vendos për lirimin e pasurisë e cila është ndaluar me këtë urdhër për ndalim afatgjatë.

IV. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij urdhri.

**Arsyetim**

Prokuroria e shtetit-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës i është drejtuar kësaj gjykate-gjyqtarit të procedurës paraprake me kërkesën PS. Nr. ___________ 2015, me të cilën ka kërkuar lëshimin e urdhrit ndalues për ngrirjen e aseteve-pasurisë së paluajtshme e cila evidentohet në emër të ___________________________ sipas fletës poseduese ____________________, për KK Prishtinë, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i shtetit, kërkesës i ka bashkëngjit: kopjen e urdhrit për ngrirje të përkohshme të aseteve, PS. Nr. ____________dt. ________2015, përshkrimin e provave të artikulueshme që e arsyetojnë urdhrin, përshkrimin e arsyeve që urdhri ndalues të ndaloj shitjen dhe identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në pasurinë e paluajtshme për të cilën është kërkuar urdhri ndalues afatgjatë.

Në shqyrtimin për konfirmimin e ndalimit të pasurisë të mbajtur në datën ___________ 2015, gjykata ka dëgjuar prokurorin e shtetit të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, av. ______________________, si dhe personat e interesuar për këtë pasuri: 1. __________________________ dhe 2. ______________________.

Prokurori i shtetit ka mbetur pranë kërkesës për lëshimin e urdhrit ndalues afatgjatë dhe ka theksuar se ka arsye për të besuar se i pandehuri do të tjetërsoi këtë pasuri nëse gjykata nuk lëshon urdhër afatgjatë për ndalim të tjetërsimit të pronës së paluajtshme e cila evidentohet në emër të tani të pandehurit, pasuri kjo që ka prova se është përfituar me vepër penale dhe e cila pritet të konfiskohet pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.

Në shqyrtimin për konfirmimin e ndalimit të pasurisë, i pandehuri e ka kundërshtuar kërkesën e prokurorit të shtetit për ndalim afatgjatë të pasurisë me deklarimin se këtë pasuri e ka krijuar shumë vjet më herët se sa koha për të cilën prokurori është duke i zbatuar hetimet në lidhje me këtë çështje penale.

Personi i interesuar për këtë pasuri _______________________, ka deklaruar se kjo pasuri është pronë e përbashkët me tani të pandehurin dhe është e krijuar me punën e përbashkët disa vjeçare prandaj ka kërkuar nga gjykata që të mos aprovojë kërkesën e prokurorit për ndalim afatgjatë.

Personi i dytë i interesuar për këtë pasuri _____________________, ka deklaruar se ka pretendime në këtë pasuri të paluajtshme sepse babai i tij ka investuar në këtë pasuri dhe tani i pandehuri ka detyrime ndaj tij.

Gjykata analizoi me hollësi të gjitha pretendimet e palëve lidhur me lëshimin e urdhrit ndalues-afatgjatë dhe në bazë të provave të prezantuara konsideron se prokurori i shtetit ka arritur që të prezantoi prova të mjaftueshme me të cilat e arsyeton në masë të mjaftuar kërkesën për urdhër ndalues afatgjatë, ndërsa i pandehuri dhe personat e interesuar nuk ishin në gjendje që të provojnë të kundërtën e pretendimeve të prokurorit, prandaj gjyqtari i procedurës paraprake gjeti se kërkesa e prokurorit të shtetit për urdhër ndalues afatgjatë është e bazuar dhe si të tillë e aprovoi.

Kështu kjo gjykatë konsideron se nga provat e prezantuar vërtetohet se pasuria e paluajtshme është pronë e tani të pandehurit dhe e regjistruar në emër të tij sipas fletës poseduese me nr: __________________, për KK Prishtinë. Kjo pasuri është krijuar brenda afatit kohor për të cilin dyshohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën edhe ka krijuar dobi pasurore në vlerë që mund të jetë edhe më e lartë se sa çmimi real i pasurisë së paluajtshme e cila ndalohet sipas kësaj urdhërese. Kjo pasuri mund të

përfshihet në aktakuzë me kërkesë për konfiskim si dobi pasurore e përfituar me vepër penale.

Pretendimet e personave të interesuar për këtë pasuri tani për tani nuk janë provuar prandaj gjykata nuk i aprovoi kërkesat e tyre.

Prandaj, në bazë të nenit 266, par. 5, 6. 2, par. 10, 11, dhe 12 të KPP-së, gjykata vendosi si më lartë.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Gjyqtari i procedurës**
**paraprake,**

_________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër kësaj urdhërese, mund të ushtrohet Ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 10 ditëve nga dita e pranimit.

**Kërkesa e prokurorit të shtetit për masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë. (neni 267 par. 4, 268 dhe 269 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË
PP. Nr. _________/2016

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda-Gjyqtarit të Procedurës Paraprake**
**Gj. PP. Nr. _________/2016**

Në bazë të nenit 267 par. 4, nenit 268 dhe 269 të KPP-së, në çështjen penale të tani të pandehurit _______________________________, i dyshuar për shkak të veprës penale _____________________________, nga neni __________ të KPP-së (vepër kjo që bënë pjesë në veprat penale të listuara në nenin 90 të KKP-së), prokurori i shtetit paraqet këtë:

## KËRKESË PËR MASË TË PËRKOSHME PËR SIGURIMIN E PASURISË

I. Në çështjen penale të tani të pandehurit_____________________________, i dyshuar për shkak të veprës penale___________________________, nga neni ___________ të KP të RK-së, në bazë të nenit 112 të KPP-së, ka lëshuar urdhër për sekuestrimin e përkohshme të aseteve që përbëhen prej një sasie prej 25.000 kg sheqer, dhe sasia prej 20.000 kg miell, tip 400. Urdhri është lëshuar në datën 20.2.2016.

   Në bazë të nenit 267, par. 4, nenit 268 dhe 269 të KPP-së, prokurori i shtetit i kërkon gjyqtarit të procedurës paraprake që në bazë të nenit 272 dhe 273 të KPP-së të lëshoi urdhër për masë të përkohshme për asetet e theksuara më lartë ashtu që pasuria e luajtshme do të administrohet nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe do të shitet për vlerën e saj aktuale në treg.

   Pasuria e luajtshme e përfshirë në këtë kërkesë, do të shitet në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

II. I pandehuri dhe personat që mund të kenë interes pasuror në këtë pasuri të paluajtshme ftohen që brenda afatit prej 14 ditëve nga dita e paraqitjes së kësaj kërkese te gjyqtari i procedurës paraprake, të paraqesin kundërshtim për masë të përkohshme.

III. Persona që mund të kenë interes pasuror në këtë pasuri të paluajtshme, janë:

1. _______________________________________ me adresë të vendbanimit në: ____________________________.

2. _______________________________________ me adresë të vendbanimit në: ____________________________.

Këta persona, duhet të ftohen në shqyrtimin për konfirmimin e ndalimit për tjetërsimin e pasurisë që do të mbahet nga gjykata.

IV. Nëse i pandehuri dhe personat tjerë që mund të kenë interes pasuror në këtë pasuri të paluajtshme, brenda afatit prej 14 ditëve nuk paraqesin kundërshtim kundër kërkesës për masë të përkohshme, prokurori i propozon gjyqtarit të procedurës paraprake që të marrë vendim në bazë të nenit 272, të KPP-së, pa mbajtur shqyrtim.

**Prokurori i shtetit**

_____________________

**Urdhri për masë të përkohshme**
**(Neni 273 të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
KR. GJPP. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit të procedurës paraprake N. N me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit A. A. ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet sipas aktvendimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me shenjën PS. Nr. _________________/2015, të dt. __________________, për shkak të veprës penale ___________________ nga neni__________, par. ____, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës të ushtruar nga prokurori i shtetit, PS. Nr. __________, dt. për urdhrin për masë të përkohshme, më datën ___________, lëshon këtë:

## URDHËR PËR MASË TË PËRKOHSHME

I. APROVOHET kërkesa e prokurorit të shtetit-PS, ashtu që URDHËROHET shitja e pasurisë së paluajtshme e cila përbëhet prej një sasie prej 25.000 kg sheqer dhe sasia prej 20.000 kg miell, tip 400, mallra këto të sekuestruara në depon e tani të pandehurit ______________________________ dhe për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se janë përfituar me vepër penale për të cilën ndaj tani të pandehurit, janë duke u zhvilluar hetimet.

II. Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar, për zbatimin e kësaj urdhërese, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së kësaj urdhërese.

### Arsyetim

Prokuroria e shtetit-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, i është drejtuar kësaj gjykate-gjyqtarit të procedurës paraprake me kërkesën, PS. Nr. ___________ 2015, me të cilën ka kërkuar lëshimin e urdhrit për masë të përkohshme – shitjen e aseteve, pasurinë e luajtshme e cila përbëhet prej sasisë prej 20.000 kg sheqer dhe sasisë prej 20.000 kg, miell tip 400, sende të luajtshme, këto për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se janë përfituar me veprën penale për të cilën ndaj tani të pandehurit _________________________, janë duke u zhvilluar hetimet.

Prokurori i shtetit, kërkesës i ka bashkëngjit: kopjen e urdhrit për sekuestrimin e përkohshme të aseteve, PS. Nr. _____________ dt. ________ 2015, përshkrimin e

provave të artikulueshme që e arsyetojnë urdhrin, përshkrimin e arsyeve që gjykata të lëshojë urdhrin për masë të përkohshme - shitjen e aseteve me arsyetimin se këto asete-mallra, me kalimin e kohës bëhen të pa përdorshme sepse ju kalon afati i përdorimit dhe ekziston rreziku i prishjes së tyre.

I pandehuri brenda afatit prej 14 ditëve nga dita e njoftimit për kërkesën e prokurorit për lëshimin e urdhrit për masë të përkohshme, ka paraqitur kundërshtim por nuk ka ngritur çështje faktike që kërkojnë marrjen e provave dhe sqarimin e fakteve.

Gjyqtari i procedurës paraprake, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e prokurorit për dhënien e urdhrit për masë të përkohshme-shitjen e aseteve, mallrave të cilat kanë afat të caktuar të përdorimit dhe i nënshtrohen rrezikut të prishjes, konstatoi se prokurori i shtetit e ka bërë të besueshme kërkesën për shitjen e këtyre aseteve.

Pretendime të personave të tretë për këtë pasuri nuk kishte.

Shitja e këtyre aseteve, do të bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar ose të Sekuestruar.

Prandaj, për arsyet e theksuara më lartë, dhe në bazë të nenit 273, të KPP-së, gjykata vendosi për dhënien e urdhrit për masë të përkohshme shitjen e aseteve-mallrave të cilave ju skadon afati i përdorimit dhe i nënshtrohen edhe rrezikut të prishjes.

Pretendime të personave të tretë për këtë pasuri nuk kishte.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. __________2016, dt. _________2016**

**Gjyqtari i procedurës**
**paraprake,**

___________________________

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër kësaj urdhërese mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej dyzetë e tetë orëve (48) nga koha e pranimit. Kundërshtimi i drejtohet kolegjit shqyrtues të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk e ndalon ekzekutimin e kësaj urdhërese.

**Urdhër për caktimin e shqyrtimit gjyqësor**
**(Neni 285-287 të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
P. KR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues _________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me shenjën PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________ për shkak të veprës penale ____________________________ nga neni __________, par. _______, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, më datën ___________, lëshon këtë:

## URDHËR PËR CAKTIMIN E SHQYRTIMIT GJYQËSOR

I. Në çështjen penale të tani të pandehurit __________________________, i akuzuar nga PS e Republikës së Kosovës sipas aktakuzës me shenjën PS. Nr. ____________ 2016, të dt. ________ 2016, shqyrtimi gjyqësor do të fillojë në datën ____________ 2016.

   Shqyrtimi gjyqësor, do të mbahet në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Krime të Rënda, Objekti “D”, salla nr. 16, kati i I-rë, Pallati i Drejtësisë-Prishtinë.

II. Në shqyrtimin gjyqësor të ftohen:

1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me adresë si në aktakuzë.

2. I dëmtuari ___________________, me adresë si në aktakuzë.

3. Përfaqësuesi i të dëmtuarit-avokati ____________________, nga Prishtina.

   3.1. pandehuri-me ftesë për pjesëmarrje në shqyrtimin gjyqësor nëpërmes të QP ku është i ndaluar.

   3.2. Urdhërohet sjellja e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë. Këtë urdhëresë do ta zbatojë Shërbimi Korrektues i Republikës së Kosovës-përkatësisht Qendra e Paraburgimit në Prishtinë.

4. Mbrojtësi i të pandehurit avokati____________________, nga Prishtina.

5. Dëshmitari ________________, me adresë të vendbanimit në _____________, me numër të telefonit____________________.

6. Eksperti i mjekësisë ligjore __________________ në adresë _______________ i cili mund të kontaktohet edhe në këtë numër të telefonit: ________________.

7. Interpreti nga gjuha _____________________, në gjuhën __________________ dhe anasjelltas.

III. Të akuzuarit së bashku me thirrje i tërhiqet vërejtja se pas shpalljes së aktgjykimit, nëse dëshiron të ushtroi ankesë ndaj aktgjykimit-ankesën duhet që ta paralajmëroi brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e shpalljes së aktgjykimit- në të kundërtën konsiderohet se ka heq dorë nga ankesa.

IV. Shqyrtimi gjyqësor mbahet në mungesë të dëmtuarit- cili nuk është thirrur si dëshmitar, dhe në këtë rast lexohet deklarata e tij për kërkesën pasurore-juridike.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

_________________________

**Leje për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor jashtë selisë së gjykatës**
**(Neni 286 i KPK-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
GJ. A. Nr. _________2016
(Lidhur me P. KR. Nr. ______/2016)

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë ______________________, në lidhje me caktimin e vendit të mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në çështjen penale të tani të pandehurit _______________________, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me shenjën PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale ________________________ nga neni__________, par. ____ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së kryetarit të trupit gjykues-gjyqtarit __________________, në datën ______________ 2016,

**CAKTON**
**VENDIN E MBAJTJES SË SHQYRTIMIT GJYQËSOR NË NDERTESË TJETËR NGA AJO E GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**

I. Shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale të tani të pandehurit ___________________, në lëndën penale PKR. nr. __________ 2016, për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme do të mbahet në Prishtinë-Salla e Kinemasë “ABC”.

II. Kryetari i trupit gjykues do të kujdesët që me kohë të njoftoi Policinë e Kosovës-me qellim të marrjs së masave të duhura për sigurinë gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor.

III. Shërbimi i logjistikës i gjykatës obligohet që kryetarit të trupit gjykues t’i ofrojë ndihmën logjistike për mbarëvajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Për këtë qellim kryetari i trupit gjykues, me kohë do të adresojë kërkesën te udhëheqësi i këtij shërbimi, me adresim të qartë të masave që duhet të ndërmerren, me qellim që shqyrtimi gjyqësor të mbahet me sukses.

**Kryetari i gjykatës,**

_________________________

**Vendimi lidhur me kërkesën për mbledhje të provave të reja-para fillimit të shqyrtimit gjyqësor (neni 288 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
P. KR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues ___________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit _____________________, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me shenjën PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale __________________________, nga neni __________, par. ________ të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me rastin e vendosjes sipas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit av. ___________________, për mbledhjen e provave të reja, më datën ___________, merr këtë:

**AKTVENDIM**

I. Aprovohet kërkesa e mbrojtësit të pandehurit __________________________, av. _______________, për mbledhjen e provave të reja me shikimin e video incizimeve nga kamera e cila ka qenë e vendosur në dritaren e lokalit afarist me emrin "________________" në rrugën: "________________" prej nga shihet edhe vendi ku është kryer vepra penale për të cilën tani zhvillohet kjo procedurë penale.

II. Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari-përkatësisht përfaqësuesi i tij, njoftohen me këtë vendim.

**Arsyetim**

Në çështjen penale të tani të pandehurit _________________________, i cili akuzohet nga PS e Kosovës për shkak të veprës penale _____________________________, nga neni _________, të KP të RK-së, shqyrtimi gjyqësor është caktuar të mbahet në datën ________2016.

Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, mbrojtësi i të pandehurit i është drejtuar gjykatës me kërkesë që të lejohet mbledhja e provave të reja për të cilat nuk është ditur deri në përfundim të shqyrtimit të dytë, me arsyetimin se prova e re është video incizimi nga një kamerë e cila ka qenë e vendosur në dritaren e lokalit afarist me emrin "________________" në rrugën: "___________________" prej nga shihet vendi ku është kryer vepra penale për të cilën zhvillohet kjo procedurë penale dhe prandaj edhe

veprimet e tani të pandehurit në kohën dhe vendin e theksuar në aktakuzë, me paralajmërimin se këto video incizime mund të jenë me ndikim në të provuarit e pafajësisë së tani të pandehurit.

Në bazë të nenit 288, par. 2, të KPP-së, kryetari i trupit gjykues aprovon kërkesën e palëve për mbledhjen e provave të reja kur prova nuk ka qenë e njohur para shqyrtimit të dytë.

Në këtë rast, ka arsye për të besuar se prova e cila kërkohet që të prezantohet dhe administrohet, nuk ka qenë e njohur para shqyrtimit të dytë sepse deri atëherë nuk është ditur për ekzistimin dhe funksionimin e kamerës së vendosur në ballkonin e lokalit afarist me emrin "________________________" prej nga mund të ishte vërejtur e tërë ngjarja në kohën dhe vendin kur është kryer vepra penale për të cilën është duke u zhvilluar kjo procedurë penale.

Gjykata konsideron se refuzimi i marrjes së kësaj prove do të mund të kishte ndikim në një gjykim të drejtë sepse të pandehurit do t'i pamundësohej që të paraqiste mbrojtjen adekuate me prezantimin e kësaj prove.

Prandaj, për arsyet e theksuara më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

__________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e posaçme sepse është marrë në përgatitje të shqyrtimit gjyqësor.

**Urdhër për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor**
**(Neni 291 i të KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
P. KR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues _________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________ sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me shenjën PS. Nr. ________/2015, të dt. _____________, për shkak të veprës penale _____________________________, nga neni __________, par. ______, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, më datën ___________, lëshon këtë:

## URDHËR PËR SHTYRJEN E SHQYRTIMIT GJYQËSOR

I. Në çështjen penale të tani të pandehurit __________________________ i akuzuar nga PS e Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës me shenjën PS. Nr. ___________ 2016, të dt. ________ 2016, shqyrtimi gjyqësor i caktuar të mbahej në datën ______________, shtyhet për datën ___________2016, për arsye se mbrojtësi i të akuzuarit e ka njoftuar gjykatën se është i penguar që të marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor më datën kur duhej të mbahej shqyrtimi gjyqësor.

   Shqyrtimi gjyqësor, do të mbahet në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Krime të Rënda, Objekti "D", salla nr. 16, kati i I-rë, Pallati i Drejtësisë-Prishtinë.

II. Me këtë urdhëresë, do të njoftohen të gjitha palët me këtë çështje penale.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

_________________________

**Vendimi për hedhje të aktakuzës**
**(Neni 292 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
P. KR. Nr. ______/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej kryetarit të trupit gjykues _________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor N. N, në çështjen penale të tani të pandehurit ______________________, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me shenjën PS. Nr. ________/2015, të dt. ____________, për shkak të veprës penale ____________________________, nga neni __________, par. ____, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, pas pranimit të njoftimit nga prokurori i shtetit për tërheqjen nga aktakuza, më datën ________, merr këtë:

## AKTVENDIM

I. HEDHET aktakuza e ushtruar nga prokurori i shtetit PS e Kosovës, me shenjën PS. Nr. ___________, e dt. ________ 2015, ndaj të pandehurit ___________________, për arsye se prokurori i shtetit para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, është tërheq nga aktakuza.

II. Aktakuza e tërhequr nuk mund të ushtrohet përsëri nga prokurori.

III. I dëmtuari ______________________________, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

IV. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore.

## Arsyetim

Në çështjen penale të tani të pandehurit __________________________, i cili akuzohej nga PS e Kosovës për shkak të veprës penale ______________________________ nga neni ________, të KP të RK-së, shqyrtimi gjyqësor është caktuar të mbahet në datën ___________ 2016.

Para ditës së mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit me njoftimin e datës ____________, është tërheq nga aktakuza.

Në bazë të nenit 290, par. 1, të KPP-së, kur prokurori i shtetit para fillimit të shqyrtimit gjyqësor tërhiqet nga akuza, kryetari i trupit gjykues e hedhë aktakuzën.

Në bazë të nenit 290, par. 2, të KPP-së, aktakuza e tërhequr nuk mund të paraqitet sërish.

Prandaj, për sa u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. Nr. _______2016**

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

__________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Ky aktvendim është marrë në fazën e përgatitjeve për shqyrtimin gjyqësor. Në bazë të nenit 408, par. 3 të KPP-së, aktvendimet që merren për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor, mund të kundërshtohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit. Prandaj, kundër këtij aktvendimi, ankesa nuk është e lejuar. Me këtë aktvendim do të njoftohen të gjitha palët.

**Vendimi për përjashtimin e publikut**
**(Neni 294 dhe 296 i KPP-së)**

**(Ky vendim-aktvendim merret gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. KR. Nr. ______/2016**

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR**

Në bazë të nenit 294, par. 1, nën paragrafi 1. 6 dhe nenit 296, të KPP-së, sipas propozimit të prokurorit të shtetit, trupi gjykues merr këtë:

**AKTVENDIM**

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, do të jetë i mbyllur për publik për shkak të mbrojtjes së dëshmitarit.

Personat që marrin pjesë në shqyrtim, paralajmërohen se detyrohen të ruajnë fshehtësinë e informatave të mësuara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e posaçme.

Ankesa kundër këtij aktvendimi lejohet vetëm në ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit.

Arsyetim i shkurtër:

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, prokurori i shtetit i kërkoi trupit gjykues që në interes të dëmtuarit-për shkak të mbrojtjes së të dëmtuarit i cili ka për t'u dëgjuar si dëshmitar, të përjashtohet publiku me arsyetimin se ekziston rreziku për dëshmitarin për shkak të dëshmisë që pritet ta prezantojë.

Trupi gjykues, aprovoi kërkesën për përjashtimin e publikut nga ky shqyrtim gjyqësor, pasi që konsideron se kanë bazë pretendimet për ekzistimin e rrezikut për dëshmitarin për shkak të dëshmimit të tij.

**Kryetari i trupit gjykues,**

_____________________________

**Vendimi për shqiptimin e dënimit personave që prishin rendin në shqyrtimin gjyqësor**
**(Neni 302 i KPP-së)**

**(Ky vendim-aktvendim merret gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. KR. Nr. ______/2016**

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR**

Në bazë të nenit 302, par. 1 të KPP-së kryetari i trupit gjykues merr këtë:

**AKTVENDIM**

I. Avokatit _________________________, i cili në këtë shqyrtim gjyqësor merr pjesë si mbrojtës i tani të pandehurit_________________, për shkak të prishjes së rendit në shqyrtimin gjyqësor i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 500,00 €, të cilin do ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve, pas plotëfuqishmërisë së aktvendimit.

   Ndaj këtij aktvendimi lejohet ankesa.

   Nëse trupi gjykues nuk e revokon këtë aktvendim pas ankesës, atëherë për ankesë vendos Gjykata e Apelit.

II. Lidhur me këtë vendim do të njoftohet Oda e Avokatëve të Kosovës.

   (Nëse vendimin për shqiptimin e dënimit e ka marrë gjyqtari individual, atëherë vet gjyqtari individual ka mundësi që pas ankesës ta revokojë dënimin. Në të kundërtën, për ankesën vendos Gjykata e Apelit).

Arsyetimi i shkurtër

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje, mbrojtësi i tani të pandehurit ____________, disa herë ka prishur rendin dhe nuk u është bindur urdhrave të kryetarit të trupit gjykues. Prishjet e rendit nga avokati __________________, janë evidentuar në këtë procesverbal sikurse edhe vërejtjet që i janë shqiptuar paraprakisht.

Për arsye se avokati ___________________, ka prishur rendin dhe nuk u është bindur urdhrave të kryetarit të trupit gjykues dhe në aplikim të nenit 302, par. 1. të KPP-së, kryetari i trupit gjykues vendosi për shqiptimin e dënimit me gjobë ndaj të njëjtit me

bindje se kjo do të jetë masë e mjaftuar për vetëdijesimin që ky avokat të respektojë rendin dhe rregullin në shqyrtimin gjyqësor.

**Kryetari i trupit gjykues,**

______________________________

**Vendimi për mohimin e të drejtës së mbrojtësit për të përfaqësuar klientin e tij (Neni 302, par. 3 i KPP-së)**

**(Ky vendim-aktvendim merret gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. KR. Nr. ______/2016**

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR**

Në bazë të nenit 302 par. 3 të KPP-së, kryetari i trupit gjykues merr këtë:

**AKTVENDIM**

Avokatit ______________________, i cili në këtë çështje penale është mbrojtës i të pandehurit _____________________, i mohohet e drejta e mbrojtjes për klientin e tij-tani të pandehurin e lartpërmendur për shkak se edhe pas shqiptimit të dënimit i njëjti vazhdon të prish rendin në shqyrtimin gjyqësor.

Për shkak se në këtë çështje penale i pandehuri nuk ka të angazhuar mbrojtës tjetër, ndërsa gjykata nuk është në gjendje që menjëherë të sigurojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për datën____________2016.

I pandehuri duhet ta njoftojë gjykatën për angazhimin e mbrojtësit tjetër më së largu 8 ditë para vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.

Arsyetimi i shkurtër.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje, mbrojtësi i tani të pandehurit ___________, disa herë ka prishur rendin dhe nuk u është bindur urdhrave të kryetarit të trupit gjykues. Prishjet e rendit nga avokati _______________, janë evidentuar në këtë procesverbal sikurse edhe vërejtjet që i janë shqiptuar paraprakisht.

Për arsye se avokati ___________________, ka prishur rendin dhe nuk u është bindur urdhrave të kryetarit të trupit gjykues dhe në aplikim të nenit 302, par. 1. të KPP-së, kryetari i trupit gjykues i ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej 500,00 € me bindje se kjo do të jetë masë e mjaftuar për vetëdijesimin që ky avokat të respektojë rendin dhe rregullin në shqyrtimin gjyqësor.

Megjithatë, avokati ___________________________, edhe pas shqiptimit të dënimit, ka vazhduar me prishjen e rendit, ashtu që:

| |
|---|
| *Shënohen veprimet e avokatit me të cilat ka vazhduar të prish rendin.* |

Sipas nenit 302, par. 3 të KPP-së, kur avokati edhe pasi që i është shqiptuar dënimi me gjobë vazhdon të prish rendin në shqyrtimin gjyqësor, i mohohet e drejta për mbrojtje dhe përfaqësim të klientit të tij.

Prandaj, kryetari i trupit gjykues vendosi që avokatit të lartpërmendur t'i mohohet e drejta për mbrojtje të klientit të tij.

Sipas nenit 302, par. 3, kundër vendimit me të cilin avokatit i mohohet e drejta për mbrojtje të klientit të tij, nuk lejohet ankesë e veçantë.

**Kryetari i trupit gjykues,**

**___________________________**

**Njoftim për mbikëqyrësin e prokurorit të shtetit**
**(Neni 302, par. 4 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**PROKURORIA THEMELORE E PRISHTINËS**
**Kryeprokurorit**
**(PP. nr. __________2016)**

**Njoftim për prishjen e rendit në shqyrtimin gjyqësor nga prokurori**

Njoftoheni se prokurori _______________________, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në datën_______________________2016, ka prishur rendin, ashtu që:

| |
|---|
| *Shënohen veprimet e prokurorit.* |

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje penale është ndërprerë për shkak të prishjes së rendit nga prokurori i shtetit.

Gjykata kërkon nga mbikëqyrësi i prokurorit që ka prishur rendin në këtë shqyrtim gjyqësor që të caktojë një prokuror tjetër që do të përfaqësojë aktakuzën.

**Kryetari i gjykatës,**

_________________________

**Njoftim për Odën e Avokatit**
**(Neni 302 par. 4 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS**
**Kryetarit**

**Njoftim për prishjen e rendit në shqyrtimin gjyqësor nga avokati**

Njoftoheni se avokati _______________________, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur në datën _____________ 2016, ka prishur rendin ashtu që:

| |
|---|
| *Shënohen veprimet e avokatit.* |

Avokatit të lartpërmendur, gjykata i ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej 500,00 € dhe për shkak të vazhdimit të prishjes së rendit i ka mohuar të drejtën për mbrojtjen e klientit të tij.

**Kryetari i gjykatës,**

_________________________

**Njoftim për mosparaqitjen e prokurorit në shqyrtimin gjyqësor**
**(Neni 306 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**PROKURORIA THEMELORE E PRISHTINËS**
**Kryeprokurorit**
**(PP. nr. __________2016)**

**Njoftim për mos paraqitje të prokurorit në shqyrtimin gjyqësor nga prokurori**

Njoftoheni se _______________________, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të caktuar të mbahet në datën ______________ 2016, nuk është paraqitur prokurori.

Në shkresa të lëndës ka provë se prokurori është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e sotme.

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje penale është ndërprerë për shkak të mungesës së prokurorit të shtetit. Vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor është caktuar për datën _________ 2016, nga ora _____.

Gjykata kërkon nga mbikëqyrësi i prokurorit që për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor të sigurojë prezencën e prokurorit të shtetit.

**Kryetari i gjykatës,**

___________________________

**Urdhëresë për ndalim, arrestim dhe shoqërim të detyruar për të pandehurin (Neni 307 par. 1 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**POLICISË SË KOSOVËS**
**Stacioni Policor Qendra në Prishtinë**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në bazë të nenit 307, par. 1, të KPP-së, lëshon:

**URDHËRARREST**

I. Urdhërohet ndalimi, arrestimi dhe shoqërimi me detyrim për të pandehurin ________________________, i lindur në datën _____________, me numër personal _____________________, dhe me vendbanim në Prishtinë, rruga _______________, nr. ______.

Sipas kësaj urdhërese, i pandehuri duhet të sillet me detyrim në datën ___________, në këtë gjykatë, Objekti "D", salla nr. 17.

II. Nëse i pandehuri e arsyeton mungesën e tij para datës së arrestimit, sipas kësaj urdhërese, kryetari i trupit gjykues do ta revokojë këtë urdhëresë.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

___________________________

**Vendimi për caktimin e paraburgimit për të pandehurin për sigurimin e prezencës së tij në seancë dhe urdhëresa për ndalim, arrestim dhe dërgim në qendrën e paraburgimit.**
**(Në bazë të nenit 187 dhe 307, par. 2 të KPP-së)**

**(Ky vendim-aktvendim merret gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. KR. Nr. ______/2016**

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR**

Në bazë të nenit 187 dhe 307, par. 2 të KPP-së, trupit gjykues, merr këtë:

**AKTVENDIM**

I. Ndaj të pandehurit ______________________, i lindur në datën____________, me numër personal ________________ dhe me vendbanim në ___________________ rruga __________________, nr.___, CAKTOHET PARABURGIMI për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin gjyqësor.

   Paraburgimi i caktuar sipas këtij aktvendimi, zgjat deri sa të shpallet aktgjykimi por jo më shumë se një (1) muaj nga dita e ndalimit, përkatësisht arrestimit dhe dërgimit të tij në qendrën e paraburgimit.

II. Urdhërohet Policia e Kosovës që të pandehurin e lartpërmendur ta ndalojë, arrestojë dhe ta dërgojë në qendrën e paraburgimit.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që me rastin e arrestimit të tani të pandehurit, të njëjtin ta njoftojë me urdhëresën për ndalim dhe arrestim dhe t'i dorëzojë edhe aktvendimin me të cilin i është caktuar paraburgimi për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtim.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që menjëherë pas arrestimit dhe dërgimit të tani të pandehurit në qendrën e paraburgimit, ta njoftojë këtë gjykatë.

Arsyetimi i shkurtër.

Në shqyrtimin gjyqësor të caktuar të mbahet në datën _______________, i pandehuri edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt, nuk është paraqitur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Nga sjellja e tani të pandehurit rezulton se ai qartazi i shmanget paraqitjes në

shqyrtimin gjyqësor, prandaj, gjykata vendosi që ndaj tij të caktohet paraburgimi për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin kryesor.

Prokurori i shtetit, ka kërkuar caktimin e paraburgimit, për sigurimin e prezencës së të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

______________________________

**Urdhëresë për ndalim, arrestim dhe dërgimin e të pandehurit në qendrën e paraburgimit (Neni 307, par. 2 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**POLICIA E KOSOVËS**
**Stacioni Policor Qendra në Prishtinë**

**URDHËRESË**
**PËR NDALIM, ARRESTIM DHE DËRGIM TË TË PANDEHURIT NË QENDRËN E PARABURGIMIT**

I. Urdhërohet Policia e Kosovës që të pandehurin ____________________, i lindur në datën __________, me nr. personal ____________________, dhe me vendbanim në ________________, ta ndalojë, arrestojë dhe ta dërgojë në qendrën e paraburgimit.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që me rastin e arrestimit të tani të pandehurit ta njoftojë me urdhëresën për ndalim dhe arrestim dhe t'i dorëzojë edhe aktvendimin me të cilin i është caktuar paraburgimi për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtim.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që menjëherë pas arrestimit dhe dërgimit të tani të pandehurit në qendrën e paraburgimit, ta njoftojë këtë gjykatë.

II. Me këtë urdhëresë, duhet të njoftohen të gjitha vendkalimet kufitare të Republikës së Kosovës. Nëse sipas kësaj urdhërese i pandehuri ndalohet në ndonjërin prej vendkalimeve kufitare të Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës- do ta njoftojë Stacionin Policor Qendra në Prishtinë, me qellim të organizimit të dërgimit të të pandehurit në qendrën e paraburgimit.

III. Kjo urdhëresë mbetet në fuqi deri në ditën e arrestimit të tani të pandehurit ose deri në ditën e revokimit të saj.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

____________________________

**Bashkëngjitur:** Aktvendimi për caktimin e paraburgimit, PKR. nr. ________/2016, i datës _________/2016, në dy kopje.

**Aktvendimi për caktimin e paraburgimit për sigurimin e prezencës së të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor**
**(Neni 307, par. 2 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. _________/2016
Dt. _________ 2016

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit _____________________________, kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve: 1. ____________________ dhe 2. ____________________, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor ___________________, në çështjen penale të tani të pandehurit ____________________, të cilin e mbron avokati ___________________, nga __________________, për shkak të veprës penale _______________________, nga neni _________ të KP të RK-së, sipas aktakuzës së PS të Republikës së Kosovës, në seancën e datës __________________, dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, në bazë të nenit 187 dhe 307, par. 2 të KPP-së, mori këtë:

**AKTVENDIM**
**PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT NDAJ TË PANDEHURIT**

I. Ndaj të pandehurit ________________________, i lindur në datën ____________, me numër personal ________________ dhe me vendbanim në ________________, rruga ___________________________, nr.___, CAKTOHET PARABURGIMI për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin gjyqësor.

   Paraburgimi i caktuar sipas këtij aktvendimi, zgjatë deri sa të shpallet aktgjykimi por jo më shumë se një (1) muaj nga dita e ndalimit, përkatësisht arrestimit dhe dërgimit të tij në qendrën e paraburgimit.

II. Urdhërohet Policia e Kosovës që të pandehurin e lartpërmendur ta ndalojë, arrestojë dhe ta dërgojë në qendrën e paraburgimit.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që me rastin e arrestimit të tani të pandehurit, ta njoftojë me urdhëresën për ndalim dhe arrestim dhe t'i dorëzojë edhe aktvendimin me të cilin i është caktuar paraburgimi për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtim.

   Policia e Kosovës e ka për obligim që menjëherë pas arrestimit dhe dërgimit të tani të pandehurit në qendrën e paraburgimit, ta njoftojë këtë gjykatë.

III. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, është në zhvillim procedura penale kundër tani të pandehurit ___________________, i cili është akuzuar nga PS e RK-së për shkak të veprës penale _______________________, nga neni ________ të KP të RK-së.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, është caktuar të mbahet për datën _______________ 2016, në ora _______. Gjykata i ka dërguar të pandehurit ftesën në mënyrë të rregullt. I pandehuri edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Nga sjellja e të pandehurit qartazi shihet se ai tenton që t'i shmanget prezencës në shqyrtimin gjyqësor.

Sipas nenit 307, par. 2 të KPP-së, kur i pandehuri tenton që t'i shmanget paraqitjes në shqyrtimin gjyqësor atëherë gjykata mund të caktojë paraburgimin për sigurimin e prezencës së tij në shqyrtimin gjyqësor.

Prandaj, për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. Nr. ________2016, dt. _________2016**

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë brenda afatit prej 24 orëve nga koha kur i pandehuri e pranon aktvendimin. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëpërmes kësaj gjykate.

**T'i dërgohet:** Policisë së Kosovës në tri (3) kopje: 1 kopje për të pandehurin, 1 kopje për qendrën e paraburgimit dhe 1 kopje për nevoja të policisë, dhe mbrojtësit të të pandehurit.

**Urdhëresë për shoqërim me detyrim për dëshmitarin-ose ekspertin**
**(Neni 309 par. 1 i KPP-së)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS
Departamenti për Krime të Rënda
PKR. Nr. __________/2016
Dt. _________ 2016

**POLICISË SË KOSOVËS**
**Stacioni Policor Qendra, në Prishtinë**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, në bazë të nenit 309, par. 1 të KPP-së, lëshon këtë:

**URDHËR**
**PËR SJELLJE ME DETYRIM PËR DËSHMITARIN-EKSPERTIN**

I. Urdhërohet shoqërimi me detyrim për dëshmitarin (ekspertin) _________________, me adresë të vendbanimit në Prishtinë, rruga _________________________, dhe i punësuar në ___________________, me seli në Prishtinë.

   Sipas kësaj urdhërese, dëshmitari (eksperti) duhet të sillet me detyrim në datën ___________, në këtë gjykatë, Objekti "D", salla nr. 17.

II. Nëse dëshmitari (eksperti) e arsyeton mungesën e tij, para datës së arrestimit sipas kësaj urdhërese, kryetari i trupit gjykues do ta revokojë këtë urdhëresë.

**Kryetari i trupit gjykues-**
**gjyqtari,**

___________________________

**Vendimi për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor**
**(Neni 310 i KPP-së)**

**(Ky vendim-aktvendim merret gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. KR. Nr. ______/2016**

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR**

Në bazë të nenit 310, par. 1 të KPP-së, sipas propozimit të prokurorit të shtetit, trupi gjykues merr këtë:

**AKTVENDIM**

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, shtyhet për kohë të pa caktuar për arsye të mbledhjes së provave të reja që kanë të bëjnë me paraqitjen e çrregullimeve mendore te i pandehuri për çka duhet të kryhen ekzaminimet përkatës nga eksperti i psikiatrisë forenzike.

Vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor, do të caktohet menjëherë pas sigurimit të provave të reja, përkatësisht konstatimi dhe mendimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e posaçme.

Arsyetimi i shkurtër:

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, mbrojtësi i të pandehurit e njoftoi gjykatën se te klienti i tij - tani i pandehur, në ndërkohë i është paraqitur çrregullimi mendor dhe për këtë arsye i kërkoi gjykatës që shqyrtimi të ndërpritet dhe të kërkohet mendimi i ekspertit të psikiatrisë lidhur me shëndetin mendor të tani të pandehurit.

Trupi gjykues, aprovoi kërkesën për sigurimin e provës së re, konform nenit 310, par. 1 të KPP-së, sepse çështja e çrregullimit mendor te tani i pandehuri, pretendohet se është paraqitur pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

**Kryetari i trupit gjykues,**

_________________________

**Procesverbal nga shqyrtimi gjyqësor**
**(neni 318-357 të KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. _______/20____**

**PROCESVARBAL NGA SHQYRTIMI GJYQËSOR PUBLIK**
- Seanca e dt. ___________20___ -
Koha e fillimit të seancës-ora ____:____

Përbërja e gjykatës:

Trupi gjykues - Kryetar i trupit gjykues: Gjyqtari ___________________

Anëtar të trupit gjykues: Gjyqtari _______________ dhe Gjyqtari ________________.

Procesmbajtës/e: Zyrtari ligjor __________________________________

Palët, në këtë procedurë penale janë:

Paditës: Prokuroria Themelore e Prishtinës,

I akuzuari ________________________, - mbrojtës Av. ______________________ (sipas autorizimit),

I dëmtuari ________________________, - përfaqësues: Av. ___________________ (me autorizim).

Lënda e shqyrtimit: Veprat penale,

1. __________________________ nga neni ____ par. ___ dhe ___ të KP të RK-së, dhe

2. __________________________ nga neni ____ par. ___ dhe ___ të KP të RK-së.
**(shënohen të gjitha veprat penale për të cilat mbahet shqyrtimi gjyqësor)**

Procedura penale në këtë çështje penale zhvillohet sipas aktakuzës së **(shënohet se cila prokurori ka ushtruar aktakuzën)** në Prishtinë - me shenjën _______/20____ të dt. _____________.

Kryetari i trupit gjykues e hap shqyrtimin kryesor, kumton lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e gjykatës duke theksuar emrin dhe mbiemrin e kryetarit të trupit gjykues, të anëtarëve të trupit gjykues si dhe të procesmbajtëses.

Palët nuk kanë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se në seancën e sotme, janë prezent:
(shënohen emrat e të gjitha palëve) p.sh.

Prokurori i shtetit____________________,

I akuzuari ___________________________,

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. __________________,

I dëmtuari ______________ dhe përfaqësuesi i Av. __________________.

Dëshmitarët (nëse janë ftuar).

Kryetari i trupit gjykues, konstaton se shqyrtimi gjyqësor është i hapur për publik.
**(në rast se ka kërkesë të bazuar për përjashtimin e publikut, kryetari i trupit gjykues duhet të vendosë duke aplikuar nenin 294 të KPP-së dhe sipas nenit 71 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur)**

**(nëse për këtë seancë nuk ka dëshmitar të ftuar, shënohet se: Për këtë seancë nuk është ftuar asnjë dëshmitar)**

***Rasti kur shqyrtimi ka filluar, për shkaqe të ndryshme është ndërprerë dhe duhet të fillojë rishtas:***

*Prokurori publik i propozon gjykatës që shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale, të mbahet në mungesë të dëshmitarëve, sepse në seancat e mëparshme janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët që janë propozuar nga palët.*

*Prokurori i shtetit i propozon gjykatës që në këtë shqyrtim gjyqësor, të lexohen deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që janë dëgjuar në seancat e mëhershme.*

*Mbrojtësi i të akuzuarit, Av.________________, deklaron se pajtohet me propozimin që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve që janë dëgjuar në seancat e mëhershme dhe përsërit propozimin që si prova të administrohen të gjitha dokumentet që i janë bashkangjitur parashtresës së mbrojtësit të akuzuarit, të dt. ___________ prej nr. ___ deri në ____.*

*Prokurori i shtetit nuk e kundërshton propozimin që si prova të administrohen edhe dokumentet që i janë bashkangjitur parashtresës së dt. _____________.*

*Përfaqësuesi i të dëmtuarës nuk i kundërshton propozimet e Prokurorit të shtetit dhe të Mbrojtësit të akuzuarit.*

*I akuzuari nuk i kundërshton propozimet e Prokurorit të shtetit dhe të Mbrojtësit të akuzuarit.*

*Në bazë të nenit 311 dhe 338 të KPP të RK-së, Gjykata merr këtë:*

***AKTVENDIM***

*Shqyrtimi kryesor në këtë çështje penale do të fillojë rishtazi.*

*Në këtë shqyrtim kryesor, nuk do të ftohen dëshmitarët dhe ekspertët të cilët janë dëgjuar më herët por do të lexohen deklaratat e tyre të dhëna në seancat e më parme.*

Ftohet i akuzuari ____________________, për verifikimin e identitetit të tij.

I akuzuari _________________________, me të dhëna personale si në aktakuzën PP. nr. _________/20_____ të dt. ________________, në paraburgim gjendet nga data _______________.

Kryetari i trupit gjykues e fton të akuzuarin që me vëmendje të përcjell shqyrtimin gjyqësor dhe e udhëzon se ka të drejtë të paraqes fakte, t'u shtrojë pyetje dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të jap vërejtje dhe shpjegime rreth deklarimeve të tyre, se ka të drejtë të mos deklarohet lidhur me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë pyetje, nëse deklarohet lidhur me çështjen nuk detyrohet që të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë, dhe se mund të mbrohet personalisht ose nëpërmes ndihmës juridike të mbrojtësit të tij sipas zgjedhjes së tij.

Kryetari i trupit gjykues e udhëzon të dëmtuarin se ka të drejtë që të paraqesë kërkesë pasurore juridike dhe mund të paraqesë propozim për realizimin e kësaj të drejte në procedurën penale.

Nga salla e gjykimit largohen dëshmitarët dhe udhëzohen që të presin në vendin e caktuar për ta, deri sa të ftohen për dëgjim.

Ftohet Prokurori i shtetit për leximin e Aktakuzës.

Prokurori i shtetit ____________________________________e lexoi aktakuzën PP. nr. ____________/20____ e dt. __________.

Ftohet i dëmtuari _____________________ që të deklarohet në lidhje me kërkesën pasurore juridike.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, Av. ______________________, deklaron se paraqet kërkesë pasurore juridike të cilën do ta realizojë në procedurë kontestimore.

Ftohet i akuzuari që të deklarohet se a e ka kuptuar Aktakuzën.

I akuzuari deklaron se e ka kuptuar Aktakuzën.

Ftohet i akuzuari të deklarohet nëse e pranon ose jo fajësinë.

I akuzuari deklaron se: E pranoj kryerjen e vrasjes si akt por nuk e pranoj kualifikimin juridik të veprës penale.

Gjykata konstaton se i pandehuri nuk e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar.

**Vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor kur i akuzuari në fillim të shqyrtimin gjyqësor e pranon fajësinë: veprohet në bazë të nenit 326 të KPP-së.**

Shqyrtimi gjyqësor vazhdon me prezantimin e provave.

Gjykata cakton këtë rend të prezantimit të provave:

1. Fjala hyrëse e palëve:
   - Prokurori i shtetit,
   - I dëmtuari, përkatësisht përfaqësuesi, dhe
   - mbrojtësi i të akuzuarit
2. Prezantimi i provave të propozuara nga prokurori i shtetit,
3. Prezantimi i provave të propozuara nga i dëmtuari,
4. Prezantimi i provave të propozuara nga mbrojtësi apo i akuzuari,
5. Prezantimin e provave që gjykata i konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale, dhe
6. Prezantimi i fjalës përfundimtare.

Ftohet Prokurori i shtetit që të prezantojë fjalën hyrëse.

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse deklaron:

Prokuroria e shtetit në këtë çështje penale propozon të administrohen këto prova materiale:
**(shënohen emrat e dëshmitarëve dhe të gjitha provat materiale, të renditura me numra rendor, të cilat Prokurori i shtetit propozon që të administrohen deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor)**

Prokurori i shtetit, propozon leximin e deklaratave të dëshmitarëve dhe ekspertëve, të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale - në seancat e më parme, si vijon:
**(shënohen të gjitha deklaratat e dëshmitarëve apo edhe të ekspertëve që janë dhënë në ndonjë fazë të procedurës së mëhershme penale e të cilat prokurori i shtetit i propozon që të lexohen)**

Ftohet përfaqësuesi i të dëmtuarit që të prezantojë fjalën hyrëse.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, Av. ____________________ në fjalën hyrëse deklaron se:
**(Shënohet deklarata e të dëmtuarit e cila mund të jetë në drejtim të provave që e mbështesin rastin dhe kërkesën e tij pasurore juridike)**

Mbrojtësi i të akuzuarit, Av. __________________ në fjalën hyrëse deklaron:
**(Shënohet deklarata e mbrojtësit të akuzuarit e cila përfshinë edhe provat me të cilat mbrojtja konsideron se do të vërtetojë pafajësinë e të mbrojturit të tij, tani të akuzuarit)**

Paraqitja e provave:
Kryetari i trupit gjykues cakton radhën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve:
- në fillim do të dëgjohen dëshmitarët e propozuar nga Prokurori i shtetit,
- dëshmitarët e propozuar nga i dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave,
- dëshmitarët e propozuar nga i akuzuari apo mbrojtësi i tij.

Dëshmitarët do të thirren për dëshmi, sipas radhës së propozuar nga palët.

Ftohet dëshmitari:
(identifikimi i dëshmitarit)
**(Kryetari i trupit gjykues mund t'i kërkojë dëshmitarit dhënien e betimit në bazë të nenit 340 të KPP-së, udhëzohet konform nenit 125 dhe 127 të KPP-së dhe i tërheq vërejtjen për pasojat e dëshmisë së rreme, konform nenit 390 dhe 391 të KP të RK-së)**

Marrja në pyetje e dëshmitarit.
Marrja e drejtpërdrejt në pyetje e dëshmitarit - konform nenit 333 dhe 336 të KPP-së.
Marrja e tërthortë në pyetje e dëshmitarit - konform nenit 334 dhe 336 të KPP-së.
Rimarrja në pyetje e dëshmitarit - konform nenit 335 dhe 336 të KPP-së.

Leximi i provave materiale - konform nenit 337 dhe 338 të KPP-së
Lexohen provat materiale:
**(Shënohet se cila provë është lexuar dhe vërejtjet e palëve)**

Lexohen deklaratat e dëshmitarëve, të dhëna në seancat e më parme:
**(Shënohet se cila deklaratë është lexuar dhe vërejtja e palëve)**

Vërejtjet e palëve:

Deklarimi i ekspertit - konform nenit 341 të KPP-së
**(kryetari i trupit gjykues mund t'i kërkojë dëshmitarit dhënien e betimit në bazë të nenit 340 të KPP-së, udhëzohet konform nenit 125 dhe 127 të KPP-së dhe i tërheq vërejtjen për pasojat e dëshmisë së rreme, konform nenit 390 dhe 391 të KP të RK-së)**

Administrimi i provave, konform nenit 343 të KPP-së
**(marrja në pyetje e dëshmitarit i cili nuk mund të vijë në gjykatë, kur është e nevojshme të zbatohet këqyrja ose rikonstruktimi jashtë shqyrtimit gjyqësor-**

**vendimi për këto veprime shënohet në procesverbal dhe pas përfundimit të këtyre veprimeve po ashtu në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor rezultatet e këtyre veprimeve-deklarata e dëshmitarit etj.)**

Leximi i deklaratave të mëparshme dhe riprodhimi i regjistrimeve, konform nenit 344 të KPP-së.
Në bazë të nenit 337 dhe 344, sipas propozimit të __________________________, Gjykata merr këtë:

**AKTVENDIM**

Pranohet propozimi i Mbrojtësit të të akuzuarit që të administrohen si prova dokumentet e bashkangjitura në parashtresën e dt. ____________ prej numrit rendor ____ deri në ____.

U lexuan dokumentet e bashkangjitura në parashtresën e dt. _______________prej numrit rendor ___ deri në ______.
**(shënohen vërejtjet e palëve nëse ka)**

Palët nuk kanë propozime tjera për prezantimin e provave.

**Shqyrtimi gjyqësor vazhdon me marrjen në pyetje të të akuzuarit ____________, i cili nuk e ka pranuar fajësinë.**

Ftohet i akuzuari: ________________________________, dhe ftohet Mbrojtësi i tij që ta merr në pyetje, në pajtim me nenin 333 të KPP-së.
**(marrja e drejtpërdrejtë në pyetje)**

Ftohet Prokurori i shtetit që ta marrë në pyetje të Akuzuarin, në pajtim me nenin 334 të KPP-së.
**(marrja e tërthortë në pyetje)**

Ftohet i dëmtuari që ta marrë në pyetje të Akuzuarin, në pajtim me nenin 334 të KPP-së.
**(marrja e tërthortë në pyetje)**

Gjykata i lejon Mbrojtësit të të akuzuarit që të mbrojturin e tij ta rimarrë në pyetje, në pajtim me nenin 335 të KPP-së.
**(rimarrja në pyetje-rehabilitimi i dëshmisë)**

Palët nuk kanë propozime tjera për prezantimin e provave.

Lexohen të dhënat penale për të akuzuarin.

**Fjala përfundimtare e palëve**

Fjala përfundimtare e Prokurorit të shtetit, në pajtim me nenin 353 të KPP-së.

Fjala përfundimtare e të dëmtuarit ose e përfaqësuesit të të dëmtuarit, në pajtim me nenin 354 të KPP-së.

Fjala përfundimtare dhe komentet në emër të të akuzuarit, në pajtim me nenin 355 të KPP-së (e paraqet mbrojtësi i të akuzuarit ose vet i akuzuari).

Komentet e Prokurorit të shtetit dhe të të dëmtuarit.

Fjala përfundimtare e të akuzuarit.

Palët nuk kanë diçka tjetër për të shtuar.

Në bazë të nenit 357 par. 2 të KPP-së, Kryetari i trupit gjykues shpall shqyrtimin gjyqësor të përfunduar.

Trupi gjykues tërhiqet për këshillim dhe votim për marrjen e aktgjykimit.

Kryetari i trupit gjykues i njofton palët se aktgjykimi do të shpallet më datën: ____________ në ora: _________ në të njëjtin vend.

Jepet urdhër që i akuzuari të sjellët nga Qendra e paraburgimit.
Shqyrtimi përfundoi në ora _________.

Vërtetojnë:

**Procesmbajtësja,**

**Kryetari i trupit gjykues/**
**Kryetari i gjykatës,**

**Palët: Prokurori i shtetit,**

**I dëmtuari,**

**I akuzuari,**

**Mbrojtësi i të akuzuarit/avokati,**

**Aktgjykimi burimor**
**(Aktgjykimi burimor gjithherë shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe merret konform nenit 359 të KPP-së)**

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Trupi gjykues (ose gjyqtari individual) u tërhoq për këshillim dhe votim, dhe më datën _________ 2016 vendosi dhe shpalli në të njëjtën ditë publikisht këtë:

**AKTGJYKIM**

I akuzuari: ________________ me të dhënat personale si në shkresa të lëndës,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

1. Në dt. ______________ rreth orës ____________, ____________________________
______________________________________________________________________
_____________________________________________________________________ -,
**(në dispozitiv të aktgjykimit shënohet se si i akuzuari e ka kryer veprën penale)**

- me këtë veprim, ka kryer veprën penale: _____________________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së,

2. Në dt. _______________ rreth orës _____________ në ______________________,
______________________________________________________________________
_____________________________________________.

Me këtë veprim, ka kryer veprën penale ____________________________________
_______________________ nga neni ____ par. ____ të KP të RK-së.

Prandaj, kjo Gjykatë në bazë të nenit ____, ____, ____, ____, ____, ____, ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, nenit ____ par. ___ të KP të RK-së të akuzuarit ____________________ **për secilën vepër penale** i shqipton dënimin, si vijon:

- Për veprën penale: ___________________________ nga neni ____ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, i shqipton **dënimin me burgim** në kohëzgjatje prej _______________ **(__) vjet**,

- Për veprën penale: ____________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së, i **shqipton dënimin me burg** në kohëzgjatje prej **një (1) vjet**.

Në bazë të nenit ____, ____, ____, ____, ____, ____, ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, nenit ____ par. ___ të KP të RK-së, si dhe të nenit ____,

____, ____, ____, ____, dhe ____, të KPP-së të akuzuarit __________________ për të gjitha veprat penale i shqipton,

**DËNIMIN UNIK**
**DËNIMIN ME BURGIM**

**Të akuzuarit: ___________________,** i shqipton **dënimin unik - dënim me burgim** në kohëzgjatje prej: ___________________ **(__) vjet,** të cilin do ta mbajë pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data: ________________ e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim.

I/E dëmtuari/a: _______________, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari: _________________ që të kompensojë shpenzimet e Procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për angazhimin e ekspertëve, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë: ____,__euro (edhe me fjalë), brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit ____ të KP-së të RK-së, të akuzuarit: ___________________ i shqiptohet edhe

**DËNIMI PLOTËSUES-KONFISKIM I SENDIT**

Të akuzuarit: _________________ i konfiskohet (shënohet se çka konfiskohet) si send i përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

_____________________________

Me rastin e marrjes së Aktgjykimit, Trupi gjykues, në bazë të nenit 367, par. 2 të KPP-së, në lidhje me paraburgimin pas shpalljes së aktgjykimit, merr këtë:

**AKTVENDIM**

Ndaj të akuzuarit: _________________________, i **vazhdohet** paraburgimi edhe pas shpalljes së Aktgjykimit, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar sipas këtij Aktgjykimi.

**Shpallja e Aktgjykimit**
**(Neni 366 i KPP-së)**

**- Shpallja e aktgjykimit është veprim i detyruar për gjykatën dhe akti i shpalljes së aktgjykimit shënohet në përfundim të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor -**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, përkatësisht Trupi gjykues, i kryesuar nga gjyqtari: ____________________ në datën: __________ 2016, në ora:___________, publikisht, në prani të palëve, shpalli aktgjykimin PKR. Nr. _______/16 të datës:___________ 2016.

Pas shpalljes së Aktgjykimit, Kryetari i trupit gjykues, shkurtimisht paraqiti arsyet e aktgjykimit.

Kryetari i Trupit gjykues, i udhëzoi palët për të drejtën në ankesë si dhe detyrimin e palëve që deri në përfundimin e procedurës penale, Gjykatën ta njoftojnë për çdo ndryshim të adresës.

**Vërtetojnë:**

**Zyrtari ligjor:**

_________________________

**Kryetari i trupit gjykues-**
**Gjyqtari**

_________________________

**Aktvendim për Vazhdim të paraburgimit pas shpalljes së Aktgjykimit**
**(Neni 367 par. 2 të KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. _______/20__**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit: _________________ - Kryetar i trupit gjykues, dhe anëtarëve të trupit gjykues: Gjyqtares: _____________________________ dhe Gjyqtarit: ______________________, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses: _______________, në çështjen penale kundër të akuzuarit: ______________, nga fshati: _____________, Komuna e _____________ tani me vendbanim në Prishtinë, lagja ____________, të cilin (sipas autorizimit) e mbron Av. __________________________, me seli në Prishtinë, rruga "______________" nr. ________, për shkak të veprave penale: 1. Vrasje e rëndë nga neni 147 nën paragrafi 3 dhe 9 të KPK-së, dhe 2. Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 328 par. 2 të KPK-së i akuzuar nga PPQ-ja në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës: PP. nr. _________/20____ të dt. ______________, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në dt. _____________, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit: _______________, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, e dëmtuara _____________ dhe përfaqësuesi i saj, Av. _________________, në dt. ______________ me rastin e marrjes së aktgjykimit dhe vendosjes për paraburgimin pas shpalljes së aktgjykimit, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Ndaj të akuzuarit: _____________________________, emri i babës: ___________ emri i nënës: ___________, mbiemri i vajzërisë: ________________, i lindur në dt. _____________, në fshatin: _________________, Komuna e _________________, tani me vendbanim në Prishtinë, lagja ______________, rruga "______________" p.n. ka të kryer shkollimin: _____________________ i pamartuar, në gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim gjendet nga data: ___________________, i VAZHDOHET PARABURGIMI, nga dita e shpalljes së Aktgjykimit PKR. nr. ___________/2014, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

II. Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

**Arsyetim**

Në çështjen penale të të akuzuarit: ______________________________, Gjykata Themelore në Prishtinë, në datën: ______________ 2015, ka shpall aktgjykimin me të

cilin i akuzuari i lartpërmendur është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej ____ vjet (**5 apo më shumë vjet**).

Në bazë të nenit 367, par. 2 të KPP-së, në rastet kur gjykata shqipton dënimin me burg prej 5 apo më shumë vjet, cakton paraburgimin ndaj të akuzuarit nëse nuk gjendet në paraburgim, ose ia vazhdon paraburgimin kur i akuzuari gjendet në paraburgim.

Tani, i akuzuari gjendet në paraburgim, prandaj duke vepruar sipas nenit 367, par. 2 të KPP-së, Gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me burg prej _____ vjet, vendosi që të njëjtit t'ia vazhdojë paraburgimin edhe pas shpalljes së Aktgjykimit.

Në bazë të nenit 367, par. 7 të KPP-së, paraburgimi i vazhduar pas shpalljes së aktgjykimit zgjat deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

**Në rastet kur i akuzuari nuk gjendet në paraburgim dhe trupi gjykues gjen se ka bazë për caktimin e paraburgimit, në pajtim me nenin 187, par. 1 të KPP-së, atëherë me aktvendim të veçantë, i cili merret me rastin e shpalljes së aktgjykimit, ia cakton paraburgimin në bazë të nenit 367, par. 3 të KPP-së.**

Në bazë të nenit 367, par. 6, ankesa kundër aktvendimit me të cilin vazhdohet paraburgimi pas shpalljes së aktgjykimit nuk e pezullon ekzekutimin e Aktvendimit.

Për sa u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. ___________/2015 dt. ________2016**

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij Aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit 3 ditor, (ose: brenda 3 ditëve) nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet nëpërmjet kësaj gjykate.

**Aktgjykimi**
**(në bazë të nenit 369, të KPP-së)**

**- Aktgjykimi i përpiluar me shkrim në dispozitiv përmban komplet aktgjykimin burimor sikurse është në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor -**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. ____/20___**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -** Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje prej gjyqtarit: ______________, - kryetar i trupit gjykues dhe anëtarëve të trupit gjykues: Gjyqtares _________________ dhe Gjyqtarit ______________, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses _____________, në çështjen penale kundër të akuzuarit _______________ nga fshati ______________ Komuna e ______________ tani me vendbanim në Prishtinë, lagja ____________ të cilin (sipas autorizimit) e mbron Av. _________________________________, me seli në Prishtinë, rruga "_____________________________" nr. ________, për shkak të veprave penale: 1. __________________________________________ nga neni _______ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të RK-së, dhe 2. ______________________________________ _____________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së i akuzuar nga Prokuroria ________________________________ në Prishtinë, sipas aktakuzës PP. nr. __________/20____ të dt. ___________, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur në dt. _____________ në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit _______________, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, e dëmtuara ________________ dhe përfaqësuesi i saj Av. _______________, në dt. _______________ vendosi dhe të njëjtën ditë publikisht, në prezencë të të gjitha palëve, shpalli këtë:

**A K T GJ Y K I M**

I akuzuari _______________ emri i babës: ____________, emri i nënës ___________, mbiemri i vajzërisë _________________, i lindur në dt. _____________ në fshatin ____________________ Komuna e ______________________ tani me vendbanim në Prishtinë lagja _____________________, rruga "______________________" p.n., me numër personal _________________________________ ka të kryer shkollimin ______________________ (gjendja statusore-nëse ka fëmijë) punësuar (ose jo), me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim gjendet nga data ___________________ e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse;

1. Në dt. _____________ rreth orës ____________ në _________________________, _________________________________________________________________________ _________________________________________________________________________ ______________________________ -,
**(në dispozitiv të aktgjykimit shënohet se si i akuzuari e ka kryer veprën penale)**

- me këtë veprim, ka kryer veprën penale: _____________________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së,

2. Në dt. ______________ rreth orës _____________ në _______________________, _________________________________________________________________________ ______________________,

me këtë veprim, ka kryer veprën penale ____________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së.

Prandaj, kjo Gjykatë, në bazë të nenit ____, ____, ____, ____, ____, ____, ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP-së të RK-së, nenit ____ par. ___ të KP-së të RK-së të akuzuarit ____________________ **për secilën vepër penale** i shqipton dënimin, si vijon:

- Për veprën penale: ___________________________, nga neni ____ nën paragrafi ___dhe __ të KP të RK-së i shqipton **dënimin me burgim** në kohëzgjatje prej **_______________ (__) vjet**,

- Për veprën penale: ____________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së i **shqipton dënimin me burg,** në kohëzgjatje prej **një (1) vit**.

Në bazë të nenit ____, ____, ____, ____, ____, ____, ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP-së të RK-së, nenit ____ par. ___ të KP-së të RK-së, si dhe të nenit ____, ____, ____, ____, ____, dhe ____, të KP-së të akuzuarit _____________ për të gjitha veprat penale i shqipton,

**DËNIMIN UNIK**
**DËNIMIN ME BURGIM**

**Të akuzuarit ________________** i shqipton **dënimin unik - dënim me burgim** në kohëzgjatje prej _________________ **(__) vjet,** të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data ________________ e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim.

E dëmtuara _______________ për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari ________________ që të kompensojë shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për angazhimin e ekspertëve, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë ____,__euro (edhe me fjalë:) brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit ___ të KP-së të RK-së të akuzuarit ___________________ i shqiptohet edhe

## DËNIMI PLOTËSUES-KONFISKIM I SENDIT

Të akuzuarit ________________ i konfiskohet (shënohet se çka konfiskohet) si send i përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

## Arsyetim

Prokuroria __________________ në Prishtinë - me Aktakuzën PP nr. ________/_____ të dt. __________ e ka akuzuar tani të akuzuarin ____________________ për shkak të veprave penale 1. ___________________________________ neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP-së të RK-së, dhe

2. ________________________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së.

Prokurori i shtetit deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë aktakuzës.

E dëmtuara _________________ personalisht dhe nëpërmes të përfaqësuesit të saj av. ___________________ ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike lartësinë e së cilës deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk e ka precizuar.

I akuzuari ____________________________________ për sa i përket veprës penale __________________________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së ka deklaruar se pranon kryerjen e veprimeve ashtu sikurse janë theksuar në aktakuzë por jo edhe kualifikimin juridik të veprës penale.

Në lidhje me këtë deklarim të të akuzuarit, Gjykata ka konstatuar se nuk ka pranim të fajësisë nga i akuzuari për veprën penale nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ lidhur me nenin ____ të KPK-së.

Për sa i përket veprës penale, nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së, i akuzuari _____________ e ka pranuar fajësinë.

Në lidhje me pranimin e fajësisë, nga tani, i akuzuari për veprën penale nga neni ____ par. ___ të KPK-së, Gjykata ka konstatuar se tani i akuzuari e kupton natyrën dhe

pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftuar me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka ndonjë rrethanë që e përjashton nga ndjekja apo përgjegjësia penale tani të të akuzuarin.

Për sa i përket veprës penale _____________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, tani i akuzuari, ka deklaruar se **(shënohet deklarata e të akuzuarit)**.

**- në rast se në fillim apo gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar dhe caktuar ekspertizë nga ana e ekspertit të psikiatrisë forenzike në lidhje me shëndetin mendor të të akuzuarit në aktgjykim shënohen edhe rezultatet e ekspertizës -**

Gjykata ka caktuar ekzaminimin psikiatrik tani të të akuzuarit ________________ dhe ka urdhëruar ekspertin e psikiatrisë forenzike, Dr. ____________________ që të kryejë ekspertimin dhe gjykatës t'i prezantojë konstatimin dhe mendimin e tij në lidhje me shëndetin mendor tani të të akuzuarit dhe aftësisë së tij për gjykim.

Eksperti i psikiatrisë forenzike Dr. _____________________ në konstatimin dhe mendimin e tij të prezantuar më dt. ________________ (ekspertiza me nr. 276) veç tjerash ka konstatuar se tani te i akuzuari _________________ nuk është konstatuar sëmundje mendore ose çrregullime mendore të natyrës së përhershme ose të përkohshme. Në kohën e kryerjes së veprës penale ("Tempora criminis") e ka pasur aftësinë për të gjykuar për rëndësinë e veprës.

Në shqyrtimin kryesor publik - seanca e dt. ___________________,Gjykata ka dëgjuar mendimin e psikiatrit forenzik Dr. _____________________ i cili pas ekzaminimit tani të të akuzuarit ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij se tani i akuzuari është i aftë për të përballuar gjykimin, se ky i akuzuar nuk ka të meta mendore, në kuptim të nenit 12 pika 1 të KP të RK-së, dhe se "tempora criminis" e ka pasur aftësinë për të gjykuar për rëndësinë e veprës.

Në shqyrtimin kryesor publik në këtë çështje penale, Gjykata, konform nenit 7 dhe 387 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Në këtë çështje penale, gjatë shqyrtimit kryesor, janë prezantuar këto prova materiale: Konstatimi dhe mendimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike, Dr. _________________ i dhënë sipas urdhëresës së Gjykatës në formën e shkruar dhe mendimit të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor (dt. __________________) në lidhje me shëndetin mendor, të tani të akuzuarit, ________________, Raportin mbi shikimin në vendin e ngjarjes me shenjën 2011-_______ VN, Skicës nga vendi i ngjarjes sipas Raportit të Policisë me

shenjën __________________, Vërtetimi mbi sekuestrimin e armës, Raportin e ekzaminimit të armës nga Laboratori i Forenzikës me nr. ______________________, dhe Raporti mbi autopsinë për tani të ndjerin _________________ me shenjën ________________, provat materiale të prezantuara nga mbrojtësi i të akuzuarit që i janë bashkangjitur parashtresës së dt. _______________ prej numrit rendor ___ deri në ___, si dhe dëgjoi dëshmitarët: ____________________________________________
1. ____________________, 2. ____________________, 3. ____________________, 4. _____________________, dhe 5. _____________________.

Eksperti i psikiatrisë forenzike, Dr. _________________________ në konstatimin dhe mendimin e tij të dhënë, në dt. ______________ (konstatimi me nr. 276) veç tjerash ka theksuar se:

**(Shënohet konstatimi dhe mendimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike të dhënë në formën e shkruar).**

Eksperti i psikiatrisë forenzike, në seancën e dt. ______________, ka deklaruar se mbetet pranë konstatimit dhe mendimit të dhënë në formën e shkruar dhe ka elaboruar këtë konstatim dhe mendim, duke theksuar veç tjerash se:
**Shënohet konstatimi dhe mendimi i ekspertit të psikiatrisë forenzike i dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe posaçërisht mendimi i ekspertit për të akuzuarin se a kishte aftësinë e të gjykuarit për rëndësinë e veprës që e kishte kryer.**

Dëshmitarja ________________________________ në deklaratën e saj të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se:
**(shënohet deklarata e dëshmitares-ajo pjesë që është me rëndësi për aktgjykim-jo në formën e kopjimit të deklaratës nga procesverbali)**

Dëshmitari _________________________________ në deklaratën e tij të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se:
**(shënohet deklarata e dëshmitarit-ajo pjesë që është me rëndësi për aktgjykim-jo në formën e kopjimit të deklaratës nga procesverbali)**

Dëshmitarja ________________________________ në deklaratën e saj të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se: **(shënohet deklarata e dëshmitares-ajo pjesë që është me rëndësi për aktgjykim-jo në formën e kopjimit të deklaratës nga procesverbali)**

Në raportin për shikimin e vendit të ngjarjes, me numër ___________________ të dt. ________________ Njësia e Forenzikës, ka konstatuar se:
**(shënohet konstatimi dhe mendimi nga njësia e forenzikës me rastin e shikimit të vendit të ngjarjes, apo të rikonstruktimit të ngjarjes)**

Sipas vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të dt. __________________, nga tani i akuzuari është konfiskuar_____________________________________________.

Në raportin e ekspertizës për ekspertimin e ______________________________ që i ishte konfiskuar tani të akuzuarit __________________________ është konstatuar se: ____________________
**(shënohet se si është përdor ky send**)

Në raportin për autopsinë e tani të ndjerit (**apo në raportin e ekspertit të mjekësisë ligjore lidhur me lëndimet trupore**) me shenjën ________________________ të dt. ____________ eksperti i mjekësisë ligjore Prof. as. dr. _____________________ ka dhënë konstatimin dhe mendimin se:
**(shënohet konstatimi dhe mendimi i ekspertit të mjekësisë ligjore në rastet kur çështja penale ka të bëjë me vrasje, apo lëndim trupor)**

Për sa i përket provave të prezantuara nga mbrojtësi i të akuzuarit - të bashkangjitura në parashtresën e datës _____________ (të evidentuara si prova prej nr. rendor ___ deri në ___)- kjo gjykatë ka konstatuar se këto prova mund të klasifikohen në dy lloje të provave: provat që dëshmojnë se:
**(shënohen provat e prezantuara nga mbrojtësi i të akuzuarit dhe elaborohen një për një duke dhënë arsyetime nga gjykata lidhur me konsideratën ndaj këtyre provave se a u jepet besimi këtyre provave apo jo me arsyetim)**

I akuzuari mbrojtjen e vet e ka prezantuar në seancën e dt. ________________, i cili veç tjerash - në kuptim të mbrojtjes - ka deklaruar se:
**(shënohet deklarata e të akuzuarit që në shqyrtimin gjyqësor e prezanton në kuptim të mbrojtjes)**

I akuzuari _____________________________, në deklaratën e dhënë në polici me dt. _____________ me fillim në ora ___:___ në prezencën e mbrojtësit të tij Av. ___________________ - deklaratë kjo që është përdorur nga prokurori publik gjatë shqyrtimit kryesor për të kundërshtuar një pjesë të deklarimit të tani të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor,- veç tjerash ka deklaruar se:
**(shënohet deklarata e të akuzuarit e dhënë më heret në polici apo në prokurori nëse ajo deklaratë është lexuar si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor)**

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare veç tjerash ka deklaruar**: "_____________ ____________________________________".**

Edhe nga deklarata e vet të akuzuarit, përtej çdo dyshimi, vërtetohet se:
**(shënohet se çka gjykata e konsideron si të vërtetuar nga vet deklarimi i të akuzuarit)**

Në këto veprime, të tani të akuzuarit, manifestohen të gjitha elementet e veprës penale të _____________________________nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së. I akuzuari duke qenë plotësisht i vetëdijshëm dhe nga motive të ulëta, që manifestohen në faktin se **(shënohet se cilat ishin motivet që i akuzuari e kishte kryer veprën penale**), e kishte.

Gjykata analizoi edhe mbrojtjen e mbrojtësit të akuzuarit Av. _________________ sidomos për sa i përket pretendimeve të mbrojtjes se: ____________________________
_____________________________________________________________________________
______________________________________________________________.

Mbrojtja e tani të akuzuarit, tezën e mbrojtjes në tërësi, e mbështet në teorinë se (veprimi i të akuzuarit): ___________________________________ është rezultat i __________________________ të shkaktuara nga ____________________________.

Një mbrojtje të tillë kjo gjykatë nuk e aprovoi sepse provat e prezantuara, pa mëdyshje, provojnë të kundërtën e tezës së mbrojtësit të tani i akuzuarit - përkatësisht se ________________________________________.

Prandaj nga provat e prezantuara - dëshmi këto të ndërlidhura me njëra tjetrën përtej çdo dyshimi vërtetohet se tani i akuzuari për (shënohet motivi i kryerjes së veprës penale).
**(shënohet se përse gjykata e merr si të vërtetuar motivin e kryerjes së veprës penale).**

Në veprimet e tani të akuzuarit _________________ manifestohen të gjitha elementet si ato objektive ashtu edhe ato subjektive të veprës penale ______________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, dhe të veprës penale ________________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së.

Kjo gjykatë, pasi që vërtetoi se tani i akuzuari _________________ është penalisht përgjegjës dhe është fajtor për veprën penale _____________________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ___ dhe ___ të KP të RK-së, dhe të veprës penale _____________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së, e për të cilat është akuzuar, të njëjtin e shpalli fajtor, duke marrë në konsideratë dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat që janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryera, i shqiptoi: - Për veprën penale ________________________________________ nga neni ____ par. ___ nën paragrafi ________ dhe _______ të KP të RK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej ______________________________(__) vjet, dhe për veprën penale _____________ ________________________________________ nga neni ____ par. ___ të KP të RK-së, i shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej ___ (_) vjet.

Të akuzuarit __________________ kjo gjykatë për të gjitha veprat penale për të cilat është akuzuar dhe është shpallur fajtor në këtë çështje penale i shqiptoi dënimin unik - dënim me burgim në kohëzgjatje prej _______________ **(__) vjet** të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin e shqiptuar, i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data __________________ e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat që janë me ndikim konform nenit ____ të KP të RPK-së.

Kështu, për të akuzuarin ________________________ Gjykata si rrethanë lehtësuese gjen se:
**(shënohen rrethanat lehtësuese)**

Si rrethana rënduese për të akuzuarin ___________________ kjo gjykatë gjeti se:
**(shënohen rrethanat rënduese)**

Shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale vrasje e rëndë, e kryer nga tashmë i akuzuari, është e lartë, sepse në Kosovë pas lufte dukuria e privimit nga jeta e personit me qellim të _________________ është prezent, dhe vetëm me dënime adekuate mund të arrihet qëllimi i dënimit, veç tjerash, qëllimi i dënimit është që të parandalojë të tjerët nga kryerja e veprave penale.

Koha e kaluar në paraburgim i të akuzuarit, është llogaritur në dënimin e shqiptuar në bazë të nenit ____ të KP të RK-së.

Kjo gjykatë me aktvendim të posaçëm ka vazhduar paraburgimin, ndaj tani të akuzuarit, ______________ deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

E dëmtuara _________________ në lidhje me realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil konform nenit 458 dhe 462 të KPP të RK-së.

Vendimi për dënimin plotësues, konfiskim i sendit me të cilin është kryer vepra penale është marrë në bazë të nenit 68 të KP të RK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit është marrë konform nenit 450, të RK-së.

Për sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP të RK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**P. nr. _____/________ i dt. _____________**

**Procesmbajtësja:** **Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,**

____________________________ ______________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëpërmes të kësaj gjykate.

**Aktgjykimi me të cilin shqiptohet dënimi dhe refuzohet akuza**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. nr. ________/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -** Departamenti për Krime të Rënda me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari _______________ si kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve: 1. _______________________ dhe 2. __________________________ anëtarë të trupit gjykues me pjesëmarrjen e sekretarit juridike (zyrtarit ligjor) si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarave: 1. ________________________nga Prishtina të cilën sipas autorizimit e mbron av. _________________, dhe 2. _____________________ nga Fushë Kosova, të cilën sipas autorizimit e mbron av. ______________ nga Prishtina, për shkak të veprës penale: Shpërdorim i detyrës zyrtare ose të autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së të akuzuara nga PPQ në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës PP. nr. _______/2004 të dt. 03.10.2005 pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në dt. _______________, në të cilin kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit __________________, të akuzuarat dhe mbrojtësit e tyre, në dt. ________________, vendosi dhe të njëjtën ditë, publikisht, shpalli këtë:

**NË EMËR TË POPULLIT**

**AKTGJYKIM**

**I**

E akuzuara ________________________ emri i babës _______________ emri i nënës __________________ mbiemri i vajzërisë ______________________ e lindur në dt. ________________ në Prishtinë me vendbanim në Prishtinë, Lagja “______________” Rruga ____________________ nr. ____, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e ___________________________________ fëmijëve, e punësuar në _______________________________________ ku realizon të ardhura personale deri në lartësinë prej ________euro (_____,00 €) në muaj në shumë neto, me nr. personal _________________, mbrohet në liri,

**ËSHTË FAJTORE**

Sepse,

Në dt. ___________________ rreth orës 00:00-00:00, në zyrën e Kompanisë tregtare “________” në Prishtinë duke qenë në cilësinë e personit zyrtar __________________, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, përvetësoi shumën e parave prej ____________,00 euro, të cilat i janë besuar në bazë të kësaj detyre të punës, në atë mënyrë që:

**(përshkruhet mënyra se si është bërë përvetësimi i parave)**

Me këtë vepër, ka kryer veprën penale: Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të nenit 99, 102, 112, dhe 391 të KPPK-së, si dhe të nenit 33, 38, 64, 82, 83, dhe 340, par. 3, lidhur me par. 1, të KPK-së të akuzuarës _________________ i shqipton,

**DËNIMIN ME BURG**

Të akuzuarës ________________________, i shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej _________________ të cilin do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

VËRTETOHET se dobia pasurore përfituar me vepër penale, nga tani të akuzuarës ____________________ është në lartësi prej ______,00 EUR, dhe kjo shumë KONFISKOHET ashtu që OBLIGOHET e akuzuara ____________________ që të paguajë shumën e të hollave prej _______,00 EUR në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara, Kompania "_____________________", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil. Kërkesa pasurore-juridike në rast se paraqitet do të kompensohet nga shuma e konfiskuar me këtë aktgjykim.

Obligohet e akuzuara ___________________ që të kompensoi shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare kurse në emër të paushallit të paguajë 150,00 EUR në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

**II**

Ndaj të akuzuarës _______________________ emri i babës: _________________ emri i nënës _____________________ me mbiemrin e vajzërisë __________________ e lindur në _____________, në Prishtinë, tani me vendbanim në Prishtinë rruga "________________" nr. ___, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e një fëmije, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, e punësuar në Kompaninë "________________", realizon të ardhura personale në lartësi prej ____,00 EUR në muaj, me nr. personal _______________, mbrohet në liri.

Në bazë të nenit 363, par. 1, nën paragrafi 1.1, lidhur me nenin 339, par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

**REFUZOHET AKUZA**

Sepse, në dt. ______________________ rreth orës 00:00-00:00 në Kompaninë "___________" në Prishtinë, gjatë ushtrimit të detyrave të punës në këtë kompani, në bashkëkryerje me tani të akuzuarën __________________ me qellim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin
**(përshkruhet dispozitivi i aktakuzës)**

- me çka në bashkëkryerje me tani të akuzuarën ________________ kishte për të kryer veprën penale: Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Për arsye se prokurori publik, gjatë shqyrtimit kryesor, ka heq dorë nga aktakuza.

E dëmtuara "______________________" për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

**Arsyetim**

PPQ-ja në Prishtinë sipas aktakuzës PP. nr. ______________ të dt. ________ 2012, e ka akuzuar tani të akuzuarën ________________ dhe __________________ për shkak të veprës penale: Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së të kryer në dëm të Kompanisë "_________________" në Prishtinë.

E dëmtuara nëpërmes të përfaqësuesit të saj av. ___________________ ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike ndaj tani të akuzuarës ________________ për shumën prej ______,00 € ndërsa ndaj ______________ për shumën prej ______,00 €.

Në vazhdim të procedurës penale, aktakuzën e ka përfaqësuar Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Të akuzuarat ___________________ dhe __________________ nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Në shqyrtimin kryesor, përfaqësuesi i të dëmtuarës, nuk ka marr pjesë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Prokurori i Shtetit, gjatë shqyrtimit kryesor, ka heq dorë nga ndjekja penale kundër të akuzuarës ________________.

E akuzuara ___________________ gjatë shqyrtimit kryesor në deklarimin e saj në kuptim të mbrojtjes, veç tjerash ka deklaruar se,
**(paraqitet deklarata e të akuzuarës e dhënë në shqyrtimin kryesor dhe në kuptim të mbrojtjes)**

E akuzuara ______________________ në deklaratën e saj të dhënë në polici në dt. ___________ në ora 14:45 (Procesverbali me nr. ___ të rastit NJRK-Prishtinë,

________________) në prezencën e mbrojtëses së saj av. ____________________, deklaratë që është lexuar gjatë shqyrtimit kryesor, kishte deklaruar se: "____________ ___________________________".
**(paraqitet deklarata e të akuzuarës e dhënë në fazën e hetimeve në polici apo tani në prokurori - deklaratë kjo që është lexuar edhe në shqyrtimin kryesor dhe është përdor për të kundërshtuar deklarimet e të akuzuarës)**

Në shqyrtimin kryesor publik në këtë çështje penale, gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit, si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarave dhe mbrojtësve të tyre, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, dhe me ndërgjegje, vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas prezantimit të provave, Gjykata plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në diapozitiv të aktgjykimit.

Këtë gjendje faktike, Gjykata e vërtetoi në bazë të:
(**theksohen deklaratat e dëshmitarëve dhe provat tjera të administruara dhe mbi bazën e të cilave gjykata konsideron se ka vërtetuar gjendjen faktike**)

Dëshmitarja _______________ gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se:

Dëshmitarja _______________ gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se:

Dëshmitarja _______________ gjatë shqyrtimit kryesor, veç tjerash ka deklaruar se:

Eksperti financiar ________________________ në konstatimin dhe mendimin e tij nr. _______/2005 dt. ____________ lidhur me lëndën P. nr. _______/05 ka dhënë mendimin se:

Prandaj, nga deklaratat dhe deklarata e tani të akuzuarës, vërtetohet se
(**shënohet se çka vërteton deklarata e vetë të akuzuarës**)

Nga deklarata e dëshmitares ________________ vërtetohet se
(**shënohet se çka vërtetohet nga deklarata e dëshmitares**)

- edhe për dëshmitarët tjerë -

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar vërtetohet se:
**(shënohet se çka vërtetohet nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit)**

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, përkatësisht se:

Në veprimet e _______________, tani të akuzuarës, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale: Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339, par. 3 të KPK-së, sepse tani e akuzuara ishte e punësuar në detyrën e ______________, ku kishte atributet e personit përgjegjës në kompani e kjo më tej do të thotë se kishe cilësinë e personit zyrtar.

Prandaj, pasi që është arritur që plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të bazuar, vërtetohet se tani e akuzuara _________________ ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar se nuk ka asnjë rrethanë që përjashton ndjekjen penale ose përgjegjësinë penale të të njëjtës, kjo gjykatë të akuzuarën ___________________ e shpalli fajtore për shkak se ka kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare ose të autorizimit, nga neni 339 par. l.3 të KPK-së dhe i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej një (1) vjet, në kufijtë e minimumit të dënimit të paraparë për këtë vepër penale.

Me rastin e marrjes së dënimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit kjo gjykatë vlerëso të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese që janë me ndikim te matja e dënimit, me ç' rast rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti, ndërsa si rrethanë lehtësuese e konsideroi faktin se është nënë e ______ fëmijëve, dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më shumë se _____ (__) vite dhe tani e akuzuara pas kryerjes së veprës penale nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin.

Gjykata, ka vërtetuar lartësinë e dobisë pasurore që tani e akuzuara e ka realizuar me kryerjen e veprës penale, dhe në bazë të nenit 82 dhe 83, të KPK-së ka vendosur që kjo dobi pasurore e përfituar me vepër penale të konfiskohet nga e akuzuara duke e detyruar të njëjtën që këtë shumë ta kthejë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara Kompania "__________________", nuk ka prezantuar gjatë shqyrtimit kryesor-përfaqësuesi i saj Av. _______________ ka qenë i njoftuar (i ftuar në mënyrë të rregullt në shqyrtimin kryesor) por nuk ka shfaqur interesim që të paraqitet në shqyrtimin kryesor.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Për sa i përket të akuzuarës _______________, Prokurori i shtetit, gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se heq dorë nga ndjekje penale.

Prandaj, për sa i përket të akuzuarës ________________, Gjykata, në bazë të nenit 363, par. 1, nën paragrafi 1.1, ka vendosur që të refuzojë akuzën.

Në bazë të nenit 450, dhe 454, shpenzimet e procedurës penale në raport me të akuzuarën _______________________, paguhen nga mjetet buxhetore.

Në raport me të akuzuarën ________________, e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil në bazë të nenit 463, par. 3, të KPP-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale, është vendosur në bazë të nenit 450, dhe 453, 454, të KPP-së.

Për sa u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. ______/2005 dt. ______ 2016**

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësja,** | **Kryetari i trupit gjykues-**<br>**Gjyqtari** |
| ___________________________ | ___________________________ |

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, nëpërmes kësaj gjykate.

**Aktgjykimi me të cilin shqiptohet dënimi kumulativ dhe konfiskohet dobia pasurore e përfituar me vepër penale**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINËS**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. _________/2015**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, në Trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari ___________________________, Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve _______________, anëtarë të trupit gjykues, me zyrtarin ligjor _______________ si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit _____________________ nga ________________, rruga "_________________" nr. ____ të cilin e mbrojnë avokatët: ____________ dhe ________________, për shkak të veprës penale: Shmangie nga tatimi nga neni 249, par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, i akuzuar nga PTH-ja në Prishtinë sipas aktakuzës PP nr. _________/___ të dt. _________ pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën ______________ ku kanë prezantuar përfaqësuesi i akuzës/prokurorja _________________, i akuzuari dhe mbrojtësit e tij, si dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës MEF - ATK në Prishtinë, me dt. ______________ vendosi dhe të njëjtën ditë në prezencën e përfaqësuesit të akuzës, të akuzuarit dhe të mbrojtësit të tij Av. _________________, si dhe të përfaqësuesit të dëmtuarës, publikisht shpalli këtë:

**A K T GJ Y K I M**

I akuzuari ___________________ emri i babës _____________ emri i nënës ________ mbiemri i vajzërisë _______ i lindur më ______________ në fshatin ______ Komuna e _______________, me vendbanim në ____________ rruga "_____________" nr. ___, shqiptar, kosovar, i martuar, baba i ___ fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore është i punësuar në NPT "______________" me seli në _____________, realizon të ardhura personale në lartësi prej _______€ në muaj, në gjendje të mirë ekonomike, më parë i padënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, në cilësinë e bashkëthemeluesit dhe pronarit të subjektit juridik "______________" me seli në _________________, në periudhën kohore-gjatë viteve ______________ me rastin e -_________________
**(Shënohet mënyra se si është kryer vepra penale-veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale sikurse që është theksuar në aktakuzë apo në mënyrën sikurse gjykata konsideron të nevojshme të shënohen veprimet e të akuzuarit por gjithnjë brenda kornizës së dispozitivit të aktakuzës duke u kujdesur për mos tejkalim të aktakuzës.)**

Me këtë ka kryer veprën penale: Shmangie nga tatimi nga neni 249, par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së.

Prandaj kjo gjykatë në bazë të nenit 34, 38, 39, 64, 71, 73, 82, 83, 84, dhe 249 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, si dhe në bazë të nenit 99, 102, 107, 112, 391, 490 dhe 492 të KPPPK-së, të akuzuarit ________________, ia shqipton:

**DENIMIN**
**ME BURG DHE DËNIMIN ME GJOBË**

Të akuzuarit _________________ i cakton **dënimin me burg në kohëzgjatje prej ________** të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe i cakton **dënimin me gjobë në lartësi prej __ €** të cilin është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, **në 12 këste** të barabarta.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit _______________ i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga data 11.12.2006 e deri me 26.03.2007

**OBLIGOHET** i akuzuari ______________ që të dëmtuarës MEF-ATK-së, në Prishtinë t'i kompensojë dëmin material në lartësi prej **_____€,** në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara MEF-ATK-ja në Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike mbi lartësinë e gjykuar me këtë aktgjykim, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

**VËRTETOHET** se dobia pasurore e fituar me anë të kryerjes së veprës penale nga i akuzuari dhe në llogari të akuzuarit, Dedë Bala, është në lartësi minimale prej **_____€.**

**KONFISKOHET dobia pasurore** e fituar me kryerjen e veprës penale nga ___________ në lartësi **prej _____€,** sepse kjo shumë e tejkalon shumën e dëmit pasuror që i është caktuar të dëmtuarës.

Në rast se konfiskimi nuk do të jetë i mundur, **OBLIGOHET** i akuzuari që pagesën në emër të dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale, në lartësi prej **_____€** ta bëjë në llogari të MEF-ATK në Prishtinë-përkatësisht Buxhetit të Kosovës - brenda afatit prej ___________ nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**OBLIGOHET** i akuzuari _______________që të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej **_____€,** kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë **_____€** në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP nr. _________/20__ të dt. __________, e ka akuzuar _____________ nga fshati ______________ Komuna e

____________ tani me vendbanim në ____________ për shkak të veprës penale; Shmangie nga tatimi nga neni 249 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, dhe deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i akuzës, ka mbetur pranë akuzës duke i kërkuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në këtë gjykatë me dt. ________________ është mbajtur shqyrtimi fillestar me ç'rast i akuzuari ________________ ka deklaruar se nuk ndihet fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në shqyrtimin kryesor publik në këtë çështje penale gjykata konform nenit _____ dhe _____ të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit dhe mbrojtësve të tij, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

I akuzuari ____________, edhe në shqyrtimin kryesor, ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, me ç'rast (në kuptim të mbrojtjes) ka theksuar se në periudhën kohore për të cilën ishte akuzuar nuk ishte marrë me tregtimin e derivateve të naftës por vetëm kishte bërë transportimin e derivateve të naftës në pikat e shitjes në Kosovë.

Pas administrimit të provave, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Tani i akuzuari _________________________ në dt. ____________ së bashku me: _______________________ kishte themeluar ndërmarrjen për qarkullimin e mallrave me shumicë dhe pakicë si dhe për eksportim dhe importim të mallrave me emrin "________________" Exp. Imp., me seli në _____________. Kjo ndërmarrje - si subjekt juridik ishte regjistruar me nr. të biznesit ________________.

I akuzuari ______________ me dt.______________ kishte themeluar ndërmarrjen me emrin "________________" me nr. të biznesit ______________.

Bashkëshortja e tani të akuzuarit ___________________________, është themeluese e ndërmarrjes "____________________" me seli në ______________ dhe është e regjistruar me nr. të biznesit _________________.

Tani i akuzuari _______________ në vitin 2010 dhe 2012, nëpërmes të ndërmarrjes së tij "________________" është furnizuar me derivate të naftës (naftë dhe benzinë) nga subjekti juridik "________________" në ____________, për sasinë prej: _______________ litra benzinë dhe _______________ litra naftë, sipas ___________________ faturave, në vlerë të përgjithshme prej _______________€, dhe këtë sasi të derivateve të naftës e ka shitur në pika të shitjes në Kosovë. I njëjti, me

rastin e furnizimit të derivateve të naftës, subjektit juridik "____________" (si liferues i mallit) nuk i kishte prezantuar numrin e biznesit të ndërmarrjes së tij, kurse me rastin e shitjes së ________________________, e që ishte shitje me shumicë, nuk ishte prezantuar në asnjë rast si shitës me shumicë nëpërmes të faturimit të mallit për subjektet juridike që u kishte liferuar mallin. Kështu, i akuzuari brenda vitit 2004 dhe 2005, në asnjë rast nuk kishte deklaruar detyrime tatimore dhe kështu i ishte shmangur pagimit të tatimit në vlerën e shtuar.

Sipas shkallës mesatare të marzhës së shitjes me shumicë të derivateve të naftës prej ____% i akuzuari me rastin e shitjes së ________________ për vlerën e përgjithshme prej **_____€, kishte përfituar _____€,** kurse obligimi i tij minimal në këtë lartësi të përfitimit (TVSH = 15%) ndaj ATK (përkatësisht Buxhetit të Kosovës) ishte **_____€.**

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi plotësisht nga konstatimi dhe mendimi e ekspertit financiar gjyqësor ______________________ të dhënë në ekspertizën me nr. ___________ të dt. ________________, nga faturat tatimore me nr. 00000, e dt. 00.00.0000 (fletë dërgesa nr. 000000), fatura tatimore nr. 000000 e dt. 00.00.0000 (fletë dërgesa nr. 00000), fatura tatimore nr. 000000 (fletë dërgesa me nr. 00000) fatura tatimore nr. 000000 (fletë dërgesa nr. 00000) dhe nga transaksioni i kryer nëpërmes të bankës komerciale _______________ me dt. 00.00.0000 në llogarinë bankare me nr. 0000000-EUR-000000.

Eksperti financiar gjyqësor ___________________________________ në ekspertizën financiare me nr. ________________ të dt. ______________ ka konstatuar se:

Ndërmarrja "_________________" në vitin 0000 dhe 0000 ka realizuar qarkullim të mallit më tepër se limiti i paraparë për t'u trajtuar si obliguese e TVSH-së, mbi 00.000,-€ dhe për derisa kjo ndërmarrje nuk është çregjistruar trajtohet si obligues tatimor. Detyrimi për TVSH lindë sipas metodës së kontabilitetit aktual (vijues) veç tjerash edhe në momentin kur mallrat janë bërë të disponueshme për konsumatorin. Pasi që ndërmarrja "____________________", ka zhvilluar aktivitet, ajo duhet të trajtohet si detyrues tatimor, përkatësisht si person i tatueshëm.

Përveç sa u tha më lartë, eksperti financiar ka konstatuar edhe se tani i akuzuari ____________________ vet apo të afërmit e tij kanë pasur të regjistruar firma-biznese tjera të cilat mund të konsiderohen si të lidhura.

Në periudhën kohore 0000-0000 ndërmarrja "________________" përmes 000 faturave me qellim të shitjes së mëtutjeshme është furnizuar me derivate të naftës nga Kompania "_____________" në _______________, në sasi prej ________________ dhe _________________ e që shprehur në vlerë financiare kapë shumën prej _____€. Me rastin e faturimit, shitësi (në këtë rast ____________) në pjesën e faturës ku evidentohen të dhënat (për shitësin) ka evidentuar në mënyrë të rregullt të dhënat e tija, kurse për sa i përket blerësit (në këtë rast firmës "_________________" dhe të akuzuarin ______________) nuk janë evidentuar të dhënat e duhura, sepse mungon

numri i biznesit i cili e identifikon statusin e blerësit, mbi bazën e të cilit vërtetohet se është apo nuk është deklarues i TVSH-së, dhe është apo nuk është firmë e regjistruar.

Sipas Udhëzimit administrativ nr. _______________ (neni ____), faturat tatimore duhet të përmbajnë numrin e biznesit, apo të TVSH-së, ngase mbi atë bazë fitohet e drejta, përkatësisht detyrimi për të vjelë apo për të deklaruar TVSH-në.

Të gjitha faturat (000 sosh), janë të përcjella me fletë dërgesa përkatëse të cilat janë me numra serik të shtypur e në të cilat janë të evidentuara të dhënat mbi blerësin "____________________" ____________, datën liferimit, llojin e derivatit, sasinë, çmimin dhe shumën, nënshkrimin e shitësit së bashku me vulën si dhe nënshkrimin e vozitësit. Lidhur me çmimin e liferimit të derivateve të naftës është vërejtur se ka dallime në mes të çmimit të theksuar në faturë nga çmimi i theksuar në fletë dërgesa, mirëpo nuk dihet se përse është ky dallim.

Prandaj, ekzistojnë të dhëna të mjaftuara, të cilat dëshmojnë se malli (________________) është shitur si mall transit-përkatësisht si shitje me shumicë.

Mbi bazën e faturave dhe fletë dërgesave të mallit të furnizuar __________________ nga firma "____________________" për firmën "____________________" rrjedh se firma "________________" nga ___________ sipas 000 faturave të cilat i referohen qarkullimit të realizuar në periudhën kohore 2010-2012 është ngarkuar me mall _________________ në vlerë prej _____€.

Pasi që subjekti/biznesi "_______________________________" e ka bërë shitjen e mëtutjeshme të derivateve të naftës - subjekteve përkatësisht bizneseve tjera - do të thotë me shumicë, dhe duke qenë se ishte ndërmjetësuese në shitjen me shumicë, sepse mallin e ka shitur në formë transiti, rezulton se ka pasur mundësi për realizimin e marzhave minimale të shitjes. Sipas praktikes aktuale marzha për ndërmjetësuesit e shitjes së __________________ me shumicë sillet prej __% deri në ___% të vlerës së mallit. Në këtë rast duke iu referuar marzhës mesatare prej ___% rezulton se firma "____________________" ka realizuar të hyra në shumën minimale prej _____€. Detyrimi tatimor në këtë shumë është në vlerë prej _____€.

Prandaj, nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar vërtetohet se tani i akuzuari __________________:

- në periudhën kohore, 2010-2012 është marrë me shitjen e _________________ si ndërmjetësues me shumicë mirëpo nuk ka deklaruar asnjë detyrim në emër të TVSH-së,

- duke llogaritur marzhën minimale prej__ % në vlerën e mallit të shitur me shumicë, i njëjti ka përfituar së paku _____€,

- detyrimi tatimor i të akuzuarit ___________________ mbi bazën e të hyrave (të përfitimit nga shitja e _______________ me shumicë _____€ x ____ %), është _____€.

Gjykata ia dha besimin e plotë konstatimit dhe mendimit të ekspertit financiar gjyqësor sepse i njëjti pas analizës së hollësishme të shkresave të lëndës dhe të provave tjera që i ka siguruar në rrugë zyrtare nga MTI-ja, ka prezantuar ekspertizën financiare, në të cilën në detaje ka prezantuar gjendjen e konstatuar dhe mendimin profesional lidhur me faktin kryesor se tani i akuzuari; a ishte marrë me shitjen e _______________ _____________ dhe në çfarë cilësie, si dhe a ishte apo jo obligues tatimor dhe nëse po mbi cilën bazë.

Konstatimin dhe mendimin e ekspertit financiar gjyqësor nuk e kanë kundërshtuar askush prej palëve në këtë çështje juridiko-penale.

Nga faturat tatimore me nr. 0000000, e dt. _________ (fletë dërgesa nr. 000000), fatura tatimore nr. 000000 e dt. _________ (fletë dërgesa nr. 00000), fatura tatimore nr. 000000 (fletëdergesa me nr. 000000), fatura tatimore nr. 000000 (fletë dërgesa nr.000000), vërtetohet plotësisht se subjekti/biznesi "__________________________" përkatësisht tani i akuzuari ________________ është furnizuar me shumicë me _________________________, nga firma "______________________" dhe këtë sasi të ____________________________, pastaj e ka shitur po ashtu me shumicë (si ndërmjetësues) firmave tjera në Kosovë, mirëpo nuk ka bërë faturimin në emër të subjektit/biznesit të tij "______________________________" dhe nuk ka paraqit asnjë detyrim të tatimit lidhur me këtë sasi të ___________________, të shitur me shumicë.

Nga transaksioni i kryer nëpërmes të bankës komerciale ______________________, vërtetohet se tani i akuzuari ___________________, në emër të biznesit të tij "__________________" me theksimin: _________________ ka bërë transferin e mjeteve në shumë prej _____€ për subjektin juridik "_________________".

Ky transaksion financiar, provon se tani i akuzuari kishte blerë në emër të subjektit/biznesit të tij "___________________________" tek subjekti juridik "_________________" derivate të naftës, dhe nuk ishte fjala për kryerjen vetëm të shërbimeve të transportit sikurse ka pretenduar tani i akuzuari në mbrojtjen e tij.

Objekt i vlerësimit nga gjykata ishin edhe deklaratat e përfaqësuesit të të dëmtuarës MEF-ATK-së dhe mbrojtësve të të akuzuarit në fjalën përfundimtare.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paraqet kërkesë pasurore juridike ndaj tani të akuzuarit në lartësi prej _____€, me arsyetimin se kjo kërkesë i referohet detyrimi të subjektit "______________________", nga ________________ (për faktin se i njëjti nuk ka shënuar numrin e biznesit në faturat e adresuara për firmën "_______________"), mirëpo pasi që nuk është e sigurt se ky detyrim do të përmbushet nga subjekti juridik "______________", atëherë ky obligim kërkohet që të përmbushet nga tani i akuzuari _______________.

Mbrojtësi i parë i të akuzuarit, avokati __________________________, në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se tani i akuzuari asnjëherë nuk ka qenë drejtor i NTP "_________________" por vetëm njeri prej aksionarëve, dhe se i njëjti nuk është marrë me "makinacione të cilat paraqiten në aktakuzë", por ishte vetëm transportues i mallrave.

Mbrojtësi i dytë i të akuzuarit, Avokati ____________________________, në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shitë-blerje mallrash në mes të Kompanisë "_____________" dhe të kompanisë së të akuzuarit por kemi të bëjmë me transport të mallit të kryer nga ana e tani të akuzuarit, se i akuzuari kishte kryer shërbime të transportit në ______________________ raste, dhe se në kohën e kryerjes së shërbimeve të transportit, nga tani, i akuzuari çështja e pagesës së tatimeve dhe çështja e ndëshkimeve për shkelje tatimore, me asnjë dispozitë ligjore nuk ishte parashikuar si vepër penale.

Gjykata aprovoi pjesërisht kërkesën pasurore-juridike të të dëmtuarës dhe atë për shumën prej _____€ kurse lidhur me pjesën tjetër të kërkesës pasurore-juridike kjo gjykatë vëren se ajo është paraqitur në formën alternative, përkatësisht në rast se nuk inkasohet nga subjekti "________________", atëherë të detyrohet tani i akuzuari që të kompensojë këtë dëm material. Lidhur me këtë çështje, kjo gjykatë vëren se një kërkesë e tillë, në formën alternative, mund të kërkohet vetëm në kontestin e rregullt juridiko-civil, ku si palë të paditura mund të jenë dy subjekte.

Gjykata nuk aprovoi mbrojtjen e prezantuar nga mbrojtësit e të akuzuarit sepse tani i akuzuari ____________________:

- personalisht ka kryer veprimtari afariste-/tregti me derivate të naftës në emër të subjektit juridik/firmës "Marash Petrol" duke bërë edhe pagesa në emër të tij dhe të subjektit/biznesit "_________________",

- me asnjë provë nuk është provuar se i njëjti ka qenë vetëm transportues i derivateve të naftës, as mbrojtësit e të akuzuarit e as vet i akuzuari deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor gjykatës nuk i kanë prezantuar as edhe një të vetmen faturë mbi transportimin e mallit (________________________________) e dihet se çdo transportues së bashku me mallin që është objekt i transportit, blerësit i paraqet edhe faturën në emër të shërbimeve të transportit. Fatura transportuese, duhet të përmbajë vendin e ngarkimit, vendin e shkarkimit, çështjen e sigurimit të mallit deri në vend shkarkim dhe kush i përmbush obligimet në emër të shërbimeve të transportit. Tani i akuzuari, ka përdorur të ashtuquajturat "fletë evidence" e që në qarkullimin financiar këto fletë evidenca nuk paraqesin asgjë,

- ka vepruar në kohën kur, në Kosovë ishte në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal, i cili në nenin 249, sanksionon veprën penale të shmangies nga tatimi.

Prandaj, kjo gjykatë konsideron se jashtë çdo dyshimi dhe plotësisht ka arritur që të vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit _________________, manifestohen të gjitha

elementet (si ato objektive ashtu edhe ato subjektive) të veprës penale të, Shmangies së tatimit nga neni 249, të KPPK-së.

Kjo sepse i njëjti duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e tijë dhe për qellim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm me rastin e tregtimit me ____________ ________________, nuk ka prezantuar numrin e biznesit të tij tek liferuesi __________________, kurse pastaj me rastin e shitjes me shumicë të këtyre derivateve të naftës, nuk ka bërë fare faturimin e mallit të shitur (duke u shërbyere me faturat e “________________”), dhe duke i ikur kështu detyrimit të tij për të paguar tatimin. I njëjti është penalisht përgjegjës dhe fajtor për vepër penale të kryer.

Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike, lartësia e dobisë pasurore të përfituar me kryerjen e veprës penale vërtetohet vetëm për atë pjesë e cila nuk është përfshirë në kërkesën pasurore-juridike.

Konform nenit ____ dhe ____ të KP të RK-së, askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të përfituar me anë të kryerjen së veprës penale, dhe kjo dobi pasurore konfiskohet. Kur i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike, lartësia e dobisë pasurore të përfituar me kryerjen e veprës penale, vërtetohet vetëm për atë pjesë e cila nuk është përfshirë në kërkesën pasurore-juridike.

Në këtë rast, Gjykata ka arritur që të vërtetoj se dobia pasurore e përfituar nga tani i akuzuari ________________, me veprën penale të kryer, është së paku _____€ (me aplikimin e marzhës, në lartësi prej 3%).

Për arsye se të dëmtuarës, MEF-ATK-së në Prishtinë, i është pranuar kërkesa pasurore-juridike në lartësi prej _____€, kjo Gjykatë ka vendosur që ndaj të akuzuarit ________________, të urdhërohet konfiskimi i shumës prej _____€, (si ndryshim në mes të lartësisë së vlerës pasurore të përfituar me veprën penale dhe të detyrimit tatimor).

Kjo gjykatë ka vlerësuar se ka arsye që të akuzuarit t’i mundësohet kthimi i kësaj shume brenda (____) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kjo gjykatë, pasi që vërtetoi se tani i akuzuari _________________ është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar dhe pasi që konstatoi se është penalisht përgjegjës, të njëjtit, duke marrë në konsideratë dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat që janë me ndikim me rastin e matjes së dënimit, si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, i shqiptoi dënimin me gjobë në lartësi prej _____€ (_______________________euro), si dhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej ___ (_____), të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me rastin e marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese Gjykata mori në konsideratë faktin se:
**(theksohen rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese që gjykata i merr në konsideratë kur vendos për llojin dhe lartësinë e dënimit**)

Konform nenit 249 të KPPK-së ndaj kryesit të veprës penale, të Shmangies nga tatimi, detyrimisht shqiptohet dënimi me gjobë dhe dënimi me burg.

Kjo gjykatë, të akuzuarit i caktoi dënimin me gjobë në lartësi prej _____€, sepse i njëjti veprën penale e ka kryer me qellim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm. Konform nenit ____ par. ___ të KP të RK-së, për veprën penale të kryer me qellim të përfitimit pasuror, gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë edhe mbi shumën prej 25.000,00 € e deri në 500.000,00 €.

Koha e kaluar në paraburgim (nga dita e arrestimit - ______________________, e deri me ___________________), të akuzuarit i është llogaritur në dënimin e shqiptuar në bazë të nenit ___ të KP të RK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit është marrë konform nenit 99 dhe 102 par. 1 të KPP-së.

Për sa u tha më lartë, dhe konform nenit 391 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. nr. _________/20____ i dt. _____________**

**Procesmbajtësja,**

**Kryetari i trupit gjykues-**
**Gjyqtari**

____________________________

____________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.

**Aktvendim për korrigjim të gabimeve teknike në aktgjykim**
**(neni 371 par. 1 të KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. nr. _______/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - Departamenti për Krime të Rënda me Gjyqtarin _____________ si kryetar i trupit gjykues, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të nenit 371 par. 1 të KPP-së në datën __________ 2016, solli këtë:

**AKTVENDIM**
**Për korrigjim të gabimeve teknike aktgjykim**

I. Në dispozitivin e aktgjykimit të PKR-së nr. __________/2105, të datës ___________, data prej kur llogaritet koha e kaluar në paraburgim e shënuar si 25 Janar 2014 korrigjohet ashtu që data prej kur llogaritet paraburgimi është 15 Janar 2015.

Formulimi i saktë, në lidhje me kohën e kaluar në paraburgim që të akuzuarit i llogaritet në dënimin e shqiptuar sipas këtij aktgjykimi është si vijon:

"në dënimin e shqiptuar sipas këtij aktgjykimi të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15 Janar 2014 e deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim".

II. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e posaçme.

**Arsyetim**

Me rastin e hartimit të aktgjykimit PKR-ja nr. ____________/2015 të datës ___________ në lidhje me llogaritjen e paraburgimit në dispozitiv është shënuar se të akuzuarit në dënimin e shqiptuar, i llogaritet koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 25 janar 2014.

Nga shkresat e lëndës rezulton se tani i akuzuari në paraburgim është nga data 15 Janar 2014.

Sipas aktgjykimit burimor në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor rezulton se me rastin e marrjes së aktgjykimit trupi gjykues ka vendosur edhe për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar ashtu që si datë fillestare prej kur llogaritet paraburgimi është data e ndalimit dhe arrestimit përkatësisht data 15 Janar 2014.

Prandaj, pasi që është vërejtur ky gabim teknik, gjykata sipas detyrës zyrtare, vendosi për korrigjimin e gabimit teknik në aplikim të nenit 371 par. 1 të KPP-së.

Ky aktvendim nuk ndikon në ecjen e afatit për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit për arsye se është fjala vetëm për korrigjime të gabimeve teknike.

Për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. ___________/2015 dt. ________2015**

**Kryetari i trupit gjykues-**
**Gjyqtari**

___________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, nuk është lejuar ankesë e posaçme.

**Aktvendim për korrigjim të gabimeve teknike në aktgjykim**
**(neni 371 par. 3 të KPP-së)**
**(në rastet kur afati i ankesës kundër aktgjykimit fillon të ec pas pranimit të këtij aktvendimi)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. nr. _______/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -** Departamenti për Krime të Rënda me gjyqtarin ______________ si kryetar i trupit gjykues, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të nenit 371 par. 3 të KPP-së në datën __________ 2016 bjerë këtë:

**AKTVENDIM**
**Për korrigjim të gabimeve teknike aktgjykim**

I. Në dispozitivin e aktgjykimit PKR. nr. __________/2105 të datës ___________ emërtimi ligjor i veprës penale për të cilin i akuzuari ______________________ është shpallur fajtor e shënuar si: "Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 1 nën paragrafi 1.4, të KP të RK-së", duhet të jetë: "Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2 lidhur me par. 1, nën paragrafi 4, të KP të RK-së".

Formulimi i saktë, në lidhje me emërtimin ligjor të veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, është si vijon:

"me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2, lidhur me par. 1, nën paragrafi 1.4, të KP të RK-së".

II. Afati i ankesës, kundër aktgjykimit, llogaritet nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi.

II. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e posaçme.

**Arsyetim**

Me rastin e hartimit të aktgjykimit, PKR. nr. ____________/2015, të datës ___________, në lidhje me emërtimin ligjor të veprës penale për të cilën tani i akuzuari ___________________, është shpallur fajtor, është shënuar vepra penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. --, nën paragrafi 1.4, të KP të RK-së.

Nga shkresat e lëndës rezulton se tani i akuzuari dhe sipas aktgjykimit burimor në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, me rastin e marrjes së aktgjykimit, trupi gjykues ka vendosur që ta shpall fajtor dhe ta dënojë për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par. 2, lidhur me par. 1 nën paragrafi 1.4, të KP të RK-së.

Prandaj, pasi që është vërejtur ky gabim teknik, Gjykata sipas detyrës zyrtare, vendosi për korrigjimin e gabimit teknik duke aplikuar nenin 371, par. 1 të KPP-së.

Ky aktvendim, ndikon në ecjen e afatit për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit për arsye se është fjala për korrigjime të gabimeve të parashikuara nga neni 365, par. 1, nën paragrafi 1.2, të KPP-së.

Në bazë të nenit 371, par. 3 të KPP-së afati i ankesës kundër aktgjykimit, fillon nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi.

Për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti për Krime të Rënda**
**PKR. nr. ____________/2015 dt. _________2015**

**Kryetari i trupit gjykues-**
**Gjyqtari**

____________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesë e posaçme. Ky aktvendim ju dërgohet palëve, sipas nenit 369 të KPP-së.

**Ankesa kundër aktgjykimit**
**(Neni 380 i KPP-së)**

**PKR. Nr. _______/20___**

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**(Departamenti për Krime të Rënda)**
**Për**
**GJYKATËN E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË**

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR. nr. ___________/20___ të dt. ___________i akuzuari (apo mbrojtësi i tij) ________________, bazuar në nenin 380, par. 1, neni 381, par. 1 dhe neni 388, par. 1 të Kodit të Procedurës Penale, brenda afatit ligjor, paraqet:

**A N K E S Ë**

Në _____ kopje

Me të cilën, në pajtim me nenin 383, të Kodit të Procedurës Penale, e atakon në tërësi aktgjykimin tani të ankimuar për shkak të të gjitha bazave ligjore për të cilat aktgjykimi mund të atakohet, përkatësisht për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të Procedurës penale,

- për shkak të shkeljes së Ligjit Penal,

- për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, dhe

- për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, konfiskimit të dobisë pasurore, kërkesës pasurore-juridike dhe vendimit për publikimin e aktgjykimit.

Me

**P R O P O Z I M**

Që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar ta ANULOJË dhe çështjen ta kthejë në rivendosje, sipas nenit 398, par. 1.3 të KPP-së, ose aktgjykimin e atakuar ta NDRYSHOJË - të bëjë rikualifikimin juridik të veprës penale dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënim më të butë.

Në bazë të nenit 390, par. 1 të KPP-së, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të njoftohen për seancën e kolegjit të Gjykatës së Apelit.

**A r s y e t i m**

Sipas aktgjykimit, tani të ankimuar, PKR. nr. ___________ dt. ___________, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, tani të akuzuarin ______________________________, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ________________________ nga neni ______, të KP të RK-së dhe i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej _____vjet, në të cilin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim, nga data _____________ deri në datën ________________, (apo edhe më tutje nëse pas shpalljes së aktgjykimit është vazhduar paraburgimi) dhe i ka konfiskuar ________________________, si send i përfituar me vepër penale (apo si send i cili është rezultat i veprës penale).

Ky aktgjykim - tani i ankimuar - është i paqëndrueshëm, sipas të gjitha bazave të ankesës, e që posaçërisht konsiston në:

1. Shkeljen esenciale të dispozitave të Kodi të Procedurës Penale

***Shënohen se cilat, sipas ankuesit, janë shkeljet esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ankuesi mund të referohet shkeljeve të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale sipas nenit 384 të Kodit të Procedurë Penale.***

2. Shkeljes së Ligjit Penal.

***Shënohen se cilat, sipas ankuesit, janë shkeljet e dispozitave të ligjit penal. Ankuesi mund të referohet shkeljeve të ligjit penal dispozitave të Kodit të Procedurës Penale - nenit 385.***

3. Vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

***Shënohet se përse, sipas ankuesit, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, apo nuk është vërtetuar plotësisht. Ankuesi mund t'i referohet nenit 386 të Kodit të Procedurës Penale.***

4. Vendimit mbi sanksionin penal.

***Shënohet se përse, sipas ankuesit, është shkelur apo nuk është aplikuar drejt ligji penal me rastin e marrjes së vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit.***

Për arsyet e theksuara më lartë i propozohet Gjykatës së Apelit si gjykatë e ankesës që në bazë të nenit 398, par. 1 nën paragrafi 1.3, dhe 1.4 të sjell këtë:

**A K T GJ Y K I M**

ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR. nr. _________/20___ i datës_________20__, dhe çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose NDRYSHET aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej _____ vjet.

Në Prishtinë,
Dt. ____________ 2016

**I akuzuari, ose mbrojtësi**
**i të akuzuarit,**

___________________________

**Aktgjykimi me të cilin jepet urdhri ndëshkimor**
**(Neni 495 i KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMLORE NË PRISHTINË**, në përbërje prej gjyqtarit individual, __________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor _______________________, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit _____________________, nga ___________________, Komuna e ________________________, për shkak të veprës penale: _________________________________________ nga neni _____ par. ___, lidhur me par. ___ të KP të RK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP. nr: ______________/_______ të dt. ______________, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me shenjën PP. nr: ___________/_______ të dt. ________________, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në dt. ________________, solli këtë:

**A K T GJ Y K I M**

**I. PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP. nr. _____________ e dt. ______________ dhe kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari _________________________________, emri i babës: _________________, emri i nënës: ________________________, i lindur në dt. __________________, me numër personal: _____________________________, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, tani me vendbanim në ___________________, rruga __________________, nr. _____,

**ËSHTË FAJTOR**

*Sepse,*

| |
|---|
| **Përshkruhet dispozitivi i aktakuzës, me mundësi që gjykata të bëjë intervenime për aq sa nuk ka ndryshim apo tejkalim të aktakuzës.** |

- me këtë veprim ka kryer veprën penale _________________________________, të parashikuar nga neni ________ par. ___ lidhur me par. ___të KP të RK-së.

Prandaj, në bazë të nenit _____, ______, _____, _____, të KP të RK-së, si dhe të nenit ____, _____, dhe nenit 495 par. 1.1 të KPPK-së, i shqipton

**DENIMIN KRYESOR**
**DENIM ME GJOBË**

Të akuzuarit:____________________, ia cakton dënimin me gjobë në lartësi prej **_____-€ (________________ euro),** të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**Vërejtje me rastin e marrjes së aktgjykimit gjykata mund të caktoi që dënimi me gjobë të paguhet edhe në disa këste. P.sh. pagesa të bëhet brenda 3 muajve në 3 këste të barabarta ashtu që kёstin e parë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit **për çdo 20 euro** të dënimit me gjobë, **nga 1 (një) ditë burg.**
Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës, në emër të kërkesës pasurore juridike, përkatësisht të dëmit material, të shkaktuar me këtë vepër penale t'i paguajë shumën prej _____€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.
Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej _____€, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**Në rastet kur shqiptohet edhe dënimi plotësues aktgjykimi përmban edhe këtë pjesë**:

Në bazë të nenit _____ të KP të RK-së, të akuzuarit _________________ kjo Gjykatë i shqipton edhe,

**DENIMIN PLOTËSUES**
***marrjen e sendit me të cilin është kryer vepra penale***

Ashtu që, të njëjtit, i konfiskohet ______________________________ si send i përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës PP. nr. _______________/_______ të dt. ____________________, e ka akuzuar ______________________________, nga ______________, Komuna e __________________________________________ për veprën penale: ________________________________________ nga neni _______ të KP të RK-së, dhe njëherësh gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi

penal, lidhur me bazueshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari individual, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 494 të KPP-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së të KPPPK-së dhe konform nenit 495, par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, dhe vendosi që të pranojë kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv.

Kjo gjykatë, konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si vijon: ______________________________________________________________ ______________________________________________, janë prova të besueshme, mbi bazën e të cilave, vërtetohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata vlerësoi edhe deklaratën e të akuzuarit në shkresat e lëndës kur ka theksuar se:

| |
|---|
| **Shënohet përmbajtje e deklaratës së të akuzuarit të dhënë në fazën e hetimeve dhe arsyet përse gjykata nuk i fal besimin asaj deklarate-natyrisht nëse ka një deklaratë të tillë.** |

Me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me lartësinë e dënimit dhe mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë, Gjykata kishte parasysh faktin se: _________________________ _______________________, (shënohen rrethanat lehtësuese për të cilat gjykata është në dijeni se duhet t'i marrë në konsideratë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit), prandaj ia shqiptoi dënimin në lartësi prej _____€, me bindje se edhe me këtë lartësi të dënimit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues, marrjen e monedhës me nr. si më lartë, është marrë në bazë të nenit _____ të KPP-së, sepse është send i përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

I akuzuari, është i obliguar të kompensojë shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, konform nenit _____ dhe ______ të KPPP-së.

Për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**

**Procesmbajtës,** **Gjyqtari,**

_________________________ _________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet.

**Vërejtje**: Me rastin e marrjes së aktgjykimit, lidhur me kundërshtimin, Gjykata nuk detyrohet me kërkesën e Prokurorit (për shqiptimin e dënimit me gjobë) e as me ndalesën nga neni 395, përkatësisht nga neni 440 i KPP-së e që do të thotë se në rast se i akuzuari përsëri shpallet fajtor, Gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ose me burg deri maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën tani është i akuzuar!

**Aktvendim për hedhjen e kundërshtimit të ushtruar, kundër aktvendimit me të cilin është hedhur kundërshtimi, kundër urdhrit ndëshkimor (Neni 496 par. 5 të KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, në përbërje prej Gjyqtarit _________________, - si gjyqtar individual, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor _______________________, si procesmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarit _______________________ nga Prishtina për shkak të veprës penale: ___________ _____________________________ nga neni _____ i KP-së të RK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës: PP. nr. _________________/ ______ të dt. 10.02.2005, me rastin e vlerësimit se kundërshtimi i të pandehurit të lartpërmendur, i ushtruar kundër aktgjykimit P. nr. _______________________, i dt. ________________, a është ushtruar kundërshtimi brenda afatit ligjor, dhe nga personat të cilët kanë të drejtë në ushtrimin e kundërshtimit - në bazë të nenit 496 par. 4 të KPP-së, në datën _______________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** kundërshtimi i të pandehurit _________________________, nga Prishtina, rruga _______________ nr. ____, i ushtruar kundër aktgjykimit të kësaj gjykate _______________ të dt. _________________ **si e paafat.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin P. nr. _________________ të dt. __________, kjo gjykatë ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor sipas aktakuzës PP. nr. _________ të dt. _____________, ndaj të pandehurit __________________ për shkak të veprës penale ______________________________ nga neni ______ të KP të RK-së ashtu që të pandehurin e lartë përmendur e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej _____€, duke e obliguar njëherësh në kompensimin e dëmit material të shkaktuar të dëmtuarit në lartësi prej ___€ si dhe e ka obliguar në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare dhe të pagesës në emër të paushallit gjyqësor, në lartësi prej _____€, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Aktgjykimi të pandehurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt.

Në aktgjykim, është dhënë udhëzimi juridik se kundër këtij aktgjykimi (me të cilin është pranuar kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor) konform nenit 496, par. 2 të KPP-së mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së tij.

I akuzuari __________________________, personalisht (ose nëpërmes të mbrojtësit të tij) ka ushtruar kundërshtimin, kundër aktgjykimit ________________________, në dt. ________________, përkatësisht pas kalimit të afatit për ushtrimin e kundërshtimit e që në këtë rast dita e fundit për ushtrimin e kundërshtimit ishte data ____________.

Prandaj, ky kundërshtim është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor.

I akuzuari ___________________, brenda afatit ligjor (neni 447 dhe 448 i KPP-së) nuk ka ushtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

Pasi që kundërshtimi, tani të akuzuarit, është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor, përkatësisht jo me kohë si e tillë, konform nenit 496, të KPP-së duhet të hedhet poshtë.

Për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**
**Dt. ____________/20___**

**Procesmbajtës,** **Gjyqtari,**

________________________ ________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet kolegjit prej 3 gjyqtarëve të kësaj gjykate.

**Aktvendim për refuzimin e ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit me të cilin është dhënë urdhri ndëshkimor nga Gjyqtari individual (Neni 496 par. 6 të KPP-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, në përbërje prej kolegjit të gjyqtarëve: 1. ________________________________, 2. ________________________________ dhe 3. ________________________________, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor __________________________ si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit _________________________________ nga Prishtina për shkak të veprës penale: _________________________________ nga neni _______ i KP të RK-së i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës PP. nr. ________________/______ të dt. ___________, me rastin e vendosjes sipas ankesës së ushtruar nga i pandehuri kundër aktvendimit mbi hedhjen e kundërshtimit kundër urdhrit ndëshkimor me shenjën P. nr. ____________ i dt. _______________ it - në bazë të neni 496 par. 6 të KPP-së, në datën_______________ mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**RFUZOHET ankesa e të pandehurit ___________________________, e ushtruar kundër aktvendimit mbi hedhjen e kundërshtimit kundër urdhrit ndëshkimor P. nr. _______________ dt. _____________si e pabazë.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin P. nr. ___________________ të dt. ____________, kjo Gjykatë ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor sipas aktakuzës PP. nr. _______________ të dt. ____________ ndaj të pandehurit _____________________ për shkak të veprës penale _________________ _______________ nga neni ______, të KP të RK-së ashtu që të pandehurin e lartë përmendur e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në lartësi prej _____€ duke e obliguar njëherësh në kompensimin e dëmit material të shkaktuar të dëmtuarit në lartësi prej _____€, si dhe e ka obliguar në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare dhe të pagesës në emër të paushallit gjyqësor në lartësi prej _____€ të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit në mënyrë të rregullt.

Në aktgjykim, është dhënë udhëzimi juridik se kundër këtij aktgjykimi (me të cilin është pranuar kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor), konform nenit 496, par. 2 të KPP-së, mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes.

I pandehuri __________________________, personalisht (ose nëpërmes të mbrojtësit të tij), ka ushtruar kundërshtimin kundër aktgjykimit ___________________________ në dt. ______________, përkatësisht pas kalimit të afatit për ushtrimin e kundërshtimit e që në këtë rast dita e fundit për ushtrimin e kundërshtimit ishte data _____________.

Duke vendosur lidhur me kundërshtimin e ushtruar kundër urdhrit ndëshkimor, me shenjën si më lartë, gjyqtari individual me aktvendimin P. nr. ___________________ të dt. _____________ ka hedhur kundërshtimin si të paafat, në bazë të nenit 496, par. 4 të KPP-së.

Kundër aktvendimit të gjyqtarit individual, me të cilin është hedhur kundërshtimi i të pandehurit, i ushtruar kundër urdhrit ndëshkimor P. nr. ______________/2016, i pandehuri ka ushtruar ankesë me kërkesë që kolegji prej 3 gjyqtarëve ta anulojë aktvendimin e gjyqtarit individual me të cilin është hedhur kundërshtimi si paafat.

Kolegji prej 3 gjyqtarëve me rastin e vendosjes sipas ankesës së të pandehurit të ushtruar kundër aktvendimit të gjyqtarit individual P. nr. __________________/2016 me të cilin është hedh kundërshtimi i të pandehurit i ushtruar kundër urdhrit ndëshkimor si i paafat, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e të pandehurit është e pabazë dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se dorëzimi i aktgjykimit P. nr. _______________ i dt. ____________ me të cilin është dhënë urdhri ndëshkimor për të pandehurit është bërë në mënyrë të rregullt ashtu që i pandehuri aktgjykimin e kishte pranuar në datën ________________.

I pandehuri kishte ushtruar kundërshtim në datën __________________ përkatësisht në ditën e 9-të pas pranimit të aktgjykimit. Sipas nenit 496, par. 2 të KPP-së kundërshtimi kundër urdhrit ndëshkimor paraqitet brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e pranimit.

Prandaj ky kundërshtim është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor.

I pandehuri ____________________ brenda afatit ligjor (neni 447 dhe 448 i KPP-së) nuk ka ushtruar kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

Pasi që kundërshtimi i tani të pandehurit është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor përkatësisht jo me kohë si e tillë konform nenit 496 të KPP-së duhet të hedhet poshtë.

Për këto arsye, Kolegji prej 3 gjyqtarëve konstatoi se gjyqtari individual drejtë kishte vendosur kur kishte hedhur kundërshtimin e ushtruar kundër urdhrit ndëshkimor si të paafat.

Prandaj, Kolegji prej 3 gjyqtarëve vendosi që të refuzoi ankesën e ushtruar kundër aktvendimit të gjyqtarit individual me të cilin ishte hedhur kundërshtimi kundër urdhrit ndëshkimor.

Për sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm**
**P. nr. _______/20__**
**Dt. ____________/20___**

**Procesmbajtës,** **Gjyqtari,**

________________________ ________________________

**UDHËZIMI JURIDIK:**
Kundër këtij aktvendimi, ankesa nuk është e lejuar. Neni 408 par. 2, 496 par. 6 dhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dt. 23.01.2013.

**Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë**

P. nr. ________/20___
(PA1. nr. _______/20__)

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË**
**- Departamenti i Përgjithshëm -**
**Për**
**GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS**

**P R I SH T I N Ë**

Kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P. nr. __________/20___i dt. ___________/20___ dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1. nr. __________/20___ të dt. __________ në bazë të nenit 432 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri (ose mbrojtësi i tij, ose Kryeprokurori i Shtetit) paraqet:

## KËRKESË PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Me kërkesë që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e plotfuqishëm, ose ta anulojë në tërësi aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë P. nr. _________/20___ dt. _________/20___, dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1. nr. _______/20____ dt. _________/20___ dhe çështjen ta kthejë në rivendosje te gjykata themelore.

Si dhe, me propozim që Gjykata Themelore në bazë të nenit 434 par. 4 të KPP-së të vendosë për shtyrjen e ekzekutimit të sanksionit penal të shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm deri në marrjen e vendimit sipas kësaj kërkese për mbrojtje të ligjshmërisë, e nëse këtë propozim nuk e aprovon Gjykata Themelore atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 435, par. 4 të KPP-së, të caktojë shtyrjen, përkatësisht ndërprerjen e ekzekutimit të sanksionit penal sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm, për të cilin është ushtruar kjo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

### Arsyetim

Sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P. nr. _________/20___ të dt. __________/20___, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit së Kosovës PA1. Nr. _____/20___ të dt. _____________, ndaj tani të pandehurit ________________________________, për shkak të veprës penale ______________________, është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej _____vjet.

Të dy aktgjykimet e përmendura më sipër, janë përfshirë në shkelje të Ligjit penal dhe me shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale, të parashikuara nga neni 384, par. 1 të këtij Kodi.

***Në vazhdim elaborohen pretendimet e ankuesit se në çka konsistojnë shkeljet e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.***

Prandaj, i pandehuri (ose mbrojtësi i tij), me rastin e ushtrimi të kësaj kërkese për mbrojtje të ligjshmërisë, i propozojnë Gjykatës Supreme të Kosovës që të marrë këtë:

**AKTGJYKIM**

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga i pandehuri (i dënuari) ______________________, dhe me aplikimin e nenit 438, par. 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të KPP-së, vendosi që të anulohen: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P. nr. __________/20___ i dt. ____________, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1. nr. _______/20__ i dt. ________/20___ dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë në rivendosje.

Prishtinë,
Dt.

**I pandehuri, ose mbrojtësi,**

__________________________

**Aktvendim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (Neni 514 par. 3 të KPP-së lidhur me nenin 88 dhe 89 të KP të RK-së)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**Departamenti i Përgjithshëm/Departamenti për Krime të Rënda**
**P. Nr. / PKR. Nr. _______/20__**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -** Departamenti për Krime të Rënda (ose Departamenti i Përgjithshëm) me Trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari, ____________________ - Kryetar i trupit dhe gjyqtarëve ____________________ e __________________ (ose vetëm gjyqtari individual) me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor _______________________ si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit _______________ nga Prishtina, për shkak të veprës penale: ____________________, nga neni ______ të KP të RK-së, sipas propozimit të paraqitur nga Prokurori i shtetit - Prokuroria Themelore në Prishtinë për shqiptimin e masës: Trajtim i detyrueshëm psikiatrik në _________________, lidhur me aktakuzën PP. nr. _____________ të dt. __________, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. _____________, në të cilin kanë qenë prezent përfaqësuesi i propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, prokurori i shtetit _______________________ i pandehuri dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare, avokati ____________________ nga Prishtina, të njëjtën ditë, mori kurse me dt. ____________ publikisht shpalli këtë:

**A K T V E N D I M**

Ndaj të pandehurit ___________________________, emri i babës: _______________, emnri i nënës:__________________, mbiemri i vajzërisë:____________________, i lindur në dt. _________në _____________, tani me vendbanim në ________________ (shënohen të dhënat tjera).

*Sepse,*
***(Shënohet dispozitivi i aktakuzës - përkatësisht përshkruhen veprimet e të pandehurit me të cilat është kryer vepra penale dhe për të cilët veprime shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik)***

- me këtë veprim, në gjendje të pa aftësisë mendore, ka kryer veprën penale _________________, nga neni ______________ të KP të RK-së,

në bazë të nenit 88 dhe 89, ose 90 të KP të RK-së, nenit 514, par. 3, nenit 515 dhe 516 të Kodit të Procedurës Penale i shqiptohet:

**MASA**
**TRAJTIM I DETYRUSHËM PSIKIATRIK**
**NË (LIRI ose ME NDALIM NË INSTITUCIONIN SHËNDETËSOR)**

I. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në (liri ose me ndalim në institucioni shëndetësor) për të pandehurin _________________________, nga ______________, do të bëhet në QSKUK-Klinika e Psikiatrisë, duke filluar nga data ______________.

II. OBLIGOHET i pandehuri që në dt. ______________, të paraqitet në Kliniken e Psikiatrisë të QSKUK, në Prishtinë që t'i nënshtrohet trajtimit psikiatrik, sipas rregullave të caktuara nga mjeku përkatës: neuropsikiatri dhe psikiatri.

III. QSKUK në Prishtinë, përkatësisht Klinika e Neuropsikiatrisë ËSHTË E OBLIGUAR që së paku 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj ta njoftojë këtë gjykatë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit të lartpërmendur.
***(në rastet kur shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm në liri aktvendimi përmban edhe këtë vërejtje:)***

IV. Në rast se i pandehuri _________________________, nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, kjo Gjykatë, sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të institucionit të kujdesit shëndetësor do ta zëvendësojë këtë masë me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim.

V. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga shpenzimet publike.

**A r s y e t i m**

Prokurori i shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, sipas aktakuzës PP. nr. ___________________ të dt. ______________, e kishte akuzuar tani të pandehurin ________________________________________, nga Prishtina për shkak të veprës penale ________________________________________ nga neni _____ të KP të RK-së, të kryer në dëm të dëmtuarit/ës nga Prishtina.

Në shqyrtimin kryesor publik, të filluar me dt. ____________, kjo gjykatë ka urdhëruar ekspertimin psikiatrik të të pandehurit, për shkak se që në fillim të leximit të aktakuzës i njëjti ka shfaqur shenja të qarta të çrregullimeve psikike.

QSKUK në Prishtinë, përkatësisht Klinika e Psikiatrisë-Reparti i psikiatrisë forenzike në raportin për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin ___________________, të prezantuar me dt. ____________ me nr. ______, ka konstatuar se tani i akuzuari për veprimet e tij, ka aftësi (llogaritshmëri) esencialisht të dëmtuar dhe i ka propozuar Gjykatës që ndaj të njëjtit të caktohet masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri (*ose me ndalim*). Ky konstatim dhe propozim për masën që duhet shqiptuar është dhënë nga mjeku ekspert, Dr. _________________________.

Pas pranimit të konstatimit mbi gjendjen e shëndetit mendor për tani të pandehurin dhe të propozimit për caktimin e masës së trajtimit psikiatrik të detyruar përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. ____________ ka

ushtruar propozim për shqiptimin e masës së sigurisë - trajtim i detyrueshëm psikiatrik, për tani të akuzuar.

Kjo gjykatë, konform nenit 88, nenit 89 dhe 90 të KP të RK-së dhe nenit 514 të KPP-së saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë, vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij.

***Në vazhdim të arsyetimit prezantohen provat dhe të gjitha të gjeturat e gjykatës mbi bazën e të cilave gjykata shqiptoi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.***

Për sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**
**PKR. nr. (ose P. nr.)__________/20____**
**dt. __________ 20___**

**Procesmbajtës,** **Gjyqtari,**

_________________________ _________________________

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në afatin prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.
Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, Gjykata duhet të vendosë në bazë të nenit 516 të KPP-së, mbi privimin nga zotësia për veprim, për tani të akuzuarin. Lidhur me këtë vendim, duhet të njoftohet Qendra për punë sociale në Prishtinë.

**T'i dërgohet:**
- PTH në Prishtinë,
- Të pandehurit,
- QSKUK-Klinikës së Neuropsikiatrisë në Prishtinë,
- Qendrës për punë sociale në Prishtinë.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Prokuroria Themelore në ___________ / Osnovno Tužilaštvo u ______________/**
**Basic Prosecution Office _____________**

PPM.nr.______
Në ______________,
Më datë ____________

Pas shqyrtimit të kërkesës së Policisë së Kosovës – Drejtoria __________________, në ___________, referenca ___________, të datës _____________, dhe materialeve tjera që i janë bashkangjitur kësaj kërkese, si dhe në pajtim me nenin _____________, të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDP), nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**
**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËRGATITORE**

Ndaj të miturit: _____________________________ (shënimet personale të të miturit)

**S E P S E**

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se ________________(te përshkruhet gjendja faktike duke përfshirë kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale

- me këtë veprim kishte (ka) për të kryer veprën penale ________________, nga neni ________________, të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Policia e Kosovës – Drejtoria __________________, në _________________, më datën ______________, i ka paraqitur kësaj prokurorie, kërkesën për fillimin e procedurës përgatitore me numër të referencës _________________, ndaj të miturit ________________, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprën penale __________, nga neni ________________, i Kodit Penal të Republikës se Kosovës (KPRK).

Kërkesës për fillimin e procedurës përgatitore i janë bashkangjitur edhe: ___________ ____________________________________________________________________.

Nga provat e Policisë, që i janë bashkangjitur kallëzimit penal, rezulton dyshimi i arsyeshëm se i mituri ____________________ më ______________________(shëno gjendjen faktike – kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe arsyeto dyshimin duke u bazuar në provat konkrete që janë në dispozicion).

Duke marrë parasysh provat e lartcekura, rezulton se janë plotësuar kushtet ligjore që në këtë çështje penale të zhvillohen procedura përgatitore, në mënyrë që të grumbullohen provat e nevojshme për të vendosur lidhur më ngritjen e propozimit për shqiptimin e dënimit me burg për të mitur (ose masës edukative) apo për pushimin e procedurës penale.

Në bazë të neneve ____________, dhe ____________, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, është vendosur si në vijim:

1) Të fillojë procedura përgatitore ndaj të miturit ____________________, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprën penale të përshkruar më lart.

2) Të dërgojë një kopje të vërtetuar të këtij vendimi te gjyqtari për të mitur në Gjykatën e Themelore në _________________.

3) Procedura përgatitore, sipas këtij aktvendimi, fillon prej datës ____________.

**Prokurori i shtetit**
**N.N.**
_____________________